

NARKOKRIMINALITETI NË KOSOVË DHE NË SHQIPËRI **(Apsekte juridiko-penale dhe kriminologjike)**

Doktoranti: RIDVAN KAJTAZI

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Juridike, me profil “E drejtë Publike”, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Vasilika Hysi

Numri i fjalëve: 64.440

Tiranë, 10 qershor 2016

DEKLARATË E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim me titull: **“Narkokriminaliteti në Kosovë dhe në Shqipëri (Aspekte juridiko-penale dhe kriminologjike)”** është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Tiranë,
Qershor 2016

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi
Ridvan Kajtazi

Tiranë, 2016

ABSTRAKT

Narkokriminaliteti paraqet një dukuri të jashtëligjshme dhe të rrezikshme mjaft të përhapur në mbarë rruzullin tokësor. Prodhimi dhe trafikimi i drogave, së bashku me trafikimin e qenieve njerëzore, me kontrabandën, me krimin ekonomik dhe me pastrimin e parave, është bërë sot një nga aktivitetet ilegale më fitimprurëse të krimit të organizuar. Përdorimi i narkotikëve dhe i substancave psikotrope po u sjellin mjaft dëme shoqërisë, në përgjithësi e, në veçanti, moshave të reja.

Në epokën e sotme të globalizmit, me shtimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe të mallrave, narkokriminaliteti ka marrë një hov të madh dhe mund të thuhet se paraqet një ndër llojet më të përhapura të kriminalitetit. Ai ka prekur shoqëritë e shumë vendeve, natyrisht, edhe shoqërinë kosovare dhe atë shqiptare, ndaj, në mënyrë të pashmangshme, ka lindur nevoja e zhvillimit dhe e intensifikimit të luftës për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie në Kosovë dhe në Shqipëri. Zhvillimit me sukses dhe në mënyrë efikase të kësaj lufte, i ndihmojnë edhe hulumtimet, analizat, studimet dhe botimet rreth kësaj dukurie.

Me këtë synim është ndërmarrë edhe ky punim doktore. Për të krijuar një pasqyrë të shtrirjes së kësaj dukurie në Shqipëri dhe në Kosovë dhe të problematikave që nxjerr ajo për strukturat e zbatimit të ligjit dhe në fushën e legjislacionit, studiuam literaturë, kode dhe akte ligjore, kombëtare e ndërkombëtare, si edhe hulumtuam në terren fenomenin. U kontaktuan dhe u anketuan tri grupe përfaqësuese, nxënës të shkollave të mesme në Shqipëri dhe Kosovë; të dënuar dhe të paraburgosur, persona që kanë përdorur dhe përdorin narkotikë. Përmes analizës së të dhënave empirike të grumbulluara nga ky

hulumtim në terren dhe trajtimin juridiko-penal të problemit, kemi mundur të vërtetojmë hipotezat e ngritura dhe t'u përgjigjemi pyetjeve kërkimore të studimit.

Fjalë kyçe: *Narkokriminalitet, trafikim, drogë, narkomani, substanca narkotike, psikotrope, Kosovë, Shqipëri, legjislacion penal, sanksion penal.*

ABSTRACT

Drug-crime represents the most illegal and dangerous and quite spread phenomenon around the globe. Produce and trafficking of drugs along with trafficking of human beings, smuggling, economic crimes and money laundry, nowadays became one of the most illegal and profitable activities of the organized crime.

In the recent era of globalization, along with the rise of the freedom of movement of people and goods, drug- crime has taken a great burst of development and it can be said that it represents one of the most widespread types of crime. It has touched societies of a lot of countries, and of course the Kosovar and Albanian societies as well, therefore it was unavoidable to raise a need to develop and intensify the need for preventing and fighting of this phenomenon in Kosovo and Albania. For the successful and efficient development of this fight, also help the researches, analyses, studies and publications regarding this phenomenon.

This was the aim of this doctoral paper. In order to have a view of the extend of this phenomenon in Albania and Kosovo and the problems arising from it for the structures of law enforcement and in the field of legislation, we have studied literature, codes and legal acts, national and international, as well as we have studied the phenomenon in the field. Three representative groups were contacted and interviewed, students of secondary schools in Albania and Kosovo; convicted and detained persons, and persons who are using and who used drugs. Through analysis of empirical data collected from this research in the field and juridical-criminal treatment of the problem we have been able to prove the raised hypothesis and to answer to the research questions of the study.

Key words: Drug-crime, trafficking, drug, drug addiction, narcotics substances, psychotropic, Kosovo, Albania, criminal legislation, criminal sanction.

FALËNDERIME

Puna për realizimin e kësaj doktrature u bë e mundur edhe në sajë të ndihmës së shumë personave, që më kanë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme që nga përcaktimi dhe strukturimi i temës, në gjetjen e literaturës bazë, ashtu edhe gjatë punës sime kërkimore dhe sidomos gjatë trajtimit të temës.

I falënderoj të gjithë ata që më përkrahën dhe më mbështetën në këtë angazhim timin.

Në radhë të parë, një falënderim të posaçëm meriton udhëheqësi im shkencor, prof. dr. Vasilika Hysi, e cila, që në fazat e para të konceptimit të temës, të strukturimit të saj dhe grumbullimit të literaturës, më është gjetur pranë me gatishmërinë dhe profesionalizmin, me udhëzime dhe këshilla konstruktive, duke më ndihmuar në aspektin shkencor që punimi të jetë sa më afër standardeve të kërkuara.

Falënderoj, pedagogët, kolegët e punës dhe miqtë që më kanë inkurajuar gjatë gjithë kohës në këtë punë timen kërkimore-shkencore.

Një falënderim i veçantë nga zemra shkon për familjen time, për prindërit e mi, për gruan time dhe fëmijët e mi, Ajanin dhe Matinin, për motrën dhe dy vëllezërit, për mbështetjen dhe përkrahjen që më kanë dhënë, duke më qëndruar pranë gjatë studimeve të doktoraturës, prandaj dhe meritojnë respekt dhe mirënjohje të thellë.

Ridvan Kajtazi

Tiranë, qershor 2016

PËRMBAJTJA

DEKLARATË E AUTORËSISË.....	II
ABSTRAKT	III
ABSTRACT	V
FALËNDERIME	VII
PËRMBAJTJA	VIII
LISTA E FIGURAVE	XV
LISTA E SHKURTIMEVE	XVII
KREU I: HYRJE	18
1.1. Shtrimi i problemit	18
1.2. Qëllimi i studimit	23
1.3. Rëndësia e studimit	24
1.4. Hipotezat e punimit.....	25
1.5. Pyetjet kërkimore të punimit.....	26
1.6. Metodologjia dhe metodat e kërkimit	26
1.7. Mundësitë dhe kufizimet.....	29
1.8. Struktura e punimit	30
KREU II: HISTORIKU I SUBSTANCAVE NARKOTIKE DHE I NARKOKRIMINALITETIT	33
2.1. Vështrim i shkurtër historik	33
2.2. Historiku i narkokriminalitetit në Shqipëri dhe në Kosovë	35
2.3. Përkufizimi i narkokriminalitetit	37
2.4. Përkufizimi dhe klasifikimi i narkotikëve.....	38
Stimulantët.....	40
<i>Kokaina</i>	<i>41</i>
<i>Kraku (CRACK)</i>	<i>42</i>
<i>Ekstazi (MDMA).....</i>	<i>42</i>
<i>Metamfetamina (methamphetamin, amphetamin)</i>	<i>43</i>

<i>Khati</i>	43
Haluçinogjenët	44
<i>Marihuana (Canabis Sativa L)</i>	45
<i>Hashashi</i>	45
<i>Vaji i hashashit (Hash Oil)</i>	45
<i>LSD (Lyser Saure Diethylamide)</i>	46
Depresantët	46
<i>Papaver Somniferum, opiumi</i>	47
<i>Morfina</i>	47
<i>Heroina</i>	48
Barbituratet	49
2.5. Përkufizimi dhe llojet e substancave psikotrope.....	49
KREU III: ASPEKTE JURIDIKO-PENALE TË VEPRAVE PENALE NË FUSHËN E NARKOKRIMINALITETIT NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË	51
3.1. Historiku i zhvillimit të legjislacionit penal në Shqipëri	51
3.2. Kodi penal i mbretërisë së Zogut	52
3.3. Kodi penal i vitit 1952	56
3.4. Kodi penal i vitit 1977	58
3.5. Legjislacioni penal pas vitit 1990	59
Ndryshimet dhe përmirësimet e tjera në Kodin Penal	62
3.6. Veprat penale në fushën e narkokriminalitetit në Kodin penal të ndryshuar	71
Prodhimi dhe shitja e narkotikëve (Neni 283)	72
Trafikimi i narkotikëve (Neni 283/a).....	78
Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës (Neni 283/b)	82
Kultivimi i bimëve narkotike (Neni 284)	83
Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale (Neni 284/a)	85
Ndihma në zbulimin e krimeve (Neni 284/b)	87
Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope (Neni 284/c)	88

Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve (Neni 284/ç).....	89
Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike (Neni 285)	90
Përshtatja e lokalit për përdorim droge (Neni 285/a)	91
Hedhja ose braktisja e shiringave (Neni 285/b).....	92
Nxitja për përdorimin e drogës (Neni 286).....	92
Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë (Neni 286/a)	93
3.7. Veprat penale në fushën e narkokriminalitetit sipas Kodit penal të Kosovës	94
3.8. Ligji penal i Kosovës i vitit 1977	95
Prodhimi i paautorizuar dhe vënia në qarkullim e narkotikëve (Neni 245)	96
Mundësimi i përdorimit të narkotikëve (Neni 246)	97
3.9. Legjislacioni penal në Kosovë pas vitit 1999	99
3.10. Veprat penale në fushën e narkokriminalitetit sipas Kodit penal të vitit 2004	101
Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope (Neni 229)	101
Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotrope (Neni 230)	103
Lehtësimi i sigurimit a i përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo i analogëve të rrezikshëm (Neni 231)	105
3.11. Veprat penale në fushën e narkokriminalitetit sipas Kodit penal të vitit 2013	107
Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge (Neni 273)	107
Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike (Neni 274)	110
Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge (Neni 275).....	112
Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope (Neni 276)	114

Lehtësimi i sigurimit apo i përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge (Neni 277)	115
Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit (Neni 278)	117
Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope (Neni 279).....	118
Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull (Neni 280)	120
Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky kapitull (Neni 281)	121
Kompensimi ndaj zbatuesve të ligjit (Neni 282)	122
KREU IV: ASPEKTE FENOMENOLOGJIKE TË NARKOKRIMINALITETIT NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË.....	124
4.1. Fenomenologjia e narkokriminalitetit në Shqipëri dhe në Kosovë	126
Vëllimi dhe struktura e narkokriminalitetit	126
Tendenca e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit sipas analizës së të dhënave	128
4.2. Analizimi i të dhënave të Policisë lidhur me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit	128
4.3. Analizimi i të dhënave të Prokurorisë lidhur me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit	135
4.4. Analizimi i të dhënave për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit dhe për autorët e tyre	137
Vendi i kryerjes së veprave penale	139
Koha e kryerjes së veprave penale.....	140
Karakteristikat personale të autorëve të veprave penale.....	144
Mosha e autorëve të krimeve	145
Gjinia e autorëve të krimeve	149
Përkatësia etnike e autorëve të veprave penale	150

Pozita sociale dhe narkokriminaliteti	151
Arsimi dhe narkokriminaliteti	152
KREU V: ASPEKTE ETIOLOGJIKE DHE ÇËSHTJE TË NARKOKRIMINALITETIT NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË	155
5.1. Faktorët e jashtëm të narkokriminalitetit	155
Industrializimi, urbanizmi dhe narkokriminaliteti	156
Emigracioni dhe narkokriminaliteti	159
Varfëria dhe narkokriminaliteti	161
Lufta dhe narkokriminaliteti	162
Arsimimi dhe narkokriminaliteti	164
Familja dhe narkokriminaliteti	166
Mjedi shoqëror si faktor kriminogjen	168
Narkomania, dukuri e përhapur te rinia	170
5.2. Faktorët e brendshëm të narkokriminalitetit	175
Karakteri	175
Temperamenti	177
Inteligjenca	177
Emocionet	178
Motivet	178
Çrregullimet mendore	180
5.3. Parandalimi i narkokriminalitetit	180
Roli i legjislacionit penal në parandalimin e narkokriminalitetit	183
Policia dhe parandalimi i narkokriminalitetit	186
Roli i doganës në parandalimin e narkokriminalitetit	191
Shërbimet e inteligjencës dhe parandalimi i narkokriminalitetit	195
Roli i gjyqësorit në parandalimin e narkokriminalitetit	196
Institucionet e vuajtjes së dënimit dhe narkokriminaliteti	201
Roli i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në luftimin e narkokriminalitetit ..	203

KREU VI: REZULTATET E PËRFTUARA NË ANKETIMET E BËRA NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË.....	206
6.1. Vështrim hyrës.....	206
6.2. Analizimi i të dhënave nga anketimi i nxënësve të shkollave të mesme, në Shqipëri dhe në Kosovë	209
6.3. Analizimi i të dhënave nga anketimi i personave të dënuar ose të paraburgosur për vepra penale në fushën e narkokriminalitetit në Shqipëri dhe në Kosovë	216
6.4. Analizimi i të dhënave nga anketimi i personave përdorues të drogave, në Shqipëri dhe në Kosovë	221
KREU VII: VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT PENAL TË DISA VENDEVE NË FUSHËN E NARKOKRIMINALITETIT	228
7.1. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Maqedonisë	229
7.2. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Malit të Zi	232
7.3. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Bosnjë dhe Hercegovinës	235
7.4. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Serbisë	238
7.5. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Gjermanisë	241
7.6. Aspekte krahasuese të legjislacionit penal të vendeve të përmendura më sipër	246
KREU VIII: ASPEKTI LIGJOR NDËRKOMBËTAR I RREGULLIMIT TË NARKOKRIMINALITETIT	250
8.1. Zanafilla e kontrollit ndërkombëtar të drogave dhe zhvillimi i konventave ndërkombëtare për kontrollimin e narkokriminalitetit.....	250
8.2. Përshkrim i shkurtër i Konventave dhe akteve të para ndërkombëtare	253
Konferenca e Shangait.....	253
Konventa ndërkombëtare e Hagës për opiumin	254
Konventa e Gjenevës për opiumin	254
<i>Procesverbali protokollar i Lejk Sakseasu</i>	255
<i>Protokolli i Parisit</i>	255

<i>Protokolli i Nju-Jorkut për opiumin</i>	<i>255</i>
8.3. Konventa Unike mbi drogat narkotike	256
8.4. Konventa mbi substancat psikotrope	258
8.5. Konventa kundër trafikut të paligjshëm të drogave dhe substancave psikotrope	260
8.6. Aderimi i Republikës së Shqipërisë në konventat ndërkombëtare	262
KREU IX: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	264
9.1. Përfundime	264
9.2. Përfundimet lidhur me hipotezat e punimit daktoral	270
9.3. Rekomandimet	273
LISTA E REFERENCAVE/BIBLOGRAFIA.....	277
LITERATURË.....	277
BURIMET PARËSORE:	282
KODE DHE LIGJE	283
VENDIME TË GJYKATAVE.....	286
BURIMET DYTËSORE, RAPORTE:.....	287
ARTIKUJ NGA MEDIA ELEKTRONIKE DHE TË SHKRUAR:	294
SHTOJCË	295
Pyetësi për nxënësit e shkollave të mesme	295
Pyetësi për të dënuarit dhe paraburgosurit.....	302
Intervista gjysmë e strukturuar.....	308
Shënime	310

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Rrugët kryesore që përshkon droga nga vendet e origjinës Pakistan, Afganistan etj., përmes Turqisë, hyn në Ballkan dhe shkon në vendet e destinacionit në Europë	20
Figura 2: Numri i rasteve të evidencuara dhe të zbuluara të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit në Shqipëri, për periudhën 2005-2015.....	129
Figura 3: Numri i rasteve të evidencuara për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit	130
Figura 4: Numri i autorëve të dyshuar në Shqipëri për periudhën 2005–2015	131
Figura 5: Numri i autorëve të dyshuar në Kosovë për periudhën 2005–2015	132
Figura 6: Sasia në kilogramë e substancave narkotike të sekuestruara në vitet 2005-2015 në Shqipëri.	133
Figura 7: Sasia në kilogramë e substancave narkotike të sekuestruara gjatë viteve 2005 - 2015 në Kosovë.	133
Figura 8: Numri i procedimeve të pranura nga Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë për periudhën 2009-2015.	135
Figura 9: Numri i procedimeve penale për veprat penale nga nenet 283, 283/a dhe 284 për periudhën 2005-2015.	136
Figura 10: Çështje të gjykuara në Shqipëri për veprat penale në fushën e drogave për periudhën 2005-2014.....	138
Figura 11: Numri i rasteve sipas vendit të kryerjes së veprës në Kosovë për periudhën 2005-2015.	139
Figura 12: Koha e kryerjes së veprave penale në fushën e narkokriminalitetit 2005-2015	141
Figura 13: Numri i veprave penale të konsumuara në Kosovë sipas muajve të vitit për periudhën 2005-2015	142
Figura 14: Numri i autorëve të gjykuar sipas veprave penale të narkokriminalitetit në Shqipëri për periudhën 2005-2014.	143
Figura 15: Të dënuarit në Kosovë, sipas veprave penale në fushën e narkokriminalitetit, 2005-2015.	144
Figura 16: Mosha e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e narkotikëve në Shqipëri	147

Figura 17: Moshë e personave të dyshuar në Kosovë për veprat penale në fushën e drogave për periudhën 2005-2015	148
Figura 18: Niveli arsimor i personave të dyshuar për veprat penale në fushën e drogave në Shqipëri për periudhën 2005-2015	152
Figura 19: Niveli arsimor i personave të dyshuar për veprat penale në fushën e drogave në Kosovë për periudhën 2005-2015	153
Figura 20: Numri i përdoruesve të trajtuar në ‘Aksion Plus’, Shqipëri, sipas gjinisë dhe grup moshave.	172
Figura 21: Numri i përdoruesve të trajtuar, sipas grup-moshës dhe gjinisë eksperimentimit të parë të drogës.....	172
Figura 22: Të dhëna lidhur me numrin e të trajtuarve në OJQ ‘Labyrinth’ në Kosovë për periudhën 2002-2014.	173
Figura 23: Të dhëna empirike nga personat që janë rehabilituar në OJQ ‘Labyrinth’ për periudhën 2002-2014.	174
Figura 24: Sanksionet e shqiptuara për veprat penale të narkokriminalitetit nga gjykatat në Shqipëri, për periudhën 2005-2014.	199
Figura 25: Sanksionet penale që u janë shqiptuar autorëve të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit në Kosovë, në periudhën 2005-2015.....	200

LISTA E SHKURTIMEVE

AKI	(Agjencia e Kosovës për Inteligjencë)
BE	(Bashkimi European)
DK	(Dogana e Kosovës)
DPB	(Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve)
DSH	(Dogana e Shqipërisë)
EMCDDA	(Qendra Europiane për Monitorimin e Drogave dhe Drogë-varësinë)
EUROPOL	(Organizata Europiane e Policisë)
FSK	(Forca e Sigurisë së Kosovës)
INTERPOL	(Organizata Ndërkombëtare e Policisë)
KGJK	(Këshilli Gjyqësor i Kosovës)
KIPRED	(Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave)
KPK	(Kodi Penal i Kosovës)
KPPK	(Kodi i Procedurës Penale i Kosovës)
KPPSH	(Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë)
KPSH	(Kodi Penal i Shqipërisë)
MPB	(Ministria e Punëve të Brendshme)
MSH	(Ministria e Shëndetësisë)
OKB	(Organizata e Kombeve të Bashkuara)
OSBE	(Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim European)
PK	(Policia e Kosovës)
PP	(Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë)
PSH	(Policia e Shtetit)
PSHK	(Prokuroria e Shtetit në Kosovë)
SIPK	(Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës)
SHBA	(Shtetet e Bashkuara të Amerikës)
SHISH	(Shërbimi Informativ i Shtetit)
UNDOC	(Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin)

KREU I: HYRJE

1.1. Shtrimi i problemit

Historikisht, substancat narkotike dhe psikotrope janë përdorur që në kohë të hershme nga njerëzimi. Me kohë, prodhimi dhe përdorimi i tyre, për dëmet që sillnin në shëndetin dhe në jetën e njerëzve, filluan të konsiderohen të jashtëligjshme. Por edhe në këto kushte, veprimtaritë kriminale në këtë fushë, nuk janë ndalur, por janë zgjeruar, madje, duke kapërcyer edhe kufijt e shteteve. Narkokriminaliteti ka marrë karakter transnacional dhe kryhet jo vetëm nga individë, por edhe nga grupe dhe organizata të caktuara kriminale.

Narkotikët paraqesin vlerë materiale e monetare, ndaj edhe krimi i organizuar, por edhe organizata terroriste, përfshihen në veprimtari kriminale të lidhura me drogat, duke prodhuar e qarkulluar me mijëra tonë lëndë narkotike në vit. Nga tregtia e palejueshme e saj, përfitohen qindra milionë dollarë. Pra, narkokriminaliteti, përveç dëmeve të mëdha në shoqëri, në jetën e njerëzve, paraqet edhe një sferë të interesit ekonomik. Ndaj ka marrë përmasa të rrezikshme. Prodhimi i palejuar, përpunimi dhe tregtia (shitja dhe blerja) e drogave dehëse paraqet aktivitet të rrezikshëm shoqëror, për të cilin mendohet se ka karakter ndërkombëtar (Milutinoviç,1981:439).

Edhe rajoni ynë, Gadishulli Ballkanik, është përfshirë dhe infektuar rëndë nga kjo dukuri, saqë konsiderohet portë hyrëse e krimit të organizuar për në Europën Perëndimore. Në Kosovë dhe në Shqipëri, drogat dhe krimet që lidhen me to janë bërë të pranishme sidomos në vitet '90. Me hapjen e shoqërisë, me rritjen e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe të mallrave, trafikimi dhe përdorimi i narkotikëve, prodhimi e përpunimi i tyre kanë ardhur në

rritje. Shkëputja e Shqipërisë nga regjimi komunist, tranzicioni i stërzgatur, trazirat dhe mungesa e rendit ndikuan dukshëm që elementë të prirur ndaj krimit të merren me drogat, për t'u pasuruar. Pozita gjeografike e Shqipërisë favorizon kultivimin e drogës dhe trafikimin e saj nga Lindja për në Perëndim (Hysi,2010:148-413).

E ndodhur mes Lindjes dhe Perëndimit, Shqipëria gjendet, tashmë, në të ashtuquajturën “Rruga ballkanike” të trafikimit të drogës për në Europën Perëndimore, duke u bërë një vend tranzitimi dhe vend ku kultivohet dhe prodhohet drogë.


Edhe Kosova, pas luftës, për shkak të brishtësisë së institucioneve të sigurisë, të kontrollit dhe të mbikëqyrjes jo të mirë të kufirit, u kthye në vend tranziti narkotikësh dhe burim furnizimi me to i vendeve të Europës Perëndimore. Zbulimi me sukses i kontrabandimit, ndërprerja e kanaleve të kontrabandës me konfiskimin e drogës dhe me zbulimin e sa më shumë personave nga hierarkia e organizatës kriminale, nënkupton njohjen e mirë paraprake të rrugëve dhe mënyrave të transportit ilegal të drogës nga vendi i prodhimit te tregu i caktuar (Korajliç&Muharremi,2009:386).

Tani, mund të themi se janë tri rrugë, që përdoren për trafikimin e lëndëve narkotike nga vendet e origjinës, në Europë:

Rruga jugore: Afganistan→Pakistan/Iran→Turqi→Bullgari→Republika e Maqedonisë →**Kosovë** ose **Shqipëri**→Itali.

Rruga qendrore: Afganistan→Pakistan/Iran→Turqi→Bullgari→Republika e Maqedonisë ose Serbi→Bosnjë dhe Hercegovinë→Kroaci→Slloveni→Itali.

Rruga veriore: Afganistan→Pakistan/Iran→Turqi→Bullgari→Rumani→Hungari ose Ukrainë→Sllovakia ose Poloni→Austri apo Gjermani (UNDOC,2008: 6-15).



Burimi: UNDOC

Figura 1: Rugët kryesore që përshkon droga nga vendet e origjinës Pakistan, Afganistan etj., përmes Turqisë, hyn në Ballkan dhe shkon në vendet e destinacionit në Europë

Shfrytëzimi i vendeve të Ballkanit për trafikimin e drogës nuk bëhet vetëm prej pozitës së përshatshme gjeografike të tyre, por edhe prej nivelit të ulët profesional të shërbimit policor dhe të doganave, mundësive për korrupsionin e zyrtarëve shtetërorë, si edhe prej dobësive të politikës së procedimit dhe dënimit të këtyre veprave penale në këto vende.

Në këto kushte, në Shqipëri dhe Kosovë u krijuan dhe gjetën terren grupe kriminale të organizuara, me përbërje etnike kryesisht shqiptare, pa përjashtuar bashkëpunimin me grupeve të huaja kriminale. Sipas një raporti të Kombeve të Bashkuara, të vitit 2015, Shqipëria, dhe Argjentina, u paraqitën si vende të origjinës apo vende tranzite të kanabisit në pesë vitet e fundit, duke konfirmuar se kultivimi dhe prodhimi i kanabisit është i

përhapur gjerësisht dhe se rrugët e trafikimit mund të ndryshojnë vazhdimisht (UNDOC,2015:39). Ndërsa nga burime europiane theksohej se “grupet etnike shqiptare të krimit të organizuar janë ndër kërcënimet kryesore të Bashkimit European”. Ata veprojnë, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë shtetit, në bashkëpunim me organizatat kriminale vendase. Nga viti 2000 deri në vitin 2006, për trafikim heroine, në Itali janë arrestuar 1.925 shqiptarë dhe, siç vë në dukje UNDOC, numri i personave të arrestuar me origjinë shqiptare për trafikimin e heroinës mbetet i konsiderueshëm (UNDOC,2008:6-15).

Në Kosovë dhe në radhët e shqiptarëve në Maqedoni, në Malin e Zi dhe në Luginën e Preshevës, ka pasur rritje të ndjeshme të narkokriminalitetit. Grupe shtetasish me kombësi shqiptare në këto vende e zgjeruan dhe e sofistikuan aktivitetin e tyre kriminal në këtë fushë. Këto grupe me strukturë përgjithësisht horizontale, brenda së cilës njihet vetëm një drejtues, për të afirmuar pushtetin e tyre, përdorin edhe metodën e ngjalljes së frikës e të terrorit. Kështu, ato kanë arritur të zotërojnë trafikun e narkotikëve për në Gjermani, Zvicër, Austri etj. Siç shprehet Pietro, grupet kriminale shqiptare (duke nënkuptuar se këta persona u përkasin etnive të ndryshme që kanë fituar shtetësinë shqiptare, apo shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi), përbëhen nga persona me prejardhje nga të njëjtat qytete, lagje, ose/dhe familje (Pietro,2007:58-89).

Grupet kriminale shqiptare veprojnë kryesisht në Europën Perëndimore, por aktivitetet e tyre i zhvillojnë në Gadishullin Ballkanik dhe janë të njohur për aktivitetin e tyre të veçantë kriminal në fushën e trafikimit të narkotikëve (Wegner&et al,2004:143-144). Grupet shqiptare në përgjithësi furnizohen (blejnë) narkotikë nga shitësit me shumicë në Turqi edhe vazhdojnë t'i shpërndajnë dërgesat e mëdha të heroinës përgjatë gjithë rrugëve ballkanike deri në tregjet e destinacionit (UNDOC,2014:37-108).

Sipas një raporti të Drejtorisë së Hetimit Antimafia në Itali, për periudhën qershor-dhjetor 2014, konstatohet se grupet kriminale shqiptare, burim kryesor të fitime kanë trafiket e paligjshme me lëndë narkotike, janë të gatshme të hyjnë në shkëmbime ndërkombëtare dhe operojnë në zona të ndryshme të botës. Mundësia për ta shfrytëzuar mbështetjen logjistike në territorin e origjinës, ua ka mundësuar që të fitojnë një rol kryesor në trafikun e drogës, aq sa të bëhen ndërmjetës të privilegjuar të bashkëpunimeve mes organizatave italiane dhe atyre të huaja (DIA,2014:116-230). Meqenëse në kontrabandën me narkotikë janë përfshirë shumë grupe dhe organizata, prodhuesit e kokainës ballafaqohen me ngopjen e disa tregjeve më të furnizuara, kështu që me padurim presin krijimin e tregjeve europiane, heqjen dhe liberalizimin e kufijve (Vula,2011:47).

Grupet e ndryshme kosovare dhe, përgjithësisht, ato shqiptare të angazhuara në trafikimin ndërkombëtar të drogës kanë arritur të fitojnë një autonomi të gjerë veprimi (pavarësi nga grupet kriminale vendore), në numrin më të madh të shteteve ku veprojnë. Kjo veprimtari e rritur e grupeve shqiptare të krimit të organizuar në disa rrugë kyçe në Ballkan, si dhe në vende të destinimit të drogës, i bën këto grupe si përfituese relativisht të rëndësishme (SOCTA,2015:9). Të dhënat më të reja tregojnë se grupet shqiptare të narkokriminalitetit nuk kufizohen me këtë lloj krimi, ato veprojnë edhe në fusha të tjera, si në ndërtim, në prostitucion, në vrasje dhe në zhvatje, marrje të parasë me shtrëngim, kërcënim etj.

Përpyekjet e vazhdueshme të shteteve dhe të organizatave të ndryshme për të luftuar narkokriminalitetin dhe dukurinë e narkomanisë në nivel botëror jo vetëm nuk janë ulur, por po shtohen dhe përsosen më tej. Këtyre përpyekjeve u janë bashkuar edhe Shqipëria dhe Kosova.

1.2. Qëllimi i studimit

Qëllimi i punimit të doktoraturës është, në radhë të parë, identifikimi dhe analiza e problematikave të narkokriminalitetit dhe të luftës kundër tij, në Shqipëri dhe në Kosovë, analizimi i legjislacionit penal, nxjerrja e problemeve dhe e vështirësive të agjencive ligjzbatuese të të dyja vendeve në përpjekjet e tyre për të parandaluar dhe luftuar këtë dukuri kriminale me karakter transnacional. Përmes kësaj analize synohet të jepet një kontribut për përmirësimin e politikave penale ndaj narkokriminalitetit dhe, njëkohësisht, për pasurimin e mendimit juridik e kriminologjik lidhur me narkokriminalitetin.

Duke evidencuar se prania e narkotikëve në shoqërinë tonë paraqet një shqetësim të madh, punimi synon të tërheqë vëmendjen për nevojën e përmirësimit të politikave shtetërore, të plan-programeve të veprimit, të mënyrave dhe të mjeteve për parandalimin dhe zvogëlimin e kësaj dukurie.

Nga ana tjetër, duke e shtrirë këtë hulumtim shkencor edhe në aspektin juridik, fenomenologjik, etiologjik dhe krahasues të legjislacionit mbi narkokriminalitetin me atë të vendeve të tjera fqinje, si Maqedonia, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovina, Serbia, të cilat ende nuk janë pjesë e BE-së dhe kanë kaluar, po ashtu, në një tranzicion politik, juridik, ekonomik, social etj., por edhe me atë të Gjermanisë, synohet që të nxjerrim ngjashmëritë dhe dallimet që ekzistojnë dhe të marrim përvojat e mira për ta përsosur legjislacionin tonë.

Përmes trajtimit të aspektit kriminologjik të narkokriminalitetit, përkatësisht, të faktorëve të jashtëm dhe atyre të brendshëm kriminogjenë, që ndikojnë në kryerjen e veprave penale në fushën e drogave, studimi synon të tërheqë vëmendjen për përmirësimin e punës dhe të rritjes së profesionalizmit të strukturave ligjzbatuese kombëtare për të shtuar

dhe përsosur aftësitë dhe metodat e tyre të luftës kundër narkokriminalitetit, jo vetëm brenda vendit, por edhe në rrafshin ndërkombëtar, përmes bashkëpunimit të frytshëm me shtetet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare.

Gjithashtu, synohet që kjo temë doktorature, përmes hulumtimit të bërë edhe në terren dhe analizave të të dhënave empirike të përfuara, të dalë me disa konkluzione dhe rekomandime, që mendojmë se do të jenë një ndihmesë për organet shtetërore në Shqipëri në Kosovë në zhvillimin me sukses të punës për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit.

Së fundi, një ndër synimet e realizimit të këtij punimi janë edhe që ai t'u vijë në ndihmë studentëve, pedagogëve, juristëve, sociologëve, organizatave të ndryshme dhe zyrtarëve që janë të interesuar dhe të angazhuar me trajtimin e problemeve të kësaj fushe.

1.3. Rëndësia e studimit

Narkokriminaliteti është trajtuar gjerësisht nga shumë autorë, ekspertë dhe profesorë vendorë ose ndërkombëtarë. Por kjo nuk e zbeh rëndësinë e këtij punimi doktorature, pasi, krahas trajtimit në aspektin e përgjithshëm, ai është i fokusuar në analizën e këtij fenomeni posaçërisht në Kosovë dhe në Shqipëri, që ndodhen në një pikë kyçe midis Lindjes dhe Perëndimit dhe cilësohen si vende tranzite dhe të origjinës së drogës. që ndodhet në një pikë kyçe midis Lindjes dhe Perëndimit, çka paraqet interes jo vetëm për studiuesit dhe strukturat shtetërore të dy vendeve tona, por edhe për studiuesit dhe organizmat ndërkombëtarë. Ato në këtë studim gjejnë të dhëna, fakte dhe opinione për shumë pyetje dhe hipoteza të ngritura nga institucione përgjegjëse rajonale ose

ndërkombëtare, që flasin për “grupe shqiptare” kriminale të rrezikshme edhe në fushën e narkokriminalitetit.

Rëndësia e punimit qëndron edhe në kontributin që jep ai në fushën e kërkimeve kriminologjike, pasi, me hulumtimin e këtij aspekti, ai plotëson mozaikun e studimeve të kësaj dukurie, e cila këtu analizohet në dy vende të rajonit të Ballkanit, që është shumë problematik në fushën e narkokriminalitetit.

1.4. Hipotezat e punimit

Shqipëria dhe Kosova, falë pozitës gjeografike dhe gjeopolitike në Gadishullin Ballkanik, paraqiten jo vetëm si vend tranziti, por edhe vende të origjinës së narkotikëve për në Europën Perëndimore. Hipotezat i kemi mbështetur në literaturë dhe në studimet e kryera rreth problemit të narkokriminalitetit në Kosovë dhe në Shqipëri.

Hipoteza 1 - Prania e substancave narkotike dhe substancave psikotrope në shkollat e mesme në Kosovë dhe në Shqipëri ndikon në qëndrimet e nxënësve, që mund të jenë faktorë kriminogjenë nxitës ose lehtësues për t’u futur në botën e krimit.

Hipoteza 2 - Politika e parandalimit dhe politika penale në Kosovë dhe Shqipëri nuk janë efektive dhe, për rrjedhojë, gjatë tranzicionit ato janë kthyer në vende dhe burim i rëndësishëm i tranzitimit të lëndëve narkotike në Europë.

Hipoteza 3 - Sistemi aktual i trajtimit dhe i rehabilitimit të përdoruesve të drogave në Kosovë dhe Shqipëri nuk është efikas.

1.5. Pyetjet kërkimore të punimit

Me hulumtimin e kësaj mikroteze të doktoratës do të arrihet në marrjen e përgjigjeve për pyetjet dhe hipotezat e ngritura. Duke u nisur nga tema e projektit, e kemi orientuar punimin mbi bazën e pesë pyetjeve kërkimore:

1. Ç'përcakton termi narkokriminalitet dhe sa është e përhapur kjo dukuri në Kosovë dhe në Shqipëri?

2. Sa efektiv është legjislacioni ynë i brendshëm lidhur me parandalimin dhe luftimin e veprave penale në fushën e drogave?

3. Pse vëllimi, struktura dhe tendenca e veprave penale në fushën e drogave në Kosovë dhe në Shqipëri kanë shënuar ngritje dhe cilët janë faktorët kriminogjenë që kanë ndikuar?

4. Cili është impakti i faktorëve ekonomikë në futjen e të rinjve në “biznesin” e drogave në vendin tonë?

5. A është legjislacioni i vendeve të Ballkanit Perëndimor i përafruar me normativën dhe me standardet ndërkombëtare?

1.6. Metodologjia dhe metodat e kërkimit

Metodologjia e përdorur në këtë punim është zgjedhur në përputhje me natyrën mjaft komplekse të dukurisë së narkokriminalitetit dhe të qëllimit që i kemi vënë vetes me këtë studim. Pasi përcaktuam objektin e studimit dhe qëllimin e tij, bëmë kërkimin dhe përzgjedhjen e literaturës së botuar, të legjislacionit përkatës dhe të studimeve të kryera në

këtë fushë, hartuam tezat e përgjithshme, skicën e planit strukturor të temës dhe përcaktuam teknikën e gjetjes së të dhënave empirike nga terreni. Pastaj nisi faza e mbledhjes së informacioneve përmbajtësore dhe e të dhënave statistikore nga institucionet gjyqësore dhe organet policore të të dyja vendeve, si dhe anketimi në terren, përmes pyetësorit dhe intervistave me grupet përfaqësuese që përzgjedhëm. Për të dhënat e mbledhura u ndoq metoda e paraqitjes nëpërmjet tabelave dhe e analizës së tyre.

Kjo metodologji e ndjekur dhe rezultatet e saj na krijuan mundësinë dhe bindjen për të kaluar në fazën më të rëndësishme, atë të hartimit të punimit. Gjatë kësaj faze, duke pasur edhe bashkëpunimin dhe ndihmën efikase të udhëheqësit shkencor, bëmë shtjellimin e temës, përpunuam dhe interpretuam të dhënat dhe rezultatet e përftuara lidhur me dukurinë që studiuam, iu përgjigjëm pyetjeve dhe hipotezave të studimit dhe natyrshëm u ndalëm në nxjerrjen e përfundimeve dhe të rekomandimeve.

Për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të punimit, zgjedhëm dhe përdorëm këto metoda:

Metoda historike – Na ka mundësuar që narkokriminaliteti të studiohet si një dukuri shoqërore dinamike, që ka lindur dhe vazhdon të jetë një e keqe e madhe, si pasojë e disa shkaqeve dhe kushteve shoqërore–ekonomike, politike etj., që zhvillohet, rritet e përhapet, në hapësirë dhe në kohë, duke përdorur forma, mjete dhe rrugë të ndryshme.

Metoda juridike – Është zbatuar përmes analizimit të zhvillimi juridiko-penal të legjislacionit penal, që lidhet me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit dhe me sanksionet ndaj tyre. Kjo metodë konsiston në trajtimin e problemeve bazuar në aket normative, juridike të brendshme dhe ndërkombëtare, gjë që ka ndihmuar për të kuptuar sesi bëhet rregullimi juridik i realizimit në praktikë të luftës kundër narkokriminalitetit.

Metoda statistikore - Duke qëmtuar të dhënat statistikore të mbledhura dhe të ofruara nga institucione të ndryshme të zbatimit të ligjit në Kosovë dhe në Shqipëri, përmes kësaj metode kemi bërë zbërthimin dhe përpunimin e tyre dhe kemi nxjerrë rezultatet dhe përfundime për çështje të caktuara të studimit.

Metoda e anketimit - Me anë të kësaj metode kemi arritur të mbledhim fakte, të dhëna, mendime dhe opinione shumë të rëndësishme, të cilat na shërbyen mjaft për hulumtimin e dukurisë së narkokriminalitetit. Sipas saj, arritëm të përgatisim dhe të realizojmë disa intervista me pyetësorë dhe me intervista gjysmë të strukturuar në disa shkolla të mesme; me të burgosur dhe me përdorues të substancave narkotike, në Shqipëri dhe në Kosovë.

Metoda e analizës – Analizën e fakteve dhe të të dhënave që lidhen me narkokriminalitetin e gjejmë gjatë gjithë punimit të doktoraturës. Por në mënyrë të spikatur kjo metodë është aplikuar në kapitullin që fokusohet në sjelljen, shqyrtimin dhe përpunimin analitik të të dhënave empirike të përfutuara përmes anketimit me pyetësorë dhe me intervista gjysmë të strukturuar, për të njohur praktikisht disa aspekte të narkokriminalitetit në terren dhe për të arritur në disa përfundime lidhur me to.

Metoda krahasuese – Duke ndjekur krahasimin e legjislacionit që rregullon narkokriminalitetin në Kosovë dhe në Shqipëri me legjislacionin e po kësaj fushe në vendet fqinje, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi, si dhe të Gjermanisë, kemi synuar të njohim përvojat e mira të legjislacionit të këtyre vendeve, me qëllim përmirësimin dhe përafrimin e legjislacionit tonë me to.

1.7. Mundësitë dhe kufizimet

Për hulumtimin e temës së doktoraturës na është mundësuar të sigurojmë, përveç literaturës së bollshme, edhe një sërë dokumentesh, kodesh, raportesh kombëtare dhe të organizatave ndërkombëtare. Në Shqipëri kemi siguruar raporte me të dhëna statistikore nga gjykatat deri në vitin 2014, të pasqyruara mjaft mirë në ueb sajtet e Ministrisë së Drejtësisë, nga Prokuroria, raporte të Policisë së Shqipërisë etj. Edhe në Kosovë kemi shfrytëzuar statistikën e siguruar nga Këshilli Gjyqësor, nga Policia etj.

Por kemi pasur edhe disa vështirësi dhe kufizime. Si të tilla mund të përmendim pamundësinë për të pasur qasje në dosjet dhe në informacionet rreth procedimeve penale për hulumtimin e rasteve individuale në Kosovë, për arsye të fshehtësisë zyrtare të këtyre procedimeve penale.

Edhe pse Policia e Kosovës na vuri në dispozicion mjaft të dhëna statistikore lidhur me veprat penale, shumë prej tyre nuk na shërbyen, madje, na e vështirësuan punën, pasi në mjaft raste për të njëjtat vepra penale ekzistonin të dhëna të ndryshme. Kufizim tjetër ka ardhur nga fakti se statistikën e siguruar nga Këshilli Gjyqësor në Kosovë ishin mjaft konfuze dhe të komplikuar, gjë që e vështirësoi shumë përdorimin e tyre me efektivitet.

Megjithë kërkesat tona të përsëritura të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit në Kosovë, ka qenë e pamundur të siguronim të dhëna statistikore rreth krimeve me lëndët narkotike dhe autorëve të tyre. Po ashtu, në Shqipëri na u refuzuar kërkesa për të siguruar të dhënat statistikore nga gjykatat për vitin 2015, gjë që na krijoi njëfarë vështirësie në shqyrtimin e problemit dhe në nxjerrjen e disa konkluzioneve.

1.8. Struktura e punimit

Ky punim doktore është strukturuar në nëntë kapituj, të ndarë në nënkapituj dhe seksione.

Kapitulli i parë përfshin vështrimin e problemit të narkokriminalitetit, të rrugëve që ndjek trafikimi i narkotikëve nga vendet e origjinës, në Ballkan dhe në vendet e destinacionit në Europë. Në të jepen qëllimi i studimit, rëndësia e tij, pyetjet kërkimore dhe hipotezat që duam të vërtetojmë, metodologjia dhe metodat që janë përdorur, mundësitë dhe kufizimet që patëm gjatë studimit dhe, në fund, struktura e tij.

Kapitulli i dytë sjell një historik të shkurtër të dukurisë së narkokriminalitetit dhe të narkotikëve. Gjithashtu, këtu merremi me përkufizimin e drogave dhe të dukurisë së kriminalitetit me to. Për të krijuar një ide se ç'janë substancat narkotike dhe ato psikotrope, dhe për pasojat që sjellin ato në këtë kapitull paraqitet klasifikimi dhe përshkrimi i tyre.

Kapitulli i tretë shtjellon aspekte juridiko-penale të narkokriminalitetit, duke u përqendruar në shikimin e legjislacionit penal në këtë fushë, në Shqipëri dhe në Kosovë, duke filluar me hapat e para të hartimit të tij dhe duke u ndalur në periudha të ndryshme e deri sot. Pjesa më e madhe e këtij kapitulli i kushtohet paraqitjes së veprave penale të narkokriminalitetit, si dhe të sanksioneve për to, të parashikuara në legjislacionin e Shqipërisë dhe të Kosovës.

Kapitulli i katërt u kushtohet aspekteve fenomenologjike të narkokriminalitetit në Shqipëri dhe në Kosovë, duke u përqendruar në vëllimin dhe strukturën tij, si dhe në tendencën që vihet re. Këto jepen në dritën e analizës që u bëhen të dhënave të Policisë, të

Prokurorisë dhe të Gjykatave në të dyja vendet, duke dhënë edhe karakteristikat e faktorëve që ndikojnë në kryerjen e veprave penale në këtë fushë.

Kapitulli i pestë merret me aspektet etiologjike të problemit që është në fokusin e studimit dhe me disa çështje themelore të punës për parandalimin e narkokriminalitetit në Kosovë dhe në Shqipëri. Këtu ndalemi te faktorët e jashtëm dhe të brendshëm, objektivë dhe subjektivë, që ndikojnë në kryerjen e veprave penale, si edhe në rolin legjislativ, të organeve të drejtësisë, të policisë për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit. Nuk është lënë jashtë vëmendjes edhe roli i bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë, si dhe roli që luajnë institucionet e kryerjes së dënimit dhe të rehabilitimit.

Kapitulli i gjashtë ka një tjetër natyrë. Ai merret me rezultatet që kemi nxjerrë nga anketimet e bëra në terren, në Shqipëri dhe në Kosovë, nëpërmjet intervistave me pyetësorë dhe intervistave të gjysmëstrukturuara. Gjithashtu, jepen dhe interpretohen përgjigjet e përftuara nga anketimet, të cilat paraqesin shumë interes, jo vetëm për studimin tonë, por edhe për strukturat e zbatimit të ligjit dhe për shoqërinë në tërësi.

Në kapitullin e shtatë, i kemi lënë vend vështrimit krahasues që u bëjmë veprave penale të narkokriminalitetit të përcaktuara në legjislativin e disa shteteve të Ballkanit, por edhe të një vendi europian, si Gjermania, që ka një legjislacion mjaft efikas në këtë fushë. Metoda e krahasimit e zbatuar, na jep mundësi të gjejmë ngjashmëritë dhe dallimet, përvojat e mira, që mund të shërbejnë edhe për ligjvënësit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit në Shqipëri dhe në Kosovë.

Kapitulli i tetë i kushtohet aspektit ligjor ndërkombëtar të rregullimit të çështjeve të narkokriminalitetit. Paraqitja e konventave, e akteve dhe e dokumenteve të tjera ndërkombëtare më të rëndësishme, që kanë të bëjnë me drogat dhe trafikimin e tyre, si dhe

me luftimin e krimit të organizuar në këtë fushë, shoqërohet edhe me komente rreth objektit që përmbajnë, si dhe rreth obligimeve që prodhojnë këto akte ndërkombëtare për çdo vend nënshkrues të tyre, siç është edhe Shqipëria.

Studimi mbyllet me *kapitullin e nëntë*, i cili përmban përfundimet dhe rekomandimet, që kemi mundur të hartojmë, si rezultat i shqyrtimit të temës dhe i analizave që bëhen në këtë punim.

Në fund të studimit jepet literatura e shfrytëzuar për hartimin e këtij punimi, si dhe skema e pyetësorëve të përdorur.

KREU II: HISTORIKU I SUBSTANCAVE NARKOTIKE DHE I NARKOKRIMINALITETIT

2.1. Vështrim i shkurtër historik

Substancat narkotike dhe ato psikotrope njihen qysh në kohët e vjetra, nga popuj të lashtë, si sumerët, që kanë jetuar në pjesën jugore të Mesopotamisë së Poshtme (Haley, 2009:72-92). Në farkopejt e perandorit kinez, Shen Nung, 2737 p.e.s., si ilaç kundër kollës dhe diarresë është përmendur hashashi (Arifi,2008:22-130). Tre mijë vjet para lindjes së Krishtit, inkasit e lashtë të Andeve përtypnin kokainë për të shtuar rrahjet e zemrës që të përballonin mungesën e ajrit në malet ku jetonin. Ndërsa peruanët vendas përtypnin kokainë gjatë ceremonive fetare. Kinezët e përmendin për herë të parë konsumimin e kanabisit para afro dyzet shekujsh, në Traktatin e botanikës kineze "Rhy-Ya" (Rosenthal,& Kubby,2003:17). Ata e kanë përdorur për qëllime terapeutike.

Në kontinentin europian njohuritë rreth përdorimit të narkotikëve kanë qenë shumë të pakta. Vetëm në fillim të shekullit XIII, në luftën e kryqëzatave, ushtarë të ndryshëm nga vendet e Lindjes së Mesme sollën në Europë opiumin (Haley,2009:72-92). Mendohet se preparatin e parë të opiumit e ka sintetizuar, gjatë shekullit XVI, i njohuri Paralecelsus, duke e emërtuar “gur i pavdekshëm”. Rreth vitit 1900 opiumi dhe morfina filluan të përdoreshin në kontinentin europian, amerikan dhe aziatik (Haley,2009:72-92). Në vitin 1805, farmacisti Sertuner arriti të veçojë një pjesë përbërëse të opiumit, që e quajti morfinë, sipas emrit të perëndisë greke të gjumit dhe të ëndrrave, Morfeus. Edhe pse ka disa mosmarrëveshje për datën e saktë të zbulimit të morfinës, është pranuar, përgjithësisht, nga

historianët mjekësorë se baza e efekteve të fuqishme të saj u zbulua mes viteve 1805 dhe 1816 nga Friedrich Wilhelm Sertürner (Busse,2006:8-25). Më vonë, në vitin 1848, Heinrich Emanuel Merck zbuloi tek opiumi papaverinën. Në vitin 1938 u bë një hap tjetër lidhur me narkomaninë, pasi kimisti zviceran, Albert Hofman, arriti të sintetizojë thartirën lisergjike dhe në vitin 1943 ai bëhet edhe përdoruesi i parë i drogës LSD-25, të cilën e kishte zbuluar vetë (Escotado, 2010:277).

Në të kaluarën jo të largët kokaina përdorej gjerësisht në mënyrë legale si anestetik lokal. Edhe sot ajo përdoret rrallë për anestezi topikale, në sy, gojë dhe në fyt përpara operacioneve të vogla kirurgjikale ose në të tjera procedura mjekësore. Ndërsa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës rreth vitit 1970 filloi të përdorej për herë të parë vaji i hashashit, nga një sekt religjioz që quhej *“Vëllazëria e dashurisë së përhershme”*.

Në vitin 1905, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shkak të krijimit të varësisë nga përdorimi i heroinës, nga Kongresi Amerikan u ndalua përdorimi i opiumit (Gosop, 1948:99-184). Organizata e Kombeve të Bashkuara, duke e parë trendin dhe rrezikun blerjes, të posedimit, shitjes, përdorimit dhe kultivimit të drogave, hartoi në vitin 1961 Konventën mbi përdorimin e substancave narkotike, dhe në vitin 1971 Konventën mbi përdorimin e substancave psikotrope.

Në vitin 1914, për herë të parë u zbulua ekstazi në Gjermani, ku është patentuar si ilaç për zvogëlimin e oreksit (Sokoli,1998:43) dhe në vitet 1980 gjeti përdorim shumë të madh nga të rinjtë në Amerikë.

Për sa u përket substancave psikotrope, në shekullin e kaluar, me zbulimin e disa medikamenteve mjekësore që u përdorën për shërimin e sëmundjeve psikike, është

vërtetuar se, nëse ato përdoren në mënyrë të pakontrolluar nga ana e pacientit ose e konsumuesit, mund të shkaktojnë varësi të madhe, ashtu si narkotikët.

2.2. Historiku i narkokriminalitetit në Shqipëri dhe në Kosovë

Narkokriminaliteti, ose kriminaliteti me narkotikë dhe narkomania, janë shfaqur herët në botë. Ndërsa në Shqipëri dhe në Kosovë historia e narkokriminalitetit është e shkurtër. Vitet e fundit kjo dukuri kriminale, së bashku me narkomaninë, sipas të dhënave të siguruar nga organet zbatuese të ligjit dhe institucionet e tjera kombëtare e ndërkombëtare, kanë marrë hov në përhapjen e tyre.

Mendohet se në Shqipëri, para viteve '90 dhe në fillim të tyre drogat e paligjshme ende nuk kishin hyrë në vend dhe pothuaj nuk njiheshin nga masa e gjerë e popullsisë. Prandaj dhe nuk flitej për narkokriminalitet. Por, pas vitit 1990, kur pushteti komunist shkonte drejt fundit dhe kur shumë shqiptarë emigruan jashtë vendit dhe kur shtetas të huaj filluan të hyjnë lirisht në Shqipëri, u futën edhe lëndë narkotike dhe nisi blerja e shitja e tyre. Me kalimin e viteve, kjo dukuri erdhi duke u zgjeruar, drogat bëhen të pranishme, regjistrohen përdoruesit dhe furnizuesit e tyre. Këtë na pohuan edhe persona përdorues droge, që kemi intervistuar në Shqipëri në kuadrin e këtij studimi. Më i moshuari prej tyre, që ishte 53 vjeç, deklaroi se drogën e kishte filluar në vitin '90, një tjetër, në vitin '91 dhe dy të tjerë në vitin '92.

Në këtë kohë veprimtaria kriminale në fushën e drogave hedh hapat e para dhe vjen duke u përhapur në mënyrë të shpejtë. Madje, nisi edhe kultivimi i bimëve narkotike në zona të veçanta të vendit. Fijet e rrjeteve të shpërndarjes së drogës të çonin në vendet

fqinje, si Greqia, Maqedonia, Bullgaria, Turqia, ato lidheshin deri edhe me mafian italiane. Nga ana tjetër, u rrit në përmasa drastike kultivimi në vend i bimëve narkotike, si kanabis sativa, duke e kthyer vendin nga një vend tranziti, në vend të origjinës së narkotikëve.

Shqipëria u kthye në një vend tranziti për trafikimin e narkotikëve, por edhe në një vend të origjinës së narkotikëve, konkretisht të kanabisit bimor. Sipas një raporti të UNDOC, në Europën Lindore, Shqipëria ende mbetet njëri nga eksportuesit më të mëdhenj të kanabisit bimor, ku prodhimi masiv filloi në pjesët jugore të vendit në fillim të viteve 1990 (UNDOC,2006:165). Prodhimi i rrëshirës së kanabisit ishte e përhapur në rajonin e Ballkanit në fillim të shekullit XX. Greqia ishte prodhues më i madh i rrëshirës së kanabisit deri rreth vitit 1920 dhe, më vonë, Shqipëria dhe ish-Jugosllavia, veçanërisht ajo që tani është ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (Bouquet,1950;Clarke,1998).

Ndërsa lidhur me konsumimin e drogave, duhet thënë se para viteve '90 në Shqipëri janë përdorur si droga duhani, alkooli dhe disa preparate farmaceutike. Në një raport të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë rezulton se edhe para viteve '90 në Shqipëri ka pasur tendenca për përdorim të substancave të ndaluara, madje, në disa raste ishte krijuar edhe varësi prej tyre. Në raport theksohet: *“Edhe pse problemet e mirëfillta të lidhura me çrregullimet e lidhura me drogat ilegale filluan mbas vitit 1994-‘95, prej sistemit diktatorial u “trashëgua” një kontingjent klientësh i përqendruar kryesisht në Tiranë, që kishin krijuar varësi nga morfina dhe petidina, një pjesë për shkaqe jatrogenike, por shumica si abuzues pikërisht me këto opioide”* (OBSh&SAIMS,2011:29).

Kosova, ndryshe nga Shqipëria, ka një histori më të gjatë të narkokriminalitetit dhe narkomanisë, për shkak të sistemit politik dhe ekonomik që ishte në fuqi para vitit '90. Sipas të dhënave statistikore të ish-Jugosllavisë, në vitin 1978, në Kosovë, nuk kishte të

regjistruar asnjë përdorues droge, por në vitin 1985, kanë qenë të regjistruar 71 përdorues droge (Blakaj,2015).

Gjatë hulumtimit për punimin e këtij disertacioni, kemi arritur tek të dhënat se në Kosovë, edhe pse në numër të vogël, kishte persona që kishin përdorur substanca narkotike.

Theksojmë këtu se po e përmendim drogat dhe përdorimin e tyre, jo për të folur për narkomaninë, pa të cilën nuk ka as narkokriminalitet, por, sepse, siç shprehen studiuesit, që të ketë përdorues drogash, duhet të ketë patjetër edhe shpërndarës, shitës të drogave. Sipas raporteve, thekson Siegel, rritja e papritur e përdorimit të drogave mund të jetë një shenjë paralajmëruese e rritjes së ardhshme në normën e krimit (Siegel,2008:34-35). Gjatë anketimeve që bëmë për këtë studim, kemi mundur ta vërtetojmë një thënie të tillë. Në intervistat e zhvilluara kemi mësuar se në fillim të viteve '90 përdoruesit e drogave nisën të merreshin edhe me shpërndarjen dhe me shitjen e tyre, pra, u kthyen në subjekte veprash penale në fushën e narkotikëve. Siç deklaroi një i intervistuar, ai e kishte filluar të përdorte heroinën e, njëkohësisht, edhe ta shiste, si shpërndarës, në Prishtinë, në moshën 13-vjeç (1995). Kjo do të thotë se në atë periudhë, në mos më herët, kanë filluar të shfaqen veprat penale me narkotikë.

2.3. Përkufizimi i narkokriminalitetit

Është vështirë të gjejmë ndonjë përkufizim rigorozisht shkencor të termit 'narkokriminalitet', por, përgjithësisht, kemi hasur në formulimin 'kriminaliteti i ndërlidhur me drogën'. Në literaturën shkencore ka përpjekje për të dhënë kontribute në këtë drejtim. Studiuesi Petroviç konkludon se pa narkomani nuk mund të ketë narkokriminalitet dhe pa

përdorues droge, nuk ka as shitës drogash (Petroviç,2004:94-124). Edhe agjencia EMCDDA shprehet se narkokriminaliteti përcaktohet si *krimet e ndërlidhura me drogën*. Sipas saj, “kriminaliteti i lidhur me drogën” përfshin katër lloje krimesh:

- ***krimet psikofarmakologjike***: që kryhen nën influencën e një substance psikoaktive, si rezultat i përdorimit akut ose kronik;

- ***krimet kompulsive - ekonomike***: që kryhen për të fituar pará (ose drogë) për të mbështetur përdorimin e drogës;

- ***krimet sistemike***: që kryhen në kuadër të funksionimit të tregjeve të paligjshme të drogës, si pjesë e biznesit të furnizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të drogës.

- ***krimet në fushën e drogës***: veprat penale në fushën e drogës të kryera (dhe të tjera ndërlidhura) (EMCDDA,2007:1).

Meqë në praktikë krimet në fushën e drogës lidhen edhe me veprimtari të tjera kriminale, si edhe me sektorë të ndryshëm të jetës së shoqërisë, krahas termit ‘narkokriminalitet’ hasen edhe terma të tjerë, si: narkoterrorizmi, narkokultura, narkotrafikimi, narkogrupet etj., me trajtimin e të cilave nuk merremi këtu.

2.4. Përkufizimi dhe klasifikimi i narkotikëve

Ç’janë substancat narkotike (drogat)? Fjalori i Shqipes së Sotme, termin *drogë* (*drogë/a*) e përcakton: lëndë kimike ose me prejardhje bimore etj., që përdoret për përgatitjen e barërave qetësuese, gjumëdhënëse, dehëse (FSHS,2002:268,826). Ndërsa termit *narkotik* (*narkotík,-u*), ky fjalor i jep kuptimin: lëndë që nxirret nga disa bimë, si hashashi etj., e cila vepron mbi sistemin nervor qendror dhe shkakton një lloj dehjeje etj.

(FSHS,2002:268,826). Në shumë fjalorë farmakologjikë ose edhe të shkencave të tjera, emërtimin *drogë* e hasim shumë më rrallë, pasi është zëvendësuar me fjalën *narkotikë*.

Organizata Botërore e Shëndetësisë cilëson si *drogë* çfarëdo substance që, duke u futur në një organizëm të gjallë, modifikon një ose më shumë funksione të tij. Ndërsa sipas studiuesit Arifi, me *drogë*, nënkuptohet çdo substancë e fituar në mënyrë natyrore ose sintetike, e cila arrin që te njeriu të krijojë një varësi psikike dhe fizike, që krijohet me ripërtëritjen e futjes në organizëm të këtyre substancave të dëmshme, jo vetëm për individin, por edhe për shoqërinë në përgjithësi (Arifi,2008:22-130).

Pra, ekzistojnë disa lloje përkufizimesh për narkotikët, duke filluar nga përkufizimi mjekësor, pastaj penal (narkotikë legalë dhe ilegalë), kriminalistik etj.

Substancat narkotike (drogat) ose pijet narkotike janë të shumëllojshme. Ndër to mund të përmendim opiumin dhe derivatet e tij, alkoolet e ndryshme si morfina, kodeina, kokaina, kanabisi, hashashi (Bicaj,2010:18-155).

Këto klasifikohen në shumë lloje. Disa i ndajnë ata nga mënyra e prodhimit dhe e përfimit të tyre; disa të tjerë nisen nga prodhimi dhe përdorimi i tyre në raport me ligjin, ose në bazë të efekteve dhe pasojave që shkaktojnë te përdoruesit.

Nisur nga mënyra e prodhimit dhe e përfimit të tyre, prof.dr.Ragip Halili (2005), përcakton se narkotikët ndahen në dy kategori kryesore, në narkotikë natyralë dhe narkotikë sintetike (Halili,2005:301-308). Narkotikët natyralë janë ata që përfihen nga bota bimore, shtazore dhe nga minerale të ndryshme, kurse narkotikët sintetike përfihen përmes proceseve artificiale dhe përzierjeve të ndryshme me substanca të tjera organike.

Pavarësisht nga mënyra e përfutimit të tyre, narkotikët, përgjithësisht, kanë efekte të njëjta, por ndodh që narkotikët e përfutur në mënyrë artificiale të kenë efekt më të fuqishëm se ata natyralë. Shkencëtari i njohur gjerman, Lewin, me ndihmën e dy neuropsikiatërve francezë, Deloay dhe Deniker, më 1957 klasifikoi drogat, e njohura deri atëherë, sipas efekteve kryesore që jepte përdorimi i tyre. Ky klasifikim është përkrahur edhe nga OBSH dhe për farmakologët mbetet klasifikimi bazë (Sokoli,1999:42).

Duke marrë për bazë efektet e tyre farmakologjike dhe psikologjike, narkotikët ndahen në tri grupe kryesore: stimulantë, halucinogjenë dhe depresantë.

Stimulantët

Drogat stimuluese kanë një efekt shumë të madh, shpejtojnë funksionet e organizmit, rrisin rrahjet e zemrës, temperaturën e trupit dhe tensionin e gjakut, amortizojnë lodhjen dhe rraskapitjen, pakësojnë oreksin dhe e bëjnë përdoruesin pak nervoz. Marrja e sasive të mëdha të stimulantëve shkakton ankth, panik, kriza, dhimbje koke, dhimbje në stomak, agresivitet dhe paranojë ndaj përndjekjes etj.

Disa autorë theksojnë se stimulantët janë narkotikë që mund ta mbajnë personin në gjendje të mirë fizike dhe psikike, kur janë të lodhur (Oakley,Ksir,&Hart,2010:110-180). Ndërsa Ramljak, vë në dukje ndikimin që stimulantët kanë në mënyrë të veçantë në sistemin qendror nervor (SQN), duke sjellë shtim të gjallërisë së brendshme, zgjuarsia të forcuar dhe zvogëlim apetiti (Ramljak,2007:6-252).

Stimulantët kategorizohen në *të lehtë*, dhe në *të fortë*.

Në stimulantët *e lehtë*, futen: *kafeina* (në çaj, kafe dhe në pijet cola); *nikotina* (te duhani); *efedrina* (që përdoret në mjekimet për astmën dhe alergjitë). Nga këta, përdoren më shumë nga të rinjtë duhani dhe kafeja.

Në stimulantët *e fortë* përfshihen: metamfetemina, kokaina, ekstazi, tabletat dobësuese (Duromoni, Tenuate Dospan, Ponderaks). Më shumë nga të rinjtë përdoren ekstazi dhe kokaina.

Nga grupi i narkotikëve stimulues, disa paraqesin interes njohjeje dhe studimi në fushën e kërkimeve jo vetëm mjekësore, por edhe kriminologjike, ndaj në vijim po përshkruajmë disa prej tyre, si: *kokaina*, *kraku*, *ekstazi (MDMA)*, *metamfetamina* dhe *khati*.

Kokaina

Është një stimulues shumë i fuqishëm i sistemit qendror nervor dhe jep shumë varësi. Njihet edhe me emrat *K*, *coca*, *ëmbëlsirë hunde*, *dëborë*, *zonja e bardhë*, *buri*, *çarli*, *goditja*, *pluhur i bardhë* dhe *pluhur yjor*. Gjatë viteve '80-'90 të shekullit të kaluar mori popullaritet të madh dhe pati përdorim të gjerë.

Kokaina e pastër burimin e ka nga fleta e bimës *coca*, që rritet kryesisht në Amerikën e Jugut, (Keefer, Ph., & Norman, L., 2010:20-37).

Në kohët moderne kokaina keqpërdoret shumë dhe paraqet drogë të rangut të dytë. Përdoret edhe në mjekësi si anestetik lokal për operacione të syrit, të fytit apo të veshit. Në treg mund të gjendet në dy forma, si *hidroklorid* dhe si "*freebase*" (bazë e lirë). Hidrokloridi ose kokaina pluhur tretet në ujë, por merret edhe në mënyrë intravenoze ose intranazale (Roger, D.W., Steven, M.M., & Roxanne, L.B., 2005:6-10). Shpesh kokaina

përzihet me pudër, sheqer, miell dhe narkotikë të tjerë, për të përfutur sasi më të mëdha droge.

Shkakton shumë shpejt eufori, me një përjetim të fuqishëm dhe të bukur intelektual dhe fitim të forcës fizike (Ramljak,2007:6-252). Nga përdorimi i vazhdueshëm i saj, përdoruesi fillon të ketë çrregullime psikike shumë të forta dhe haluçinacione e, në shumë raste, kalojnë në gjendje delirante dhe në krime. Rreziku më i madh prej saj është infektimi me sëmundje të rënda, si SIDA, Hepatiti A dhe B etj.

Kraku (CRACK)

Kraku përftohet me përzierjen e kokainës me sodën e bikarbonatit dhe me ujin, pastaj nxehet, për të eliminuar hidrokloridin, duke prodhuar kokainë për përdorim (pirje) (Peck,1997:1-10). Pihet si duhani, shkakton eufori brenda 10 sekondave - ky efekt është i fortë dhe shumë i shpejtë (Olive,2008:18). Krijon tepër varësi dhe ka efekt shumë të fortë, ndaj konsiderohet si një ndër drogat më të rrezikshme, pasi sjell infarkt të zemrës, hemorragji cerebrale e deri vdekje.

Ekstazi (MDMA)

Ekstazi është, edhe stimulant, edhe haluçinogjen. Në vendet anglishtfolëse përmenden rëndom këta emra: *Denis and Meance, Disco Biscuit, Ones Burger,ZM-25s, kalifornia sun rice, bonbone, acid* etj. (Gosop,2007:99-184).

Paraqitet në dy forma: gjysmësinetike dhe në pluhur të pastër kristali në ngjyrë të bardhë (Gosop,2007:99-184). Zakonisht, është në formë kapsulash, tabletash, por edhe në formë pluhuri. Përdoret në rrugë orale, në rrugë intravenoze ose edhe intranazale dhe shkakton veprime më të shpejta dhe që zgjasin më tepër, dëmton qelizat e trurit, ndikon në ADN-në e njeriut, ndaj nuk përdoret as për qëllime mjekësore.

Metamfetamina (methamphetamin, amphetamin)

Njihet me disa emra, si *Speed* (shpejtësia), *Whiz*, *Blues*, *Meth* etj. (Gerald, 2007:4). Më i përdorur është *Crystal Meth*. Gjendet në formë pluhuri, si kristal i bardhë, nuk ka erë dhe ka shije të idhët.

Pasojat e përdorimit të saj janë të mëdha, shkakton çrregullime të rënda në tru, sëmundjen e skizofrenisë paranoide, varësi të madhe, haluçinacione të fuqishme, ankth etj. (Weishiet&White,2009:87). Metamfetamina dhe amfetamina, zakonisht, përdoren në formë tabletash, duke i gëlltitur, por mund të përdoret edhe nëpërmjet të rrugëve intranazale ose intravenoze.

Khati

Njihet edhe me emrat: *cat*, *chat*, *kus-es-salahin*, *çaj i Abisinisë*, *sallatë e Afrikës* etj. Nxirret nga gjethet dhe sythet e bimës *Catha edulis*, që rritet në vendet e Afrikës Verilindore dhe në Gadishullin Arabik. Përdoret duke përthypur gjethet dhe sythet e bimës,

por edhe si çaj. Përdoret edhe si stimulant, në raste të argëtimesh. Në mjekësi është përdorur për shërimin e disa sëmundjeve, si ulcerës, obezitetit dhe depresionit.

Përdorimi për një kohë të gjatë, te meshkujt mund të shkaktojë ulje të dëshirës seksuale, kurse te femrat bën që të lindin foshnja me peshë minimale.

Haluçinogjenët

Drogat haluçinogjene hyjnë në grupin më të madh të narkotikëve të përdorur deri tani. Nuk janë ilaçe (barna), edhe pse disa prej tyre janë prodhuar në mënyrë sintetike për t'u përdorur në mënyrë legale në mjekësi, por sot të gjitha këto kryesisht janë droga ilegale etj. (Arifi,2008:22-130).

Psikofarmakologu berlinez Lewin i ka përkufizuar haluçinogjenët si “substancë që shkaktojnë eksitim cerebral në formë haluçinacionesh, iluzionesh dhe vizionesh, që pasojnë me humbje të vetëdijes apo simptoma të ndryshimit të funksionit të trurit”.

Personat, nën ndikim të këtyre substancave, shohin, dëgjojnë dhe i ndiejnë gjëra që nuk ekzistojnë ose mund të shohin gjëra të tjetërsuara, përjetojnë eufori emocionale dhe psikologjike, të folura dhe të qeshura të tepruara, djersitje, panik, paranojë, humbje të kontaktit me realitetin, sjellje të çuditshme, brengosje dhe mendime të tmerrshme për përdoruesin e tyre.

Haluçinogjenët më të njohur janë: *marihuana, hashashi, vaji i hashashit, LSD, PCP, ibogaini, meskalini, skopolabini* etj.

Marihuana (Canabis Sativa L)

Marihuana është emër i përgjithshëm i drogave që përftohen nga bima *Canabis Sativa*. Ekzistojnë tri lloje të kryesore: *Canabis Sativa*ⁱ, *Canabis Indica*ⁱⁱ dhe *Canabis Ruderalis*ⁱⁱⁱ.

Në trevat shqiptare, për shkak të klimës, kjo bimë rritet në formë të egër, por edhe kultivohet. Bima njihet me ermin kërp dhe është njësezonale, me fletë të dhëmbëzuara, rritet deri në 120 cm e më shumë. Shqipëria, për këtë lloj droge, është vend i origjinës.

Edhe në Kosovë, pas luftës policia ka gjetur shumë sipërfaqe të mbjella me këtë lloj bime, që atje njihet me emrat: *bari*, *xhoint*, *gane*, *hash*, *smok*, *ganxhi* etj. Zakonisht, marihuana pihet si cigare, *xhoint*, ose duke e thithur me nargile (*boin paibe*).

Hashashi

Është derivat i bimës *Canabis Sativa L*, por, ndryshe nga marihuana, përftohet nga fruti i kësaj bime. Sipas vendit të kultivimit, emërtohet: *afganistanezi*, *kafuri*, *turku i gjelbër*. Përftohet në mënyrë sintetike dhe natyrale. Hashashi dhe marihuana përdoren shumë në Kosovë. Ata tymosen si cigare, por edhe pihen të përzier me opium apo me alkool. Efektet e tij më shumë janë në aspektin psikologjik, sesa fizik.

Vaji i hashashit (Hash Oil)

Prodhohet me kullimin e nxehtë dhe me filtrimin e rrëshirës nga ekstraktimi i të gjithë materialit bimor me tretës organikë, si alkooli, eteri ose benzeni (Cole,2006:21). Vaji

është tre-katër herë më i fortë se vetë hashashi, i cili prodhohet nga bima *Canabis sativa L*, e që njihet me emrin *Bhanga*, (Boire,1996:20). Ngaqë është i fortë, ai përdoret duke vendosur në cigare apo në mbështjellësen e cigares një apo dy pika vaj hashashi.

LSD (Lyser Saure Diethylamide)

Në ditët e sotme konsiderohet substanca më e fuqishme, 100 herë më e fortë se kokaina dhe kategorizohet në grupin A të narkotikëve të ndaluar. Ajo ndërron perceptimet psikike të njeriut, jep perceptime joreale të objekteve dhe të sendeve.

Njihet me emrat: *trip, acid, haze, LSD 25, letër* apo *fotografi*. Gjendet në forma të ndryshme e më shpesh në formën e fotografive të ndryshme, në madhësi të pullave postale, apo edhe në formë pluhuri të bardhë.

Përdorimi i saj paraqet rrezik për përdoruesin, pasi dhe ka ndodhur që përdorues të ndryshëm janë hedhur nga ndërtesa apo nga ura të larta, duke menduar se janë zogj dhe se mund të fluturojnë (Pellerin,1998:105-112).

Depresantët

Historikisht, njerëz të kulturave të ndryshme kanë përdorur agjentë kimikë për të nxitur gjumin, për të zvogëluar stresin dhe për qetësimin e anktheve. Këta agjentë kimikë njihen si substanca depressive, *depresantë*. Depresantët janë në dispozicion të njerëzve prej më pak se 100 vjetësh (Klosterman,2006:8).

Këto substanca veprojnë në sistemin nervor qendror, konkretisht, në vatrën e zgjimit dhe të gjumit në tru. Njerëzit që janë nën ndikim të drogave depresante i shqiptojnë keq fjalët, kanë pengesa kur ecin, kanë reflekse të ngadalshme, e humbin vetëdijen, bien në komë. Në sasi të vogla ato japin efekte qetësuese. Në doza të mëdha shkaktojnë gjumë të thellë deri në vdekje (Hanson,Venturelli,&Fleckenstein,2011:109-169).

Në grupin e depresantëve hyjnë: *opiumi, morfina, heroina, barbituratet, medatoni, inhalantët, steroidet* etj.

Papaver Somniferum, opiumi

Fjala opium rrjedh nga greqishtja “opion”, që do të thotë lëng i bimës, i koagulluar nga lulëkuqja e opiumit (Singel Convention,1961,article 1, par. 1). Lulëkuqja e opiumit, *mak, poppy, papaver, clubs*, me emrin *papaver somniferum*, është bimë njëvjeçare me trung dhe fletë me lartësi deri 1.60 metra. Pas çarjes së kapsulës, lëngu, si qumësht i bardhë, mbledhet, pastaj mpikset, thahet dhe nxihet në diell. Më pas, fërkohet dhe ngjishet me duar, duke formuar opiumin bruto.

Ekzistojnë disa lloje të *papaver somniferum*, që njihen me emrat: *album, glabrum, depressum, setigerum* etj.

Morfina

Morfina përfitohet nga opiumi drejtpërdrejt (Arifi,2008:22-130). Futet në organizëm në mënyrë intravenoze apo edhe orale, por edhe nëpërmjet rrugëve nazale. Gjendet në

formë kristalesh, pluhuri, lëngu apo ampulash, me emërtimet: *macja e vogël, zonja ëmë, dajë ëndërruesi, emsel dhe tab*.

Morfina është një ndër analgjetikët më të fortë dhe pëlqehet nga narkomanët, sepse pakëson dhimbjet. Si shenja të përdorimit të morfinës janë zverdhja e lëkurës, e bebëzave të syrit, dridhja e muskujve, higjiena e dobët personale etj..

Heroina

Heroina është substancë gjysmësinetike e përftuar nga derivatet e morfiumit në vitin 1874 (Ramljak,2007:6-252). Përbëhet nga kristale të imëta, të ngjashme me sheqerin pluhur, me miellin e klasit të parë apo me detergjentin. Heroina është substancë e fuqishme dhe e quajnë: *horse, white lady, dragon, H, boy, smack* etj. (Plačko,1997:229).

Konsiderohet një nga narkotikët më të rrezikshëm, që çon drejt shkatërrimit të njeriut. Heroina provokon pagjumësi, përzjerje dhe të vjella, ngushtim dhe fiksion të bebëzave të syrit, humbje oreksi, kurse përdoruesi shumicën e kohës është në gjendje letargjike (Bicaj,2010:18-155). Krijon varësi fizike dhe psikike dhe, në shumë raste, infektimin me sëmundje, si SIDA apo hepatiti.

Konsumohet në disa mënyra, pihet si cigare, thithet me hundë, injektohet me shiringë në vena. Kjo e fundit është mënyra më dominuese dhe kërkon ndihmë profesionale.

Në Kosovë dhe në Shqipëri heroina gjendet në sasi të mëdha, një pjesë e saj përdoret për konsum në vend, kurse pjesa tjetër trafikohet në vendet e BE-së.

Barbituratet

Barbituratet janë qetësues dhe hipnotikë, që gjejnë një përdorim të madh në mjekësi dhe hyjnë në grupin e mjeteve qetësuese-depresive dhe, si të tilla, shërbejnë për zbutjen dhe pengimin e dhimbjeve të ndryshme, për mjekimin e epilepsisë dhe si anestetikë gjatë operacioneve të ndryshme (Arifi,2008:22-132).

Kanë disa emërtime: *bards, barbies, blue, devills, gorrillas* etj. Te përdoruesi shkaktajnë eufori, që i përngjan gjendjes së dehur, pagjumësi, pengesa në të folur, mungesën e koordinimit fizik dhe të ekuilibrit. Nëse kombinohen me heroinë, amfetaminë apo me alkool, shkaktajnë helmim të rëndë apo vdekje.

2.5. Përkufizimi dhe llojet e substancave psikotrope

Në Konventën e Kombeve të Bashkuara, të vitit 1988, kundër qarkullimit të substancave narkotike dhe psikotrope, thuhet: “Substanca psikotrope nënkupton çdo substancë natyrore, ose sintetike, ose materie natyrore të përmendur në listat e tabelave I, II, III dhe IV^{iv}, të Konventës mbi substancat psikotrope, të vitit 1971“ (Petroviç,2004:94-124).

Ato janë substanca stimuluese dhe depresante të sistemit nervor qendror, haluçinogjene dhe psikostimulatore të karakterit të veçantë. Pasi konsumohen, shkaktajnë shqetësim, pagjumësi, gjumë, haluçinacione, ndikojnë në aftësinë e veprimit dhe të reagimit të lëvizjeve dhe të të menduarit; disa prej tyre shkaktajnë varësi psikike dhe fizike. Njihen edhe si medikamente narkotike.

Për klasifikimin e tyre nuk ka një sistem unik, por, përjashtimisht, mund të mendohet se substanca psikotrope janë të gjitha ato substanca që gjenden në listat I, II, III dhe IV të Konventës mbi substancat psikotrope të vitit 1971 (Convention on Psychotropic Substances, 1971). Kjo Konventë i ka detyruar shtetet të kenë regjim shumë të ashpër ndaj këtyre substancave, për shkak të rrezikut që kanoset nga keqpërdorimi i tyre.

Ky përshkrim i shkurtër i disa drogave u bë jo thjesht për të shuar kuriozitetin rreth tyre, as thjesht për të treguar rrezikun që paraqesin për shëndetin dhe jetën e njerëzve, por më shumë për të theksuar se janë pikërisht këto produkte ilegale, me të cilat kryhen veprat penale, si prodhimi, trafikimi, shitja dhe tranzitimi i tyre. Pikërisht me to kryhen krime, jo vetëm nga individë, por nga grupe të mirëfillta të organizuara kriminale, vendore, por edhe në bashkëpunim me ato të vendeve të tjera. Me këto droga, ushtrojnë veprimtari të dendur edhe organizatat terroriste për përfitime kolosale financiare, me të cilat sigurojnë armë dhe mbajnë në këmbë grupe, madje, edhe ushtri terroriste, që janë bërë sot kërcënim për mbarë botën.

KREU III: ASPEKTE JURIDIKO-PENALE TË VEPRAVE PENALE NË FUSHËN E NARKOKRIMINALITETIT NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË

3.1. Historiku i zhvillimit të legjislacionit penal në Shqipëri

Me vështrimin historik të legjislacionit që lidhet me këtë fushë, të hartuar dhe të përmirësuar e të plotësuar në periudha të ndryshme, synojmë të japim një pasqyrë të qartë rreth veprave penale, në fushën e narkotikëve, të parashikuara në kode dhe në ligjet përkatëse, si dhe të sanksioneve ndaj tyre në periudha kyçe të shtetit shqiptar dhe të Kosovës. Trajtimi i veprave penale të narkokriminalitetit nga këndvështrimi juridiko-penal dhe kriminologjik bëhet mbështetur në politikën penale dhe në politikën parandaluese që zbatohen lidhur me trafikimin dhe përdorimin të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe ndihmon që këto politika të përsosen vazhdimisht dhe të implementohen në praktikë me efikasitetin e duhur.

Historiku i zhvillimit të shtetit shqiptar paraqet një model interesant dhe të vështirë, pasi sistemi politik në Shqipëri ka ndryshuar shumë herë. Historia e krijimit të shteteve, kombeve në Ballkan gjatë shekullit XIX, ishte përplot masakra, si dhe me ato që sot i quajmë “spastrime etnike”, por që në atë kohë njiheshin më së shumti si plaçkë e zakonshme lufte (Erebara, 28 nëntor 2012). Këtu nuk bën përjashtim edhe krijimi i shtetit të ri shqiptar në vitin 1912 dhe ecuria e tij gjatë një shekulli. Ndryshimi disa herë i sistemit politik, pa dyshim, ka reflektuar edhe në sistemin juridik edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë.

Legjislacioni penal shqiptar e ka zanafillën e zhvillimit të vet historik që nga themelimi i shtetit të Arbrit (Elezi, I., & Elezi, E., 2010:15-97), për të vazhduar pastaj me

ndryshime të vazhdueshme, me krijimin e statuteve të qyteteve-komunave në fillim të shekullit XIV, që, përveç karakterit të përgjithshëm, kishin edhe karakter të normave penale. Zhvillime njohu legjislacioni penal edhe në Perandorinë Osmane, pjesë e së cilës u bë me dhunë Shqipëria e pushtuar prej e saj. Krahës shariatit, Perandoria Osmane nxori *Kanunametë* (kodet) nga sulltan Mehmeti II, por në vitin 1858, si dhe me ndryshimet e shtesat e bëra më 27 maj 1909, hyri në fuqi Kodi ose ligji penal osman (Elezi, I. & Elezi, E. 2010:15-97). Ky Kod penal ishte në fuqi edhe në shtetin shqiptar të krijuar me shpalljen e Pavarësisë.

Në fillimin e shekullit XX, në legjislacionin penal të shtetit të ri shqiptar fillojnë të përcaktohen edhe normat e para juridike me karakter penal kundër narkokriminalitetit. Këto rregullime patën rëndësi, sepse në atë kohë qarkullonte dhe ishte në përdorim sidomos opiumi. Sipas një raporti të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, të vitit 2008, substancat narkotike, ose drogat, filluan të paraqesin interes për superfuqitë për faktin se në vitin 1906, 25 milionë njerëz përdornin opium dhe, gjatë viteve 1906-1907, janë prodhuar 41.000 tonë opium në nivel botëror (UNDOC, 2008:6-15).

Shqipëria, megjithëse ishte një shtet i copëtuar nga vendet fqinje dhe i rrënuar nga luftërat dhe pushtimet e vazhdueshme, përqafoi legjislacionin penal të shteteve të zhvilluara në atë kohë, si Italia dhe Franca. Përqafimi i legjislacionit, i idesë për të luftuar kriminalitetin, u mundësua me dekretin e 3 qershorit 1927, për miratimin e Kodit penal shqiptar të kohës së Zogut.

3.2. Kodi penal i mbretërisë së Zogut

Ky kod penal përbën themelin e legjislacionit penal të shtetit shqiptar me qasje perëndimore, pasi ai u krijua në modelin e frymës europiane, konkretisht, Kodit penal italian (Elezi,I.&Elezi.E,2010:15-97). Sipas këtyre autorëve, Kodi penal i shtetit shqiptar, i vitit 1928, ndahet në tri pjesë: 1. Libri i parë, me 10 tituj, parashikon fajet dhe ndëshkimet përgjithësisht (Pjesa e përgjithshme); 2. Libri i dytë, me 10 tituj dhe 65 krerë, parashikon deliktet; dhe 3. Libri i tretë, me 4 tituj dhe 25 krerë, parashikon kontravencionet (kundërvajtjet).

Në këtë Kod penal, për herë të parë, parashihen edhe veprat penale në fushën e narkokriminalitetit, përkatësisht, në pjesën e dytë, **Deliktet**, *titulli VII “Deliktet kundër tërësisë publike”, kapitla III, “Deliktet kundër shëndetësisë dhe ushqimeve publike”,* në disa dispozita ligjore, konkretisht, në nenet 358,359 dhe në nenet 360,362 dhe 363, që përcaktojnë vepra penale sipas veprave penale të neneve 358 dhe 359.

Në nenin 358 të këtij Kodi përcaktohej: *“Kushdo që fut kontrabandisht brenda në Republikë, opium ose ekstrakte të tij, morfinë ose kripërat e saj, morfinë të destiluar ose kripërat e saj ose bi-klorur të opiumit dhe kripërat dhe përmbajtjet e saj, kokainë ose kripërat dhe përmbajtjet e saj, hashash ose përmbajtje të tij, si dhe kushdo që transporton këto nga një vend i Republikës në tjetrin ose i vë në shitje, ose i merr pa leje të Qeverisë, i mban pranë tij ose ndërmjetëson me çdo mënyrë për shit-blerjen, ose lehtëson përdorimin e tyre ndëshkohet me burgim nga një muaj deri në një vit dhe me gjobë të rëndë nga 100 deri 1000 franga ari”.*

Objekt i kësaj vepre penale ishin marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar kontrollin dhe ligjshmërinë e përdorimit e të qarkullimit të lëndëve të

mësipërme, për shkak të rrezikut të madh që ato paraqesin për shëndetin publik (Muçi, 2002:22-27).

Me interes është fakti që vëmendjes së hartuesit të kodit në fjalë nuk i ka shpëtuar edhe problemi se ç'duhet bërë me sasi të drogave, që u kapen autorëve të krimit. Duke e përcaktuar sesi do të procedohet me drogat e kapura, Paragrafi 2, i nenit 358, merr karakter procedural. Sipas kësaj dispozite, këto substanca do të konfiskoheshin, gjë që tregon se nuk tolerohej në këtë drejtim.

Por ka edhe një gjë tjetër që të tërheq vëmendjen. Paragrafi 2, i nenit 358, përcakton se nëse *“një kallëzues kallëzon në lidhje me këto vepra penale, atij i jepet gjysma e barnave të konfiskuara”*. Kjo tregon synimin e ligjvënësit për të nxitur dhe inkurajuar shtetasit që të bëhen pjesë e zbulimit të veprave penale, duke ndihmuar me informacione për kryerjen e krimeve dhe për kapjen e autorëve të tyre. Natyrisht, kuptohet që këtu bëhet fjalë për një shpërblim material me mallin e konfiskuar, me kusht që ky të shitej a të përdorej sipas ligjeve në fuqi. Kjo është një praktikë që nuk mund të mos nxisë mendime dhe opinione edhe në kohën e sotme, kur narkokriminaliteti ka marrë përmasa shqetësuese dhe kur agjencitë e zbatimit të ligjit dhe organet e drejtësisë kanë shumë nevojë për bashkëpunimin e komunitetit dhe të autorëve të veprave penale për zbulimin e aktiviteteve kriminale dhe të autorëve të tyre.

Është me interes të thuhet se qysh në atë kohë në dispozitat e këtij Kodi hartuesi ka theksuar se veprat penale të përcaktuara në ato dispozita konsiderohen të tilla vetëm kur kryhen me dashje dhe nga personi që, në momentin e kryerjes së krimit, kishte mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe ishte i përgjegjshëm. Edhe kjo flet për frymën perëndimore të legjislacionit të asaj periudhe.

Në nenin 359 të këtij Kodi, thuhej: *"Kushdo që jep ose merr me recetë të rreme barnat e lartpërmendura, ndëshkohet me burgim deri në një muaj ose me gjobë të rëndë nga 15 deri në 200 franga ari"*. Shihet që përmes kësaj dispozite ligjore, përcaktoheshin qartë veprimet që inkriminoheshin, me qëllim sigurimin e administrimit të barnave, sipas rregullave të përcaktuara me ligje të asaj kohe.

Ndërsa dispozitat e neneve 360, 362 dhe 363, të Kodit penal, parashikonin kryerjen në rrethana rënduese të veprave penale të parashikuara nga nenet 358 dhe 359, duke sanksionuar edhe dënime më të rënda ndaj autorëve të tyre.

Konkretisht, në paragrafin 1 të nenit 360 të Kodit penal përcaktohej: *"n.q.s. prej fajeve të parashikuara në nenet 358 e 359 shkaktohet vdekja ose lëndimi trupor i ndonjë personi, burgimi i rëndë nuk mund të jetë më pak se 5-vjet në rastin e parë dhe jo më pak se 3-muaj në rastin e dytë"*. Kurse në paragrafin 2, përcaktoheshin si rrethana cilësuese rënduese rastet, kur *"nga fajet e mësipërme shkaktohet vdekja e dy ose më shumë personave ose vdekja e njërit vetëm dhe lezioni trupor i një ose me shumë të tjerëve"*. Paragrafi 3, i nenit 360, parashikonte si rrethanë cilësuese rënduese rastet që kishin *"si pasojë vetëm lëndimin trupor të dy ose me shumë personave, duke parashikuar një dënim jo më pak se 6 muaj"*.

Edhe në nenin 362, përcaktuar rrethanë cilësuese rënduese: *"Kur ndonjëri nga deliktet e parashikuara në këtë titull bëhet nga një person që është ngarkuar me shërbimet, punimin ose ruajtjen e materialeve të cilat tregohen po në atë titull, dënimit për fajin i shtohen edhe 1/6 deri 1/3 e tij"*. Kjo është shprehje e qartë e penalizimit të personave që, për shkak të detyrës, administrojnë dhe punonin me substancat e përmendura në nenin 358.

Ndërsa neni 363 përcaktonte rrethana lehtësuese, si: “kur në deliktet e parashikuara në kaptinat e para të këtij titulli, rreziku që shkactohej nga faji ishte mjaft i vogël, ose kur fajtori ishte kujdesur dhe kishte vepruar në mënyrë efektive për ndalimin ose kufizimin e pasojave të rrezikut. Në raste të tilla ndëshkimi mund të zbriste nga 1/3 deri në 2/3”.

3.3. Kodi penal i vitit 1952

Me ndryshimet politike pas Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri u bënë ndryshime edhe në legjislacionin penal. Fillimisht, në vitin 1948, me dekret nr.615, datë 13.5.1948, u shpall Ligji nr.599, datë 13.05.1948: Kodi Penal-Gazeta Zyrtare nr.63, E premte, 4 qershor 1948, f.1-15, me gjithsej 106 nene, hyri në fuqi pjesa e përgjithshme e Kodit penal të asaj kohe. Kurse në vitin 1952 u miratua Kodi penal, që kishte dy pjesë: pjesën e përgjithshme dhe atë të posaçme. Neprat penale në fushën e narkokriminalitetit në atë kohë listoheshin në pjesën e posaçme të Kodit penal, në kapitullin XI, “Krimet kundër rendit administrativ”, dhe në kreun VII, “Krimet kundër shëndetit të popullit”, përkatësisht, në nenin 284.

Me krime kundër rendit administrativ kuptoheshin atë kohë ato vepra (veprime ose mosveprime), shoqërisht të rrezikshme e të kundërligjshme (Elezi,1974:430-431).

Në Kodin e ri Penal të vitit 1952, tërheq vëmendjen neni që trajton problemet e kultivimit, prodhimit dhe mbajtjes, me qëllim shitjen të lëndëve narkotike dhe dënimet që caktoheshin për këto vepra penale.

Është me interes fakti se edhe në Kodin penal të vitit 1928, edhe në Kodin penal të vitit 1952 përcaktohet lloji i narkotikut **hashash**, por me një dallim: në paragrafin 1, të

nenit 284 të Kodit penal të vitit 1952, është përcaktuar si veprim i kundërligjshëm *mbjellja e hashashit pa lejen e duhur*. Kjo e fundit është një risi, në krahasim me Kodin e vitit 1928 të mbretërisë, ku nuk bëhej fjalë për mbjelljen e hashashit.

Gjithashtu, në nenin 284 vëmë re që sanksionohet edhe konfiskimi i bimëve të mbjella. Mendojmë se shtysë për hartimin e këtij neni, lidhur me kultivimin e bimëve narkotike, nuk ka qenë thjesht prirja për ta parashikuar se kjo veprë mund të ndodhë në të ardhmen, por sepse qysh atëherë duhet të ketë pasur praktikisht veprime konkrete për mbjellje parcelash me hashash në zona të ndryshme të vendit, ku e favorizonte klima. Kjo na bën të mendojmë se mbjellja në masë e kanabisit, që është kaq e përhapur sot në Shqipëri, nuk është një dukuri e re, por vazhdim i një praktike të vjetër, të cilën regjimi i asaj kohe e evitoi me ligjet e masat e tij të rrepta.

Me interes për mendimin teorik në fushën penale është edhe lloji i dënimit që sanksionohet në dy paragrafët e parë të nenit 284, për veprën penale të kultivimit dhe të shitjes së lëndëve narkotike: *dënimi me punë korrektuese*. Kjo, me sa duket, përputhej me politikën e kohës për edukimin nëpërmjet punës, kuptohet, në varësi të figurës së subjektit dhe të familjes së tij apo të shkallës së përfshirjes në veprën penale në fjalë etj.

Lidhur me këtë, theksojmë edhe diçka tjetër. Sipas nenit 24 të Kodit të procedurës penale dhe nenit 17 të ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, dënimi me *punë korrektive* mund të zëvendësohet nga gjykata me heqje lirie, nëse subjekti nuk përmbushte detyrimet e tij (Gjika, 1974:308). Me këtë, ligjvënësi diktonte tolerancën zero për krimet e kësaj natyre. Nëse i dënuari nuk plotësonte kushtet e vëna, merrte dënimin që parashikonte ligji, pa asnjë lehtësim.

Lidhur me nenin 284, të Kodit penal të vitit 1952, vëmë re që në Paragrafin 3 parashikohej në formë taksative që *“veprat e kryera nga paragrafët e mësipërm (të dispozitës 284–shën. im–R.K.) të kryera me mjeshtri dënohen me heqje të lirisë deri në 3-vjet dhe me konfiskimin e lëndëve të përmendura”*.

Këtu të bie në sy një masë e re dënimi, ku nuk përmendet dënimi *me punë korrektuese*. Kjo, me sa duket, ka të bëjë me cilësimin e veprave penale si të kryera me mjeshtri, që na bën të mendojmë se bëhet fjalë për veprime të paligjshme, si përpunimi, përzierja e lëndëve narkotike, mbajtja e pajisjeve për këtë etj., probleme këto që meritojnë të hulumtohen nga juristët dhe ekspertët e fushës.

3.4. Kodi penal i vitit 1977

Në vitin 1976, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë miratoi Kushtetutën e vendit, e cila bazohej kryesisht në mendimin politik dhe ideologjik. Një vit pas miratimit të saj, në vitin 1977, me ligjin nr.5591, datë 15.6.1977, Fletore Zyrtare, Tetor, Tiranë, u miratua edhe Kodi penal, i cili, në përgjithësi, paraqet një regres, në krahasim me Kodin penal të vitit 1952. Në këtë periudhë, preokupimi më i madh ishte ndjekja dhe luftimi i armiqve të pushtetit, sesa luftimin i dukurive të tjera kriminale, ndaj ky Kod penal nuk pati ndonjë përparim lidhur me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit. Ai kishte vetëm një dispozitë ligjore, nenin 134/2, në seksionin IV, “Krimet kundër sigurimit shoqëror, kreu VIII, “Krimet kundër rendit administrativ”, ku sanksionohej: *“Përgatitja, mbajtja dhe shitja e lëndëve narkotike dënohet me riedukim nëpërmjet punës ose me dënim me heqje lirie deri në 10-vjet”*.

Objekt i kësaj figure krimi ishin marrëdhëniet juridike të vendosura në shtet për të siguruar kontrollin e administrimin e lëndëve narkotike në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Rregullat në lidhje me ruajtjen, përdorimin, dhënien e lëndëve narkotike nga farmacitë, spitalet etj., ishin caktuar nga Ministria e Shëndetësisë (Elezi,A.,2012:55-56).

Actus reusi (elementi i sjelljes), në këtë figurë krimi, paraqitet në tri veprime: përgatitja, mbajtja, apo shitja e lëndëve narkotike.

Në formulimin e këtij neni bie në sy ndryshimi i masës së dënimit të veprave penale të narkokriminalitetit, në krahasim me Kodin penal të vitit 1952. Gjithashtu, në vend të *punës korrektuese*, këtu kemi një formulim të ri, *riedukim nëpërmjet punës*, pra, nuk quhej ‘dënim’, por ‘riedukim’, gjë që flet për ndikimin e politikës shtetërore e partiake të kohës në legjislacion dhe në organet e drejtësisë.

3.5. Legjislacioni penal pas vitit 1990

Viti 1990 është vit i rëndësishëm për shtetin shqiptar, pasi përmbysja e sistemit dhe hapja e Shqipërisë sollën ndryshime të mëdha politike, ekonomike dhe sociale në vend. Shqipëria ishte përshkruar gjithmonë si vendi më i varfër dhe më pak i zhvilluar i Europës, mbase dhe i vetmi vend në kontinent ku standardet e jetesës ishin të njëjta me ato të vendeve të botës së tretë (Bufi.Y.,2002:16-17). Shqipëria kaloi në ekonominë e tregut dhe u bë një vend demokratik, vend i hapur dhe i mundësive.

Në këto rrethana, u vu re edhe fenomeni i keqkuptimit dhe i keqpërdorimit të lirisë dhe demokracisë, sidomos nga elementët kriminalë, që, duke përfituar edhe nga mungesa e stabilitetit dhe e rendit, filluan të veprojnë dhe të zgjerojnë aktivitetin e tyre kriminal. Hapja

e kufijve, lëvizja e lirë krijuan mundësitë që ata të zhvillojnë narkokriminalitetin brenda vendit, por edhe në vende të tjera të rajonit e më gjerë. Shqipëria nisi të përballej me drogat dhe dalëngadalë po kthehej në një pikë kyçe për krijimin dhe veprimin e rrjeteve të trafikimit dhe të shpërndarjes së narkotikëve që vinin nga vendet e origjinës, Afganistani dhe Pakistani, për në vendet e destinacionit, në Europën Perëndimore. Narkokriminaliteti po merrte formën e krimit të organizuar.

Megjithë ndryshimet e mëdha të sistemit politik dhe ekonomik dhe me problemet e krijuara në fushën e kriminalitetit në përgjithësi, deri në vitin 1994, ligjet dhe kodet ishin ende ato të sistemit të kaluar. Vetëm në janar 1995, bazuar në Ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, Kuvendi i Shqipërisë, miratoi Kodin e ri penal, që hyri në fuqi më 1 qershor 1995. Ky kod, ndryshe nga kodet e mëparshme penale, trajton disa vepra penale në fushën e narkokriminalitetit, duke përcaktuar qartë veprimet e kundërligjshme në këtë fushë.

Gjatë viteve të tranzicionit, falë edhe pozicionit të saj gjeografik, Shqipëria ka pasur dhe ka si problem të madh dhe shqetësues trafikimin dhe kultivimin e përdorimin e narkotikëve. Kjo nxori në pah nevojën për ndërhyrje në legjislacionin penal, për pëmirësimin dhe plotësimin e tij, si dhe për harmonizimin me legjislacionin e vendeve të tjera.

Në përputhje me këto kërkesa, që diktoheshin nga situata e rëndë e krijuar në fushën e narkokriminalitetit, në Kodin penal, Kreu VIII, "Krime kundër autoritetit të shtetit", në seksionin III, "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike", veprave penale në këtë fushë u kushtohen katër nene: neni 283: *Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*; neni 284: *Kultivimi i bimëve narkotike*; neni 285: *Mbajtja e pajisjeve për prodhimin e narkotikëve*; dhe neni 286: *Nxitja për përdorimin e drogës*.

Këto dispozita kanë të bëjnë pikërisht me temën e këtij punimi doktorature dhe meritojnë një interpretim në kuadrin e mendimit teorik të fushës penale.

Sipas këtyre dispozitave, veprat penale konsiderohen të konsumuara kur personi i kryen me dashje dhe në momentin që i kryen ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe është i përgjegjshëm.

Neni 283 i Kodit Penal të vitit 1995 e zgjeron shumë objektin grupor të figurës së krimit, e shtrin atë në marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar ligjshmërinë dhe kontrollin e: *prodhimit, përzierjes, përgatitjes, shpërndarjes, mbajtjes, ofrimit për shitje, shitjes, shpërndarjes me çdo mënyrë, transportimit të çdo lloj droge narkotike ose substance psikotrope në kundërshtim me dispozitat ligjore, si dhe jetën e shëndetin e personit të mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale* (Elezi, 2009:512-531).

Duke shprehur qartë përgjegjësinë penale që ka çdo person i përfshirë në kryerjen e veprave të mësipërme, ky nen, me të drejtë, ka rënduar edhe dënimin me burg, që shkon nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 284 i referohet veprës penale të *kultivimit dhe tregtimit të bimëve apo farërave që shërbejnë për prodhimin e narkotikëve*. Edhe pse kur Kodi penal hyri në fuqi, kryerja e kësaj vepre nuk ka qenë e përhapur, në dekadën e fundit, me gjithë plotësimet/ndryshimet që i janë bërë legjislacionit, megjithëse forma më e rëndë e kësaj vepre dënohet më rreptë, ajo ka shënuar rritje, që duket në shtimin e sipërfaqeve të mbjella me *Canabis sativa L.*, edhe në rastet e proceduara penalisht për këtë krim. Kjo tregon se krimi nuk ndalet as para shtërngimit të sanksioneve penale, prandaj agjencitë e zbatimit të

ligjit duhet ta intensifikojnë edhe më tepër punën e tyre parandaluese dhe forcën goditëse dhe të mos nisen nga ideja se thjesht forcimi i ligjit do t'ua presë rrugën kriminelëve.

Si rrethanë të cilësuar të kësaj vepre penale, Kodi penal e parashikon organizmin, drejtimin, ose financimin e veprimtarisë kriminale të përmendur më lart e për të cilën kryerësi ose kryerësit dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim.

Neni 285 i k.p. sanksion se *“mbajtja, prodhimi, transferimi, shpërndarja e pajisjeve, e materialeve ose e substancave që janë përdorur ose do të përdoren për prodhimin e drogës narkotike ose substancave psikotrope, dënohen me burgim gjer në pesë vjet”*.

Kurse në nenin 286 përcaktohet si vepër penale nxitja e personave për përdorim të drogave. Duhet thënë se kjo paraqet një risi në këtë Kod penal, pasi, në përmbajtjen e nenit 286 theksohet qartë se është vepër e paligjshme dhe e dënueshme nxitja e përdorimit të drogës narkotike ose injektimi i saj pa pëlqimin e të dëmtuarit, si dhe kur kjo vepër bëhet ndaj fëmijëve ose në institucione penale, shkollore, sportive etj. parashikon dënime shumë të rënda për autorët.

Ndryshimet dhe përmirësimet e tjera në Kodin Penal

Përhapja e trafikimit të lëndëve narkotike, shtimi i aktivitetit të grupeve të krimit të organizuar në këtë fushë diktonin nevojën që të ndërhyhej në legjislacion, të bëheshin plotësime dhe përmirësime të tjera, me qëllim rritjen e efikasitetit të luftës kundër narkokriminalitetit. Në fund të viteve '90 dhe në vitet 2000 u bënë disa ndryshime në Kodin penal, përmirësime këto, që konsiderohet se ishin mjaft të nevojshme, duke

plotësuar me elemente të reja dispozitat ligjore që rregullojnë veprat penale në fushën e narkokriminalitetit.

Këto ndryshime filluan 3 vjet pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal, nga viti 1998, me ligjin nr.8279 datë 15.1.1998, ndryshuar më pas me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001, *Për trafikimin e narkotikëve* (neni 283/a). Ky ligj paraqet një risi, pasi sjell shtimin në Kodin penal të veprave kriminale të dënueshme në fushën e narkokriminalitetit (neni 2, paragrafët *dh, e, ë dhe f*, të ligjit). Konkretisht u shtua neni 283 a, “Trafikimi i Narkotikëve” sipas të cilit, *Krijimi nga ana e personave, që për shkak të detyrës administrojnë substanca të tilla, i lehtësirave për marrjen a përdorimin e narkotikëve në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore dënohet deri në 10 vjet burgim”*.

Për të kufizuar rrethanat që lehtësojnë marrjen dhe përdorimin e drogës, është shtuar këtu edhe neni 283/b, që inkriminon *personat, që, për shkak të detyrës, administrojnë substanca narkotike dhe, në kundërshtim me ligjin, u krijojnë lehtësi kriminelëve dhe narkomanëve marrjen a përdorimin e tyre*.

Kjo ka shumë rëndësi për vendin tonë, ku komprometimi dhe korruptimi i zyrtarëve shtetërorë, i punonjësve të administratës etj. janë bërë dukuri që i kanë zënë frymën shoqërisë. Ndaj themi se përcaktimi për të vënë para ligjit dhe organeve të drejtësisë personat zyrtarë që favorizojnë narkokriminalitetin, është me vend dhe i ndërmarrë në kohën e duhur.

Po në këtë kuadër, shumë pozitive është inkriminimi i personave me funksione shtetërore, që krijojnë kushte apo lehtësi për veprimtari kriminale, si *organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatave kriminale që merren me kultivimin, prodhimin, fabrikimin, ose trafikun e paligjshëm të narkotikëve* (neni 284/ a).

Mendojmë se edhe ky përmirësim i Kodit penal ka qenë shumë i domosdoshëm, jo vetëm ngaqë veprimtari të tilla u bënë tepër të pranishme në Shqipëri, por edhe për një arsye tjetër shumë të rëndësishme, sepse ky nen, që dikton vënien nën sundimin e ligjit të zyrtarëve të veshur me pushtet, kontribuon edhe në minimizimin e fenomenit antiligjor të mosndëshkueshmërisë së personave zyrtarë të të gjitha niveleve, fenomen ky që ekziston prej 25 vjetësh dhe është bërë mjaft irritues në perceptimin popullor, por edhe atë ligjor.

Në kuadrin e përpjekjeve të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me atë të vendeve Perëndimore, ligjvënësit shqiptarë, bazuar në orientimet e politikës penale ndërkombëtare lidhur me krimin e organizuar në përgjithësi, dhe atë të narkokriminalitetit, në veçanti, kanë vlerësuar nevojën e bashkëpunimit mes organeve policore dhe të drejtësisë me institucione dhe individë. Për ta inkurajuar dhe mundësuar këtë bashkëpunim ata shtuan nenin 284/ b: *Ndihma në zbulimin e krimeve*.

Ky nen ka të bëjë me favorizimin dhe lehtësimin e dënimit të atyre autorëve të veprës penale, të cilët, në kushtet e pendimit, pranojnë të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë organet e drejtësisë për parandalimin dhe zbulimin e aktiviteteve kriminale dhe të autorëve të tyre. Sigurisht që një ndërhyrje e tillë në legjislacion e bën këtë më bashkëkohor dhe e afron me normat juridike e penale të komunitetit europian, ku synojmë të integrohemi. Nga ana tjetër, edhe shtetasit e përfshirë në vepra kriminale, kur shohin që me ligj favorizohen, nëse ndihmojnë dhe bashkëpunojnë, e mirëpresin këtë, e bëjnë këtë hap, që mund t'i shpjerë ata edhe në rrugën e shkëputjes nga krimi.

Neni 63 i këtij ligji përcakton që të ndryshonte dispozitën ligjore e nenit 283, duke konsideruar vepra penale edhe katër mënyra të tjera të kryerjes së krimit, si: *dhënia ose*

marrja në çdo formë, tregtimi dhe dorëzimi i substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike. Me sa duket, këto vepra penale u shtuan, ngaqë në praktikë ato kishin marrë një përhapje dhe zhvillim shqetësues. Prandaj themi se ky nen i Kodit penal pati një plotësim të justifikuar dhe mjaft të dobishëm.

Bazuar në konventat ndërkombëtare, është ndryshuar dispozita e këtij neni duke mos inkriminuar veprimet e personave, që ‘vetëm për përdorim vetjak dhe në doza të vogla japin ose marrin në çdo formë, mbajnë, dorëzojnë substanca psikotrope apo farëra të bimëve narkotike’. Kjo është në të mirë të këtyre personave në planin penal, por, njëkohësisht, tregon se shteti ligjor dhe demokratik vepron në përputhje me aktet juridike ndërkombëtare, me marrëveshjet dhe koventat e ndryshme ku bën pjesë. Kjo na afron edhe më shumë në bashkëpunimin dhe në partneritetin me shtetet dhe me organizmat ndërkombëtarë në fushën e jurisprudencës dhe të luftës kundër narkokriminalitetit.

Theksojmë se ligjvënësi, pa e cenuar këtë, ka vlerësuar drejt që, për shkak të shkallës së rrezikshmërisë që bart kryerja e kësaj vepre penale, thekson që autorët *dënohen me burgim të rëndë*.

Ndërsa me dispozitën e nenit 64 të ligjit të përmendur, u parashikua ndryshimi në tërësi i dispozitës së nenit 283/a, duke përcaktuar një figurë tjetër krimi dhe duke parashikuar si veprime të kundërligjshme: *importimin, eksportimin, tranzitimin dhe tregtimin, në kundërshtim me ligjin, të substancave narkotike ose psikotrope, si edhe të farërave të bimëve narkotike.* Po ashtu, këtu u shtua paragrafi 2, që parashikon rëndimin e masës së dënimit, kur vepra penale kryhet *në bashkëpunim ose më shumë se një herë*.

Presupozohej që kjo dispozitë, e formuluar dhe e miratuar në këtë mënyrë, të jepte efektet e saj në praktikë në reduktimin e kryerjes së këtyre veprave penale të narkokriminalitetit.

Me sa duket, për shkak të rritjes drastike të numrit të parcelave të kultivuara me bimën *Canabis sativa L*, u pa i nevojshëm ndryshimi në dy paragrafë të nenit 284 dhe plotësimi i një tjetri. Në paragrafin 1, u shtua si i kundërligjshëm *Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope*. Paragrafi 2 u shtua edhe parashikimi i kryerjes së veprës penale *në bashkëpunim, ose më shumë se një herë*, njëkohësisht, duke rritur masën e dënimit nga "nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet".

Krahas përcaktimit si vepër penale prodhimin dhe trafikimin e drogave, u parashikuan vepra të reja penale, jo vetëm për të përafëruar Kodin penal shqiptar me Konventën e Palermos, por edhe si nevojë për parandalimin dhe dënimin e krimeve të reja me narkotikë. Kështu u shtuan dy vepra të reja penale: "Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope" (neni 284/c). Me këtë ndryshim dënohen "*prodhimi, fabrikimi, nxjerrja, rafinimi, përgatitja pa licensë ose në kapërcim të përmbajtjes së tij i lëndëve narkotike dhe psikotrope*". Si rrethana rënduese janë parashikuar kryerja e veprës *në bashkëpunim*, si dhe *organizimi, drejtimi, ose financimi i saj*.

Ndryshimet në Kodin penal, të vitit 2001, sollën si risi kriminalizimin e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të paligjshëm të prekursorëve, të kryer nga një person i vetëm ose "*në bashkëpunim ose më shumë se një herë, si dhe organizimin, drejtimin ose financimin e kësaj veprimtarie*" (neni 284/ç).

Për shtimin e masave preventive efikase për kontrollimin dhe luftën kundër narkokriminalitetit, në nenin 68 të ligjit nr.8773, përcaktohet që neni 285, të ndryshohet te pjesa e substancave kimike bazë ose e substancave të tjera të çfarëdollojshme, e pajisjeve, e materialeve, në rast se dihet që ato përdoren ose do të përdoren, për prodhimin, ose trafikimin e paligjshëm të substancave narkotike a psikotrope. Po ashtu, u ndryshua edhe sanksioni penal, duke e ngritur dënimin nga tre gjer në dhjetë vjet burgim për autorin e kësaj vepre penale.

Me qëllim që të mbrohen individit dhe shoqëria nga dukuria e narkomanisë, u shtua në Kodin penal dispozita ligjore 285/a, e cila penalizon veprimet e kundërligjshme të përshtatje apo lejim për përshtatje të ambienteve private dhe publike apo sendeve, me qëllim që personat e tjerë të konsumojnë narkotikë apo substanca psikotrope.

Ky fenomen kishte filluar të shfaqej rëndom nëpër qytetet e mëdha, ndaj dhe nuk mund të anashkalohej më nga legjislacioni penal.

Një dukuri tjetër negative që nisi të përhapej nëpër mjediset publike apo të hapura ishte dhe hedhja e shiringave ose e instrumenteve të tjera që shërbejnë për injektimin apo pirjen e drogave. Kjo u vlerësua jo vetëm si ndotje e mjedisit, por, më së shumti, edhe si një rrezik për mundësinë e ripërdorimit të tyre për konsumimin e narkotikëve. Prandaj u ndie e nevojshme të penalizohej si veprim i kundërligjshëm *hedhja apo braktisja e shiringave* ose e instrumenteve të rrezikshme në vende publike apo të hapura për publikun. Për këtë, u shtua neni 285/b, që penalizon individët dhe institucionet e ndryshme mjekësore apo laboratorët e ndryshëm, që kryejnë këtë vepër penale.

Po me ligjin nr.8773, të vitit 2001, u bënë ndryshime edhe në nenin 286 të Kodit penal. Në këtë dispozitë u shtua veprimi i kundërligjshëm, që nuk ishte përcaktuar më parë:

dhënia në përdorim ose injektimi i drogave tek të tjerët, *pa dijeninë dhe pa pëlqimin e tyre...*

Kjo pjesë e shtuar u vjen në ndihmë sidomos organeve të hetimit dhe atyre gjyqësore në vlerësimin e veprës penale, që më parë paraqitej e ndërlikuar. Autorët e këtij veprimi tani inkriminoheshin vetëm kur e kryenin atë në mënyra të kamufluara, ndërsa viktimat, ose nuk vihej në dijeni, ose mashtrohej në forma të ndryshme, ose, kur ajo rezistonte, mbi të ushtrohej dhunë për ta konsumuar drogën. Me këtë nen bëhej më e qartë pozita e atij që e kryente këtë veprim.

Neni 71, i ligjit nr.8773, përcakton që pas nenit 286, të shtohet neni 286/a, *Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë.*

Plotësimi i Kodit penal me këtë dispozitë ishte një hap i kohës dhe një përgjigje e fortë ndaj avancimit dhe sofistikimit të krimit të organizuar në fushën e drogave, i cili, duke shfrytëzuar mundësitë financiare, përsoste praktikën dhe format e kryerjes së veprimtarisë tij, dhe përdorte arritjet teknologjike, edhe ato të fjalës së fundit, përfshi edhe laboratorë modernë të drogës.

Edhe pas vitit 2001, sidomos me ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” (me ligjin nr.8920, datë 11.7.2002), Kodi penal shqiptar është përmirësuar disa herë, me ligje të veçanta.

Në vitet 2004 dhe 2006 (me ligjin nr.9271, 9 shtator 2004, dhe me ligjin nr.9559, 8 korrik 2006) është ndryshuar ligji nr.7975, 21 korrik 1995, “Mbi substancat narkotike dhe psikotrope” (*Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr.20, 25 gusht 1995, f.853*), i cili përcakton rregullat e prodhimit, manifakturimit, importit, eksportit, ruajtjes dhe tregtimit të

substancave narkotike dhe psikotrope. Lista e drogave nën kontroll është pjesë e këtij ligji (EMCDDA,2013:2-35).

Ndryshime iu bënë edhe ligjit nr.8750, datë 26.3.2001, për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope (*Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr.14, 13 prill 2001, f.391*), që përcakton standardet për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të drogave dhe lëndëve për prodhimin e tyre. Ligji lejon përdorimin e metodave të detajuara hulumtuese, siç janë ‘blerja e simuluar’, ‘dërgesat e kontrolluara’ dhe agjentët ‘e infiltruar’ ose ‘të fshehtë’. Gjithashtu, në këtë ligj është parashikuar krijimi dhe funksionimi i Komitetit Kombëtar për Koordinimin e Luftës kundër Drogë (EMCDDA,2013:2-35).

Me rëndësi është edhe ligji nr.8874, 29 mars 2002, “Për kontrollin e lëndëve që mund të përdoren për prodhimin e paligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope” (*Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, nr.12, 29 prill 2002, f.359*). Ai përcakton rregullat për kontrollin e substancave që shpesh përdoren për prodhimin e paligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope, me qëllim parandalimin e shpërndarjes apo shmangien nga destinacioni ligjor i substancave të tilla. Lista e substancave nën kontroll është pjesë e këtij ligji. Edhe ligji nr.9108, datë 17.7.2003, “Për substancat dhe preparatet kimike”, rregullon administrimin e substancave dhe të preparateve kimike për mbrojtjen e jetës, të shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe të mjedisit nga rreziqet që mund të shkaktojnë lëndët e rrezikshme.

Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nuk mund të jenë efikasë, nëse nuk goditen edhe pasuritë e individëve apo të grupeve të krimit të organizuar, të vëna nga veprimtaritë kriminale. Ligji nr.10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e

krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” është një hap i rëndësishëm në mbushjen e boshllëkut që ekzistonte në legjislacion në këtë fushë, si edhe për përafrimin e politikës penale shqiptare me standardet ndërkombëtare. Ligji përcakton qartë procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe në trafikimin e narkotikëve. Nga vetë qëllimi që përcaktohet në ligj del e qartë se ai vepron ndaj çdo personi të dyshuar. Pra, nuk kërkohet që personi të jetë i dënuar në vendim penal të formës së prerë. Ky nuk është një ligj penal, por ka ndikim të drejtpërdrejtë në goditjen e aseteve dhe të pasurive të vëna nga persona të përfshirë në veprimtari kriminale.

Ndryshime u bënë edhe në Kodin e procedurës penale, lidhur me llojet e hetimeve të veçanta që ndërmerren. Sipas ligjit nr.8750, datë 26.3.2001, për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope, i jepet e drejta prokurorit të aplikojë masa të ndryshme hetimi, si vëzhgimi, përgjimi, ndalimi në rrugë, dërgesat e kontrolluara, operacionet sekrete etj., që, aktualisht, kanë treguar se janë shumë të dobishme për zbulimin e rrjeteve kriminale të lidhura me trafikimin e drogave (Ligji nr.8750).

“Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit 2013-2020” dhe “Plani i veprimit shumësektorial”, që, tashmë, janë hartuar dhe miratuar në Republikën e Shqipërisë, përveç të tjerash, shtrojnë nevojën e vazhdimit të përpjekjeve për përsosjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të legjislacionit që lidhet me parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit. Kjo do të thotë që ky proces asnjëherë nuk quhet i përfunduar.

Si përfundim, mund të themi se ndryshimet e shpeshta dhe të shumta të legjislacionit që rregullon fushën e veprave penale të narkokriminalitetit janë jo vetëm një proces normal në zhvillimin e përsosjen e legjislacionit, por edhe një domosdoshmëri e kohës, që t'u përgjigjen situatave dhe përhapjes së krimit të krimit të organizuar me narkotikët.

3.6. Veprat penale në fushën e narkokriminalitetit në Kodin penal të ndryshuar

Siç e pamë dhe më sipër, me ndryshimet e bëra, në legjislacionin e fushës së narkokriminalitetit janë përfshirë edhe dispozita të reja, janë përmirësuar dhe plotësuar shumë të tjera, si dhe janë përcaktuar dhe plotësuar mjaft inkriminime veprash penale. Kjo nxjerr nevojën që këto dispozita, nene dhe paragrafë të njihen mirë, të lexohen dhe të interpretohen sa më mirë nga gjyqtarët dhe prokurorët, nga ekspertët dhe juristët, nga studiuesit, nga pedagogët e studentët, si dhe nga strukturat e tjera të zbatimit të ligjit. Kjo është e domosdoshme, sidomos për zbatimin sa më të drejtë të tyre në praktikë. Dihet që në Shqipëri ka ligje të mira, por drejtësia vuan, ngaqë këto ligje nuk zbatohen si duhet në praktikë, ose zbatohen të shtrembëruara, ose sipas interesave të politikës, duke cenuar, kështu, në mënyrë flagrante dhënien e drejtësisë. I tillë është, tashmë, perceptimi dominues i publikut të gjerë për organet shqiptare të drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit, por edhe i ndërkombëtarëve.

Tashmë, është pranuar si brenda vendit, por edhe nga organizmat ndërkombëtare që Shqipëria është një nga vendet e origjinës së narkotikëve, si marihuana dhe hashishi, kurse heroina përpunohet dhe trafikohet në sasi të mëdha, për në vendet e Europës Perëndimore

(US Dept of Statet,2011a:106-111). Kjo është një arsye më shumë që këto dispozita të ndryshuara dhe të përmirësuara të Kodit Penal të Shqipërisë dhe veprat penale të narkokriminalitetit që përcaktohen në to, të analizohen në mënyrë të detajuar në anën objektive dhe subjektive të figurës së krimeve.

Në vijim, jemi përpjekur të bëjmë një paraqitje dhe analizë të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit sipas Kodit penal të ndryshuar, por edhe duke iu referuar praktikës gjyqësore në disa gjykata të Republikës së Shqipërisë.

Në kreun VIII, seksioni III, “Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike”, të Kodit penal të ndryshuar parashikohen trembëdhjetë dispozita ligjore, ku përcaktohen veprat penale në fushën e narkokriminalitetit. Krahas tyre, parashikohen edhe kundërvajtje penale në fushën përdorimit të substancave narkotike ose psikotrope dhe me ndryshimet e bëra në vitin 2004, kriminalizohen si vepër penale më vete organizatat kriminale (neni 333) dhe grupet kriminale të strukturuar (neni 333/a).

Prodhimi dhe shitja e narkotikëve (Neni 283)

Gjatë dekadave të fundit, në Shqipëri, numri i atyre që prodhojnë dhe shesin drogë, është rritur. Për këtë arsye u rishikua dispozita për këto vepra penale.

Figura e veprës penale ‘Prodhimi dhe shitja e narkotikëve’ - Paragrafi 1, i nenit 283, përcakton nëntë veprimet e kundërligjshme që përbëjnë figurën e këtij krimi: shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi dhe mbajtja e substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave

të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tij, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla.

Me interes është fakti që edhe në praktikën gjyqësore, kjo dispozitë e Kodit penal përgjithësisht, zbatohet drejt. Këtë e shohim edhe në vendimin me numër të regjistrimit themeltar Nr.1593/397 dhe numër të vendimit nr.427, të Kolegjit penal të Gjykatës së Apelit në Tiranë, datë 25.4.2014, në të cilin janë konsideruar si forma të kryerjes së veprës penale nga dispozita e nenit 283, paragrafi 1, të nëntë veprimet e mësipërme.

Vepra penale quhet e konsumuar edhe kur subjekti ka kryer një nga veprimet e parashikuara, përveç rastit kur personi që e kryen, i ka narkotikët, substancat psikotrope apo farërat e bimëve narkotike *për përdorim vetjak dhe në doza të vogla*.

Duke marrë për bazë numrin e përdoruesve dhe të shpërndarësve apo, siç njihen, *“shitës të vegjël”*, penalizimi i këtyre veprimeve është i domosdoshëm. Si forma më e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet kur ajo kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë.

Nga ana objektive, krimi kryhet me veprime aktive ose mosveprime shoqërisht të rrezikshme e të kundërligjshme, në disa mënyra dhe forma. Nga ana subjektive, vepra konsiderohet krim kur kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, sepse personi parashikon kundërligjshmërinë e veprimeve të tij dhe i dëshiron ose me ndërgjegje i lejon pasojat (Elezi,2009:512-531).

Paragrafi 3, i nenit 283, përcakton formën më të rëndë të veprës penale, duke përcaktuar tri veprime të kundërligjshme: organizimin, drejtimin dhe financimin e veprimtarisë me narkotikë.

Në këtë dispozitë vihet re që nuk penalizohet posedimi i substancave narkotike ose psikotrope për nevoja ose përdorim personal dhe në doza të vogla. Kjo do të thotë që subjekti që i posedon ato për këtë qëllim, mund të mos ndiqet penalisht dhe gjykata mund ta lirojë nga përgjegjësia penale.

Nënvizojmë se ky mendim, që është në bazë të interpretimit të dispozitës sipas normës juridike, mbështetet edhe nga pikëpamja e shkencave mjekësore, sipas së cilës subjektet nuk mund të jenë përgjegjës penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi 1, nëse substanca narkotike apo substanca psikotrope, që u kapet në posedim, është në doza të vogla edhe nëse përmes metodave shkencore arrihet në përfundim se personi është përdorues i substancave narkotike.

Megjithatë, mendoj se këtu ka një problem. Në praktikë, shitësit e substancave narkotike ose psikotrope, duke e njohur mirë ligjin, për t'iu shmangur atij, në shumicën e rasteve, nuk mbajnë sasi të mëdha të këtyre substancave, por, sasi të vogla, të ndara në varësi të llojit të narkotikëve. Për shembull, kur bëhet fjalë për marihuanë ose hashash, shpërndarësit mbajnë në posedim pako të vogla, në doza tre ose katërgramëshe, që konsiderohet se është një dozë për përdorim, e shumta, nga dy persona. Kjo është konstatuar shpesh në terren, kur agjencitë e zbatimit të ligjit janë përballur me persona që, në momentin e kapjes, kanë pasur në posedim doza të vogla narkotikësh. Në raste të tilla, agjentët e kanë të vështirë të përcaktojnë nëse personat që kapen janë apo nuk janë përdorues droge, ndaj, si fillim, për të qenë brenda, mbështesin versionin se ata janë përdorues. Raste të tilla krijojnë probleme edhe për organin e prokurorisë dhe për gjykatën në interpretimin e kësaj dispozite.

Prandaj lind nevoja që të ketë një përcaktim më të qartë se çfarë nënkuptohet me shprehjet “*përdorim vetjak*” dhe “*doza të vogla*”, ngaqë në ligj nuk ka një përcaktim ekzakt të sasisë së substancës narkotike që nuk përbën vepër penale. Kjo ka bërë që të krijohen pështjellime në interpretimin e këtyre shprehjeve dhe në çështjen sesi duhet të veprohet në këto raste. Kështu që është dashur dhe është pritur interpretimi dhe dhënia e mendimit nga ana e Gjykatës së Lartë, për të sqaruar dhe për të vendosur lidhur me zbatimin e kësaj dispozite të Kodit penal. Interpretimi i saktë dhe i drejtë i këtyre shprehjeve që përmban dispozita ligjore në fjalë, ka shumë rëndësi, pasi në praktikën gjyqësore, për motive nga më të ndryshme, në mjaft raste, persona që janë marrë me shitje, me ofrimin për shitje, me shpërndarjen etj. të substancave narkotike, janë përjashtuar padrejtësisht nga përgjegjësia penale.

Po sjellim këtu një rast të dhënies së mendimit për këtë problem nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë, duke ndihmuar në lehtësimin e interpretimit dhe zbatimit të kësaj dispozite.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Shqipëri, me vendim Nr.1 dhe Regj. Themeltar Nr.1, datë 27.03.2008, kanë dhënë vendim unifikues në lidhje me çështjen e interpretimit të togfjalëshit “*...përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla...*” dhe me njëjësimin e praktikës gjyqësore.

Gjyqtarët kishin vendosur ta kalojnë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me:

1) *Mbi cilat kritere duhet të bazohet gjykata për të përcaktuar nëse bëhet fjalë për “dozë të vogël” dhe a mund të përcaktohet konkretisht sasia maksimale e lëndës narkotike që do të konsiderohet “dozë e vogël”?*

2) *Kur doza çmohet jo e vogël, por mjekët e konsiderojnë për përdorim vetjak ditor, a do të konsiderohet mbajtja e saj si “për përdorim vetjak”?*

3) *Sasia e lëndës narkotike që përjashton nga dënimi personin për shkak të faktit që e ka për përdorim vetjak a duhet të ndryshojë në lidhje me llojin e lëndës narkotike?* (Vendimi Unifikues Nr.1(27.03.2008), p.3).

Vendimi unifikues i sipërcituar e ka interpretuar këtë çështje. Ai përcakton rregulla të veçanta dhe interpreton saktë togfjalëshin, duke vënë parakushte që duhet të plotësohen, me qëllim që të konsiderohet se personi ka ose jo përgjegjësi penale. Në këtë vendim gjykata arsyeton:

“e veçanta e rrethanës së “... përdorimit vetjak..” është se ajo nuk qëndron më vete. Ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se, duke u bazuar vetëm në ekzistencën e saj (të faktit të provuar tashmë, sipas të cilit lëndë narkotike dhe psikotrope etj. mbahet për përdorim vetjak), nuk ekziston edhe figura e krimit të parashikuar në nenin 283 të K. Penal. Kësisoj, ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se nuk ekziston baza ligjore (figura e krimit) për të marrë mbajtësin e tyre në përgjegjësi penale. Përkundrazi, për të mos u marrë mbajtësi i lëndëve të tilla në përgjegjësi penale, duhet të provohet se ekziston edhe rrethana e dytë, që ka lidhje me sasinë e këtyre lëndëve, e cila, sikurse shprehet ligjvënësi në vetë dispozitën e përmendur, duhet të jetë “në doza të vogla” (Vendimi unifikues nr.1, datë 27.03.2008).

Lidhur me nocionin juridik “doza të vogla”, Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në përfundimin unifikues se *doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo e substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël.* Gjykata arsyeton se përcaktimi i tillë i nocionit “në doza të vogla”, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit penal, veç rolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve dhe të personave që kanë varësi nga droga, luan dhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundërligjshëm të këtyre lëndëve, që, kur përhapet në përmasa të mëdha, shndërrohet në patologji sociale.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përmes vendimit unifikues çmojnë se *“përdoruesi i lëndëve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetjak, qoftë edhe në doza të vogla, kur është shpërndarës i saj, në një nga format që parashikon neni 283/1 i K.*

Penal, ka përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Çmojnë gjithashtu se, përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të K. Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së varësisë nga droga të personit konkret - mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope”.

Edhe pse vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është i rëndësishëm dhe qartëson në detaje figurën e krimit posaçërisht për çështjen e togfjalëshit të përcaktuar në dispozitën e nenit 283, paragrafi 1, në disa nga vendimet që kemi studiuar gjatë punimit të doktoraturës, vihet re mungesa ose moszbatimi i këtij vendimi unifikues, posaçërisht për çështjen “....përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të K. Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti....”.

Siç shohim në vendimin e tij me nr.56250-01373-00-2013, i Regj.Themeltar nr.00-2014-1072 i Vendimit (109), datë 16.04.2014, Kolegji i Gjykatës së Lartë ka konstatuar me të drejtë se Gjykata e Apelit, në arsyetimin ligjor të vendimit të ankimuar ka pretenduar, ndër të tjera, se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin nr.69, datë 29.01.2013, ka vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues nr.1, datë 27.03.2008, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë “kur nga gjykata në mënyrë të padrejtë janë thirrur në cilësinë e ekspertëve mjekë-ligjorë, ndërkohë që në vendimin e gjykatës është kërkuar të thirren ekspertë specialistë të fushës e, konkretisht, mjekë-toksikologë, meqenëse sasia e lëndës narkotike është 0.719 gram, duhet patjetër të kryhet një ekspertim i tillë, pasi në përgjigje të saj do të konkludohet nëse qëndron ose jo akuza e ngritur ndaj të pandehurit

Y.M. Në nenin 283/1 të Kodi penal është përcaktuar: “... përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla”.

Trafikimi i narkotikëve (Neni 283/a)

Pozita gjeografike e ka bërë Shqipërinë një oaz të grupeve kriminale dhe, nga ana tjetër, trafikimi i narkotikëve, paraqet një ndër veprat penale më të rrezikshme në fushën e narkokriminalitetit. Grupet e krimit të organizuar me origjinë nga Shqipëria, Pakistani dhe Turqia, zotërojnë tregun europian të trafikimit të heroinës (SOCTA,2013:20).

Nisur nga fakti se Shqipëria, si shumë shtete të tjera të Ballkanit Perëndimor, është bërë portë hyrëse e narkotikëve për në Europën Perëndimore, figura e krimit që lidhet me trafikimin e narkotikëve, është parashikuar në dispozitën e nenit 283/a të Kodit penal.

Objekt i këtij krimi janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar rendin dhe qetësinë, jetën e shëndetin e personit e posaçërisht rendin e transportimit, importimit, eksportimit, tranzitimit e të tregtimit të substancave narkotike, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale (Elezi,2009:512-531). Ndërsa subjekt i trafikimit të narkotikëve janë trafikanti i drogës ose financuesi i saj.

Figura e veprës penale ‘Trafikimi i narkotikëve’ – paraqet një rrezikshmëri mjaft të lartë shoqërore. Zakonisht, në kryerjen e saj përfshihen shumë persona, grupe të krimit të organizuar, sepse ndërmarrja dhe realizimi i veprimeve të kundërligjshme që përbëjnë figurën e veprës në fjalë, kërkojnë përgatitje të mëdha, organizime, financime dhe angazhim të shumë personave. Vlerësimet e kryera kanë treguar se “trafikantët shqiptarë”, kontrollojnë 70% ose më shumë të trafikimit të heroinës që hyn në një numër tregjesh

kryesore të destinacionit (Europës) dhe ata janë përshkruar si një "kërcënim për BE-në" nga ana e Këshillit të Europës, të paktën, për vitin 2005 (UNDOC,2008:6-15).

Në dispozitën e nenit 283/a të kodit penal shqiptar, është parashikuar: *“Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”*. Vepra penale bën pjesë në figurat e krimit, që karakterizohen si formale. Ekzistenca qoftë vetëm e njërës nga format e përcaktuara në ligj për kryerjen e veprës penale (importimit, eksportimit, tranzitimit apo tregtimit) do të duhet të interpretohet si kryerje e saj, pasi secila prej tyre qëndron më vete (Trenova, 2009:234).

Lidhur me diskutimet që kanë lindur në praktikë për kuptimin juridik të termit “trafikim”, i jemi referuar praktikës së Gjykatës së Lartë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të vendimit unifikues me nr.8/7 i Regj.Themeltar dhe numër vendimi 3, datë 24.01.2011, në paragrafin 18 të vendimit konkludojnë: *“Termi juridik i “trafikimit” njihet dhe përdoret tashmë gjerësisht nga akte të së drejtës ndërkombëtare dhe në legjislacione të vendeve të ndryshme. Në mënyrë të përgjithshme, në fushën e së drejtës, me trafikim është kuptuar veprimtaria a tregtimi, kombëtar ose ndërkombëtar, i paligjshëm, i mallrave dhe shërbimeve”*. Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në përfundim se kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të veprave penale të “trafikimit” sipas Kodit tonë Penal është parimi i territorit, i prekjes dhe i përdorimit të tij, me qëllim realizimin në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar (Vendimi unifikues Nr.3, datë 27.1.2011).

Neni 283/a, paragrafi 2, përcakton: *“Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”*. Pra, theksohet *“...ose më shumë se një herë...”*, domethënë, dy ose më tepër herë, në interval kohe të ndryshme, dhe me kusht që të mos jetë dënuar e të ketë marrë formë të prerë vendimi për rastin e parë, sepse ndryshe do të kemi përsëritje, në kuptim të nenit 50 të Kodit penal (Elezi, 2009:512-531).

Duke e arsyetuar në vendimin unifikues nr.3, datë 27.01.2014, lidhur me vendimin për kualifikimin e veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), Kolegjet e Bashkuara janë shprehur se ka rëndësi thelbësore të vërtetohet kryerja me dashje e veprimeve apo mosveprimeve konkrete për të realizuar, në mënyrë të kundërligjshme, qëllimin e dëshiruar nga autorët e veprës, hyrjen (sjelljen) ose daljen (dërgimin) e paligjshëm të narkotikëve nga territori shqiptar ose kalimin e paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar në atë të shteteve të tjera, kryesisht, për të realizuar përfitime të ndryshme për vete ose për të tretë. Bazuar në këto vlerësime, praktika gjyqësore shqiptare ka hasur në mjaft raste, kur është ngritur pyetja nëse vepra penale e parashikuar nga neni 283/a, *“Trafikim me narkotikë”* nuk mund të mbetet në fazën e tentativës. Një precedent me rëndësi paraqitet në vendimin me numër të Regjistrimit Themeltar nr:56260-01084-00-2013 dhe nr.00-2015-714 i Vendimit (50), i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili arsyeton:

“...Më datë 07.11.2012, rreth orës 21:30, nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Vlorë, në mjetin e lundrimit, peshkarexhë, me emrin “Serena Di Mare”, e cila ndodhej e ankoruar në vendin e quajtur “Tri Port”, Vlorë, është gjetur një sasi prej 1.115 (një mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) kg e 5 (pesë) g, sasi bimore, e dyshuar si lëndë narkotike, e llojit Cannabis Sativ. Kjo sasi e dyshuar si lëndë narkotike, është sekuestruar nga policia, si rezultat i një informacioni anonim, të ardhur me datë 07.11.2012, rreth orës 20.00, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, sipas të cilit, në anijen “Serena Di Mare”, e sapoankoruar në “Tri Port”, Vlorë, gjendej një sasi e madhe

lënde narkotike, e cila, nuk kishte arritur të trafikohej drejt Italisë, pasi koha e keqe, kishte detyruar anijen që të kthehej në Port. Lënda narkotike e siguruar nga personi me emrin “Besho”, që është i gjykuari A. M., do të transportohej në drejtim të Italisë. Fillimisht kjo lëndë narkotike e strehuar pranë zonës së “Triportit”, Vlorë me motorskafin në pronësi të të gjykuarit E. K., i shoqëruar nga të gjykuarit, vëllezërit R.X., alias E.Ç., dhe D.Ç., do të transportohej nga toka në det; sipas marrëveshjes së arritur me të gjykuarin Sokol Muho, te mjeti peshkarexhë “Serena Di Mare” në pronësi të këtij të fundit, e më pas nga ky mjet do të dorëzohej lënda narkotike në një skaf të shpejtë me 4 (katër motorë) në zonën e “Batllat e Semanit” pozicionuar në zonën veriperëndimore të Gjirit të Vlorës, në distancë afërsisht prej 20 milje detare nga bregu, ku ishte përgatitur për t’u nisur përfundimisht në drejtim të Italisë.....”.

Praktika gjyqësore shqiptare ka raste të tilla, prandaj Kolegjet e Bashkuara në vendimin unifikues nr.3, datë 27.01.2011, kanë vërejtur se, në zbatim të drejtë të ligjit penal dhe bazuar në jurisprudencën e konsoliduar penale, nisur nga veçantitë e mënyrës së kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) dhe duke qenë se kryhet me dashje, sipas rastit, autorët kanë përgjegjësi penale për kryerjen e veprës penale ose për veprën penale të mbetur në tentativë, nëse, krahas shfaqjes së mendimit kriminal dhe përgatitjes eventuale për të ardhmen, ata me dashje, kryejnë veprime e mosveprime konkrete dhe të drejtpërdrejta mbi objektin e krimit, me të cilat synojnë (aty për aty) arritjen e qëllimit kriminal, ardhjen e pasojave të dëshiruara prej tyre, pra, kryerjen e veprës.

Në paragrafin 3, të këtij neni, përcaktohet: “*Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet*”. Kjo është forma më e rëndë e kryerjes së figurës së krimit, prandaj, duke u bazuar në rrezikshmërinë e saj, me të drejtë, është përcaktuar një minimum shumë i lartë i dënimit.

Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës (Neni 283/b)

Kjo dispozitë ligjore synon mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e personit, rendin për marrjen dhe përdorimin e drogës, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale (Elezi,2009:512-531).

Figura e veprës penale ‘Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës’. Neni 283/b përcakton dy veprime të kundërligjshme, që janë qenësore për konsumimin e kësaj vepre penale:

- 1) Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe
- 2) Krijimi i lehtësirave personave që, për shkak të detyrës, administrojnë substanca narkotike ose psikotrope, për përdorimin e tyre në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse.

Edhe kryerja e njërit prej këtyre veprimeve mjafton që vepra penale të konsiderohet e konsumuar plotësisht. Nga ana objektive, sipas prof.dr.Ismet Elezit, vepra penale që përcakton nenit 283/b, kryhet me anë të krijimit të lehtësirave (favorizimeve) për marrjen dhe përdorimin e këtyre substancave në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga ana e personave që, për shkak të detyrës, administrojnë substanca narkotike apo psikotrope.

Subjekt i krimit është personi që, për shkak të detyrës, administron substanca, narkotike, si p.sh., farmacistët, kryeinfermierët, infermierët, veterinerët, dentistët etj. (Elezi,2009:512-531).

Kultivimi i bimëve narkotike (Neni 284)

Objekt i krimit të kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të ndaluar kultivimin e bimëve apo substancave narkotike dhe psikotrope, që drejtohen kundër rendit e sigurisë publike, si dhe kundër jetës e shëndetit të njeriut, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale (Elezi,2009:512-531).

Figura e veprës penale ‘Kultivimi i bimëve narkotike’ – Ky nen, në tre paragrafët e tij, jep qartë elementet që përbëjnë veprën penale: *kultivimin pa leje të bimëve për prodhimin e narkotikëve; kryerjen e saj në bashkëpunim ose më shumë se një herë; dhe organizimin, drejtimin apo financimi e kësaj veprimtarie*. Për secilën prej tyre jepen edhe sanksionet penale përkatëse.

Nga ana objektive, krimi kryhet me anë të kultivimit të bimëve, që shërbejnë, apo dihet se shërbejnë, për prodhimin dhe nxjerrjen e bimëve narkotike apo psikotrope, pa leje dhe pa autorizim të organeve shtetërore kompetente sipas ligjit (Elezi,2009:512-531). Nga ana subjektive, krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Në praktikën gjyqësore janë vënë re paqartësi ose keqinterpretime të figurës së kësaj vepre penale. Po sjellim këtu një rast të tillë.

Kolegji penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2014-1965 i Vendimit (231) dhe Nr.56280-01190-00-2012 i Regjistrat Themeltar, datë 19.12.2014, ka vënë re se: *“Më datë 03.08.2010, në fshatin Mazhe e Madhe, Komuna Bubq, të Rrethit Krujë, në zonën e quajtur “Dylbegë”, nga ana e policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Krujë, është konstatuar një parcelë toke e mbjellë me 36 bimë, të cilat për nga karakteristikat e përgjithshme shfaqen si bima “Cannabis sativa”. Nga ana e organit të akuzës janë*

ndërmarrë veprimet e para hetimore, si është realizuar këqyrja e vendit të ngjarjes, janë sekuestruar dhe dërguar për ekspertim mostra të bimëve të gjetura, janë pyetur në cilësinë e deklaruesve personat që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, si dhe janë ndërmarrë veprime të tjera hetimore. Gjatë hetimit ka rezultuar se toka në të cilën janë gjetur këto bimë është në pronësi të shtetasit H.P., mirëpo bazuar në një marrëveshje gojore ky i fundit nuk e posedon këtë pasuri”, me ç’rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin nr.16, datë 17.02.2012, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit Sh.P., për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 K. Penal dhe në zbatim të kësaj dispozite dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Kurse Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.796, datë 18.07.2012 ka vendosur: *“Prishjen e vendimit Nr.16, datë 17.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Sh.P.”.*

Në një rast tjetër vëmë re se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me regjistër themeltar numër Nr.56280-00344-00-2008 dhe nr.00-2010-532 të vendimit (94), datë 10.02.2010, ka konstatuar se: *“...më datën 7.7.2004, Policia Gjyqësore e sektorit të Antidrogës në Komisariatit e Policisë Fier, në kuadrin e një kontrolli të përgjithshëm të zonës, ka bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes që ndodhet në fshatin Ngjeqar të Komunës Ruzhdie dhe pikërisht në parcelën në pronësi të shtetasit H.G., ku nga këqyrja në kopsht përreth banesës, kanë rezultuar të mbjella dhe të kultivuara midis perimeve të stinës dhe 20 rrënjë bime të ngjashme me bimën narkotike të opiumit. Bimët narkotike të gjetura në këtë parcelë janë sekuestruar, dy prej të cilave janë dërguar për ekspertimin kimik në LQK, ku, nga akti i ekspertimit bio-kimik nr.3819, datë 16.07.2004, ka rezultuar se lënda bimore objekt ekspertimi është papaverum somniferum (opiumi) dhe sipas ligjit nr.7975, datë*

26.07.1995 “Për barnat dhe lëndët psikotrope”, klasifikohet në kategorinë e lëndëve narkotike...”, me ç’rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.259, datë 30.11.2006, ka vendosur: Të deklarojë fajtores të pandehurën L.G., për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” dhe, në bazë të nenit 284/1 të K. penal, ta dënojë atë me 3 (tre) vjet burgim.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.260, datë 26.10.2007, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.259, datë 30.11.2006, të Gjykatës së Fierit.

Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale (Neni 284/a)

Përkufizimi i organizatës kriminale jepet në nenin 28 të Kodit penal të Shqipërisë: “Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale”. Edhe në literaturën e të drejtës penale, kriminaliteti i organizuar është konsideruar si shkalla më e lartë e organizimit të kriminalitetit profesionist, ndërsa me krim të organizuar nënkuptohet krijimi i grupeve dhe bandave të ndryshme të organizuara, që bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt për kryerjen e veprave penale (Elezi,2002:9).

Trajtimi në legjislacionin shqiptar i këtyre formave të rënda të narkokriminalitetit u diktua nga fakti se në Shqipëri, duke filluar nga vitet ’90, u krijuan mjaft grupe kriminale që e vendosën aktivitetin e tyre në trafikim narkotikësh, duke e parë këtë si mjaft

fitimprurës. Siç vënë në dukje edhe studiuesit, tashmë, ato janë bërë shqetësuese, jo vetëm brenda vendit, por edhe për rajonin dhe për Europën. Grupet kriminale shqiptare, aktive në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të përbëra prej, të paktën, 3-4 anëtarësh dhe janë të përfshira më së shumti në trafikun e narkotikëve, kryesisht të kanabisit, por ato, gjithashtu, trafikojnë droga të forta, si heroina dhe kokaina, drejt vendeve fqinje, me destinacion shtetet e Bashkimit Europian (BE), (Zhilla,F.&Lamallari,B.2015:9). Këto veprimtari kanë ardhur duke u shtuar, çka vërtetohet edhe nga rastet e zbuluara dhe nga numri i të dënuarve. Në një intervistë, juristi Simoni thekson se trafikimi i narkotikëve nga grupet kriminale shqiptare ka njohur rritje të konsiderueshme që nga viti 2008. Janë rreth 528 të dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për periudhën 2008-2013 (Simoni.S.,30.06.2014).

Figura e veprës penale ‘Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale’ – Sipas Kodit penal, veprime të figurës së kësaj vepre penale janë: *organizimi, drejtimi dhe financimi* i organizatave kriminale që kultivojnë, prodhojnë, fabrikojnë, ose trafikojnë narkotikë; si edhe *krijimi i kushteve apo lehtësirave* për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore.

Përcaktimi i qartë dhe më vete i këtyre elementeve të figurës së kësaj vepre krijon në praktikë mundësi për evidencimin dhe përcaktimin më të mirë të grupeve kriminale, si dhe për goditjen penale ndaj tyre.

Nga ana subjektive, kjo vepër konsiderohet penale, kur ky krim kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe për përfitim material. (Elezi,2009:512-531). Këtu theksojmë edhe faktin shumë të rëndësishëm që dispozita penale përcakton si subjekt të krimit personin, që kur kryen veprën, ka mbushur moshën 14 vjeç. Kjo, sepse ka pasur raste kur mjaft të rritur, për

t'i shpëtuar ligjit ia mveshin kryerjen e krimit të miturve, të cilët më parë nuk konsideroheshin si subjekt i kësaj vepre penale.

Ndihma në zbulimin e krimeve (Neni 284/b)

Kjo dispozitë ligjore favorizon organet e ndjekjes penale për zbulimin e krimeve të parashikuara në nenin 284/a, të autorëve të tyre, si dhe i jep mundësi gjykatës që të përgjysmojë masën e dënimit të dhënë ndaj fajtorit të penduar e, në raste të veçanta, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese të përjashtojë nga dënimi (Elezi, 2009:512-531).

Thelbi i këtij neni është inkurajimi dhe mbështetja e *ndihmës në zbulimin e krimeve*. Dispozita parashikon lehtësimin e dënimit ose përjashtimin e dënimit për personin e arrestuar ose të dënuar për ndonjë rënie nga veprat penale që lidhen me trafikun e narkotikëve etj., në rast se ndihmon apo bashkëpunon me organet e ndjekjes dhe të drejtësisë për zbulimin e aktiviteteve kriminale të personave të tjerë që kryejnë të tilla krime.

Me këtë dispozitë krijohet një avantazh në luftimin dhe parandalimin e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit. Ajo është favorizuese për personin apo personat që duan dhe bashkëpunojnë me institucionet e zbatimit të ligjit në Shqipëri për zbulimin e veprave të tjera apo të personave që merren me aktivitet kriminal. Ky bashkëpunim, që vjen nga persona që njohin ata që organizojnë dhe drejtojnë trafikimin, që dinë se do të kryhen të tjera vepra penale të narkokriminalitetit, është një ndihmë e jashtëzakonshme për zbulimin, parandalimin e tyre dhe për kapjen e autorëve. Prandaj nuk mund të refuzohet, vetëm pse jepet nga një person që është kapur për kryerje të një krimi. Dispozita inkurajon dhe mbështet bashkëpunimin me drejtësinë të personave të penduar, për luftimin e

narkokriminalitetit dhe, nga ana tjetër, tregon se ligjet shqiptare po përafrohen me legjislacionin e avancuar të vendeve të tjera.

Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope (Neni 284/c)

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, në mbështetje edhe të akteve juridike ndërkombëtare, për të siguruar rendin e sigurinë publike, jetën e shëndetin e personit, rendin e prodhimit, të fabrikimit, nxjerrjes, rafinimit, përgatitjes së lëndëve narkotike dhe psikotrope, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale (Elezi,2009:512-531).

Si ***figura të veprës penale ‘Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope’*** dispozita ligjore përcakton: *prodhimin, fabrikimin pa licensë lëndë narkotike; kryerjen e veprës në bashkëpunim ose më shumë se një herë; dhe si rrethana cilësuese të këtij krimi: organizimin, drejtimin ose financimin e kësaj veprimtarie.*

Paragrafi 2, i nenit përcakton: *“Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”*; kurse në paragrafin 3, ligjvënësi ka përcaktuar rrethana të tjera cilësuese të kësaj figure krimi, si: *“organizimi, drejtimi, ose financimi i kësaj veprimtarie”*, që dënohen rëndë, nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Nga ana subjektive, krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Edhe pse në dispozitë nuk thuhet shprehimisht, krimi kryhet me qëllim fitimin material ose të çdo përfitimi tjetër (Elezi,2009:512-531).

Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve (Neni 284/ç)

Objekt i këtij krimi janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar rendin e sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e personit, rregullat për prodhimin, importimin, eksportimin, tranzitimin, tregtimin dhe mbajtjen e prekursorëve të caktuara me ligj, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale (Elezi,2009:512-531).

Si ***figura të veprës penale*** neni përcakton: *prodhimin, importimin, eksportimin, tranzitimin, tregtimin dhe mbajtjen, në kundërshtim me ligjin, të prekursorëve, por edhe kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë.*

Këtu duhet kuptuar mirë fakti që, nëse vepra penale kryhet më shumë se një herë, domethënë, dy ose më tepër herë, në intervale kohore të ndryshme, në qoftë se, për rastin e parë, personi është dënuar dhe vendimi ka marrë formë të prerë, atëherë kemi përsëritje, në kuptim të nenit 50, dhe vepra cilësohet në bazë të paragrafit të 1, të nenit 284/ç, në lidhje me nenin 50; në të kundërtën, kur është më shumë se një herë, vepra cilësohet sipas nenit 284/ç, paragrafi 2 (Elezi.2009:512-531).

Për t'u shënuar është edhe që paragrafi 3 i nenit 284/ç përcakton si rrethana cilësuese: *organizimin, drejtimin ose financimin e kësaj veprimtarie.*

Subjekt i krimit mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, i cili kryen njërën ndër format apo veprimet e kundërligjshme në lidhje me prekursorët, si dhe organizatori, drejtuesi dhe financuesi i tyre (Elezi,2009:512-531).

Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike (Neni 285)

Objekti i krimit është i njëjlojtë me atë figurave të mësipërme, marrëdhëniet juridike të vendosura për ndalimin e mbajtjes, prodhimit, transportimit të substancave kimike, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga këto veprime ose mosveprime kriminale (Elezi,2009:512-531).

Figura të kësaj vepre penale përcaktohen: *prodhimi, mbajtja, transportimi ose shpërndarja e substancave kimike bazë ose e substancave të tjera të çfarëdollojshme, e pajisjeve, e materialeve, në rast se dihet që ato përdoren ose do të përdoren për prodhimin ose trafikimin e paligjshëm të substancave narkotike a psikotrope.*

Praktika ka treguar se grupet kriminale edhe i përziejnë substancat narkotike dhe psikotrope me substanca bazë kimike, me qëllim shtimin e sasisë së narkotikëve, apo substancave psikotrope. Kjo dukuri është bërë shpesh edhe objekt i proceseve gjyqësore.

Për këtë flet edhe ky rast i praktikës gjyqësore: Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2010-617 i Vendimit(414) dhe numër të regjistrimit themeltar 56290-00124-00-2008, datë 05.05.2010, ka konstatuar: “...Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, pasi ka analizuar me imtësi çdo episod që nga ai i datës 10.06.2004, kur i gjykuari L.Sh., i njohur edhe me emra të tjerë, pas trafikimit nga Gjermania në Itali ka furnizuar me sasinë prej 100 kg substancë përzierëse për prerjen e heroinës dhe shtimit të sasisë së saj grupin e drejtuar nga E.Y., e deri në datën 03.09.2004, kohë në të cilën sasi të ndryshme të lëndës narkotike janë trafikuar, pra, çdo episod të kryerjes së veprës penale, veprimeve të secilit të gjykuar, ka gjetur fajtorë dhe dënuar të gjykuarit me vendimin nr. 24, datë 28.05.2007, ashtu siç është pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi....”.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.37, datë 24.9.2007, ka lënë në fuqi vendimin nr.24, datë 28.5.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me një ndryshim në lidhje me të gjykuarin E.Y., kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.37, datë 24.9.2007 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë (Vendim nr.00-2010-617 i Vendimit (414).

Raste të tilla, kur, për të njëjtën çështje penale, gjykata të shkallëve të ndryshme japin vendime të ndryshme, që bien ndesh me njëri-tjetrin, flasin se diçka nuk shkon në legjislacion ose në njohjen dhe interpretimin e tij nga trupa gjyqësore. Por nuk është vendi këtu, për trajtimin e dukurive të tilla, që janë të shpeshta në praktikën gjyqësore, sidomos në Shqipëri.

Përshtatja e lokalit për përdorim droge (Neni 285/a)

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar rendin e sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e personit. Subjekt i tij mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm. Nga ana subjektive quhet krim, kur vepra kryhet me dashje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Si **figura të veprës penale** përcaktohen *përshtatja ose lejimi për përshtatjen e lokalit, banesës, mjeteve motorike dhe të çdo mjeti tjetër publik ose privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substance narkotike ose psikotrope.*

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime ose mosveprime shoqërisht të rrezikshme e të kundërligjshme, me mënyra dhe forma të ndryshme (Elezi,2009:512-531).

Hedhja ose braktisja e shiringave (Neni 285/b)

Këto veprime, relativisht të përhapura, përbëjnë problem jo vetëm për ndotjen e mjedisit, por edhe për komunitetin. Megjithatë, në ligj ato përcaktohen si kundërvajtje penale.

Objekt i kësaj kundërvajtjeje penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar rendin e sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e personit.

Figura e kundërvajtjes penale janë: *hedhja ose braktisja e shiringave, në vende publike ose të hapura për publikun, si dhe në mjedise private të përdorimit të përbashkët të shiringave ose instrumenteve të rrezikshëm, të përdorura për marrjen e substancave narkotike ose psikotrope, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.*

Nga ana objektive, kundërvajtja penale kryhet me hedhjen ose braktisjen e shiringave në mjedise të hapura publike etj., ndërsa subjekt i krimit mund të jetë çdo person që kur e kryen atë ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm. Nga ana subjektive, kundërvajtja konsiderohet penale, kur kryhet vetëm me dashje.

Nxitja për përdorimin e drogës (Neni 286)

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për përdorimin e drogës narkotike ose të substancave psikotrope, që kanë pasoja për shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe posaçërisht të fëmijëve, si dhe pasoja të tjera ekonomiko-shoqërore, të mbrojtura

posaçërisht me legjislacionin penal nga veprime ose mosveprimet kriminale (Elezi,2009: 512-531).

Figura të veprës penale përcaktohen: *nxitja e të tjerëve për përdorimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope ose dhënia në përdorim ose injektimi i tyre te të tjerët, pa dijeninë dhe pëlqimin e tyre; si edhe: kur nxitja apo injektimi i detyruar bëhet ndaj fëmijëve apo në institucione penale, shkollore, sportive apo të çdo veprimtarie tjetër shoqërore.*

Nga ana objektive, krimi kryhet nëpërmjet nxitjes së të tjerëve për përdorimin e lëndëve narkotike ose psikotrope; nëpërmjet dhënies në përdorim ose injektimit të tyre tek të tjerët, pa dijeninë dhe pëlqimin e këtyre të fundit. Ndërsa nxitja bëhet me anë të këshillimit, udhëzimit, bisedimit për t'ia mbushur mendjen tjetrit për përdorimin e drogës ose me anë të injektimit të drogës, narkotikëve apo substancave psikotrope, pa pëlqimin e të dëmtuarit (Elezi,2009:512-531). Nga ana subjektive, kjo vepër konsiderohet krim kur kryhet me dashje.

Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë (Neni 286/a)

Përcaktimi në këtë nen i kësaj vepre përbën një risi, jo vetëm për legjislacionin shqiptar, por edhe për atë të shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Veprimet që paraqesin **figurën e veprës penale** janë: *Prodhimi dhe përdorimi i sistemeve telematike, i mjeteve dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë, në rastet e veprave penale të parashikuara në nenet 283 gjer në 286/a të këtij Kodi, ose për të mundësuar, ose për të lehtësuar konsumimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope, ose për të transmetuar a përhapur njoftime publicitare për stimulimin e përdorimit të tyre.*

Nga ana objektive, krimi kryhet me veprime ose mosveprime shoqërisht të rrezikshme e të kundërligjshme, me mënyra dhe forma të ndryshme... Kurse nga ana subjektive kryhet me dashje (Elezi,2009:512-531).

Këto dispozita të Kodit penal aktual të Shqipërisë, për rregullimin e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit, provojnë se legjislacioni ynë është gjithëpërfshirës dhe në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar. Por rëndësi ka zbatimi drejt i tyre në praktikë.

3.7. Veprat penale në fushën e narkokriminalitetit sipas Kodit penal të Kosovës

Deri në vitin 1999 Kosova ka kaluar një periudhë tejet të vështirë dhe ka pasur mjaft probleme edhe në fushën e legjislacionit penal, për arsye se hartimi dhe zbatimi i tij ishte në dorë të pushtetit të saj, regjimit serb. Historikisht, pushtimi i Kosovës nga Perandoria Osmane e, më pas, nga Serbia, ka bërë që ligjet të mbronin vetë rendin sundues.

Vetëm në vitin 1974 u bë kurorëzimi i pavarësisë së krahinave me miratimin e Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KAHRC&KEC,2012:30).

Kjo Kushtetutë, më në fund, pas një historie të gjatë të luftës për barazi nën sundimin serb, i dha Kosovës autoritet të plotë juridik mbi territorin e saj, duke ia ngritur statusin nga një krahinë autonome brenda Serbisë, afërsisht me status të njëjtë me 6 republikat e tjera të Federatës (Malcom,1998:314-333&Judah,2002:38). Kushtetuta i dha Kosovës përfaqësim të drejtpërdrejtë dhe të barabartë në të gjitha organet vendimmarrëse, me të drejtën e vetos. Nuk mund të merrej asnjë vendim në nivelin federal apo në atë të Serbisë pa pëlqimin e Kosovës. Gjithashtu, ajo i garantonte Kosovës të drejtën të krijonte të gjitha institucionet e nevojshme dhe legjitime, përfshirë Kuvendin, qeverinë, sistemin

gjyqësor dhe policinë. Statusi i republikës, megjithatë, kurrë nuk i ishte dhënë Kosovës (KIPRED,2009:14).

Zanafilla e hartimit të ligjeve penale në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës (tani Republika e Kosovës) nis në vitin 1974, pas miratimit Kushtetutës së Jugosllavisë. Më u pasua me hartimin e kodeve dhe të ligjeve të tjera. Por duhet thënë se, ngaqë ato bazoheshin në frymën e Kushtetutës e RSFJ-së, dhe në përmbajtjen e tyre kishin edhe vulën e shovinizmit serb.

Në vijim po sjellim një vështrim të përmbledhur të këtij legjislacioni.

3.8. Ligji penal i Kosovës i vitit 1977

Duke u bazuar në Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974, përkatësisht neni 281, paragrafi 1, pika 12, u përcaktua koncepti i decentralizimit të së drejtës penale materiale në njësitë federale. Në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Kosovës u dekretua Ligji penal (28 qershor 1977), që përmbante 21 krerë, me 228 nene. Ai hyri në fuqi nga data 1 korrik 1977, pas shpalljes në Gazeta Zyrtare, nr.20/77,

Miratimi i Ligjit penal të Kosovës të vitit 1977 pati rëndësi historike në zhvillimin shoqëror, politik, por, posaçërisht, në lëmin juridik dhe juridiko-penal të Kosovës. Megjithatë, konstatojmë se në këtë Kod penal nuk parashikohet asnjë dispozitë ligjore për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit. Lidhur me to vepronte Ligji penal federativ, i cili, pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të RSFJ nr.44/76 (Përmbledhje e ligjeve penale, 1979:9-13) hyri në fuqi më 1 korrik 1977. Ky Ligj penal federativ, që përmbante 24 krerë, me gjithsej 264 nene, në pjesën më të madhe rregullonte çështjet e përgjithshme të së

drejtës penale, kurse në pjesën e posaçme parashikonte vetëm ato vepra penale që rrezikonin ose dëmtonin të mirat juridike, që i përkisnin tërë shoqërisë në territorin e tërë Jugosllavisë, si dhe veprat penale që kryheshin nga personat zyrtarë që kanë qenë të inkuadruar në organet federative (Përmbledhje e ligjeve penale, 1979:9-13).

Në kreun XXII të Ligjit penal federativ të vitit 1977, ndër veprat penale kundër vlerave shoqërore, vetëm dy prej tyre lidheshin me fushën e narkokriminalitetit. Ato ishin:

- a) Prodhimi i paautorizuar dhe vënia në qarkullim e narkotikëve (neni 245);
- b) Mundësimi i përdorimit të narkotikëve (neni 246).

Megjithëse i përkasin një kohe të shkuar, mendojmë se është me interes për mendimin juridik-penal analiza e këtyre veprave penale, pasi ka rëndësi jo vetëm nga këndvështrimi i analizës historike të legjislacionit penal, por edhe për të kuptuar ecurinë e tij lidhur me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit në Kosovë.

Prodhimi i paautorizuar dhe vënia në qarkullim e narkotikëve (Neni 245)

Ky nen kishte tre paragrafë, që rregullonin prodhimin e paautorizuar dhe vënien në qarkullim të narkotikëve.

Paragrafi 1 përcaktonte: *“Kush prodhon në mënyrë të paautorizuar, përpunon, shet ose ofron për shitje apo për qëllime shitjeje blen, mban ose transporton, ose ndërmjetëson në shitjen ose blerjen, apo në ndonjë mënyrë tjetër pa autorizim vë në qarkullim substanca ose preparate që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope, do të dënohet me gjashtë muaj deri në pesë vjet burg”*.

Objekt i krimit ishin marrëdhëniet juridike të vendosura në atë kohë në shoqërinë e

RSFJ-së, për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, si dhe shëndetin e njerëzve. Nga ana objektive, krimi kryhej me veprime aktive, shoqërisht të rrezikshme dhe të kundërligjshme, në disa mënyra dhe forma. Përcaktohej qartë se edhe ndërmarrja e vetëm njërit prej veprimeve të kundërligjshme të përmendura, mjaftonte që figura e krimit të konsiderohej e konsumuar. Subjekt i krimit ishte çdo person i përgjegjshëm, që kishte mbushur moshën e përgjegjësisë penale. Gjithashtu, parashikohej që ky krim ndodh kur kryhet me dashje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Forma më e rëndë e këtij krimi përcaktohej në paragrafin 2: *“në qoftë se vepra penale nga paragrafi 1, i këtij neni, është kryer nga disa persona që janë bashkuar për t’i kryer këto vepra apo autori i kësaj vepre ka organizuar rrjetin e rishitësve ose të ndërmjetësve, ose në qoftë se vepra penale është kryer me narkotikë apo substanca psikotrope veçanërisht të rrezikshme, autori do të dënohet me një deri në dhjetë vjet burg”*.

Siç shihet, në këtë paragraf inkriminohej bashkëpunimi mes personave për t’i kryer veprat penale. Për këtë figurë krimi, parashikohej dënim i rëndë. Ndërsa paragrafi 3, përcaktonte sekuestrimin e narkotikëve dhe substancave psikotrope, si dhe mjetet për përgatitjen e tyre.

Mundësimi i përdorimit të narkotikëve (Neni 246)

Kjo vepër penale përbënte shqetësim të madh për regjimin e asaj kohe, prandaj inkriminimi i veprimeve të mundësimit të përdorimit të narkotikëve ka qenë i pashmangshëm. Në paragrafin 1 përcaktohej: *“kush e nxit tjetrin për të përdorur narkotikë*

ose substanca psikotrope, ose i jep narkotikë ose substancë psikotrope për të përdorur ai ose ndonjë person tjetër, ose ia vë në dispozicion lokalet për të përdorur narkotikë ose substancë psikotrope, apo në ndonjë mënyrë tjetër ia bën të mundur tjetrit përdorimin e narkotikëve ose të substancave psikotrope, do të dënohet me tre muaj deri në pesë vjet burg”.

Siç shihet, numri i veprimeve që inkriminohen në këtë nen është i madh. Objekt i krimit ishin marrëdhëniet juridike të vendosura në RSFJ, për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, si dhe shëndetin e njerëzve. Nga ana objektive, krimi kryhej përmes nxitjes së tjetrit për përdorim të narkotikëve ose substancave psikotrope, ofrimit të tyre personit tjetër për përdorim, vënies në dispozicion të lokalit për përdorimin e tyre. Subjekt i krimit ishte çdo person i përgjegjshëm, në moshën e përgjegjësisë penale dhe krim quhej i kryer, kur bëhej vetëm me dashje.

Paragrafi 2 parashikonte: *“Në qoftë se vepra penale nga paragrafi 1, i këtij neni është kryer ndaj të miturit ose ndaj një numri më të madh personash, ose me narkotikë apo me substancë psikotrope veçanërisht të rrezikshme, ose ka shkaktuar pasoja sidomos të rënda, autori do të dënohet me një deri në dhjetë vjet burg”.* Pra, këtu cilësohet vepra penale për shkak të personave që mbrohen nga mundësimi, ofrimi, apo nga nxitja për përdorim të narkotikëve apo substancave psikotrope.

Paragrafi 3 përcaktonte që narkotikët dhe substancat psikotrope do të sekuestrohen.

Me kalimin e viteve, ndryshimet politiko-juridike që ndodhën në RSFJ, dhe sidomos tendenca e Serbisë për nënshtrim dhe sundim mbi territorin dhe mbi jetën politike e juridike të Kosovës, sollën më datën 22 mars 1989 shfuqizimin e Ligjit penal federativ dhe të Ligjit penal të Kosovës, për t’u zëvendësuar me Ligjin penal të Serbisë. Kjo pati

shumë reperkusione mbi liritë dhe të drejtat e popullit të Kosovës.

3.9. Legjislacioni penal në Kosovë pas vitit 1999

Ndryshime të rëndësishme në legjislacionin penal të Kosovës ndodhën menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe shpalljes së saj nga Serbia. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244, që autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm të vendoste praninë ndërkombëtare në Kosovë, të krijonte një administratë të përkohshme për Kosovën, duke ndërtuar dhe mbikëqyrur zhvillimin e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse. Të gjitha kompetencat legjislative dhe ekzekutive, përfshirë edhe administrimin e gjyqësorit, iu veshën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, si zyrtari civil më i lartë ndërkombëtar i UNMIK-ut (Hasani,2013:3).

Kjo situatë e re diktoi që sistemi i drejtësisë në Kosovë të kalojë nëpër reforma të vazhdueshme dhe, siç thonë edhe studiuesit Vokshi dhe Musliu, deri para shpalljes së Pavarësisë, Kosova ka pasur probleme shumë të mëdha me sistemin juridik tejet të komplikuar (Vokshi&Musliu,2013:14). Nisur nga fakti se ishte situatë emergjente dhe nuk kishte hapësirë e as kohë që të hartohej një kod penal dhe kodi i procedurës penale, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, më 12 dhjetor 1999, nxori Rregulloren nr.1999/24 mbi ligjet në fuqi në Kosovë. Në nenin 1, paragrafi 1.1, të saj përcaktohej se ligj në fuqi në Kosovë do të jenë: a) Rregullorja e shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretariatit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me të. b) Ligji në fuqi në Kosovë, i 22 marsit 1989.

Duket qartë se me këtë rikthehej në fuqi Ligji penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe i Ligjit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë që ishin në fuqi qysh nga 22 marsi 1989.

Por ky sistem ishte i përbërë nga nivele të ndryshme të “ligjit të zbatueshëm”, që kishte krijuar pasiguri juridike (Muharremi,2008:5). Kjo situatë vazhdoi derisa u përgatit dhe hyri në fuqi Kodi penal i përkohshëm i Kosovës, më 6 prill 2004, së bashku me Kodin e procedurës penale të Kosovës (Elezi,I.&Elezi,E.2010:75-95).

Këto dy kode janë një bazament i fuqishëm në legjislacionin e Kosovës edhe për luftimin e narkokriminalitetit në vend. Dispozitat kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të përkohshëm përfshiheshin në Kapitullin XXI, ‘Veprat penale kundër shëndetit publik’, në nenet 229, 230, 231.

Sigurisht, kjo i dha shtytje punës për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit në Kosovë, por theksojmë se një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajti aprovimi i Ligjit të barnave narkotike, psikotrope dhe prekursorëve, Nr.02/L-128, i shpallur në *Gazetën zyrtare*, nr.35, 15 gusht 2008. Ky ligj rregullon çështjen e licensimit të personave juridikë për shitje, blerje, eksportim dhe importim të substancave narkotike, psikotrope, por edhe të prekursorëve. Ai bën edhe klasifikimin e bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe të prekursorëve në bazë të rrezikshmërisë së tyre gjatë përdorimit, duke i përfshirë në katër lista, aneks i tij. Gjithashtu, ligji përcakton masat e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimit të bimëve, të barnave narkotike, të substancave psikotrope dhe prekursorëve etj.

3.10. Veprat penale në fushën e narkokriminalitetit sipas Kodit penal të vitit 2004

Sikurse është thënë edhe më lart, Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, i vitit 2004, përfshinte tri vepra penale të fushës së narkokriminalitetit, të emërtuara “Veprat penale kundër shëndetit publik”.

Në bazë të këtyre dispozitave, objekt grupor i veprave penale për narkotikë janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar ligjshmërinë dhe kontrollin e prodhimit, kultivimit, tregtimit, posedimit, shitjes, shpërndarjes të substancave narkotike dhe substancave psikotrope, si dhe jetën dhe shëndetin e njeriut (Elezi, 2009:512-531).

Parashikimi i këtyre veprave u bë edhe duke u bazuar në Konventat ndërkombëtare, që i kushtojnë vëmendje të veçantë rrezikut të madh të veprimtarive të kundërligjshme me narkotikë. Për të parë ecurinë e legjislacionit penal në fushën e narkokriminalitetit dhe që të vlerësojmë politikën penale të ndjekur në Kosovë ndaj këtyre veprave penale, po i paraqesim ato në detaje.

Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope (Neni 229)

Paragrafi 1 i këtij neni përcakton se përbëjnë vepër penale:

a) Blerja ose posedimi me qëllim shitjeje i substancave a preparateve që ishin shpallur të rrezikshme, narkotikë apo substanca psikotrope;

b) Shpërndarja ose ofrimi për shitje i substancave a preparateve që ishin shpallur të rrezikshme, narkotikë apo substanca psikotrope.

Kryerja e kësaj vepre penale përcaktohet në veprime alternative, si: blerja apo posedimi me qëllim shitjeje, shpërndarjeje apo ofrimi me qëllim shitjeje të substancave apo të preparateve, që janë shpallur të rrezikshme si narkotikë dhe substanca psikotrope (Salihu, 2009:289-295). Nga ana objektive, vepra penale konsiderohet e konsumuar edhe nëse personi kryente vetëm njërin nga veprimet e përcaktuara në këtë nen, kurse, nga ana subjektive, kjo vepër penale quhet e kryer vetëm kur bëhet me dashje.

Në paragrafin 2 të nenit 229, sanksionohet një formë më e rëndë e kësaj vepre penale: *shpërndarja, shitja, transportimi ose dërgimi i substancave apo preparateve, të cilat janë shpallur të rrezikshme ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje, ose oferte për shitje pa autorizim.*

Kurse paragrafi 3 parashikonte një tjetër formë të rëndë të kësaj vepre penale: *eksportimin ose importimin e paautorizuar të substancave ose preparateve, të cilat ishin shpallur të rrezikshme, narkotikë, apo substanca psikotrope*”, e cila dënohet me burgim të rëndë (tre deri në dhjetë vjet).

Kodi i përkohshëm penal përcaktonte se nuk konsiderohet vepër penale, nëse veprimet e mësipërme kryheshin me autorizim.

Objekt i këtij krimi ishin marrëdhëniet juridike të vendosura në bazë të ligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe perkursore, si dhe siguria e jetës dhe e shëndetit të njeriut. Kryerja e kësaj vepre penale përcaktohet me veprime alternative, si: blerja apo posedimi me qëllim shitjeje, shpërndarjeje, apo ofrimi me qëllim shitjeje të substancave

apo të preparateve, të cilat janë shpallur të rrezikshme si narkotikë dhe substanca psikotrope (Salihu,2009:289-295).

Nga ana objektive, vepra penale konsiderohej e konsumuar nëse personi kryente edhe vetëm njërin nga veprimet e përcaktuara në nenit 229, kurse nga ana subjektive kjo vepër penale quhej e kryer vetëm kur bëhej me dashje. Subjekt i veprës penale mund të ishte personi i përgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale dhe që e kishte mbushur moshën e përgjegjësisë penale.

Duhet theksuar se me Kodin e përkohshëm penal të Kosovës nuk ka qenë e lejuar blerja apo posedimi i narkotikëve për *përdorim personal*. Por kjo krijonte probleme në praktikë, pasi nga strukturat policore të shumë shteteve ka dalë se shitës, por edhe trafikantë narkotikësh, përdorin vetë substanca narkotike apo psikotrope, me qëllim që, në rast se arrestohen për posedim narkotikësh, ata deklarohen si përdorues narkotikësh, pasi kështu kanë lehtësime dhe sanksionet, që u shqiptohen atyre, janë më të buta se ato ndaj autorësve që nuk janë përdorues të narkotikëve (US Dept of Justice,1992:113-114).

Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotrope (Neni 230)

Në Republikën e Kosovës, pas vitit 1999, numri i rasteve të kultivimit, përpunimit dhe prodhimit të substancave narkotike apo psikotrope erdhi duke u shtuar. Kjo diktoi nevojën e penalizimit të kësaj vepre. U përcaktuan si veprime të kundërligjshme: kultivimi, prodhimi, përpunimi, ekstraktimi dhe përgatitja e paautorizuar e substancave a

preparateve, që janë shpallur të rrezikshme si narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shitjen, shpërndarjen, ose ofrimin për shitje.

Kryerja edhe e vetëm njërit prej këtyre veprimeve, në mënyrë të paautorizuar, nga subjekti konsiderohet se vepra penale sipas paragrafit 1, të nenit 230, konsumohet plotësisht dhe autori dënohet me burgim.

Në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni përcaktohen format më të rënda të kësaj vepre penale. Në paragrafin e 3 të nenit kemi veprimet e kundërligjshme:

1) Shitja e paautorizuar e pajisjeve a materialeve, duke e ditur se ato janë përdorur ose do të përdoren për kultivimin e paligjshëm, për prodhimin, përpunimin apo trafikimin e cilësdo substancë ose preparati që është shpallur i rrezikshëm si narkotik ose substancë psikotrope a analoge.

2) Furnizimi i paautorizuar i pajisjeve a materialeve, duke e ditur se ato janë përdorur ose do të përdoren për kultivimin e paligjshëm, prodhimin, përpunimin apo trafikimin e cilësdo substance ose preparati që është shpallur i rrezikshëm si narkotik ose substancë psikotrope a analoge.

Dënimi penal me burgim ashpërsohet për formave më të rënda të kryerjes së kësaj vepre penale. Kur ka rrethana cilësuese, janë parashikuar pesë forma të kualifikuara të rënda të saj: nëse vepra penale kryhet nga personi që vepron si anëtar i një grupi; nga personi që është pjesëtar i forcave policore apo është përgjegjës për zbatimin e ligjit; nga një autor që është person zyrtar dhe vepron gjatë ushtrimit të detyrës së tij; kur vepra është kryer duke përdorur fëmijën ose në dëm të personit të tillë, apo nëse personi ka përzier narkotikët ose substancat e rrezikshme psikotrope me substanca të tjera, me ç'rast ka shtuar

rrezikun për shëndetin e viktimës. Vepra penale mund të quhet e kryer vetëm kur bëhet me dashje.

E rëndësishme është se dispozita në fjalë parashikon që goditja e grupeve kriminale bëhet jo vetëm me dënimin me burgim të anëtarëve të tyre, por edhe përmes goditjes së pasurisë së tyre. Në paragrafin 5 të këtij neni, përcaktohet se të gjithë narkotikët, substancat psikotrope, analogët, ose mjetet e prodhimit të tyre konfiskohen.

Gjithashtu, nga neni që po analizojmë, kuptojmë se prodhimi apo përpunimi i narkotikëve është i paraparë me dispozita taksative, kurse objekt i veprës penale janë substancat ose preparatet, që janë të shpallura si drogë apo substanca psikotrope (Salihu,2009:289-295). Pasoja e kësaj vepre penale është rreziku i madh për shëndetin dhe jetën e njerëzve.

Kjo dispozitë përcakton se, kur veprimet me të cilat kryhet vepra, bëhen për konsum personal, ato nuk konsiderohen vepër penale. Këtë vlerësim e gjejmë në legjislacionin e shteteve të zhvilluara, ku konsumimi apo përdorimi i narkotikëve apo substancave psikotrope nuk quhet i dënueshëm, ngaqë ato zbatojnë parimin e mosndëshkimit të personave që e dëmtojnë me dashje veten e tyre.

Lehtësimi i sigurimit a i përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo i analogëve të rrezikshëm (Neni 231)

Ky nen kishte dy paragrafë. Prof. dr. I. Salihu, me të drejtë ka nënvizuar se, me plotësimin e Kodit penal, duhej të riformuloheshin të dy paragrafët e tij, që të jenë në pajtim me titullimin e kësaj vepre penale (Salihu,2009:289-295).

Në paragrafin 1 parashikohet: *Kushdo që administron narkotikë, substanca psikotrope ose analoge dhe, për shkak të detyrës që ka, lehtëson sigurimin ose përdorimin e tyre në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet*”. Edhe pse në këtë paragraf është parashikuar se këtë vepër penale ***mund ta kryejë kushdo***, nga përmbajtja e saj del se këtë vepër penale mund ta kryejnë vetëm personat, të cilët administrojnë, menaxhojnë narkotikë (Salihu,2009:289-295).

Në paragrafin 2 parashikohet që *“drejtuesi ose pronari i lokalit apo i hapësirës tjetër të mbyllur, të cilën e përdor publiku, i cili lejon apo toleron përdorimin e narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave të rrezikshme, analoge dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet”*.

Objekt i krimit janë shëndeti dhe jeta e njeriut. Nga ana subjektive, vepra quhet e kryer, vetëm kur bëhet me dashje, por për ekzistimin kësaj vepre penale është i mjaftueshëm edhe vetëdashja eventuale. Subjekt i veprës është personi që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe në kohën e kryerjes është i përgjegjshëm, i cili është pronar i një hapësire të caktuar, apo i ndonjë lokali që me vetëdije apo me qëllim toleron e lejon përdorimin apo konsumin e drogës. Inkriminimi i këtyre veprimeve është më shumë i karakterit preventiv, me arsyetimin se mendohet që në shumë shtete, përfshirë edhe Kosovën, ekzistojnë hapësira të caktuara, të cilat përdoren ekskluzivisht për përdorim apo konsumim të narkotikëve.

Lidhur me këtë kod duhet të theksojmë se, pas shpalljes së Pavarësisë, Kuvendi i Kosovës, me ligjin nr.03/L-002, datë 6 nëntor 2008, për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, në titull dhe në tërë tekstin hoqi atributin “i përkohshëm”, kështu që prej asaj date quhet Kodi penal i Kosovës (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Natyrisht, edhe më pas, Kodi do të përmirësohej e do të plotësohej në vazhdimësi.

3.11. Veprat penale në fushën e narkokriminalitetit sipas Kodit penal të vitit 2013

Nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave ligjore të Kodit penal të vitit 2004 ishte e madhe. Profesorë, prokurorë dhe gjykatës bashkëpunuan për hartimin e një Kodi të ri penal. Në këtë punë u përfshinë edhe institucionet e të drejtës penale, që ndryshuan dhe plotësuan dispozitat ligjore të Kodin penal dhe të Kodit të procedurës penale.

Kodi i ri, i përmirësuar, u shpall në *Gazetën zyrtare* nr.19, datë 13 korrik 2012, dhe hyri në fuqi më 1 janar 2013. Ai përmban mjaft risi lidhur me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit, që janë parashikuar në kapitullin XXIII. Në të, këto vepra janë më të shumta në numër dhe formulimet e tyre janë plotësuar. Duke qenë se ky Kod është ende në fuqi, mendojmë se është me vlera njohëse teorike dhe praktike analiza e këtyre dispozitave dhe e dallimeve mes tyre.

Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge (Neni 273)

Kodi penal ka inkriminuar disa forma të qarkullimit të narkotikëve dhe substancave psikotrope, që janë me dimensione vendore dhe ndërkombëtare

(Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770). Objekti i përgjithshëm mbrojtës i veprës penale nga neni 273 është shëndeti i njerëzve, ndërsa pasoja e saj është në rrezikshmërinë ndaj tij.

Mjetet me të cilin kryhet kjo vepër penale janë narkotikët dhe substancat psikotrope a prekursorët të shpallur të rrezikshme. Si narkotikë apo substanca psikotrope konsiderohen ato natyrore, si dhe substancat dhe preparatet artificiale të përpunuara nga këto substanca, që janë të listuara në regjistrin e narkotikëve të rrezikshëm, dhe substancat psikotrope dhe prekursorë të paraqitur në tabelat bashkangjitur Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekursorë (nr.02/L-128).

Figura e veprës penale - Sipas nenit 273, konsiderohen vepër penale:

a) Blerja e paautorizuar me qëllim shitjeje apo shpërndarjeje, ose ofrimin për shitje i substancave apo preparateve, që janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge;

b) Posedimi i paautorizuar me qëllim shitjeje apo shpërndarjeje, ose ofrimi për shitje i substancave apo preparateve, që janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge.

Kryerja e njërit prej këtyre veprimeve të kundërligjshme, mjafton që vepra penale të konsiderohet e konsumuar. Një çështje me interes për diskutim është termi *substanca analoge*, që përdoret në nenin 273. Ky term nënkupton çfarëdo substance, që nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope dhe efektet e të cilave ajo i riprodhon.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar rendin juridik dhe shëndetin e personit; janë rregullat e blerjes, shitjes, eksportit, importit të

substancave narkotike apo psikotrope dhe analogëve. Si veprime të kundërligjshme janë edhe shpërndarja, shitja, transportimi, dorëzimi, ndërmjetësimi, dërgimi, apo dërgimi në tranzit i substancave apo preparateve, që janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose analoge, me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje. Për rrezikshmërinë shoqërore që bart, edhe për kryerjen e një prej këtyre veprimeve të kundërligjshme, autorit i jepet dënim mjaft i rëndë, deri në 12 vjet.

Veprim tjetër i inkriminuar është eksporti dhe importi i paautorizuar i substancave narkotike apo psikotrope dhe analogëve të rrezikshëm për shëndetin e njeriut. Për këtë veprim, goditja e grupeve kriminale bëhet jo vetëm me dënimin me burgim të anëtarëve të tyre, por edhe me goditje të pasurisë. Në paragrafin 5 të këtij neni parashikohet konfiskimi i substancave narkotike, psikotrope ose analoge dhe i mjeteve për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e substancave narkotike dhe psikotrope.

Veprat penale nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij neni konsiderohen të konsumuara nëse kryhet qoftë edhe njëri nga veprimet e kundërligjshme të përmendura. Meqë elementi përbërës i figurës së kësaj vepre penale është “pa autorizim” dhe mjeti për kryerjen e kësaj vepre penale janë narkotikët dhe substancat psikotrope a preparatet e shpallura të rrezikshme për shëndetin e njeriut, vepra ka karakter udhëzues dhe është e nevojshme që në përshkrimin e mënyrës së kryerjes së saj të ceket dispozita adekuate e Ligjit mbi prodhimin, shitjen, përpunimin dhe transportimin e drogave (Salihu&Zhitija&Hasani: 2014:7-770).

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person që ka arritur moshën e përgjegjësisë penale dhe që në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm.

Objekt i përgjithshëm mbrojtës i kësaj vepre penale është shëndeti i njerëzve, ndërsa pasoja e saj përbëhet në rrezikshmërinë ndaj shëndetit të njerëzve. Mjetet me të cilat kryhet kjo vepër penale janë narkotikët dhe substancat psikotrope a prekursorët të shpallur si të rrezikshëm (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Autor i kësaj vepre penale quhet personi që vepron në mënyrë të kundërligjshme. Prodhimi, përpunimi dhe qarkullimi i narkotikëve dhe i substancave psikotrope lejohen vetëm në mjekësi, veterinari dhe për qëllime shkencore dhe rregullohen me ligje dhe akte të posaçme. Kështu, bujq individualë mund të kultivojnë kanabisin (kërpin) në bazë të një lejeje të posaçme nga organi kompetent dhe me një kontratë paraprake me ndonjë organizatë-kompani të qarkullimit të barnave. Eksporti dhe importi i këtyre prodhimeve mund të bëhet vetëm me leje të posaçme të organit shtetëror kompetent.

Vepra penale mund të kryhet në forma alternative. Format themelore të kryerjes së saj parashikohen në par. 1, 2 dhe 3 të nenit 273 dhe mund të kryhen me 9 veprime të caktuara alternative dhe secili konsiderohet veprim me të cilin mund të kryhet vepra penale. Lidhur me fajësinë, autori duhet të veprojë me dashje (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike (Neni 274)

Neni 274, përcakton një formë të rëndë të veprimeve të kundërligjshme shoqërisht të rrezikshme, për jetën dhe shëndetin e njeriut, por edhe për sigurinë shoqërore dhe për marrëdhëniet juridike.

Figura të veprës penale konsiderohen veprimet e kundërligjshme: prodhimi, kultivimi, përpunimi, nxjerrja dhe përgatitja e paautorizuar e substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope (neni 274, par.1).

Secili nga këto veprime paraqet formë të posaçme me të cilën kryhet vepra penale, por konsiderohet se kryhet një vepër penale në bashkim fiktiv edhe në raste kur autori ndërmerret dy apo më tepër veprime të ndryshme, me të cilat kryhet kjo vepër penale (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Me *kultivim* nënkuptohen të gjitha veprimet e nevojshme, që nga mbjellja e deri te vjelja e bimëve narkotike. Ndërsa me *prodhim* duhet kuptuar tërë procesi i nevojshëm për përfitim të llojeve të narkotikëve, substancave psikotrope, preparateve dhe substancave analoge, si edhe veprimtaria për përfitim të llojeve të ndryshme të drogave natyrore dhe artificiale. *Përpunimi* është një proces teknologjik për arritjen e cilësisë dhe llojit të drogave. Fjala *ekstrakton* (*nxjerr*) shpreh procesin për përfitim të ekstraktit (tharmit, majasë) që shërben për përgatitjen e substancave a preparateve tjera që janë të shpallura si të rrezikshme për shëndetin e njeriut (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:759).

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të ndaluar prodhimin, kultivimin, përpunimin, nxjerrjen apo përgatitjen e substancave, apo preparateve të shpallura si narkotikë, apo substancat psikotrope, si dhe mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të njeriut.

Paragrafi 2, përcakton katër veprime të tjera të kundërligjshme: prodhimin, kultivimin, përpunimin dhe shitjen ose ofrimin për shitje të substancave analoge. Për konsumimin e një apo më shumë veprimeve të kundërligjshme, përcaktohen dënime alternative me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Forma më e rëndë e veprës penale

përcaktohet në paragrafin 3, ku parashikohen veprimet e kundërligjshme: prodhimi, transportimi dhe shpërndarja e preparateve që përdoren për prodhim dhe përpunim të paautorizuar të substancave narkotike apo psikotrope. Ndërsa në paragrafin 4 përcaktohen veprimet alternative të kundërligjshme, si: transportimi, shpërndarja, shitja dhe furnizimi me vegla, pajisje apo materiale narkotike, të cilat janë përdorur ose do të përdoren për kultivimin, prodhimin, përpunimin, përdorimin apo trafikimin e paautorizuar (Salihu& Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Subjekt i kësaj vepre penale është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe që në momentin e kryerjes së veprës penale është i përgjegjshëm.

Nga ana subjektive, vepra quhet e kryer kur bëhet vetëm me dashje. Në paragrafin 5 të nenit parashikohet konfiskimi i substancave narkotike, psikotrope, i substancave analoge dhe i mjeteve për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e substancave narkotike dhe psikotrope.

Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge (Neni 275)

Sipas paragrafit 1, ndëshkohet kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge. Kjo është vepra më e lehtë e paraparë në këtë kapitull të veprave penale të narkotikëve. Zakonisht, ajo ka të bëjë me hashashin, marihuanën dhe, në disa raste, edhe me drogat e rënda. Sipas këtij përkufizimi, nuk inkriminohet konsumimi vetjak i narkotikëve. Megjithatë, në praktikë posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave

psikotrope ose analoge nxjerr probleme, sidomos kur ata që kapen se posedojnë narkotikë, substanca psikotrope ose analoge, pretendojnë se i kanë për përdorim personal.

Figurë e veprës penale konsiderohet veprimi i kundërligjshëm: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale është siguria e jetës dhe e shëndetit të personit. Nga ana objektive, krimi kryhet duke ndërmarrë edhe vetëm njërin veprim, posedimin e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge. Nga ana subjektive, vepra penale njihet kur kryhet vetëm me dashje.

Me posedim nënkuptohet mbajtja e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, pra, në këtë rast, autori e ka pushtetin ndaj sendit në mënyrë të paautorizuar dhe atë e mban (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Për shkak të rritjes së numrit të personave që përdorin narkotikë, ishte mjaft e nevojshme që me dispozitë ligjore të përcaktohej maksimumi i sasisë e narkotikëve apo substancave psikotrope ose analoge që një përdorues mund t'i posedojë.

Figura e krimit e parashikuar në paragrafin 2, për nga forma është e privilegjuar, pasi vepra penale konsiderohet e kryer në raste kur autori është fillestar dhe sasia e narkotikut, e substancës psikotrope apo analoge nuk e kalon peshën mbi tre (3) gramë (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Subjekt i veprës penale mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe që në momentin e kryerjes së krimit është i përgjegjshëm. Ai mund të jetë konsumues edhe shpërndarës. Penalizimi i kësaj vepre është shumë i gjerë dhe përfshin çdo posedim, pa marrë parasysh sasinë dhe llojin e narkotikëve. Posedimi i sasisë së vogël çon në konstatimin se mbahet për nevoja vetjake e jo për shitje. Konventa për

narkotikët lidhur me rastet e rëndësisë së vogël rekomandon shtetet që për dënim alternativ të parashikojnë masa të tjera edukative rehabilituese e të ngjashme. Këtu, mund të aplikohet neni 11 i këtij Kodi, si vepër e rëndësisë së vogël (Baçiç&Pavloviç,2006:643). Vepra quhet e kryer kur bëhet me dashje, kur autori është i vetëdijshëm për mbajtjen e paautorizuar të narkotikut dhe se përbën vepër penale.

Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope (Neni 276)

Me këtë nen bëhen përpjekje të mbrohen jeta dhe shëndeti i njeriut, që janë dhe objekti mbrojtës i kësaj vepre penale. Kjo kryhet vetëm me intoksikim, pa dëshirën e personit që intoksikohet. Ka disa në mënyra për të bërë intoksikimin: përmes pijeve, ushqimit, tymosjes, injeksionit, tabletave dhe frymëmarrjes.

Figura e veprës penale është veprimi i kundërligjshëm i intoksikimit të personit tjetër me narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, pa dijeninë e tij.

Objekt i krimit është siguria e shëndetit dhe jetës së njeriut. Subjekt pasiv i kësaj vepre penale është cilido person, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore ose moshën (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770). Subjekt i veprës penale është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm. Nga ana subjektive, vepra quhet e konsumuar, kur bëhet vetëm me dashje, kur autori është i vetëdijshëm se po helmon personin tjetër me narkotikë, substanca psikotrope ose analoge, pa dëshirën e këtij. Vepra konsiderohet e kryer në momentin kur autori ka filluar intoksikimin. Tek kjo vepër penale nuk është inkriminuar situata, nëse rezulton me dëmtimin e rëndë të shëndetit të personit të intoksikuar apo vdekja e personit të

tillë, normalisht, kur autori ndaj këtyre pasojave vepron me pakujdesi (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Lehtësimi i sigurimit apo i përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge (Neni 277)

Kjo vepër penale ishte parashikuar edhe në Kodin e përkohshëm penal të Kosovës (2004), por kishte paqartësi dhe zbrazësi juridike.

Kurse, sipas nenit 277 të Kodit Penal të Kosovës, konsiderohet vepër penale lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge.

Veprimet me të cilat kryhet kjo vepër penale nuk janë përcaktuar si alternative: lehtësim për sigurimin e drogave ose lehtësim për përdorimin e tyre në kundërshtim me ligjin. Lehtësimi i sigurimit të drogave bëhet në mënyra të ndryshme, me veprime ose me mosveprime. Veprim i tillë është: premtimi i lehtësimit, i cili mund të jetë afatshkurtër ose i përhershëm. Kjo vepër penale quhet e kryer edhe vetëm me lehtësimin e sigurimit të drogës, pavarësisht se kjo nuk është konsumuar nga viktimat.

Mënyrat e lehtësimit të përdorimit të drogës janë të shumëllojshme dhe varen nga rrethanat e kryerjes së veprës penale, cilat duhen vërtetuar për secilin rast. Lehtësim i përdorimit sipas këtij inkriminimi duhet kuptuar çdo veprim me të cilin personi tjetër joshet që të konsumojë narkotik, substancë psikotrope apo analoge, si: formimi i bindjes për konsumim të një apo më shumë personave, shtytja, dhënia apo mënyra tjera stimuluese për konsumim narkotikësh, substancash psikotrope apo analogëve. Mjafton vetëm ngashënjimi i një personi, për ekzistimin e kësaj vepre penale. Lehtësim i përdorimit do të ishte edhe

dhënia e mjeteve me të cilat konsumohen drogat ose vënia e drogës në disponim për konsumim etj. (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Në nenin 277 janë bërë plotësime thelbësore, për të pasqyruar qartë figurën e krimit, veprimet që kanë të bëjnë me administrimin e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge dhe, për shkak të detyrës që ka, edhe me pronarin apo drejtuesin e lokalit apo të hapësirës tjetër të mbyllur që përdoret nga publiku, që lejon apo toleron përdorimin e narkotikëve.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e njeriut. Nga ana objektive, krimi kryhet me veprime alternative: lehtësimi për sigurimin e drogave ose lehtësimi për përdorimin e tyre. Në paragrafin 2 jepen veprimet, me të cilat kryhet vepra: lejimi apo tolerimi i përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge nga drejtuesi apo pronari i lokalit.

Subjekt i veprës penale paraqitet në rrethana të cilësuar: personi që administron narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, si farmacisti, persona në organizata qeveritare ose joqeveritare që kanë nën administrim narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, si dhe personi drejtues apo pronar i lokalit apo i ndonjë hapësire tjetër të mbyllur, që përdor publiku. Nga ana subjektive vepra quhet e kryer kur bëhet me dashje direkte apo të tërthortë.

Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit (Neni 278)

Me këtë dispozitë inkriminohet kultivimi i bimës së hashashit, i shkurre së kokainës ose kanabisit, me qëllim prodhimin e narkotikëve ose të substancave psikotrope. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kroacisë nr.KZ28/99, me *kultivim* nënkuptohen të gjitha veprimet e nevojshme që nga mbjellja e deri te vjelja e bimëve narkotike (hashashit, shkurre së kokainës, bimën e kanabisit). Sipas praktikës gjyqësore, është kualifikuar veprimi i mbjelljes dhe rritjes (kultivimit) të katër bimëve të kanabisit (kërpit), nga e cila përfitohet droga marihuana, pavarësisht nëse është mbjellë dhe rritur për nevoja vetjake apo për shitje (Bačić&Pavlović,2006:643).

Kultivimi pra përfshin procesin e mbjelljes dhe rritjes së bimëve, nga të cilat prodhohen narkotikët dhe substancat psikotrope. Ai quhet vepër penale, kur bëhet i paautorizuar dhe me qëllim prodhimin e narkotikëve ose substancave psikotrope. Nga ky formulim del se, nëse kultivimi i këtyre bimëve bëhet për qëllime të tjera, për shembull, për prodhimin e kërpit ose të produkteve të tjera dhe, nëse nuk bëhet me qëllim prodhimin e narkotikëve ose substancave psikotrope, por për konsumimin vetjak apo për shitje, atëherë nuk ka vepër penale.

Figurë e veprës penale konsiderohet kultivimi i paautorizuar i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimës së kanabisit, me qëllim prodhimin e narkotikëve ose substancave psikotrope. Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të ndaluar kultivimin e këtyre bimëve, si dhe ato që lidhen me rendin dhe sigurinë e jetës dhe të shëndetit të personit. Nga ana objektive, krimi kryhet me një veprim, kultivimin pa

autorizim, ndërsa objektet, me të cilat kryhet, veprimi janë alternative: bima e hashashit, shkurrja e kokainës, bima e kanabisit. Subjekt i veprës penale është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe që në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm. Kultivimi quhet vepër penale vetëm kur kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe kur autori është i vetëdijshëm se po kultivon bimë nga të cilat dëshiron të prodhojë narkotikë apo substanca psikotrope (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Mendojmë se përcaktimi në Kod i kësaj figure krimi është bërë me të drejtë, pasi në praktikë është shtuar ndjeshëm kultivimi i këtyre bimëve, gjë që e tregon edhe sasia shumë e madhe e bimëve të kanabisit të konfiskuara dhe të asgjësuar, si dhe trafikimi i tij në vendet fqinje.

Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope (Neni 279)

Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope nga grupet kriminale paraqesin rrezikshmëri të lartë për individin, shoqërinë dhe shtetin. Këto veprime të kundërligjshme përbëjnë **figurën e veprës penale**. Kryerja e njërit prej këtyre veprimeve nga ana e subjektit dhe sidomos kur përfshihen sasi të mëdha narkotikësh apo substancash psikotrope, dënohet mjaft rëndë. Edhe pse termi “sasi të mëdha” nuk është i përcaktuar në këtë dispozitë, organet gjyqësore mund të përcaktojnë se cilat duhet të konsiderohen sasi të mëdha.

Veprimet e kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni paraqiten si alternative:

- 1) organizimi për kryerjen e ndonjë vepre penale nga ky kapitull;
- 2) drejtimi i kryerjes së ndonjë nga veprat penale të këtij kapitulli
- 3) financimi për kryerjen e ndonjë vepre penale nga ky kapitull.

Siç duket qartë, ndëshkohen organizatori, drejtuesi dhe financuesi i kryerjes së ndonjëres nga veprat penale të këtij kapitulli.

Me organizim duhet kuptuar dhënia e idesë, rekrutimi apo gjetja e personit për ta kryer veprën penale e deri tek krijimi i kushteve për kryerjen e veprës penale (Salihu& Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Këtu, duhet bërë dallimi mes organizimit të kryerjes së ndonjë vepre penale nga ky kapitull dhe veprës penale ‘krim i organizuar’, që përmendet në paragrafin 2 të këtij neni. Te vepra penale, krim i organizuar nga neni 283 par. 2, autori merret me organizimin, themelimin, mbikëqyrjen, menaxhimin ose drejtimin e veprimtarisë së grupit kriminal të organizuar. Ndërsa kjo vepër penale, që po analizojmë, konsiston në organizimin e kryerjes së ndonjëres nga veprat penale të këtij kapitulli, pa marrë parasysh se kush e kryen atë, një person apo një grup.

Veprim tjetër i kryerjes së kësaj vepre është *drejtimi* i saj. Ky nënkupton dhënien e udhëzimeve për mënyrën, kohën, vendin e kryerjes së veprës penale, hartimin e planit etj. Ndërsa *financimi* është mbështetja në të holla apo pasuri tjetër e atyre që kryejnë këtë vepër.

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe në momentin e kryerjes së veprës penale është i përgjegjshëm. Nga ana subjektive, vepra quhet e kryer, kur bëhet vetëm me dashje.

Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull
(Neni 280)

Me këtë dispozitë synohet t'i jepet goditje e fortë krimit të organizuar në fushën e narkotikëve. Ajo shënon një frymë të re në legjislacionin e Kosovës, por edhe të vendeve të rajonit.

Figura e veprës penale - Sipas nenit 280, konsiderohet vepër penale konvertimi, apo transferimi i pasurisë, që rrjedh nga kryerja e cilësdo vepre penale nga ky kapitull, me qëllim fshehjen apo mbulimin e origjinës së paligjshme apo ofrimin e ndihmës personit që është i përfshirë në kryerjen e veprës penale apo veprave të tilla, për t'iu shmangur pasojave juridike të veprimeve të tij (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Me *konvertim* nënkuptohet shndërrimi i një prone në një pronë tjetër, pronë e paluajtshme, në pronë të luajtshme; shndërrimi i një valute në një valutë tjetër apo në ndonjë metal të çmuar; valutë, në pronë të paluajtshme apo të luajtshme etj. Ndërsa, me *transferim* nënkuptohet ndërrimi i pronarit të pasurisë apo i poseduesit, i shfrytëzuesit, i mbajtësit të pengut; futja në formë aksionesh në ndonjë korporatë ekonomike ose te ndonjë person tjetër juridik, apo në forma tjera, nga e drejta e pronësisë dhe të drejtave të tjera sendore; si edhe transferimi i sendeve të luajtshme me vlerë jashtë shtetit të Kosovës.

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe që në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm. Nga ana subjektive, vepra konsiderohet e kryer, kur bëhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë.

Me shumë vlerë është përcaktimi që bëhet në paragrafin 2, të nenit 280, se goditja e grupeve kriminale bëhet jo vetëm me dënimin me burgim të anëtarëve të tyre, por edhe me goditje të pasurisë së përfituar si pasojë e kryerjes së veprës apo veprave penale në fushën e narkotikëve. Kjo pasuria e konvertuar apo e transferuar konfiskohet.

Kjo ka shumë rëndësi, sepse duke konfiskuar pasurinë e të dënuarve për këtë vepër penale, hiqet mundësia dhe pritet rruga e përdorimit të kësaj pasurie për vazhdimin e veprave të tjera kriminale që lidhen me narkotikë.

Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky kapitull (Neni 281)

Neni 281 përcakton rrethana cilësuese dhe, nëse veprat penale nga nenet 273, 274, 275, 276 dhe 278 kryhen në rrethana të tilla, sanksionet penale janë mjaft të larta. Rrethanat cilësuese kanë qenë përcaktuar edhe në Kodin e përkohshëm penal të vitit 2004, por në Kodin e tanishëm ato janë përcaktuar në një dispozitë të vetme.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të ruajtur rendin dhe sigurinë e jetës, shëndetin e njerëzve etj.

Veprat penale, të parashikuara nga nenet 273, 274, 275, 276 dhe 278 të Kodit penal, paraqesin rrezikshmëri të lartë për individin dhe shtetin, aq më shumë kur kryhen në rrethana të tilla, si: autori është person zyrtar; autori përdor ose kanos se do të përdorë dhunë ose armën; vepra është kryer brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë metrash nga cilido institucion i edukimit apo autori është person zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij etj. (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Kompensimi ndaj zbatuesve të ligjit (Neni 282)

Kjo dispozitë lidhet me situatat kur organet e zbatimit të ligjit, për të mundësuar provat e kryerjes së një krimi, përdorin praktikat simuluese, duke blerë sasi të ndryshme narkotikësh nga poseduesit e tyre, gjë që, pa dyshim, kërkon shpenzim fondesh monetare. Por këto shpenzime nuk ka pse të bien në kurriz të shoqërisë, të taksapaguesve, ndaj ligjvënësi, me shumë të drejtë, parashikon që kjo barrë financiare të bjerë mbi të inkriminuarit.

Pikërisht këtë përcakton neni 282: *“Kur personi dënohet për ndonjë vepër penale nga ky Kod, gjykata mund ta urdhërojë personin e dënuar që të bëjë kompensimin e cilësdo agjenci për zbatimin e ligjit, për shpenzimet e arsyeshme të bëra nga agjencia përkatëse në blerjen e narkotikëve ose substancave psikotrope nga ai person ose nga agjenti i tij, si pjesë e hetimit që shpie në dënimin e tij”.*

Kjo dispozitë është e re në sistemin tonë penal, edhe pse këto shpenzime mund të kompensohen nga i dënuari, kur ato të llogariten si shpenzime të procedurës penale që, në fakt, edhe janë (Salihu&Zhitija&Hasani:2014:7-770).

Kjo risi, pa dyshim, ka impakt pozitiv, jo vetëm në goditjen penale të autorëve të veprave penale me narkotikë, por edhe në rrafshin ekonomiko-financiar, pasi dihet që hetimi dhe zbulimi i veprave penale në fushën e narkokriminalitetit ka një kosto financiare të lartë, ndaj dhe kujdesi për shpenzimet është i domosdoshëm. Në këtë kuptim dispozita e mësipërme është një kontribut edhe në këtë drejtim.

Nga sa u tha më lart, konsiderojmë se legjislacioni në fushën e narkokriminalitetit në Kosovë ka evoluar vazhdimisht, është përmirësuar e plotësuar, duke mbushur zbrazëtitë dhe duke evituar mangësitë që ka pasur. Në Kodin penal të vitit 2013 është rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse kapitulli i veprave penale në fushën e narkokriminalitetit, duke marrë si model Kodin penal të Shqipërisë. Kjo ka ndikuar pozitivisht në luftën kundër narkokriminalitetit në Kosovë.

KREU IV: ASPEKTE FENOMENOLOGJIKE TË NARKOKRIMINALITETIT NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË

Njohja e kriminalitetit nuk është problem i lehtë, pasi është fjala për një dukuri komplekse, në të cilën ndikojnë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm (Hysi,2010:147-413).

Por edhe më shumë rëndësi ka njohja e shkaqeve dhe e rrënjëve të kësaj dukurie. Siç thonë edhe shumë studiues këto janë të natyrave të ndryshme, ndaj dhe kërkohet përfshirja e kriminologëve edhe e specialistëve dhe studiuesve të fushave të ndryshme të shkencës. Shkaqet e kriminalitetit përbëjnë problemin më të rëndësishëm dhe të mprehtë për shkencën e kriminologjisë, ndërsa në të përqendrohen elemente të filozofisë, ekonomisë, politikës, jurisprudencës, psikologjisë sociale, sociologjisë etj. (Gjonçaj,L.&Gjonçaj,G., 2013:178).

Aspekti kriminologjik i narkokriminalitetit ka rëndësi të madhe preventive, sepse, përmes tij arrihen përpilimi dhe zbatimi i masave dhe i planeve parandaluese apo represive. Zbatimi me sukses i këtyre masave varet edhe nga faktorët fenomenologjikë dhe ata etiologjikë.

Në kushtet, kur trendi i zhvillimit të shoqërisë në Shqipëri dhe në Kosovë ka ndikuar edhe në përhapjen e kriminalitetit, është bërë imperative që agjencitë dhe strukturat e zbatimit të ligjit jo vetëm të ndjekin dinamikën dhe trendin e veprave kriminale në këtë fushë, por edhe të bëjnë evidencimin sistematik të tyre, të bëjnë analiza, përgjithësime, me qëllim që të njihet dhe të jetën nën kontroll situata.

Përpjekje në këtë drejtim ka, por mendojmë se duhet bërë më shumë për të pasur një tablo të qartë dhe më të plotë në planin kombëtar në të dyja vendet. Sipas statistikave

zyrtare, vetëm në vitin 2014 janë kryer 1.25 milionë vepra që lidhen me narkokriminalitetin, prej tyre 781.000 lidhur me posedimin dhe me përdorimin vetjak të kanabisit (EMCDDA,2015: 6-12). Sot llogaritet se në përmasa botërore ka më se 246 milionë përdorues tnarkotikësh, të moshës 15-64 vjeç (UNDOC,2015:1-60).

Policia dhe Prokuroria japin shifra, nga të cilat konstatohet se në Shqipëri dhe në Kosovë kemi rritje të trendit të krimeve, të procedimeve penale dhe të dënimeve në fushën e drogës për periudhën 2007-2011 nga 10% deri 100% (ESB,2014:9-173).

Edhe lidhur me përdoruesit problematikë të drogës në Kosovë nuk ka statistika dhe vlerësime të gjendjes. Vlerësimi i cituar më së shpeshti i popullsisë përdoruese të drogës është mes 10.000-15.000 individëve, prej këtyre, përafërsisht 4.000-5.000 mendohet të jenë përdorues të heroinës (EMCDDA,2014dh:15-25). Ndërsa në Shqipëri mendohet se numri i përgjithshëm i të rriturve (të moshës 15-64 vjeç), që kanë provuar ndonjëherë ndonjë lloj droge të paligjshme është vlerësuar se luhetet midis 40.000 dhe 60.000 personave (prevalenca e jetës e midis 2.0% dhe 2.8%), (EMCDDA,2013:16-45).

Këto të dhëna janë alarmuese. Prej tyre kuptojmë se aspekti kriminologjik i narkokriminalitetit, siç shprehen edhe studiuesit, duhet trajtuar seriozisht dhe në mënyrë sistematike, për të pasur të dhëna të sakta, mbi të cilat të ndërtohet edhe puna për luftimin e narkokriminalitetit. Prandaj dhe aspekti kriminologjik është mjaft i rëndësishëm dhe aktual, pasi tani gjithnjë e më tepër jemi po ballafaqohemi me një dukuri kriminale apo me një dukuri të rrezikshme psiko–sociale. Në mjaft institucione, në shkolla të zakonshme, në burgje, është futur përdorimi i lëndëve narkotike (Papandile,J.&Papandile,E.,2010:230). Profesor dr. Ragip Halili konstaton, me të drejtë, se narkomania paraqet dukurinë negative shoqërore, që manifestohet në përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe të pijeve

të tjera narkotike (Halili,2005:115-308). Gjithashtu, ky autor thekson se: Kur flitet për narkomaninë si faktor socio-patologjik në kriminologji, zakonisht, mendohet për të gjitha pasojat e kësaj dukurie e, në rend të parë, për raportet dhe lidhjet e saj me sjelljet kriminale (Halili,2005:115-308).

4.1. Fenomenologjia e narkokriminalitetit në Shqipëri dhe në Kosovë

Fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit, me strukturën dhe dinamikën e tij (Halili,2005:115-308).

Ekzistojnë shumë teori dhe mendime të kriminologëve për fenomenologjinë kriminale. Kriminologu Hans Gross mendon se fenomenologjia kriminale duhet të merret me studimin e simptomave të jashtme të kriminalitetit (Halili,2005:115-308).

Pjesë e fenomenologjisë kriminale është edhe fenomenologjia e narkokriminalitetit, që merret me studimin nga këndvështrimi i jashtëm, pra, me format përmes të cilave manifestohet kjo dukuri kriminale. Kriminaliteti është një dukuri sociale komplekse, që karakterizohet nga këndvështrime të ndryshme, ndër të cilat më kryesore janë vëllimi, struktura, tendenca dhe dinamika e tij (Hysi,2010:147-413).

Më poshtë po ndalemi në trajtimin e këtyre këndvështrimeve, njohja e të cilave shërben për rritjen e efikasitetit të punës për parandalimin dhe luftimin e anrkokriminalitetit.

Vëllimi dhe struktura e narkokriminalitetit

Vëllimi i kriminalitetit nënkupton tërësinë e krimeve të kryera në një kohë të caktuar dhe vend të caktuar (Hysi,2010:147-413). Analizimi i këtij vëllimi është i domosdoshëm dhe detyrë e dorës së parë për organet dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Ai realizohet me një punë sistematike, përmes statistikave kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë rëndësi të madhe, sepse tregojnë ecurinë e narkokriminalitetit, rënien apo rritjen e tij. Krahas kësaj, ato mundësojnë edhe njohjen me llojet dhe strukturën e veprave kriminale në këtë fushë.

Për të pasur një pasqyrë të vëllimit dhe strukturës së narkokriminalitetit në Kosovë dhe në Shqipëri, në kuadrin e këtij studimi kemi mbledhur të dhëna statistikore të ndryshme nga institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë dhe në Shqipëri. Sipas Policisë së Shqipërisë, për periudhën 2007-2011, vëllimi i narkokriminalitetit ka shënuar rritje. Në raport me popullsinë (që, sipas regjistrimit të vitit 2011, ishte 2.821.977 banorë - INSTAT, 2011:6-10), në Shqipëri, në vitin 2007, në fushën e drogave janë regjistruar 16 krime për 100.000 banorë; në vitin 2008, 21 krime për 100.000 banorë; në vitin 2009, 20 krime për 100.000 banorë; në vitin 2010, 17 krime për 100.000 banorë dhe në vitin 2011, 26 krime për 100.000 banorë (ESB,2014: 9-173).

Në Kosovë, (popullsia e së cilës, sipas regjistrimit të vitit 2011 (ASK, 2015:17-92), ishte 1.820.631 banorë) sipas Policisë, për periudhën 2007-2011, vëllimi i narkokriminalitetit është rritur. Raporti i veprave penale në fushën e drogave me popullsinë në Kosovë në vitin 2007 ishte 4 krime për 100.000 banorë; në vitin 2008, 5 krime për 100.000 banorë; në vitin 2009, 4 krime për 100.000 banorë; në vitin 2010, 5 krime për 100.000 banorë dhe në vitin 2011, 8 krime për 100.000 banorë (ESB,2014:9-173).

Me interes janë edhe statistikave për procedimet penale dhe për dënimet për veprat penale në fushën e narkotikëve. Në Shqipëri, në vitin 2010, për këto lloje veprash janë regjistruar 22 procedime penale për 100.000 banorë, prej tyre 52% janë dërguar në Gjykatë (ESB,2014: 9-173). Ndërkaq, sipas statistikave të Gjykatës, në Shqipëri, në vitin 2007 janë dënuar 9 persona për 100.000 banorë; në vitin 2008, 10 të dënuar për 100.000 banorë; në vitin 2009, 13 të dënuar për 100 000 banorë; në vitin 2010, 12 të dënuar për 100.000 banorë dhe në vitin 2011, 19 të dënuar për 100.000 banorë (ESB,2014:9-173).

Tendenca e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit sipas analizës së të dhënave

Tendenca e kriminalitetit nënkupton drejtimet kryesore të kriminalitetit në tërësi, ose të llojeve të veçanta të krimeve në një periudhë kohe të caktuar (Hysi,2010:147-413).


Në vijim po sjellim një analizë të statistikave të Policisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Gjykatave në Shqipëri dhe në Kosovë për narkokriminalitetin në vitet 2005-2015.

4.2. Analizimi i të dhënave të Policisë lidhur me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit

Numri i personave të dyshuar për vepra penale në fushën e drogave që figurojnë në të dhënat e Policisë, jo gjithnjë është tregues i saktë i kriminalitetit. Këtë e themi jo thjesht nga pasaktësitë që vihen re në disa raste në këto statistika, por ato nuk japin një situatë reale

edhe sepse ndodh që shumë prej të dyshuarve të Policisë nga hetimet e mëtejshme mund të mos rezultojnë të tillë ose nuk zbulohen dhe nuk kapen. Kjo shpjegon mospërputhjet midis evidencimeve të rasteve dhe të personave dhe numrit real të atyre që janë zbuluar e kapur.

Konkretisht, gjatë periudhës 2005-2015, Policia Shqipëri ka evidencuar 23.137 raste, nga të cilat ka zbuluar 14.889 raste, ose 64.35%. Siç shihet, ka një diferencë të madhe ndërmjet rasteve të regjistruara dhe rasteve të zbuluara në fakt. Sidoqoftë, duhet thënë se të dhënat nga Policia janë një burim i rëndësishëm informacioni për ecurinë e narkokriminalitetit, ndaj dhe i kemi përdorur në këtë studim, pasi na kanë shërbyer për t'i analizuar dhe për të nxjerrë përfundime.



***Burimi (Policia e Shtetit, Statistika për periudhën 2005-2015)**


Figura 2: Numri i rasteve të evidentuara dhe të zbuluara të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit në Shqipëri, për periudhën 2005-2015

Nga një vështrim i shpejtë i këtyre statistikave, në figurën nr. 2, shohim se në Shqipëri numri më i madh i veprave penale në fushën e narkokriminalitetit të evidentuara është regjistruar në vitin 2010, kurse në vitin 2011 kemi numrin më të madh të rasteve të

zbuluara, konkretisht 95.67%.

Në Kosovë, droga jo vetëm është bërë e njohur edhe përdoret prej të rinjve, por edhe trafikohet. Luftimi i narkokriminalitetit, sidomos i krimit të organizuar në këtë fushë, konsiderohet prioritet thelbësor.

Nga të dhënat statistikore të Policisë së Kosovës për veprat penale në këtë fushë për periudhën 2005 – 2015, shohim se, janë iniciuar 4.120 raste, nga të cilat, 1.150 raste të trafikimit, 2.537 raste të posedimit dhe 433 raste të kultivimit të bimëve narkotike. Numri më i vogël i rasteve në fushën e narkokriminalitetit (203) është regjistruar në vitin 2008, kurse numri më i madh i rasteve të iniciuara (640) është në vitin 2014.




***Burimi: Policia e Kosovës**

Figura 3: Numri i rasteve të evidencuara për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit në Kosovë, 2005-2015

Një aspekt tjetër me rëndësi i ecurisë së narkokriminalitetit është edhe analiza lidhur me numrin e personave të dyshuar për veprimtari kriminale. Ky tregues, në Shqipëri


ka shënuar ulje-ngritje, por tendenca është rritja e tyre. Sipas Policisë, për periudhën 2005-2015 janë regjistruar si të dyshuar për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit 23.123 persona. Vitet 2005 dhe 2006 kanë numrin më të vogël të të dyshuarve, kurse viti 2010 paraqet rekord, me 8.288 të dyshuar.



***Burimi (Policia e Shtetit, Statistika për periudhën 2005-2015)**

Figura 4: Numri i autorëve të dyshuar në Shqipëri për periudhën 2005–2015

Ndërsa në Kosovë, sipas statistikave zyrtare të Policisë, gjatë periudhës 2005-2015, janë evidencuar 6.202 të dyshuar. Më shumë ka pasur në vitin 2014 (871 persona), kurse më pak janë në vitin 2005 (354). Nga statistikat mund të kuptojmë se numri i të dyshuarve gradualisht nga viti 2005 ka pasur rritje të numrit të personave të dyshuar.



***Burimi: Policia e Kosovës**

Figura 5: Numri i autorëve të dyshuar në Kosovë për periudhën 2005–2015

Tendenca e narkokriminalitetit mund të vlerësohet edhe përmes të dhënave statistikore mbi sasinë e substancave narkotike dhe psikotrope të sekuestruara gjatë aktiviteteve operationale të policisë kundër trafikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike.

Në Shqipëri, në periudhën 2005-2015, policia ka konfiskuar sasi të mëdha narkotikësh. Siç shihet në figurën 6, sasia më e madhe e narkotikëve të sekuestruar për këtë periudhë është ajo e marihuanës, 303.702 kilogramë e 998 gramë. Për sasinë më të madhe të marihuanës së konfiskuar spikat viti 2014, me 97.226 kilogramë e 101 gramë. Kjo, për shkak të impaktit që pati operacioni në fshatin Lazarat, që është njohur si vendi më i madh i kultivimit të marihuanës në Shqipëri. Kokaina paraqet sasinë më të vogël të substancave të konfiskuara për periudhën 2005-2015, me 140 kilogramë e 31 gramë. Heroinë janë konfiskuar gjithsej 2.333 kilogramë e 348 gramë, kurse hashash, 1.719 kilogramë.

Viti	Heroinë	Kokainë	Canabis Sativa	Marihuanë	Hashish	Të tjera
2005	17kg 555gr	2kg 858gr	1020 kg 394gr	3.160kg 432gr	20kg 013gr	5kg 116gr
2006	12kg 041gr	3kg 857gr	1020 kg 394gr	6.754kg 207gr	20kg 013gr	5kg 116gr
2007	137kg 969gr	6kg 715gr	2040 kg 788gr	9.914kg 639gr	40kg 25gr	10kg 232gr
2008	275kg 939gr	13kg 431gr	4081kg 576gr	19.829kg 278gr	80kg 050gr	20kg 465gr
2009	551kg 878gr	26kg 863gr	8163kg 152gr	39.658kg 556gr	160kg 101gr	40kg 931gr
2010	1.103kg 757gr	53kg 727gr	16.326kg 304gr	79.317kg 113gr	320kg 203gr	81kg 862gr
2011	21kg 402gr	2kg 205gr	352gr	7677kg 628gr	21kg 131gr	25kg 759gr
2012	91kg 990gr	4kg 239gr	164kg 931gr	19.550kg 520gr	1001kg 704gr	171kg 362gr
2013	47kg 320gr	16kg 104gr	35.6gr	20.614kg 519gr	32kg 009gr	2kg 238gr
2014	73kg 491	10kg 028gr	/	9.7226kg 101gr	24kg 450gr	561kg 639gr
2015	38kg 194gr	27kg 084gr	11,400kg 727gr	/	/	10.086kg 491gr
Total	2.371 kg 194gr	167 kg 084gr	44.217 kg 727 gr	303.702kg 998gr	1.719kg 701gr	10.248kg 649gr

Burimi (Policia e Shtetit, Statistika për periudhën 2005-2015)

Figura 6: Sasia në kilogramë e substancave narkotike të sekuestruara në vitet 2005-2015 në Shqipëri.

Për Kosovën, të dhënat për sekuestrimin e narkotikëve në vitet 2005-2015 pasqyrohen në figurën nr.7.

Viti	Heroina	Marihuanë	Hashash	Kokainë	Ekstazi	Të tjera
2005	36kg 475gr	55kg 304gr	206gr	3kg 785gr	40 copë	22kg 189gr
2006	14kg 648gr	66kg 635gr	382gr	1kg 721gr	0.00	23kg 799gr
2007	47kg 766gr	32kg 123gr	0.00	1kg 920gr	61 copë	1kg 619gr
2008	44kg 644gr	177kg 490gr	0.00	2kg 150gr	40 copë	13gr
2009	36kg 121gr	43kg 644gr	0.00	1kg 446gr	2,169. copë	2kg 455gr
2010	55kg 611gr	199kg 277gr	3gr	221gr	6 copë	1kg 318gr
2011	60kg 331gr	216kg 649gr	0.00	2kg 738gr	699 copë	5kg 389gr
2012	94kg 125gr	1,237kg 994gr	548gr	7kg 396gr	153 copë	886gr
2013	22kg 434gr	580kg 927gr	0.00	3kg 868gr	107 copë	57gr
2014	9kg 606gr	737kg 937gr	0.00	21kg 104gr	52 copë	6kg 030gr
2015	9kg 585gr	461kg 721gr	0.00	55gr	265 copë	9kg 306gr
Total	454kg 628gr	3.832kg 991gr	1kg 138gr	46 kg 404gr	3.592 copë	73kg 058gr

***Burimi: Policia e Kosovës**

Figura 7: Sasia në kilogramë e substancave narkotike të sekuestruara gjatë viteve 2005 -2015 në Kosovë.

Nga këto të dhëna vërehet se sasia më e madhe e sekuestruar, është ajo e marihuanës, 3.832 kilogramë e 991 gramë, e pasuar nga heroina, 445 kilogramë e 043 gramë (Policia e Kosovës,2016).


Siç shohim nga të dhënat statistikore të Policisë, në Shqipëri dhe në Kosovë vërehet një tendencë rritjeje e grupit të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit, krahasuar me më parë. Por në Kosovë, përveç rritjes së numrit të rasteve të veprave penale, tendencë rritjeje ka edhe numri i personave të dyshuar (*Policia e Kosovës*,2016).

Ky trend kurrësi nuk duhet neglizhuar nga organet e zbatimit të ligjit, të cilat pas shifrave, duhet të shohin edhe mangësitë në punën e tyre, si në aftësinë zbuluese, por edhe goditëse të tyre ndaj krimit dhe kriminelëve, që merren me trafikimn e narkotikëve. Kjo kërkon rritje cilësore të kualifikimit e profesional të efektivave të tyre, por edhe forcimin e bashkëpunimit midis agjencive dhe institucioneve të ndryshme, si dhe me komunitetin. Ndërsa institucionet shkencore, akademike kanë obligimin që në bashkëpunim me organet ligjzbatuese të evidencojnë dhe të analizojnë shkaqet e kësaj rritjeje të veprave kriminale dhe të autorëve të tyre. Këto nuk bëhen me fushata apo në mënyrë sporadike, por duhen vënë në themel të punës së tyre dhe të kenë vazhdimësi.

4.3. Analizimi i të dhënave të Prokurorisë lidhur me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit

Të dhënat e Prokurorisë për procedimet penale të pranuar, paraqesin të tregues të rëndësishëm dhe janë një burim i mirë për analizimin e tendencës së krimit, në përgjithësi, e, në veçanti, të narkokriminalitetit.


Meqenëse në Kosovë nuk kemi mundur të sigurojmë të dhëna të Prokurorisë së Shtetit për numrin e procedimeve penale të pranuar lidhur me narkokriminalitetin, jemi mjaftuar me të dhënat që kemi siguruar nga raportet e Prokurorisë së Përgjithshme e Shqipërisë dhe të Departamentit amerikan të Shtetit Duke analizuar të dhënat e kësaj Prokurorie për vitet 2007-2015, konstatohet se veprat penale që ndërlidhen me narkotikë, pa përjashtuar veprën penale *Trafikimi i narkotikëve*, nga neni 283/a i Kodit penal, del se janë pranuar 6.237 procedime penale (PP, 2005-2015&US Dept of State 2009-2015).



***Burimi: Raportet e Prokurorisë së Përgjithshme 2005-2015 dhe US Dept of State 2009-2015.**

Figura 8: Numri i procedimeve të pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë për periudhën 2009-2015.

Nga statistikat e Departamentit amerikan të Shtetit del se në Shqipëri në periudhën 2009-2015 prokuroritë kanë dërguar për gjykim 2.318 çështje penale që lidhen me narkokriminalitetin (US Dept of State 2009-2015). Ndërsa numri i të pandehurve të dënuar në këtë periudhë për krime në këtë fushë është 2.776 persona (PP,2005-2015).



***Burimi: Raportet vjetore të Prokurorisë së Përgjithshme 2005-2015.**

Figura 9: Numri i procedimeve penale për veprat penale nga nenet 283, 283/a dhe 284 për periudhën 2005-2015.

Në figurën nr.9 janë analizuar të dhënat e procedimeve penale për tri vepra. Sipas tyre, rezulton se veprat penale nga neni 283 dhe 283/a kanë tendencë rritjeje, në krahasim me vitin 2012 (PP,Shqipëri,2013:8-247). Peshë specifike që zë vepra penale *Trafikim i narkotikëve* nga neni 283/a, në grupin e veprave penale *Trafike të paligjshme*, është 38%, ndërkohë që në vitin 2012 ky tregues ka qenë 27.74% (PP,Shqipëri,2013:8-247).

4.4. Analizimi i të dhënave për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit dhe për autorët e tyre

Në gjykimin e çështjeve penale dhe të dyshuarve për krime në fushën e narkokriminalitetit, gjykata paraqet hallkën e fundit të zinxhirit të sistemit të drejtësisë penale. Ndryshe qëndron problemi, kur është fjala për përdoruesit e substancave narkotike, të cilët, sipas rastit, edhe mund të mos përfundojnë në proces gjyqësor. Por ne po ndalemi këtu te praktika e gjykatave për të njohur dinamikën e çështjeve gjyqësore të hapura për vepra të ndryshme të narkokriminalitetit gjatë periudhës që po analizojmë dhe të autorëve të tyre.

Është konstatim i përgjithshëm rritja e numrit të proceseve gjyqësore për procedimin e të dyshuarve të zbuluar dhe të kapur nga policia. Për studimin tonë me interes janë të dhënat që kemi siguruar rreth tyre nga burime të organeve të drejtësisë, sepse në to shohim dinamikën e proceseve gjyqësore, objektin dhe karakteristikat e veprave penale që ato kanë gjykuar, vendin dhe kohën e kryerjes. Në këto statistika gjejmë të dhëna edhe për personat e dyshuar, të gjykuar dhe të dënuar për vepra të narkokriminalitetit. Këto kanë vlera, pasi na ndihmojnë t'i analizojmë jo vetëm në aspektin sasior, por edhe duke depërtuar në disa tregues, si karakteristikat personale, mosha, gjinia, përkatësia etnike, pozita sociale dhe arsimimi i të dyshuarve dhe të gjykuarve.

Shqyrtimi dhe përshkrimi i tyre këtu, mendojmë se janë me interes, jo vetëm për studimin tonë, por edhe për strukturat e zbatimit të ligjit, si policia, organet e drejtësisë, prokuroria dhe gjykatat, për juristët dhe ekspertët e kësaj fushe.

Me këto synime, më poshtë po sjellim analizimin e të dhënave empirike të siguruara, të ndara në disa grupe: çështjet e gjykuara sipas viteve, sipas vendit dhe kohës së kryerjes së krimit, sipas autorëve të gjykuar dhe karakteristikave të autorëve.

Çështjet e gjykuara

Në figurën nr.10 pasqyrohen të dhënat lidhur me numrin e çështjeve të gjykuara në Shqipëri për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit. Gjykatat kanë shqyrtuar në total 3.320 çështje të tilla, dinamika e të cilave tregon tendencën në rritje të numrit të tyre nga viti në vit. Nga shqyrtimi i bërë rezulton se numri më i madh i çështjeve të gjykuara është regjistruar në vitin 2014, gjithsej 519. Kurse viti 2005 ka numrin më të vogël, 122 çështje të gjykuara.




***Burimi: (Ministria e Drejtësisë, Vjetari Statistikor për periudhën 2005-2014)**
 Figura 10: Çështje të gjykuara në Shqipëri për veprat penale në fushën e drogave për periudhën 2005-2014

Vendi i kryerjes së veprave penale

Për ta kuptuar më qartë vëllimin dhe strukturën e narkokriminalitetit, jemi ndalur edhe në vendin e kryerjes së veprave penale të kësaj fushe në Kosovë, për periudhën 2005-2015, duke parë raportin qytet-fshat dhe sipas rajoneve policore.

Raporti fshat-qytet: Lidhur me vendin e kryerjes së veprave penale në fushën e narkokriminalitetit në Kosovë, duhet të bëjmë një sqarim: si vend i kryerjes së veprës penale të posedimit të substancave narkotike, kryesisht dhe më së shumti, janë qytetet. Kurse për kultivimin e bimëve narkotike, si vend i kryerjes së veprës penale, zakonisht, dhe në pjesën dërrmuese të rasteve, paraqiten vendet rurale, ku ka sipërfaqe të bollshme toke.

Nuk duhet neglizhuar këtu fakti që viteve të fundit janë konstatuar raste që edhe në qytete të ndryshme që janë kultivuar bimë narkotike në oborret e shtëpive, madje, edhe në vazo lulesh etj., kuptohet, në sasi të vogla.



***Burimi: Policia e Kosovës.**

Figura 11: Numri i rasteve sipas vendit të kryerjes së veprës në Kosovë për periudhën 2005-2015.


Sipas Rajoneve policore, situata është paraqitur në figurën nr.11. Nga 4.120 raste të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit në vitet 2005-2015, pjesa më e madhe e tyre 1420 raste (34.47%) kanë ndodhur në Rajonin e Prishtinës, që përfshin 7 komuna; pastaj vjen Rajoni i Prizrenit, që ka 5 komuna, me 676 raste (16.41%); i ndjekur nga Rajoni i Mitrovicës, me 6 komuna, me 605 raste (14.68%); Rajoni i Gjilanit, që ka 4 komuna, me 527 raste (12.79%); Rajoni i Pejës, me 4 komuna, me 498 vepra (12.09%) dhe, në fund, Rajoni i Ferizajt, që përfshin 5 komuna, me 394 raste (9.56%) (*Policia e Kosovës*,2016).

Koha e kryerjes së veprave penale

Koha paraqet një të dhënë të rëndësishme lidhur me vëllimin dhe strukturën e narkokriminalitetit, pasi ka të bëjë me efikasitetin e strukturave policore në të gjitha orët e ditës e të natës dhe në të gjithë muajt e vitit. Duke njohur frekuencën e kryerjeve të krimeve në kohë, policia dhe efektivat e saj, që vigjilojnë dhe kontrollojnë gjatë gjithë kohës, u krijohet mundësia ta planifikojnë më mirë punën, të bëjnë ndarje detyrash dhe forcash sipas orëve kur mendohet se mund të ketë fluks më të madh krimesh. Pra, e drejtojnë vëmendjen dhe impenjimin e tyre në ato intervale kohore, që kriminelët zgjedhin më shumë për kryerjen e veprave penale.

Statistikat e Policisë së Kosovës, për periudhën 2005-2015, tregojnë se veprat penale në fushën e drogave ndodhin më shumë në 12-orëshin e dytë të ditës, nga ora 12:00 e drekës deri në orën 24:00 të mesnatës. Gjatë këtyre orëve kanë ndodhur 2.531 raste (61.43%). Kurse në harkun tjetër kohor, nga ora 00:00 në mesnatë deri në orën 12:00 të mesditës janë kryer më pak, 1.589 raste (38.57%) (*Policia e Kosovës*,2016).

Nga figura nr.12 rezulton se mes orës 21:00 - 00:00 janë kryer më shumë vepra penale, gjithsej 779 raste. Kjo tregon se në këto orë shpërndahe dhe konsumohet më shumë drogë, ndaj dhe strukturat e luftës kundër krimit duhet të intensifikojnë më shumë punën e tyre në këtë hark kohor të ditës.




***Burimi: Policia e Kosovës**

Figura 12: Koha e kryerjes së veprave penale në fushën e narkokriminalitetit 2005-2015

Krahas njohjes së konsumimit të veprave penale në fushën e drogave gjatë ditës, me interes kriminologjik është edhe shtrirja sezonale ose mujore e kryerjes së këtyre veprave. Njohja e përhapjes kohore së tyre ka vlerë, sepse mundëson organizimin më të mirë të programeve parandaluese të narkokriminalitetit, duke pasur parasysh faktorët nxitës dhe mundësitë që u ofrohen autorëve të veprave penale, me synimin që t'u pritët rruga atyre dhe të minimizohen sa më shumë krimet në këtë fushë.

Siç shohim në figurën nr.13, vepra penale të narkokriminalitetit kryhen në të gjithë

muajt e vitit (*Policia e Kosovës*, 2016), por gushti rezulton si muaji kur janë konsumuar më shumë vepra penale, ndërsa nëntori ka më pak vepra penale të kryera. Ndërsa sipas stinëve, rezulton se më shumë vepra penale janë kryer në verë, 1.587 raste.



***Burimi: Policia e Kosovës**


Figura 13: Numri i veprave penale të konsumuara në Kosovë sipas muajve të vitit për periudhën 2005-2015

Të dyshuarit e gjykuar

Me interes për studimin tonë, por edhe për strukturat e zbatimit të ligjit dhe për studiuesit, janë edhe statistikat që flasin për gjykimin e të dyshuarve dhe për dënimin e autorëve të krimeve në fushën e narkokriminalitetit.

Në figurën nr.14 pasqyrohet numri i të dyshuarve që janë gjykuar në periudhën 2005-2015 në Shqipëri për veprat penale me drogat, sipas neneve 283, 283a, 284, 284a, 284c, 285, 285a dhe 286/1 të Kodit penal. Nga të dhënat del se në 3.320 çështje të dërguara

në gjykatë, gjatë këtyre viteve, janë gjykuar gjithsej 4.204 persona të dyshuar. Pjesa më e madhe e tyre, 2.287 persona, janë gjykuar për veprën penale nga neni 283 i Kodit penal. Gjithashtu, nga statistikat e studiuara del se në vitin 2013 janë gjykuar 663 persona, shifër tri herë më e madhe se ajo e vitit 2005 (209 persona). Edhe ky shembull tregon se numri i veprave penale të fushës së narkokriminalitetit gjatë kësaj periudhe ka ardhur në rritje nga viti në vit.




***Burimi: Ministria e Drejtësisë, Vjetari Statistikor për periudhën 2005-2014.**

Figura 14: Numri i autorëve të gjykuar sipas veprave penale të narkokriminalitetit në Shqipëri për periudhën 2005-2014.

Tregues i rëndësishëm i goditjes së narkokriminalitetit, pa dyshim, është dënimi i personave, për të cilët është provuar se janë autorë të veprave penale. Ne u interesuam dhe kërkuam të dhëna statistikore për këtë dhe, meqë Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës na ofruan disa prej tyre, i analizuam dhe bëmë konstatimet e mëposhtme.

Në figurën nr.15 pasqyrohet numri i personave të dënuar në periudhën 2005-2015, për veprat penale, të ndara sipas neneve të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës (2004) dhe Kodit penal aktual. Në këto shifra të bie në sy fakti që nga 1812 të dënuarit gjithsej, më shumë prej tyre (1.073) janë dënuar për veprën penale nga neni 229, që ka të bëjë me blerjen ose posedimin me qëllim shitjeje, shpërndarjen ose ofrimin për shitje të substancave a preparateve të shpallura të rrezikshme, si narkotikë apo substanca psikotrope.



***Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës.**

Figura 15: Të dënuarit në Kosovë, sipas veprave penale në fushën e narkokriminalitetit, 2005-2015.

Karakteristikat personale të autorëve të veprave penale

Narkokriminaliteti nuk mund të shpjgohet dhe nuk mund të parandalohet e të luftohet si duhet pa studiuar karakteristikat personale të autorëve të përfshirë në këtë lloj krimi. Aspektet ekonomike, etnike e familjare, kanë rëndësinë e tyre për përfshirjen në

rrugën e narkokriminalitetit, por ato gërshetohen me aspekte psiko-sociale të individit, si: personaliteti, stili i jetesës, rrethi shoqëror, edukimi etj. që janë shtytës tepër të fortë për t'i shtyrë në krim persona të ndryshëm. Këto karakteristika nuk janë mënyrë uniforme tek individë dhe në vende të ndryshme, ndaj ato duhen njohur në mënyrë empirike në terrenin konkret, rast pas rasti, duhen studiuar dhe analizuar sistematikisht, për të nxjerrë përfundime të drejta dhe të dobishme për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit.

Kjo është e domosdoshme, sepse, siç vë në dukje autorja Hysi, studimi i fenomenologjisë kriminale tregon se kriminaliteti nuk ka përhapje të njëjtë në mosha dhe persona të ndryshëm, në zona dhe në vende të ndryshme; kriminaliteti është më i pranishëm në kategori sociale të caktuara etj. (Hysi,2010:147-413).

Nisur nga ky konkluzion, në parashtrimet tona të mëposhtme përpiqemi të shtjellojmë disa karakteristika të autorëve të krimeve me droga, si: mosha, gjinia, përkatësia etnike, pozita sociale, arsimimi i tyre etj.

Mosha e autorëve të krimeve

Mosha e autorëve të veprave të ndryshme të narkokriminalitetit është studiuar vazhdimisht. Ka mendime dhe teori të ndryshme lidhur me ndikimin që mosha ka kryerjen e krimeve. Dihet që njeriu, që nga mosha rinore dhe në faza të caktuara të jetës, ndryshon karakterin, emocionet, moralin etj. Ndikimi i këtyre ndryshimeve është i madh dhe ato shpeshherë lënë gjurmët e tyre në sjelljen dhe prirjet e individit, që mund të jenë pozitive dhe negative.


Në Shqipëri dhe në Kosovë, ku para viteve '90 nuk ka qenë shumë i përhapur përdorimi i narkotikëve, për shkak të ndryshimeve rrënjësore politike dhe ekonomike që ndodhën në vitet '90, mjaft persona, sidomos të moshave të reja, ranë pre ose u përfshinë me vetëdije në këtë lloj kriminaliteti, jo vetëm si konsumues dhe përdorues drogash, por edhe si posedues të narkotikëve dhe substancave psikotrope, si shpërndarës, shitës, trafikantë të tyre, duke krijuar një kontingjent të rrezikshëm për shoqërinë në të dyja vendet. Me kalimin e viteve, narkokriminaliteti u shtri edhe në kultivimin e bimëve narkotike, me qëllim prodhimin dhe shitjen e drogave. Duke u zgjeruar nga viti në vit, narkokriminaliteti në Kosovë dhe në Shqipëri ka përfshirë një pjesë të mirë të rinjsh, që zgjodhën rrugë të paligjshme për t'u pasuruar.

Duke u fokusuar te mosha e autorëve të veprave penale të narkokriminalitetit, sikurse shihet nga figurat nr.16 dhe 17, numrin më të madh të personave të dyshuar si autorë e kanë të rinjtë e grup-moshës 19-26 vjeç. Kjo është mjaft shqetësuese, sepse në Shqipëri dhe në Kosovë, një përqindje e madhe e popullsisë u takon moshave të reja.

Shifrat flasin se **në Shqipëri**, nga 23.123 persona, që është numri total i të dyshuarve për kryerjen e veprave të narkokriminalitetit, të miturit e moshës deri në 14 vjeç, janë 69 persona (0.30%); grup-mosha 14-18 vjeç, me 1279 persona (5.53%); grup-mosha 19-26 vjeç, me 6787 persona (29.35%); grup-mosha 27-35 vjeç, me 5186 persona, (22.43%); grup-mosha 36-45 vjeç, me 5123 persona (22.16%); dhe grup-mosha mbi 45 vjeç, me 4679 persona (20.23%) (*Policia e Shtetit*,2015).

Nga këto të dhëna konkludojmë se kontingjenti i personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale të narkokriminalitetit ka në një shtrirje të gjerë nga pikëpamja e moshës, duke filluar nga të miturit e deri tek të rriturit mbi 45 vjeç. Kjo situatë nxjerr mjaft

probleme, si për hartuesit e legjislacionit penal, ashtu edhe për shoqërinë, sidomos për plan-veprimet e parandalimit të narkokriminalitetit, pasi secila grup-moshë ka karakteristika të ndryshme nga njëra-tjetra, të cilat do të kërkonin metoda dhe praktika pune nga më të ndryshmet me secilën kategori.




***Burimi: Policia e Shtetit**

Figura 16: Moshë e personave të dyshuar për veprat penale në fushën e narkotikëve në Shqipëri

Ndërsa lidhur me moshën e të dyshuarve për veprat penale me narkotikë **në Kosovë**, kemi situatë tjetër. Numri i të dyshuarve është më shumë se 3 herë më i vogël se në Shqipëri; të miturit në Kosovë nuk përbëjnë problem lidhur me drogat; kurse grup-moshë që ka kryer më shumë vepra penale është 22-35 vjeç, me 2643 të dyshuar.

Më konkretisht, kemi këtë pasqyrë: nga 6202 të dyshuar, për periudhën 2005-2015, deri në moshën 14 vjeç është 1 i dyshuar; të grup-moshës 14-18 vjeç janë 1012 persona

(16.31%); të grup-moshës 19-21 vjeç, janë 1558 persona (25.13%); të grup-moshës 22-35 vjeç janë 2643 persona (42.61%) dhe mbi moshën 35 vjeç janë 988 persona (15.94%) (*Policia e Kosovës, 2016*).



***Burimi: Policia e Kosovës**

Figura 17: Mosha e personave të dyshuar në Kosovë për veprat penale në fushën e drogave për periudhën 2005-2015

Këtu duhet pasur parasysh edhe fakti se tjetër është numri i të dyshuarve dhe i të arrestuarve, dhe tjetër është numri i të gjykuarve dhe i të dënuarve për veprat penale në fushën e drogës, sepse disa nga të dyshuarve mund të mos u provohet kryerja e veprës penale, të tjerë nuk zbulohen ose nuk kapen. Kjo ka të bëjë me efikasitetin e punës së agjencive të luftës kundër krimit, me prioritetet e politikës penale dhe me faktorë të tjerë. Megjithatë, numri i atyre që kapen dhe dalin para drejtësisë, gjithsesi, është një tregues që

na orienton për shkallën e përhapjes së një krimi dhe ndihmon për nxjerrjen e përfundimeve përkatëse, që pastaj kontribuojnë në organizimin e punës për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit.

Gjinia e autorëve të krimeve

Studimet e organizmave rajonale dhe globale, siç janë UNDOC dhe EMCDDA, konkludojnë se veprat penale në fushën e narkotikëve ose të substancave psikotrope, kryhen nga meshkujt dhe më pak nga femrat. Këto të fundit shfaqen më shpesh në cilësinë e transportuesit të narkotikëve dhe të substancave psikotrope. Nga numri total i të dyshuarve për vepra penale në fushën e narkokriminalitetit për periudhën 2005-2015, në Kosovë, 5.962 persona janë meshkuj (96.13%), dhe vetëm 240 femra (3.87%) (*Policia e Kosovës, 2016*).

Ndërsa në Shqipëri, statistikat e Policisë për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit gjatë periudhës 2005-2015, konfirmojnë se të dyshuar për këtë veprimtari janë 23.123 persona, por pa mundur ndarjen e tyre sipas gjinisë (*Policia e Shtetit, 2016*). Lidhur me 4.204 personat e gjykuar në Shqipëri për veprat penale të narkokriminalitetit, për periudhën 2005-2014, del se 211 persona (5.01%), janë femra. Numri më i madh i femrave të gjykuara për këto vepra shënohet në vitin 2006 (67 persona), ndërsa në vitet 2012 dhe 2013 janë gjykuar nga 7 femra, në vitin 2014 janë gjykuar 11 femra (*MD, Vjetari Statistikor, 2005-2014*).

Në Kosovë gjatë periudhës 2005-2015 janë shpallur fajtorë për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit gjithsej 1.794 persona, prej të cilëve 1.726 të rritur. Prej këtyre

1.677 janë meshkuj, 49 janë femra. Ndërsa midis të miturve, 60 janë meshkuj dhe 8 femra (ASK&KGJK,2005-2015).

Nga këto të dhëna rezulton se femrat nuk janë të përfshira në masë të madhe në vepra penale me narkotikë. Edhe në përdorimin e narkotikëve femrat zënë një përqindje të vogël, në krahasim me meshkujt. Sipas të dhënave për vitin 2014, përdorues të kokainës ishin 85% meshkuj, 15% femra; përdorues të kanabisit 83% meshkuj, 17% femra; të amfetaminës 71% meshkuj, 29% femra dhe përdorues të heroinës 80% meshkuj, 20% femra (EMCDDA,2015:6-65). Po sipas kësaj qendre, del se në Europë, për sa i përket vdekjes së përdorueseve të substancave narkotike nga mbidoza, prin gjinia mashkullore, me 78%, kurse 22% janë femra (EMCDDA,2015:6-65).

Përkatësia etnike e autorëve të veprave penale

Nga pikëpamja kriminologjike dhe sociologjike raporti *autor krimi - etni* ka interes të veçantë. Studimi i tij mundëson njohjen e shkallës së përfshirjes së grupeve etnike, në këto lloje krimesh. Në analizën e këtij raporti duhet parë me vëmendje struktura e narkokriminalitetit. Studimet tregojnë se përfshirja e personave të huaj, e minoriteteve lidhet më shumë me trafikimin e substancave narkotike nga vendi i origjinës apo i tranzitit, në vendin e destinacionit. Përkatësia etnike e personave të dyshuar si autorë të narkokriminalitetit, përgjithësisht, është heterogjene, pasi ky lloj kriminaliteti kërkon bashkëpunim ndërmjet personave nga vende të ndryshme.

Në Kosovë, nga 6.202 persona të dyshuar në vitet 2005-2015 për vepra penale me narkotikë, 5.701 (91.92%) janë të etnisë shqiptare; 189 (3.05%) serbë dhe 312 (5.03%) të

etnive të tjera, boshnjakë, turq, romë, moldavë etj. (*Policia e Kosovës*,2016).

Për përkatësinë etnike të të dyshuarve në fushën e narkokriminalitetit në Shqipëri, nuk siguroam të dhëna, përveçse nga 23.123 të dyshuar gjithsej, vetëm 171 ishin shtetas të huaj.

Pozita sociale dhe narkokriminaliteti


Prej kohësh ekziston ideja se shkakut i një sërë problemeve sociale është varfëria (Hysi,2010:147-413). Për kriminologët, gjendja sociale apo statusi social gjithnjë është konsideruar si një karakteristikë që kontribuon në praninë dhe në përhapjen e kriminalitetit, duke u fokusuar në shtresat e ulëta apo në kategorinë e të papunëve dhe se ulja e nivelit jetësor e shoqërisë ndikon në mënyrë të pashmangshme në uljen e nivelit të jetesës së individëve dhe grupeve të caktuara sociale, gjë që, në fund të fundit, mund ta provokojë në njëfarë mënyre një pjesë të popullatës drejt shfaqjeve kriminale (Vula,2010:118-119).

Në anketimin e 100 personave që vuanin dënimin me burg në Kosovë dhe në Shqipëri, 82 prej tyre u shprehën se janë futur në rrugën e kriminalitetit me drogat nga varfëria.

Kurse në anketimin me 24 përdorues narkotikësh në Kosovë dhe në Shqipëri, vetëm dy deklaruan se varfëria e skajshme i ka shtyrë në përdorimin e narkotikëve; vetëm dy deklaruan se kishin qenë në marrëdhënie pune, kurse të tjerët kishin qenë të papunë.

Arsimi dhe narkokriminaliteti

Lidhja ndërmjet arsimit dhe përfshirjes në krim të personave, si dhe ndërmjet nivelit arsimor dhe llojit të veprave penale të kryera, paraqet interes në kriminologji (Hysi, 2010:147-413). Nga të dhënat e Policisë në Shqipëri, nga 23.123 të dyshuar për vepra penale në fushën e narkokriminalitetit, me arsim fillor ishin 16.99%; me arsim 8-9 vjeçar ishin 53.98%; me arsim të mesëm, 23.93% dhe me arsim të lartë; 2.57%. Për 586 persona (2.53%), nuk kishte të dhëna se ç'nivel arsimimi kanë pasur (fig.nr.18), (Policia e Shtetit,2016).




***Burimi: Policia e Shtetit**

Figura 18: Niveli arsimor i personave të dyshuar për veprat penale në fushën e drogave në Shqipëri për periudhën 2005-2015

Në Kosovë, sipas Policisë, nga numri total prej 6.202 të dyshuarish për kryerjen e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit, me arsim fillor ishin 51.91%; me arsim të

mesëm, 41.74% dhe me arsim të lartë, 4.66%. Për 105 persona apo 1.69% nuk kishte të dhëna lidhur me arsimimin (fig. nr.19), (Policia e Kosovës,2016).



Burimi: Policia e Kosovës

Figura 19: Niveli arsimor i personave të dyshuar për veprat penale në fushën e drogave në Kosovë për periudhën 2005-2015

Duke trajtuar në këtë kapitull fenomenologjinë e narkokriminalitetit (vëllimin dhe strukturën e tij) në Shqipëri dhe në Kosovë, u përpoqëm t'i analizojmë ato lidhur me vendin, kohën, moshën, gjininë, përkatësinë etnike, arsimimin dhe pozitën sociale të autorëve, me synimin që, përmes kësaj qasjeje të trajtimit shkencor të narkokriminalitetit dhe të luftimit të tij, të kuptohen më mirë se cilët faktorë ndikojnë më shumë në futjen e individëve të ndryshëm në rrugën e kriminalitetit me narkotikë, cilët janë shkaktarët e narkokriminalitetit, duke u fokusuar në aspektin social të kësaj dukurie. Mendojmë se analiza e të dhënave në këtë prizëm është në përputhje edhe me botëkuptimin modern,

sipas të cilit kriminologjia nuk mbetet vetëm në studimin e shkaqeve të kriminalitetit, por ajo duhet të merret edhe me nevojën dhe me problemet që lidhen me qasjen dhe me veprimin e shoqërisë ndaj kriminalitetit. Kemi pasur parasysh këtu faktin se parandalimi dhe lufta kundër narkokriminalitetit nuk duhet t'u lihen vetëm strukturave të zbatimit të ligjit, por ato kërkojnë përfshirjen e tërë shoqërisë, që mund të japë një kontribut të madh në përballimin e sfidës që përbën narkokriminaliteti në Kosovë dhe në Shqipëri. Duke pasur parasysh rëndësinë e vlerave të trajtimit kriminologjik të karakterit dhe të formimit të njeriut, të psikës së tij etj., duke nxjerrë në pah kushtet dhe rrethanat sociale të mësipërme, mendojmë se ndihmojmë në gjetjen e përgjigjeve dhe të interpretimeve të drejta të aspekteve empirike të lidhura me çështjet e dukurisë së narkokriminalitetit.

KREU V: ASPEKTE ETIOLOGJIKE DHE ÇËSHTJE TË NARKOKRIMINALITETIT NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË

Për të patur sukses në luftën kundër kriminalitetit shërben edhe hulumtimi i faktorëve etiologjikë kriminalë, përmes të cilit arrihet përcaktimi i njohjes së gjithanshme të lidhjeve dhe të raporteve të shumë dukurive shoqërore, ekonomike, sociale, politike, psikike, me dukuritë kriminale. Studimi i fenomenologjisë kriminale është me rëndësi, por kërkohet të dihen se cilat janë arsyet e kësaj fenomenologjie, me qëllim që të hartohen programe parandaluese. Etiologjia kriminale studion dhe bën hulumtimin e shkaqeve, të burimeve dhe të rrënjëve të dukurisë së kriminalitetit në një vend (Halili,2005:115:378). Aspekti etiologjik i veprave penale në fushën e drogave ka rëndësi, sepse edhe vetë narkomania është faktor kriminologjik për shkallën e përhapjes së kësaj dukurie, por edhe për forma të tjera të kriminalitetit.

Faktorët etiologjikë ndahen në dy grupe të mëdha: në grupin e faktorëve të jashtëm (objektivë) apo ekzogjenë, dhe në faktorët e brendshëm (subjektivë) apo endogjenë (Halili, 2005:115:378). Në vijim analizohen këta faktorë, që ndikojnë në shfaqjen e narkokriminalitetit.

5.1. Faktorët e jashtëm të narkokriminalitetit

Mjaft hulumtime rreth kriminalitetit dhe sjelljes kriminale konkludojnë se sjellja njerëzore kushtëzohet nga forcat që janë jashtë kontrollit të individit. Teoricienë të tjerë mbrojnë tezën se njerëzit me vetëdije e zgjedhin vetë kryerjen e krimit. Kurse disa

përfaqësues të kriminologjisë pohojnë se sjellja kriminale është rezultat i ndikimit të faktorëve biologjikë, psikologjikë dhe sociologjikë.

Sa më sipër, del se për kryerjen e veprave kriminale ndikojnë faktorë *të jashtëm* dhe faktorë *të brendshëm*. Është pranuar që faktorët e jashtëm, ose objektivë, janë të shumtë dhe ndahen në: **faktorët ekonomik-shoqërorë** (industrializimi, urbanizimi, migrimi, krizat dhe depresionet ekonomike, varfëria, papunësia, mungesa e profesionit etj.); **faktorët ideopolitikë** (konfliktet politike dhe kulturore, lufta, arsimimi, mjetet e komunikimit, si ato të shkruara ashtu edhe ato elektronike, religjioni); **faktorët mikrogruporë** (familja, shkolla, mjedisi shoqëror), **faktorët socio-patologjikë** (prostitucioni, patologjia seksuale, alkoolizmi, narkomania, bixhozi, bredhja (sorollatja) dhe lëmosha, hakmarrja dhe gjakmarrja etj. (Halili,2005:115-378).

Këtu po ndalemi vetëm në ata faktorë që kanë ndikimin më të madh apo që konsiderohen si kryesorë në shfaqjen dhe përhapjen e narkokriminalitetit.

Industrializimi, urbanizmi dhe narkokriminaliteti

Industrializimi dhe urbanizmi në Shqipëri dhe në Kosovë kanë pasur një trend jashtëzakonisht të madh në të gjitha aspektet, si në zhvillimin e trafikut, në ndërtimet, në rritjen dhe mbipopullimin e qyteteve, si edhe në urbanizmin social. Njihet nga të gjithë dukuria masive e zhvendosjes demografike kaotike e popullsisë së Shqipërisë dhe Kosovës nga fshati në qytet, nga veriu në jug e anasjelltas. Ky faktor ka ndikuar shumë në rritjen e përhapjen e dukurisë së narkokriminalitetit, sidomos të narkomanisë.

Sipas raporteve të institucioneve shtetërore, rezulton se faktori i jashtëm i industrializimit dhe i urbanizmit përbën një faktor kriminologjik me ndikim të madh në strukturën dhe tendencat e narkokriminalitetit. Të vendosur pa asnjë rregull në qytet, pa asnjë regjistrim në gjendjet civile dhe pa adresa banimi, të gjendur pa punë, shumë nga të ardhurit në qytet, për të mbijetuar, u morën me vjedhje, grabitje, mashtrime, por edhe me kontrabandë deri edhe me droga, që ose i blenin për t'i shitur, ose për t'i shpërndarë tek të tjerë. Kështu, të detyruar nga gjendja e pashpresë dhe nga varfëria, por edhe duke përfituar nga mungesa e rendit dhe nga mosveprimi i forcës së ligjit mjaft prej tyre përqaftuan rrugën e krimit edhe në fushën e drogave. Me kalimin e kohës, falë edhe lëvizjes së lirë dhe mungesës së kontrollit në kufi, futja e drogës nga jashtë, por edhe kalimi i saj përtej kufirit u bënë të zakonshme dhe mënyrë jetese e pasurimi për mjaft shqiptarë e kosovarë. Kjo veprimtari kriminale me drogat erdhi duke u organizuar gjithnjë e më shumë, kur mjaft të emigruar të viteve '90-'91 ndihmonin ose vinin edhe vetë në vendlindje duke sjellë narkotikë, ose duke organizuar trafikun dhe shpërndarjen e tyre. Strukturat e brishta të zbatimit të ligjit ishin të pafuqishme për ta ndalur këtë shfaqje të re të krimit në fushën e narkotikëve, madje, edhe shumë elementë të këtyre strukturave, edhe nga ata që ishin në pushtet e në politikë u përfshinë vetë në këto veprimtari kriminale, qoftë me mbështetje financiare, qoftë duke i drejtuar apo duke u krijuar lehtësira këtyre personave me veprimtari narkokriminale.

Nga ana tjetër, ardhja nëpër qytete, tek mjaft të rinj, që nuk merreshin me veprimtari kriminale, u shfaqën dëshirat dhe prirjet për përvetësimin e modelit të jetesës në metropol, për t'u shtirur modernë, për të bërë jetë "trendi" etj. Kjo ka dhënë efektin e vet

në Kosovë në periudhën e pasluftës, me shfaqjet e dukurisë së narkokriminalitetit dhe të shtimit të numrit të përdorueseve të substancave narkotike. Për këtë flet edhe intervista e një vajze kosovare që, e rritur në fshat, kur vajti për studime në Prishtinë, siç thotë vetë ajo, pa që aty *‘jeta ishte shumë e vrullshme, mërzhitesha për familjen dhe nuk mund të ambientohesha... dilnim me shoqen dhe argëtoheshim deri në mbrëmje, por... argëtimi nuk bëhej pa alkool’*. Më poshtë ajo tregon se pas ca kohësh një shok e mori *“në apartamentin e tij, më ofroi për të pirë një cigare. Më pas kuptova se kisha konsumuar marihuanë”*. Kaq u desh që ajo të vazhdonte me përdorimin edhe të substancave të tjera si LSD, heroinë, amfetaminë.

Sigurisht, ky është vetëm një nga shembujt e shumtë të kësaj dukurie, që dëshmojnë se çfarë ndikimi ushtrojnë urbanizimi dhe lëvizjet demografike drejt qyteteve dhe metropoleve në përhapjen dhe rritjen e narkokriminalitetit. Tashmë, është e njohur që numri më i madh i përdoruesve të drogave gjendet në zonat urbane, qytetet e mëdha si Prishtina, Tirana, Fieri, Durrësi, Vlora etj., dhe se pjesa dërrmuese e përdoruesve të drogës, janë adoleshentët dhe të rinjtë, që frekuentojnë masivisht lokale dhe klube nate ku shërbehen hapur dhe fshehurazi, bashkë me pijet alkoolike, edhe substanca narkotike. Por një tjetër e keqe e madhe është sidomos fakti që në qytete përdorimi i drogave ka gjetur terren edhe në insitucionet e arsimit, si në shkolla, konvikte etj., ku sistemohen dhe mësojnë të mitur dhe adoleshentë, që bien pre e substancave narkotike e psikotrope.

Kuptohet në shfaqjen e këtyre fenomene të narkokriminalitetit dhe të narkomanisë ndihmojnë edhe mangësitë në punën e agjencive të zbatimit të ligjit dhe indiferentizmi i

shoqërisë në tërësi, që nuk bëjnë sa duhet për ta menaxhuar mirë këtë situatë që ka krijuar zhvillimi dhe urbanizmi.

Emigracioni dhe narkokriminaliteti

Kriminologjia vazhdimisht është e interesuar të studiojë lidhjet ndërmjet emigrimit dhe kriminalitetit, duke e parë këtë problem nga dy këndvështrime: lidhja midis kriminalitetit dhe emigracionit ilegal (klandestin) dhe lidhja midis kriminalitetit dhe emigrimit të përhershëm (Hysi,2010:147-413).

Emigrimi i njerëzve është një nga faktorët e jashtëm që pati dhe ka një ndikim të madh në shfaqjen e narkokriminalitetit në Kosovë e sidomos në Shqipëri. Rënia e sistemit komunist dhe sistemi demokratik në zhvillim krijuan avantazhe për një jetë më të mirë për shumë persona. Por kalimi nga sistemi i mbylljes “hermetike” në një shoqëri të hapur, u krijoi mundësi edhe shfaqjes së formave të reja të krimit në shoqërinë shqiptare, ndër to edhe të kriminalitetit me droga. Qenë të shumtë ata që, për t’u pasuruar shpejt, iu futën marrjes me drogë, blerjes dhe shitjes, trafikimit të saj, por edhe shpërndarjes në doza të vogla për konsumatorët e rinj të narkotikëve, që, në atë periudhë, u shtuan si kërpudhat pas shiut. Nga intervistat gjysmë të strukturuar me 13 persona që kanë përdorur substanca narkotike, 4 prej tyre deklaruan se filluan të përdorin drogën në fillim të viteve ‘90, sapo droga kishte hyrë në Shqipëri. Njëri deklaroi se kishte nisur në vitin 1990, një tjetër, në vitin 1991, ndërsa dy persona, në vitin 1992. Me interes është deklarimi i tyre se drogën ua ofruan shokët që kishin emigruar pas vitit 1990 jashtë shtetit.

Edhe në Kosovë, një numër relativisht i madh personash iu futën rrugës së narkokriminalitetit, për shkak të migrimit në vitet 1990 në vendet e Europës Perëndimore. Disa u morën me drogë për qëllime përfitimi, të tjerë për përdorim vetjak. Këta i nxitën i favorizuan apo i përfshinë në këto veprimtari sidomos ata kosovarë të vendosur në Perëndim para vitit 1990 dhe që, në kushtet e papunësisë, të mungesës së profesionit, të mosnjohjes së gjuhës, të kulturës vendase etj. u morën me blerje dhe shitje droge.

Këta emigrantë të rinj dhe të hershëm konsiderohen si kontribues i madh edhe në rritjen e numrit të narkomanëve në Kosovë dhe në Shqipëri. Për këtë flet edhe rrëfimi i një personi të intervistuar në Tiranë, që tregon sesi migracioni shkaktoi futjen e tij në rrugën e drogës. Mes të tjerave, ai theksoi: *“Isha 15 vjeç kur u njoha me emigracionin... ndihesha i humbur, më mungonte shumë dashuria e familjes dhe e miqve... Fillova shkollën, por aty pata kontaktin tim të parë me botën e errët të drogës... Hera e parë ishte një cigare marihuanë. Mendoja se ishte diçka normale, sepse pjesa me e madhe e bashkëmoshatarëve të mi e pinte shpesh dhe me dëshirë... Unë vija nga një vend që nuk e kishte njohur kurrë tragjedinë e drogës, ndaj m'u duk diçka e re dhe e bukur... Kurioziteti im për drogën sa vinte dhe rritej. Çdo fundjave shkonim në diskotekë dhe konsumonim rregullisht ekstazi. Në diskotekat, pianobaret u njoha me të ashtuquajturat droga të rënda, me fjalë të tjera heroina, kokaina dhe ketamina...”* (Intervistë, me M.K., 32-vjeçar, përdorues drogash të rënda, Tiranë).

Një rrethanë që ka ndihmuar emigrantët për ushtrimin e narkokriminalitetit në Shqipëri edhe Kosovë, ka qenë edhe kontrolli i dobët i kufijve. Ky u ka mundësuar personave vendas dhe të huaj të shfrytëzojnë Shqipërinë dhe Kosovën si vende tranziti të trafikimit të drogave, por edhe si vende të prodhimit e përpunimit të drogave.

Varfëria dhe narkokriminaliteti

Varfëria paraqet një ndër faktorët kryesorë të përhapjes së narkokriminalitetit. Ajo ndikon në shfaqjen e formave të veçanta të tij. Shumë persona, për shkak të varfërisë së madhe dhe nevojës për mjete jetese, futen në rrugën e narkokriminalitetit, në forma të ndryshme. Në fillim, duke shërbyer si shpërndarës substancash narkotike apo psikotrope dhe, gradualisht, si shitës dhe si përdorues të rregullt të tyre. Nga anketimi me përdorues të substancave narkotike dhe psikotrope në Shqipëri dhe në Kosovë, 4 persona deklaruan se përdorimin e narkotikëve e kishin filluar për shkak të kushteve ekonomiko-sociale (varfërisë). Sipas tyre, ndikuan edhe faktorë të tjerë që ata të përdornin substanca narkotike. Për të siguruar drogën për vete dhe për t’ia shitur të tjerëve, ata u detyruan të bëhen shpërndarës. Krahas konsumimit të drogës, ata u përfshinë edhe në veprime që përbënin vepra penale.

Por të shumtë ishin ata që u morën me këtë lloj krimi për të bërë pasuri. Me sa duket, ata kishin përvetësuar mirë atë që kishte deklaruar një ish-trafikan i drogës nga Amerika Jugore, me emrin e koduar “Alonso”, se futja në rrugën e trafikimit të narkotikëve bëhet për disa arsye, por më kryesorja është për të bërë pará në mënyrë të shpejtë, për të larë kreditë e shtëpive dhe për të nxjerrë bukën e gojës, kurse disa të tjerë për të shkolluar fëmijët e tyre (“Koha ditore”, 8 dhjetor 2010, p.20).

Sipas një raporti të *Bankës Botërore*, të vitit 2007, 60% e popullatës së Kosovë jeton në varfëri, kurse 15% në varfëri të skajshme. Edhe në Shqipëri, sipas Institutit të Statistikave, varfëria është rritur nga 12,5% në vitin 2008, në 14,3% në vitin 2012. Ndërsa popullsia ekstremisht e varfër, e përcaktuar si personat që kanë vështirësi në përmbushjen e

nevojave bazë ushqimore, është rritur nga 1,2% në vitin 2008, në 2,3% në vitin 2012, kurse varfëria ekstreme është rritur si në zonat urbane 2,2% ashtu dhe në ato rurale 2,4% (INSTAT,2015:6).

Nga studimet e bëra dhe nga vërtetimet në terren del se narkokriminalitetin nuk e shkaktojnë vetëm faktorët ekonomikë dhe shoqërorë. Këta faktorë ndërlidhen me rrethana dhe shkaqe të tjera. Nuk është varfëria ekonomike ajo që shkakton „kriminalitetin e organizuar“, atë të „jakave të bardha“, që implikohen edhe në fushën e drogës. Pa dashur t'u hyjmë rrethanave, motiveve dhe specifikave që i shtojnë këta të fundit në këto krime, është e domosdoshme që shteti dhe shoqëria në Shqipëri dhe në Kosovë t'u kushtojnë vëmendjen e duhur problemeve të varfërisë, minimumit jetik, punësimit, marrjes së masave ekonomike-sociale etj. Me ndërhyrjet dhe me rregullimet që duhen bërë në këto drejtime, kontribuohet në reduktimin e varfërisë, por edhe të narkokriminalitetit.

Lufta dhe narkokriminaliteti

Lufta është një faktor tjetër i rëndësishëm, që favorizon shfaqjen dhe rritjen e shkallës së kriminalitetit me narkotikë. Ndikimi i rrethanave të luftës në manifestimet e ndryshme kriminale, mund të shkaktohet në tri faza. Flitet për ndikimin e rrethanave në fazën e përgatitjes së luftës, në fazën e zhvillimit të luftës dhe në fazën e pasluftës (Halili, 2008:249-259).

Këtu po ndalemi në rrethanat e pasluftës, sepse në këto kushte u ndodh konkretisht Kosova në vitin 1999 e në vazhdim. Lufta e zhvilluar në Kosovë la shumë pasoja të rënda,

të cilat goditën më së shumti moshat e reja të popullsisë, adoleshentët dhe të rinjtë. Në këtë fazë paraqiten sjellje kriminale të lidhura me krimin e organizuar, me trafiket ilegale.

Periudha e pasluftës në Kosovë ishte shumë e vështirë, sidomos në gjendjen ekonomike të saj. Po ashtu, institucionet shtetërore ishin të pafuqishme dhe të pakonsoliduara, kufijtë nuk mbikëqyreshin mirë as nga autoritetet ndërkombëtare. Në kushte të tilla përfiton elementi kriminal. Kjo u vu re në rritjen dukshëm të numrit të personave të dyshuar për shitje, mbajtje dhe trafikim të drogave, por edhe i narkomanëve. Raporti i vitit 2011 për Strategjinë Ndërkombëtare të Kontrollit të Narkotikëve (INCSR), ka vënë në dukje se, sipas UNICEF-it, nga 15.000 narkomanë që ishin në vitin 2001, në Kosovë, tani janë 20.000 persona që konsumojnë narkotikë (*US Dept of State*,2011b:4-7).

Por për periudhë të pasluftës dhe për ndikimin e saj në përhapjen e narkokriminalitetit, mund të flitet edhe për Shqipërinë. E kemi fjalën për atë që ndodhi këtu në vitin 1997, kur shteti ra, u rrëmbyen armët nga depot ushtarake dhe dolën sheshit, deri edhe në duart e fëmijëve dhe vendi u fut në një gjendje lufte reale, që pasoi edhe gjatë vitit 1998. Lidhur me këtë, prof.dr.V.Hysi, vlerëson se, nëse i referohemi vitit 1997, në Shqipëri anarkia e krijuar në vend solli një mosfunksionim të plotë të shtetit dhe të organeve të tij (Hysi,2010:147-413). Në këto kushte, në vitet 1997, 1998 vendin e mbyti krimi, bandat e armatosura, vrasjet me armë, vjedhjet, grabitjet kudo, në shtëpira, në banka, në rrugë, deri duke u prerë gishtat femrave për t'u marrë unazat. Por krahas tyre, morën përmasa tonditëse trafiku i qenieve njerëzore dhe i lëndëve narkotike, nga kufiri tokësor dhe me gomone apo anije në det. Duke përfituar nga kaosi, pasiguria, nga mungesa e rendit dhe mosruajtja e kufijve, elementët kriminalë, grupet e organizuara kriminale, tani edhe të

armatosur, bënë ligjin në tranzitimin dhe trafikimin e drogës në vendet e rajonit dhe në Europën Perëndimore.

Arsimimi dhe narkokriminaliteti

Arsimimi cilësor i një shoqërie bën që kjo të jetë e shëndoshë mendërisht e fizikisht. Arsimi është shumë i rëndësishëm, për përparimin e individit, të vendit dhe shoqërisë, por edhe se, duke pasur më shumë shkolla, ka më pak burgje. Edukimi dhe arsimimi ndikojnë në shmangien dhe në zvogëlimin e pjesëmarrjes së të rinjve në kriminalitet. Ngritja kulturoro-arsimore është një faktor me rëndësi në formimin dhe aftësimin e personalitetit të njeriut për të pasur një jetë të sigurt dhe më të suksesshme (Halili,2008:249-260).

Sot, në Kosovë dhe në Shqipëri, si kudo në botë, institucionet arsimore, në veçanti, shkollat, përballen me probleme të ndryshme të narkokriminalitetit. Adoleshentët e sotëm, qysh prej shkollës tetëvjeçare ekspozohen ndaj elementëve që konsumojnë ose shpërndajnë drogë. Duke qenë se janë vende përqendrimi të adoleshentëve dhe të të rinjve, shkollat nëpër qytete, sidomos ato të mesme, janë kthyer në shënjestër të shpërndarësve apo të shitësve të drogës. Nuk mungojnë rastet kur grupe kriminale tentojnë të rekrutojnë midis të rinjve nxënës që t'i përfshijnë në radhët e delinkuentëve.

Në një studim të Institutit të Shëndetit Publik në Shqipëri të kryer në shkolla, me të rinjtë e moshave 14-18 vjeç, 5.4% e të anketuarve kishin eksperimentuar me kanabis, 4% ekstazi, 1.4% heroinë dhe 1.6% kokainë.

Është shumë shqetësues fakti që mjaft të rinj të shkollave të mesme ekspozohen ndaj drogave në mjediset shkollore ose pranë tyre. Kjo është një kampion alarmi, jo vetëm

për institucionet shtetërore të arsimit, por edhe për strukturat e zbatimit të ligjit, pasi shitësit dhe shpërndarësit e drogës, veprojnë në dritën e diellit edhe pranë shkollave.

Problem është edhe mospërfshirja e mjaftueshme e disa fëmijëve dhe e të rinjve në shkollim dhe braktisja e shkollës nga ata që janë të regjistruar. Niveli i ndërprerjes së studimeve të shkollës së mesme dhe nëntëvjeçare është i lartë. Kjo nuk mund të anashkalohet, pasi përbën një faktor potencial të rrezikut që ata të rinj që lënë shkollën të merren me përdorimin dhe trafikimin e drogës. Duke mos u angazhuar në ndonjë veprimtari, rreziku që ata të rinj të jepen pas veprimeve të dëmshme dhe të kundëligjshme është i madh.

Marrjen e nxënësve me drogë e ndihmojnë edhe mungesat e ndjeshme të kuadrit të kualifikuar si mësimdhënës, por edhe si edukatorë. Ka mësues që çalojnë në raportet e tyre me nxënësit, nuk njohin karakteristikat e personalitetit të këtyre, sillen brutalisht me ta ose janë të patrajnuar për të identifikuar fëmijët e prirur për të braktisur shkollën, për të abuzuar me substancat narkotike apo për t'u përfshirë në veprime delinkuente në mjediset e shkollës. Po ashtu, në shkolla është bërë normale që mësuesit të mos bëjnë punë shtesë me nxënësit që kanë vështirësi në mësim, që janë problematikë dhe që paraqesin burim rekrutimi nga kriminelët. Ka mësues që ndihmën e tyre e ofrojnë me pagesë. Sjellje të tilla të mësuesve ndaj nxënësve, mosbashkëpunimi i rregullt i tyre me prindërit, mungesa e shërbimeve psikologjiko-pedagogjike në shkolla nuk ndihmojnë, përkundrazi, ndikojnë për keq në punën për shmangien e të rinjve nga rruga e keqe e drogës. Për të mos folur pastaj edhe për mësues neglizhentë apo që të shtyrë nga paga dhe shpërblimi jo i kënaqshëm, kërkojnë burime të tjera përfitimi, si veprimet e paligjshme të lejimit ose të favorizimit të futjes në mjediset e shkollës të substancave narkotike etj.

Të gjithë këta faktorë ndikojnë në përhapjen e narkokriminalitetit në shkolla. Në Kosovë, gjatë vitit 2014, janë regjistruar 12 vepra penale në fushën e drogave në ambiente shkollore, janë arrestuar 15 persona dhe janë konfiskuar 217.67 gramë marihuanë (*Policia e Kosovës*, 2014).

Për parandalimin dhe reduktimin e këtyre dukurive në shkolla, ligjet ekzistojnë, por kërkohet një bashkërendim cilësor i punës së strukturave të zbatimit të ligjit me institucionet arsimore, me drejtuesit e tyre, si dhe me komunitetin e prindërve. Shkolla, nga ana e saj, përmes ngritjes së nivelit shkencor dhe formues të programeve dhe teksteve të lëndëve mësimore, si dhe të mësimdhënies, mund dhe duhet të bëjë më shumë për edukimin e të rinjve, për korrigjimin e sjelljeve dhe të devijimeve psikike dhe sociale tek të rinjtë dhe për orientimin e drejtë të tyre. Në to duhet të zënë vend programe bashkëkohore të parandalimit të narkokriminalitetit, me qasje edukative për nxënësit, për identifikimin sa më shpejt të atyre që abuzojnë me duhanin, alkoolin, me droga, si dhe për zhvillimin e aktiviteteve që ndihmojnë në uljen e kërkesave të të rinjve për to dhe për të rritur tek ata aftësinë për refuzimin dhe rezistencën ndaj marrjes së tyre. Në këtë drejtim shërben edhe pajisja e shkollave me mjete bashkëkohore tekniko-materiale, me mjedise dhe mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të lira dhe shoqërisht të dobishme me nxënësit, për t'i mbajtur larg drogave. Po ashtu, më shumë duhet bërë për informimin sistematik të nxënësve për drogat, për rrezikun dhe pasojat individuale, familjare dhe sociale që ato sjellin.

Familja dhe narkokriminaliteti

Për shumicën e sociologëve dhe kriminologëve, familja konsiderohet një nga

institucionet më të rëndësishme për edukimin e fëmijës (Hysi,2010:147-413). Familja hyn në grupin e faktorëve mikrogruporë me ndikim të madh në edukimin dhe zhvillimin e të rinjve. Ajo paraqitet edhe si faktor kriminogjen i jashtëm, mjaft i rëndësishëm në përhapjen e dukurisë së narkokriminalitetit. Sidomos familjet me gjendje të vështirë ekonomike, me raporte të çrregulluara ndërmjet bashkëshortëve, që karakterizohen nga mospajtimet, grindjet dhe tensionet e përditshme, si paralajmëruese të divorcit. Këto familje përbëjnë një ambient të zymtë dhe ndjellakeq që i bën fëmijët e tyre të kthehen në delinkuentë, të merren me krime. Mosmarrëveshjet, deri në ndarje të prindërve, destabilizojnë dhe çrregullojnë jetën normale të vetë familjes, por edhe rritjen dhe përparimin e drejtë intelektual dhe njerëzor të fëmijëve. Familjet e degraduara moralisht ndikojnë për keq dhe bëhen një faktor kriminologjikë për fëmijët që kanë sjellë në jetë.

Është mjaft e rëndësishme për shoqërinë e një vendi që ta ketë sa më të shëndoshë dhe të konsoliduar mirë qelizën bazë të saj, familjen, që kjo të funksionojë normalisht, mbi bazën e harmonisë dhe të marrëdhënieve shumë të mira ndërmjet anëtarëve të saj. Bazë për këtë janë, në radhë të parë, raportet shumë të mira midis vetë prindërve, por, pa dyshim, edhe midis tyre dhe fëmijëve. Edukata që u jepet fëmijëve në familje, është faktori tjetër shumë i rëndësishëm që ata të bëjnë një jetë të rregullt, të qetë dhe normale, jetë e cila i përshtatet rregullimit shoqëror.

Këto i themi jo për t'u hyrë në pjesë sociologëve, por në funksion të nevojës që edhe kriminologjia të evidencojë edhe më mirë shkaqet dhe faktorët krimogjenë që burojnë në familje dhe ndikojnë që fëmijët të bien pre e krimit me droga. Kjo ka të bëjë edhe me rritjen e rolit të shtetit dhe të shoqërisë për kujdesin ndaj familjeve, veçanërisht të atyre me probleme ekonomike, që të kontribuojnë jo vetëm me ndihma sociale, por edhe me

punësimin qoftë edhe të një pjesëtari të saj, me lehtësimin e familjeve me shumë fëmijë duke i sistemuar nëpër institucionet e fëmijëve etj. Edhe më i madh duhet të jetë ky kujdes për fëmijët me prindër të divorcuar, që duke mos përballuar dot acarimin dhe vështirësitë në familje, rrezikojnë të përfundojnë në rrugën e vjedhjeve dhe të narkokriminalitetit.

Mjedisi shoqëror si faktor kriminogjen

Mjedisi shoqëror është hapësira ku jeton dhe vepron njeriu. Njeriu një kohë të gjatë të jetës e kalon në një mjedis shoqëror, në një lagje, në një kuart apo rrugë të caktuar (Halili,2008:249-286). Në këtë mjedis, individi, qoftë fëmijë apo i rritur, hyn në shoqëri dhe në marrëdhënie me të tjerë dhe kjo, pa dyshim, luan një rol të madh në formimin dhe edukimin e tij. Në këtë kuptim, mjedisi social konsiderohet një faktor që kërkon vëmendjen e duhur të shtetit dhe të mbarë shoqërisë, që aty të ketë sa më pak ose aspak kushte për shfaqjen e kriminalitetit. Kjo është e domosdoshme, pasi edhe sipas një studimi kriminologjik, është vërtetuar se një numër i madh personash “veprimtarinë e tyre delinkuente dhe kriminale e kanë filluar nën ndikimin e shoqërimit me grupet e tilla të delinkuentëve të mitur në lagje” (Halili,2008:249-286).

Krijimi i një mjedisi shoqëror të qetë, pa probleme dhe me një jetë të rregullt dhe normale, ku të gjithë shkojnë mirë me njëri-tjetrin dhe tregojnë kujdes për mirërritjen e të miturve dhe të të rinjve, është me shumë interes, në radhë të parë, me të ardhmen e këtyre fëmijëve, që ata të ecin në rrugën e duhur, duke u shmangur nga sjelljet dhe veprimet e kundërligjshme.

Nga praktika njihet mirë që rrugicat pa dritë, hyrjet e pallateve, mjedise të blloqeve e të lagjeve, ku, zakonisht, nuk ka prani dhe lëvizje njerëzish, janë vendet e preferuara të elementëve të grupeve të organizuara kriminale që merren me shitjen, blerjen, trafikimin dhe përpunimin e drogave. Pikërisht këtu takojnë dhe shoqërohen ata me të rinj dhe me fëmijë që banojnë aty, si dhe me persona që njihen si përdorues të narkotikëve. Këtu bëjnë ata edhe rekrutimin e bashkëpunëtorëve të rinj, madje edhe të mitur, duke i tërhequr në rrugën e narkokriminalitetit.

Shpëtimi i këtyre nga kjo rrugë është një mision humanitar shumë i domosdoshëm, për të penguar shtimin e delinkuentëve dhe përhapjen e narkokriminalitetit, për të shpëtuar jetë. Një mjedis shoqëror i shëndoshë në bllok dhe në lagje, është një garanci më shumë për të rritur një rini me të ardhme të shëndoshë.

Një mjedis tjetër shoqëror që frekuentohet shumë nga të rinjtë dhe ku këta janë të rrezikuar të bëhen përdorues substancash narkotike apo edhe të përfshihen në vepra penale të narkokriminalitetit janë lokalet e natës, pabet, diskotekat dhe veprimtari të tjera argëtuese, ku ka grumbullime të mëdha. Prirja e të rinjve, në Kosovë dhe në Shqipëri, për të përqafuar mënyrën ‘perëndimore’ të jetesës, duke shkuar në këto mjedise, ku konsumohen cigare, pije alkoolike dhe drogë, është një problematikë shqetësuese. Për shkak të drogimit, një person vrau në çast 4 veta në një lokal nate në Tiranë. Ai po vuan dënimin, por 4 jetë njerëzish, ndonjë edhe pa asnjë shkak, u shuan.

Nga hulumtimi i bërë nëpër disa kafene dhe lokale të Prishtinës, kemi dëgjuar të rinj që thonë: *“Nëse nuk pi ‘bari’ (marihuanë), je bal (fshatar)”*. Kjo flet për mentalitetin e sëmurë që ka në radhët e të rinjve, të cilët konsumimin e narkotikëve e barazojnë me

modernen, me shkuarjen në Europë. Frekuentimi i këtyre mjediseve nga të rinjtë, ka rritur përdorimin dhe abuzimin me drogat.

Narkomania, dukuri e përhapur te rinia


Narkomania hyn në grupin e faktorëve socio-patologjikë të kriminalitetit. Është i njohur kalimi nga përdorues, në shitës e shpërndarës droge, çka përbën vepër penale dhe e anasjellta, kur një shitës apo trafikant droge, nis e përdor edhe vetë. Statistikat tregojnë se përdorimi i drogës dhe abuzimi me to në Shqipëri dhe në Kosovë kanë njohur rritje. Ato janë bërë, tashmë, një fenomen i përhapur, sidomos në qytetet e mëdha, por që po shtrihet edhe në qytetet e vogla. Kjo ndodh edhe për shkak se posedimi dhe përdorimi i drogave të paligjshme për konsum vetjak nuk penalizohet në ligjin e tanishëm. Sipas disa përdoruesve të narkotikëve, individët e arrestuar prej policisë, zakonisht, mbahen jo më shumë se 72 orë. Në këto rrethana, mjaft të rinj, të shtyrë dhe nga kërshtëria apo nga shoku, provojnë një herë drogë, të tjerë krijojnë varësi prej saj dhe e përsërisin. Të shumtë janë ata që kalojnë në abuzim me narkotikët, duke përdorur drogë herë pas here dhe kthehen në narkomanë. Kjo dukuri është me pasoja të rënda, deri në humbje jete, sidomos nga overdozat.

Në Kosovë kërkesa për drogë nuk kufizohet vetëm për narkotikët e paligjshëm. Vihet re se ka nisur edhe abuzimi me substanca farmaceutike, si me trodon, një lloj metadoni, që merret pa recetë doktori. Këto e komplikojnë mjaft varësinë e përdoruesit ndaj drogës. Ndërsa në Shqipëri flitet për dhjetëra mijë përdorues droge, ndër të cilët ka edhe 14, 15-vjeçarë dhe nuk mungojnë edhe të vdekur nga overdoza.

Ndërsa në fillim të viteve '90 aplikohet droga intravenoze, më pas, në vitet '95-'97 nisi një mënyrë e re e marrjes së drogës, djegia në fletë alumini dhe tymosja, pirja me cigare, thithja me hundë. Tani vazhdon të mbizotërojë mënyra me shiringa. Duhet thënë se problem është edhe bashkëpërdorimi i drogave në grup, gjë që sjell rreziqe për marrjen e SIDA-s.

Shteti dhe shoqëria, në Shqipëri dhe në Kosovë, bëjnë vazhdimisht përpjekje për parandalimin dhe reduktimin e kësaj dukurie. Për këtë qëllim ka edhe organizata joqeveritare, vendase dhe të huaja, që merren me problemet e narkomanisë, por ato janë të pakta dhe kanë kapacitete njerëzore e financiare të pamjaftueshme. Shumica e tyre është e përqendruar në kryeqytetet e dy vendeve, por veprojnë edhe në qytete të tjera. Veprimtaria e tyre zhvillohet në dy drejtime: në zbatimin e programeve parandaluese dhe në ofrimin e trajtimit mediko-psiko-terapik. Zbatohet programi i trajtimit me **metadon**, por ky nuk mjafton për të gjithë përdoruesit e substancave narkotike dhe psikotrope.


Rehabilitimi i përdoruesve të narkotikëve në Shqipëri organizohet nga disa organizata joqeveritare dhe nga shërbimi klinik i Toksikologjisë dhe i Varësisë në Qendrën Spitalore “Nëna Tereza” në Tiranë. Nga një anketim në OJF ‘Aksion Plus’ në Tiranë, kemi siguruar të dhëna empirike lidhur me numrin e personave të trajtuar në këtë qendër gjatë vitit 2013. Në figurën nr.19, pasqyrohen grup-moshat e 613 përdoruesve të trajtuar në këtë qendër. Numri më i madh i tyre i përket grup-moshës 31-35 vjeç (184 persona), pasuar nga grup-mosha 26-30 vjeç, me 156 përdorues. Nga numri total prej 613 personave, 560 janë meshkuj dhe 53 femra.



***Burimi: OJF 'Aksion Plus'**

Figura 20: Numri i përdoruesve të trajtuar në 'Aksion Plus', Shqipëri, sipas gjinisë dhe grup moshave.

Sipas të dhënave, në këtë qendër nuk është trajtuar asnjë person nën moshën 16-vjeçare, por nga të dhënat empirike që kemi siguruar rezulton se të rinjtë e grupmoshës 16-20-vjeçare që përdorin drogë përbëjnë një numër të konsiderueshëm.



***Burimi: OJF 'Aksion Plus'**

Figura 21: Numri i përdoruesve të trajtuar, sipas grup-moshës dhe gjinisë eksperimentimit të parë të drogës.

Kjo doli nga kontakti me vetë personat që janë paraqitur për t'u rehabilituar në OJF 'Aksion Plus', që deklaruan se për herë të parë kanë eksperimentuar me drogën 302 persona të grup-moshës deri në 16 vjeç dhe 218 të grup-moshës 16-20 vjeç. Ndërsa në të dhënat e Qendrës 'Aksion Plus', lidhur me këtë grup-moshë, ishin në kundërshtim me realitetin.


Edhe në Kosovë pas vitit 1999, u krijuan OJQ, por erdhën edhe nga jashtë për të ushtruar aktivitetin e tyre me objekt trajtimin e përdoruesve të drogës. Për këtë qëllim në Kosovë operon edhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës, që ka një repart me kapacitete të vogla, si dhe Qendra Mediko-Psikoterapike e OJQ 'Labyrinth'.

Meshkuj	Femra	Mosha	Të punësuar	Të papunësuar	Jetojnë me familje	Nuk jetojnë me familje	Kanë jetuar jashtë Kosovës	Nuk kanë jetuar jashtë Kosovës
979	78		352	699	917	136	560	495
92.62 %	7.38 %		33.30 %	66.13%	86.75%	12.87%	52.98%	46.83%

***Burimi: OJQ Labyrinth 2002-2014**

Figura 22: Të dhëna lidhur me numrin e të trajtuarve në OJQ 'Labyrinth' në Kosovë për periudhën 2002-2014.

Sikurse shihet nga tabela, në këtë qendër, gjatë periudhës 2002-2014, janë rehabilituar 1.057 persona, prej të cilëve 979 meshkuj dhe 78 femra. Prej tyre, 352 (33.30%) persona ishin të punësuar dhe 699 persona (66.13%), të papunë; 560 veta (52.98%) kanë jetuar jashtë Kosovës. Nga numri total, 276 persona (26.11%), kanë përjetuar mbidozë (overdozë) ('Labyrinth',2015).



***Burimi: OJQ 'Labyrinth' 2002-2014**

Figura 23: Të dhëna empirike nga personat që janë rehabilituar në OJQ 'Labyrinth' për periudhën 2002-2014.

Edhe fakti i paraqitur në figurën nr.23 është shqetësues: 696 persona (65.85%) e kanë filluar drogën në Kosovë, 331 të tjerët (31.32%) e kanë filluar jashtë Kosovës ('Labyrinth', 2015).

Një e dhënë tjetër me interes jo vetëm studimor, por edhe për hartimin dhe zbatimin e programeve të trajtimit të përdoruesve të drogës është se 779 (73.70%) persona të trajtuar në OJQ 'Labyrinth', të moshës mesatare 17 vjeç, deklaruar se si drogë të parë kanë përdorur marihuanë ose hashash; 199 persona (18.73%), me moshë mesatare 22 vjeç, e kanë filluar me heroinë. Aktualisht, 922 persona (87.23%) që trajtohen në këtë qendër, aktualisht, kishin drogë primare heroinën, kurse 106 persona (10.03%) kanë marihuanën ('Labyrinth', 2015).

5.2. Faktorët e brendshëm të narkokriminalitetit

Kriminologjia është e interesuar të studiojë personalitetin e personit, autor të veprës penale (kalimi në veprim) dhe faktorët që ndikojnë në formimin e personalitetit të autorit të veprës penale (Hysi,2010:147-413). Sado faktorët e jashtëm ose objektivë luajnë rol me rëndësi në paraqitjen e sjelljeve kriminale, dukuria e narkokriminalitetit dhe shkaqet e tij nuk mund të shpjegohen drejt dhe deri në fund pa analizën e ndriçimin e faktorëve të brendshëm apo të atyre subjektivë (Halili,2005:115-378).

Faktorët e brendshëm të lidhur me narkokriminalitetin ndahen në: **psikologjikë** dhe në **biologjikë**. Ndër faktorët psikologjikë, apo psikikë, bëjnë pjesë: *karakteri, temperamenti, shprehitë dhe prirjet për përdorim narkotikësh, inteligjenca, emocionet dhe motivet*. Studimet shkencore kriminalistike, mjeko-ligjore dhe psikologjike tregojnë se kontingjenti kryesor i narkomanëve përbëhet nga: a) psikopatët me prirje për të kaluar në depresion dhe në veprime të rënda kriminale, b) njerëz histerikë me prirje shpirtërore për të bërë aventura, c) njerëz me ndjenja instiktive për të shijuar jetën; ç) njerëz të prirur me ndjenja seksomane (perversë) dhe d) njerëz që sugjestionohen lehtë dhe me vullnet të dobët (Begaj,1999:564). Në vijim po paraqesim shkurt disa nga faktorët e brendshëm, subjektivë, të narkokriminalitetit.

Karakteri

Karakterin e përbëjnë të gjitha ato veti që tregojnë qëndrimin e individit ndaj disa parimeve, vlerave dhe rregullave moralo-etike të shoqërisë apo të një ambienti të caktuar...

Disa autorë, si veti dhe tipare të karakterit, përmendin nderin, altruizmin, ndërgjegjshmërinë, vetëbesimin, ndershmërinë, vetëkritikën, konsekuencën, qëndrueshmërinë, labilitetin (paqëndrueshmërinë), modestinë, egoizmin, frikën, çiltërinë (sinqeritetin), agresivitetin, këmbëngulësinë dhe veçori të tjera (Halili,2008:249-350).

Tiparet e karakterit formohen me procesin e socializimit të njeriut. Në këtë proces, rol mbizotërues luajnë familja, shkolla dhe mjedisi shoqëror. Përgjithësisht, mendohet se personat që merren me shitjen, blerjen, kultivimin etj., të drogave, por edhe përdoruesit (narkomanët) janë persona me karakter të “dobët”. Ndërsa personat që merren me “biznesin” e drogave shprehin interes vetëm për rritjen e numrit të klientëve (përdoruesve), prandaj në, raste të caktuara, shfaqen me ‘shpirt të madh’ duke shpërndarë falas sasi droge në shkolla, kafene, lokalet e natës, ku ekziston mundësia që të rinjtë të fillojnë përdorimin e drogave. Ndërsa 24 persona të intervistuar deklaruan se, edhe pasi kishin filluar trajtimin me metadon në “*drop qendra*”, në Kosovë dhe në Shqipëri, ata kishin përdorur përsëri substanca narkotike dhe psikotrope.

Narkomanët kanë dobësi karakteri. Siç shprehet studiuesi Demolli, karakteri i dobët i tyre, i paqëndrueshëm, apo ambiciet për aventura dhe dëshira për sensacione të llojeve të ndryshme i shtyjnë këta persona të konsumojnë substanca narkotike (Demolli,1996:143). Prandaj psikologët dhe punonjësit socialë gjatë trajtimit të narkomanëve për varësinë nga droga, synojnë, në radhë të parë, të forcojnë karakterin e tyre. Por kjo mund të bëhet edhe nga familja, edhe nga shkolla me fëmijët me karakter të dobët, pra, para se ata të përfundojnë në përdorues droge. Pikërisht kjo punë preventive, në kohën e duhur, është e domosdoshme dhe e dobishme, pasi është më e lehtë, më rezultative në parandalimin e narkomanisë, por edhe pa kosto ekonomike për shoqërinë.

Temperamenti

Në shfaqjen e kriminalitetit, në një masë të madhe ndikon edhe temperamenti i njeriut. Temperamenti është veti dhe cilësi psikike e njeriut, “e cila manifestohet në reagimin e tij ndaj ngacmimeve dhe nxitjeve, shtyrjeve të brendshme dhe ngasjeve të ndryshme, të jashtme” (Halili,2008:249-350).

Ekzistojnë katër lloje temperamenti: *kolerik, sanguin, flegmatik dhe melankolik*. Shpeshherë narkokriminelët janë persona me temperament të ashpër dhe gjaknxhtë, që reagojnë shumë shpejt dhe brutalisht. Studimi i sjelljeve të tyre tregon se kanë temperament sanguin ose flegmatik. Edhe përdoruesit e drogave janë me shumë temperament. Gjatë vërtetimit të drejtpërdrejtë në “*drop qendrën*” në Shqipëri, ndeshëm rastin kur një përdorues, në një moment, kaloi në agresivitet mjaft të lartë. U desh ndërhyrja e stafit mjekësor për ta qetësuar situatën.

Inteligjenca

Inteligjenca është aftësia e të menduarit dhe aftësia për të zgjidhur probleme ose për t’u orientuar në situata të ndryshme (Hysi,2010:174-413). Gjetjet e psikologjisë tregojnë se, kur njerëzit me inteligjencë të lartë i hyjnë kriminalitetit, ata janë të prirur të kryejnë krime në nivel të lartë organizimi. Ata që merren me trafikim narkotikësh janë persona me një inteligjencë shumë të lartë. E kundërta ndodh me narkomanët, shkalla e inteligjencës së të cilëve mendohet e ulët.

Emocionet

Edhe emocionet ndikojnë në shfaqjen e narkokriminalitetit. Zakonisht, në krimet që kryhen nën ndikimin e emocioneve, tek autori krijohet gjendje e paqëndrueshmërisë emocionale. Personat që kanë probleme emocionale, veçanërisht ata që emocionalisht janë jo të qëndrueshëm, të shqetësuar dhe të tronditur në jetën e përditshme, bien më lehtë në situata të kryerjes së veprimeve kriminale.

Narkokriminelët, në shumicën e rasteve, janë persona joemotivë, krejt ndryshe nga përdoruesit e narkotikëve. Këta të fundit janë tepër emotivë, sidomos në ato raste, kur kriza nga mungesa e konsumimit të drogës shkon duke u rritur. Në këto kushte, ata kryejnë krime të ndryshme, si vjedhje, grabitje, sulme fizike etj. Konstatohet se individët emocionalisht të ndjeshëm, të tronditur, nuk kanë aftësi t'i kontrollojnë veprimet e veta, nuk mund t'i tejkalojnë ngacmimet dhe provokimet e ndryshme të ambientit (Halili, 2008:249-350).

Motivet

Është e kuptueshme që çdo krim, edhe i fushës së narkokriminalitetit, e ka një motiv, diçka e shtyn autorin t'i futet një veprimi të paligjshëm, që, sigurisht, është me pasoja të rrezikshme për të tjerët a për shoqërinë dhe ndëshkohet nga ligji. Praktika, studimet e ndryshme dhe proceset gjyqësore tregojnë se motivet që i shtynjë personat për të kryer krime janë të ndryshme.

Me motive, “në vështtrimin penalo-juridik kuptohen shtyrjet e brendshme, të cilat bëjnë që personi të kryejë vepra penale. Ato lindin te personi që është nën ndikimin e

ngacmimeve të jashtme, p.sh., nga fyerjet ose nga veprimet e paligjshme e të pamoralshme të një tjetri etj.” (Elezi&Kaçupi&Haxhia,2006:117). Autorë të tjerë kanë këndvështrime të tjera për motivet. Sipas Halilit, motivet paraqesin “fuqitë nxitëse, që e shtyjnë një individ të jetë aktiv, e orientojnë dhe e udhëheqin veprimtarinë e tij në jetë” (Halili,2005:115-378). Ndërsa Hysi, shprehet se motivet janë forcat e brendshme që e shtyjnë personin edhe “në zgjidhjen e problemeve ose të situatave konkrete” (Hysi,2005:238).

Por këto forca të brendshme shtytëse në shumë raste shpiten edhe në agresion, duke shkaktuar dëmtime fizike apo edhe vdekje të viktimës. Lidhur me këtë, Nushi konkludon: veprimtaria dhe sjelljet e njeriut “që sjellin lëndime psikike e fizike, madje, edhe asgjësime të tyre, sipas disa psikologëve, rrjedhin nga motivi i agresivitetit” (Nushi,2002:233-438).

Në literaturën profesionale, theksohet se në jetën e përditshme, disa motive paraqiten si forcë shtytëse në nxitjen apo shtyrjen e individit në kryerjen e veprave penale dhe se këto motive kanë të bëjnë me trupin dhe me bazën biologjike të tij. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ato motive janë të lindura.

Këtu dalim te një ndarje tjetër që u bëjnë motiveve studiuesit: motivet janë të lindura (biologjike) dhe të fituara (Nushi,2002:233-438). Si motive biologjike mund të konsiderohet motivi prindëror, motivi për ushqim, motivi për ngrohje, për shuarjen e etjes, motivi seksual, motivi për pushim fizik, motivi për largimin e dhembjes gjatë lëndimit, si dhe motive të tjera të karakterit anatomiko-biologjik (Halili,2005:115-378). Kurse motivet sociale, të fituara, konsiderohen se janë të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: motivin e shoqërimit, të vetëpohimit, të agresivitetit dhe atë material (Hysi,2010:147-413).

Te disa vepra të narkokriminalitetit është e vështirë të përcaktohet motivi, për shkak se, në të shumtën e rasteve, narkokriminelët që merren me trafikimin e narkotikëve në

kryerjen e kësaj vepre penale nisen kryesisht nga përfitimi material, pra, nga paraja, kurse narkomanët, që përdorin substanca narkotike, kanë thjesht motiv biologjik.

Çrregullimet mendore

Edhe çrregullimet mendore ndikojnë në shfaqjen e kriminalitetit. Me çrregullime mendore cilësohen ata njerëz “të cilët kanë ikur nga njëmendësia objektive dhe në sjelljet e tyre kriminale mund të ndikojnë të tjera rrethana, sidomos ambienti dhe rrethi shoqëror, kushtet e caktuara familjare dhe ndikime të tjera” (Halili,2005:115-378).

Nga analizimi i të dhënave empirike që kemi grumbulluar lidhur me këtë problem, kemi arritur në përfundimin se çrregullimet mendore të llojit të neurozave, psikozave dhe psikopatike të ndryshme janë faktorë mbizotërues që ndikojnë te narkomanë të ndryshëm të kryejnë veprime penale shumë të rënda vrasjeje.^v

5.3. Parandalimi i narkokriminalitetit

Krimi i organizuar dhe terrorizmi, përfshirë edhe narkokriminalitetin, përbëjnë një kërcënim serioz afatgjatë për sigurinë kombëtare, për shoqërinë, ekonominë dhe cilësinë e jetës dhe nuk mund të luftohen me veprime sporadike dhe pa plane veprimi të studiuara, pa një strategji kombëtare. Rëndësi të dorës së parë, marrin sidomos lufta dhe masat parandaluese për zvogëlimin e kërcënimit të krimit të organizuar të lidhur me narkotikët dhe lufta e vendosur dhe efikase kundër tij.

Kriminaliteti, si dukuri shoqërore negative dhe e rrezikshme, manifestohet në forma të ndryshme gjatë tërë rrjedhës së historisë njerëzore (Sahiti,1995:13). Çdo hulumtim shkencor, kërkon që, pas hulumtimit të dukurisë kriminale, të planifikohen masat për parandalimin dhe luftimin e dukurive të ndryshme, pra edhe të narkokriminalitetit.

Me shprehjen **masa parandaluese** kuptojmë tërësinë e veprimeve, të cilat ndërmerren nga një rreth i gjerë i subjekteve shoqërore dhe qëllimi i përgjithshëm i tyre është parandalimi i narkokriminalitetit nëpërmjet luftimit dhe eliminimit të shkaqeve dhe të kushteve që përcaktojnë sjelljet kriminale të trafikimit, transportimit, posedimit, përdorimit apo të shitjes së substancave narkotike dhe substancave psikotrope (Hysi, 2005:238-525). Pra, siç shihet këtu, theksi vihet te nevoja e njohjes së shkaqeve të narkokriminalitetit si kusht për parandalimin dhe luftimin e tij.

Kjo studiuese i ndan masat parandaluese në tri grupe: a) parandalimi parësor, b) dytësor dhe c) tretësor.

Ekzistojnë standarde ndërkombëtare në parandalimin e narkokriminalitetit. Parandalimi i suksesshëm i narkokriminalitetit kërkon përpjekje prej gjithë shoqërisë për të siguruar zhvillimin harmonik, duke respektuar dhe nxitur zhvillimin e personalitetit të individit, ngritjen arsimore të të rinjve dhe të prindërve të tyre, duke zhvilluar trajnime të ndryshme përmes organizatave qeveritare dhe joqeveritare, sensibilizimin e opinionit të gjerë për pasojat e narkokriminalitetit dhe narkomanisë etj.

Qëllimi kryesor i punës parandaluese është shmangia e të rinjve nga fillimi i përdorimit të drogës, por, nëse ata e kanë filluar përdorimin e tyre, atëherë të synohet parandalimi i çrregullimeve në zhvillim (varësinë), (UNDOC,2015b:9).

Në parandalimin e narkokriminalitetit rëndësi të madhe ka roli i shtetit dhe i shoqërisë në realizimin e reformave juridike, ekonomike dhe, në përgjithësi, i reformave shoqërore, që ndikojnë në mënjanimin e këtyre shkaqeve të shfaqjes së narkokriminalitetit, si dhe në parandalimin e përdorimit, posedimit, shitjes e të trafikimit të narkotikëve sidomos nga të rinjtë. Këtij qëllimi i shërben sidomos implementimi i strategjive kombëtare për luftën kundër narkokriminalitetit. Këto strategji shtrojnë si obligim prioritar parandalimin, pastaj luftën kundër krimit, duke zhvilluar metoda e praktika të përparuara dhe efikase ligjore, institucionale, operationale dhe shkencore, sipas standardeve të vendeve të BE-së. Në këtë drejtim marrin përparësi parandalimi dhe ulja në mënyrë të ndjeshme e kultivimit dhe e prodhimit të drogës; goditja me forcë dhe pa tolerancë e individëve, grupeve apo organizatave kriminale të shitjes dhe të trafikut të brendshëm dhe atij ndërkombëtar të drogave. Kjo kërkon edhe koordinimin e strukturave përgjegjëse për parandalimin e goditjen e trafikeve të paligjshme me strukturat homologe të vendeve fqinje që territoret e Shqipërisë dhe të Kosovës të mos përdoren si vende tranziti për trafikimin e narkotikëve. I domosdoshëm është edhe forcimi i punës së agjencive të specializuara për luftën kundër drogës, kualifikimi dhe trajnimi profesional i tyre. Pa dyshim, këtu luan rol edhe përsosja e menaxhimit të kufirit dhe forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të drogave. Rëndësi të veçantë marrin edhe programet e parandalimit të narkokriminalitetit për të rinjtë e shkollave, me synim që të ndërhyhet sa më herët te nxënësit për t'i njohur me rreziqet që vijnë nga drogat. Këto programe të përfshijnë edhe trajnimin e mësuesve për menaxhimin e mirë të klasave, për të edukuar sjellje pozitive të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj.

Por, mbi Këtu më poshtë po sjellim rolin që kanë strukturat e ndryshme legislative dhe ligjzbatuese për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit. Po e fillojmë me rolin që luan në këtë drejtim kërkohet legjislacioni që lidhet me drogat dhe me luftën kundër tyre.

Roli i legjislacionit penal në parandalimin e narkokriminalitetit

Sistemi i legjislacionit penal luan rol të rëndësishëm në parandalimin dhe goditjen e narkokriminalitetit. Shqipëria dhe Kosova kanë bërë plotësime dhe përmirësime në legjislacionin që lidhet me parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit dhe kanë shtuar bashkëpunimin ndër-institucional për zbatimin e tij. Gjithashtu, kanë forcuar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe pjesëmarrjes në operacione të përbashkëta. Në funksion të zgjerimit të këtij bashkëpunimi kundër krimit të organizuar Shqipëria ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi dy e shumëpalëshe me vende dhe organizata rajonale e ndërkombëtare. Instalimi i linjave të sigurta të komunikimit ka sjellë rritje të ndjeshme të shkëmbimit të informacionit me EUROPOL-in, me zyrat ndërlidhëse të vendeve të Bashkimit Europian dhe ato të palëve të treta, të atashuara pranë këtij organizmi. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar rajonal, Shqipëria ka qenë kontributore në përgatitjen dhe miratimin e Konventës së SELEC.

Për intensifikimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, Shqipëria ka aderuar në një sërë aktesh ndërkombëtare, si: Ligji nr.9554, datë 8.6.2006, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare”; ligji nr.9725, datë 7.5.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin shtesë të paktit

ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike”; ligji nr.9726, datë 7.5.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e dytë shtesë të paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike”; ligji nr.9753, datë 14.6.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për akses ndërkombëtar në drejtësi””; ligji nr.9833, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve””, për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura; ligji nr.9834, datë 22.11.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë”; ligji nr.9838, datë 10.12.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponenteve dhe municioneve”, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar; ligji nr.9871, datë 11.2.2008, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë”, si shtesë e Konventës Europiane për ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për ndihmë juridike për çështjet penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre etj.

Ndër vite Shqipëria ka fuqizuar kapacitetet administrative, ligjore dhe profesionale të strukturave të mbrojtjes së dëshmitarëve. Në këtë kuadër janë miratuar: ligji nr.10173, datë 22.10.2009, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë"; ligji nr.10461, datë 13.9.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10173, datë 22.10.2009, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë"; aktet nënligjore, si Urdhri i Përbashkët nr.3, datë 05.01.2011, i ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Punëve Publike dhe Transportit "Për pajisjen me dokumentacion të personave të

mbrojtur"; Udhëzuesi "Për përcaktimin e procedurave standarde që duhet të zbatohen nga oficerët e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e shtetasve, përfshirë edhe viktimat e trafikimit, që bashkëpunojnë" me organet e drejtësisë" etj. (Vendimi i KM, nr.663,17.07.2013:6-13).

Në Kosovë, në dekadën e fundit janë bërë reforma në sistemin e drejtësisë, me qëllim përmirësimin e rolit parandalues të institucioneve në luftimin e kriminalitetit, në përgjithësi, dhe, në veçanti, të kriminalitetit me drogë. Për luftimin kundër drogës, Kosova ka në fuqi një bazë të gjerë legislative, ku si parësorë mund të përmendim: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin Penal të Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Kosovës; Ligjin nr.02/L-128 për Barnat Narkotike, substancat Psikotrope dhe Prekursorë; Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë; Ligjin për Gjykatat; Ligjin nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit; Ligjin nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; Ligjin nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Ligjin nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës; Ligjin nr.03/L-053 Mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë; Ligjin nr.04/L-076 për Policinë; Ligjin nr.04/L-015 Për mbrojtjen e dëshmitarëve; Ligjin nr.04/L-043 Për mbrojtjen e Informatorëve; Kodin e Drejtësisë për të Mitur; Kodin Doganor dhe të akcizave; Ligjin nr.03/L-191 Për ekzekutimin e sanksioneve penale; Ligjin nr.03/L-183 Për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare; Ligjin nr.03/L-196 Për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit; Ligjin nr.04/L-31 Për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale etj.

Standardet e krijuara ndërkombëtare përmes Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, të vitit 2000, dhe dy protokollet shtesë të saj,

Konventës së Këshillit të Europës dhe Direktivat e BE-së, rekomandojnë nevojën e forcimit dhe bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër narkokriminalitetit.

Zbatimi në praktikë i të gjitha këtyre që përmendëm më sipër, pa dyshim, ka dhënë efektin e vet. Bazuar në legjislacionin e pëmirësuar dhe të harmonizuar me atë ndërkombëtar, Shqipëria ka shënuar arritje në programin e saj për reduktimin e prodhimit dhe zvogëlimin e sipërfaqeve të kultivuara me bimë narkotike, për pakësimin e trafikimit të drogave, për garantimin e një kontrolli efektiv dhe sigurimin e territorit të saj. Çdo vit, është implementuar një plan veprimi i veçantë për luftën kundër kultivimit të kanabisit, ku janë përfshirë pushteti lokal dhe institucionet e tjera shtetërore. Lufta kundër narkokriminalitetit është bërë më efektive. Në vitet 2007-2012 është rritur ndjeshëm numri i operacioneve me teknikat speciale të hetimit. Janë zhvilluar 252 operacione, që kanë goditur 254 grupe kriminale të trafikimit dhe të shpërndarjes së narkotikëve. Krahësuar me vitin 2007, në vitin 2012 numri i operacioneve me teknikat speciale të hetimit u rrit 47 % (Vendimi i KM, nr.663, 17.07.2013:6-13).

Policia dhe parandalimi i narkokriminalitetit

Në çdo shoqëri njerëzore policia ka qenë organi kryesor i shtetit në luftën kundër kriminalitetit (Shishani,2006:67). Veprimtaria parandaluese dhe represive janë dy komponente kryesore, tek të cilat policia orienton detyrat e saj (Latifi,2001:26). Funksionimi shoqëror i policisë është pjesë e funksionimit të shtetit (Kostiç,1987:33).

Si organi më i rëndësishëm shtetëror që kujdeset për mbrojtjen dhe sigurimin e rendit, policia kryen veprimtari me rëndësi edhe në luftën kundër kriminalitetit, përfshirë

edhe narkokriminalitetin, duke zbatuar masa parandalues, por edhe represive, kur e kërkon nevoja. Kjo veprimtari duhet të bazohet mbi parimet themelore të policisë së udhëhequr nga inteligjenca. Këto parime kanë për qëllim udhëheqjen e të gjithë zyrtarëve policorë në rastet kur marrin masa operative teknike dhe veprime të tjera (Latifi,2000:30).

Në Shqipëri, Policia e Shtetit veprimtarinë e saj e zhvillon në përputhje me Ligjin Nr.108/2014, datë 31.07.2014, Fletore zyrtare nr.137. Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar nga legjislativi, me qëllim reformimin e sistemit policor të vendit për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit. Në bazë të ligjit për Policinë e Shtetit, struktura e saj organizative është e ndarë në drejtori të përgjithshme dhe drejtori të qarqeve, që kanë edhe seksione të veçanta të luftimit të kriminalitetit. Në kuadër të Policisë së Shtetit ekziston Departamenti kundër krimit të organizuar dhe krimit të rëndë, i cili bën menaxhimin e veprimtarive që kryhen nga strukturat e luftës kundër krimit, për rritjen e standardeve të sigurisë në vend, për parandalimin dhe luftën kundër krimit, në përgjithësi, dhe luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, në veçanti. Ligji për Policinë e Shtetit, parashikon edhe aplikimin e masave të veçanta të hetimit, bashkëpunimin e fshehtë me individë, transferimin ndërkombëtar të të dhënave etj., me qëllim luftimin e kriminalitetit në përgjithësi, përfshirë dhe narkokriminalitetin.

Në Shqipëri ajo po luan një rol të madh në parandalimin proaktiv dhe në luftimin e narkokriminalitetit në të gjithë territorin e vendit. Sipas ministrit të PB të Shqipërisë, Tahiri, në vitin 2013 në gjithë territorin e Shqipërisë ishin të kultivuara 323 hektarë dhe janë shkatërruar vetëm 7.5% të kësaj hapësire ndërsa në vitin 2015 vetëm 44 hektarë janë kultivuar në të gjithë territorin e Shqipërisë (Fjalimi i Ministrit të PB, Saimir Tahiri, 16 shtator 2015).

Vlen të përmendet këtu ndërhyrja e vendosur e policisë së shtetit në bazën më problematike për kultivimin e kanabisit, në fshatin Lazarat, ku më parë nuk guxonte të futej këmbë polici. Shkatërrimi i kësaj baze që kultivonte, prodhonte dhe trafikonte sasi të mëdha narkotikësh që një goditje e madhe e narkokriminalitetit. Por edhe pas kësaj goditjeje të madhe që mori narkokriminaliteti, policia vazhdon të ndeshet me shkelësit e ligjit, që e zhvendosën mbjelljen dhe kultivimin e kanabisit në zona të tjera të vendit. Vitet e fundit, nga veriu në jug, janë zbuluar parcela të shumta të mbjella me kanabis dhe policia ka djegur mijëra rrënjë bimë, ka sekuestruar sasi të mëdha narkotikësh dhe ka arrestuar mjaft të dyshuar. Sfida vazhdon, pasi krimi nuk ndalet, etja për pará ka bërë që kanabisi të kultivohet edhe në zona malore, në parcela të fshehura ndër pyje e në skutat më të largëta.

Në Kosovë, policia në kuadër të MPB-së, po përballet çdo ditë me veprimtari të ndryshme kriminale, kuptohet, edhe me vepra të narkokriminalitetit. Funkzioni i Policisë këtu rregullohet me Ligjin Nr.04/L-076 ‘Për Policinë’. Në kuadër të strukturës organizative të Policisë së Kosovës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë funksionon edhe Departamenti për Hetimin e Krimin, i cili ka për qëllim parandalimin e kriminalitetit, zbulimin dhe hetimin e autorëve të veprave penale, me anë të mbledhjes dhe paraqitjes së fakteve, dëshmive dhe provave që dëshmojnë fajësinë ose pafajësinë e personave të dyshuar për vepra penale, si dhe vënien e tyre para drejtësisë.

Në kuadër të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë janë realizuar disa operacione të përbashkëta për luftimin e narkokriminalitetit, si: Rasti i koduar “*Trekëndëshi*” (2011), Rasti i koduar “*Patkoi*” (2011), Rasti i koduar “*Era*” (2012), Rasti i koduar “*Elenika*” (2013), Rasti i koduar “*Perëndimi*” (2014), Rasti i koduar “*Kokaina*” (2014), Rasti i koduar “*Mekaniku*” (2014) (Policia e Kosovës, 2016). Janë zhvilluar edhe

operacione të tjera të karakterit ndërkombëtar me shtete të tjera, me qëllim parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit.

Nevoja e parandalimit dhe e luftimit të trafikimit të drogave dhe bashkëpunimit ndërkombëtar ka diktuar nevojën që Shqipëria dhe Kosova të krijojnë organe të specializuara të luftës kundër drogës, mes të cilave drejtoritë për hetimin e trafikimit të narkotikëve. Në Kosovë kjo u krijua në vitin 2004. Këto drejtori kanë dhënë ndihmesën e tyre në mjaft raste për luftimin e narkokriminalitetit, në parandalimin e rasteve të narkomanisë të moshat e reja etj.

Lidhur me masat parandaluese, të veprave penale në fushën e drogave, sidomos në kultivimin shpërndarjen dhe konsumimin e drogave, policia, duhet të fokusohet në këto aspekte:

- Veprimi i Policisë në komunitet. Ky është një projekt mjaft i rëndësishëm për luftimin e narkokriminalitetit në bashkëpunim me shoqërinë civile, me institucionet e qeverisjes lokale apo qendrore; me shkollat, prindërit etj.

- Aplikimi i projektit “Policia e udhëhequr nga intelijenca”. Ky synon që në luftën kundër narkokriminalitetit policia të mos mjaftohet me forcën reaguese, por të shohë si obligim të saj edhe punën shkencore studimore, për njohjen, analizimin e dukurisë, të faktorëve dhe shkaqeve që ndikojnë në përhapjen e saj, të statistikave, me qëllim që e tërë puna e saj të ndërtohet mbi konkluzionet teorike-praktike që ajo nxjerr lidhur me parandalimin e narkokriminalitetit.

- Një qëndrim më proaktiv në marrëdhëniet me komunitetin, nxitja dhe përfshirja në nismat e komunitetit për edukimin dhe argëtimin e të rinjve për t'i shmangur ata nga rruga e narkomanisë dhe e krimit.

- Bashkëpunimi ndërkombëtar me policinë e vendeve të rajonit dhe më gjerë, si për shkëmbimin e informacioneve dhe të përvojave të mira, por edhe pjesëmarrja e suksesshme në operacione të përbashkëta me to për luftimin e narkokriminalitetit;

- Hartimi dhe implementimi i planeve operative për mbajtjen në mbikëqyrje dhe kontroll mjediset dhe hapësirat publike, lokalet e natës, kafenetë dhe automjetet, si dhe rritja e efikasitetit të operacioneve operative për kapjen dhe ndalimin e atyre që i përdorin këto mjedise për trafikim dhe përdorim droge, si dhe të autorëve të veprave penale të narkokriminalitetit.

- Hartimi i akteve nënligjore, në bashkëpunim me prokurorinë dhe gjykatat, për procedurat e ruajtjes (sigurimit), të konfiskimit dhe të asgjësimit të substancave narkotike dhe psikotrope;

- Organizimi i fushatave të ndryshme për vetëdijesim të qytetarëve për pasojat e përdorimit të narkotikëve;

- Organizimi i ligjëratave dhe i work-shopeve me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme lidhur me drogat dhe pasojat e përdorimit të tyre.

- Shtimi i numrit të zyrtarëve policorë, në njësitë antidrogë që veprojnë në rajonet policore në tërë Kosovën;

- Trajnimi i zyrtarëve policorë për mënyrën dhe metodat e hetimit të narkokriminalitetit;

- Trajnimi i zyrtarëve policorë dhe i punëtorëve socialë për metodat e fshehjes së narkotikëve dhe të substancave psikotrope nga personat e dyshuar;

- Zbatimi i masave shtesë për “blerje të simuluar të narkotikëve dhe të psikotropëve” nga ana e zyrtarëve policorë;

- Krijimi i një sistemi të mirëfilltë të sigurimit të informacioneve të shërbimeve të inteligjencës për grupet e krimit të organizuar, që merren me trafikimin e narkotikëve dhe të substancave psikotrope etj.

Përmbushja me sukses e misionit që ka Policia në kontrollin e territorit, në menaxhimin e sigurt të kufijve dhe në përballimin me krimin në përgjithësi dhe narkokriminalitetin, në veçanti, realizohet me fuqizimin dhe modernizimin e vazhdueshëm të strukturave dhe personelit të saj, me përmirësimin e kapaciteteve të hetimit dhe të informacionit, si dhe atyre operacionale, logjistike dhe infrastrukturore. Kështu ajo rrit efikasitetin dhe aftësitë parandaluese dhe goditëse ndaj narkokriminalitetit.

Në këtë funksion duhet parë edhe organizimi i Policisë, sepse ka mendime që numri i madh i strukturave qendrore, lokale dhe private me natyrë policore dobësojnë efikasitetin e punës në terren për zbatimin me efektivitet të misionit të Policisë. Po ashtu, më shumë duhet bërë për kualifikimin e vazhdueshëm profesional të efektivave të strukturave policore dhe sidomos për përmirësimin e etikës së tyre në raport me qytetarët.

Roli i doganës në parandalimin e narkokriminalitetit

Dogana luan një rol gjithnjë e më të madh në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Duke qenë e pranishme në pikat e kalimit të kufitar, duke pasur nën vëzhgim zonën kufitare, si edhe duke mbajtur nën kontroll rrjetin rrugor kombëtar, dogana ka një mision të rëndësishëm mbrojtës, që shtrihet në shumë fusha.

Kur është fjala për luftën kundër narkokriminalitetit, roli i doganave ka të bëjë me zbulimin, bllokimin dhe ndalimin e futjes së substancave të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin me parandalimin e tregtisë me mallra të ndaluara dhe me një luftë më të gjerë kundër kontrabandës dhe krimit të organizuar (DK,2015a:8).

Edhe pse legjislacioni doganor në Kosovë dhe Shqipëri vazhdimisht plotësohet dhe përmirësohet në përputhje me legjislacionin europian, doganat e dy shteteve duhet të përvetësojnë dhe të zbatojnë koncepte dhe praktika moderne doganore dhe standarde të reja, sipas të cilit parimi i punës është që veprimet operative të udhëhiqen nga inteligjenca. Kështu kontribuohet edhe më mirë për zbulimin e drogave dhe kapjen e trafikantëve të tyre.

Kosova dhe Shqipëria kanë një bashkëpunim të mirë në sektorin e doganave, madje është bërë shumë për afrimin dhe po shkohet drejt bashkimit doganor. Fakti që Kosova dhe Shqipëria do të kenë doganën e tyre të përbashkët do t'i japë një impuls rritjes së punës për parandalimin e narkokriminalitetit në të dyja vendet.

Megjithatë, kërkohet që ky sektor të shërbejë me më shumë efikasitet dhe konkretisht në zbulimin dhe pengimin e veprimeve të paligjshme që lidhen me narkokriminalitetin. Doganat duhet të bashkëpunojnë më shumë me institucione të vendit, si me Policinë, Prokurorinë, Administratën Tatimore, me Ministrinë e Shëndetësisë etj., me qëllim që të njohin mirë, si subjektet e paligjshme në këtë fushë, ashtu dhe subjektet e licensuara që merren me prodhimin, importimin, eksportimin, shitjen e barnave narkotike apo psikotrope. Sepse shumë prej këtyre veprojnë edhe në mënyrë të paligjshme, ndaj duhen shënjestruar qysh në kufi, me qëllim që të mos lejojnë depërtimin brenda vendit apo trafikimin jashtë vendit të mallrave të tyre që lidhen me narkokriminalitetin. Kjo është e domosdoshme, pasi ka mjaft substanca kimike që përdoren për prodhimin e ligjshëm të

produkteve farmaceutike, të parfumeve, kozmetikës, të plehrave, vajrave etj. që bëhen jashtëzakonisht të rrezikshme, kur personat që merren me narkokriminalitet dhe subjekte të ndryshme prodhuese ua ndryshojnë destinacionin e ligjshëm dhe, megjithëse kanë licensë të rregullt nga shteti, i përdorin ato për të prodhuar droga, si heroinën, kokainën, ekstazin apo amfetaminën. Duke pasur informacion për të tilla subjekte nga organet e tjera shtetërore, doganat do të arrijnë t'i pengojnë që në kufi këto produkte, masë kjo e rëndësishme parandaluese.

Gjithashtu, administratat doganore në Kosovë dhe Shqipëri duhet të krijojnë njësi të veçanta, të specializuara dhe të aftësuara për zbulimin dhe hetimin e narkotikëve, për mbledhjen, trajtimin dhe përdorimin sa më efikas të informacionit. Zhvillimi dhe përsosja e sistemit informativ të analizës së rrezikut dhe të selektivitetit sipas kanaleve në bazë të profileve të riskut, janë kyç për rritjen e efektivitetit në zbulimin veprave penale të narkokriminalitetit.

Një element i qenësishëm i punës së doganave është lufta kundër keqpërdorimit të sistemit doganor dhe korrupsionit të zyrtarëve të tij. Këto kanë qenë dhe mbeten problem në Shqipëri dhe në Kosovë.

Shqipëria dhe Kosova kanë tashmë legjislacionin bazë në fushën doganore, në përputhje me legjislacionin e BE-së. Nga ana e saj, Shqipëria ka Kodin e vet doganor, ka Ligjin nr.102/2014 për doganat. Gjithashtu, ajo ka aderuar, tashmë, në Konventa ndërkombëtare në fushën doganore, me marrëveshje ndërkombëtare dhe bilaterale, si në Konventën ndërkombëtare “Për asistencë të ndërsjellë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore”, Nairobi”; në Konventën TIR, të vitit 1975 etj. Ndërsa Kosova, për shkak të situatës politike dhe juridike në të cilën ndodhet ka të

dekretuar vetëm ligjin nr.04/L099 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor Nr.03/L-109 Doganor dhe akcizave të Kosovës.

Sidoqoftë, dogana e Kosovës, e themeluar në vitin 1999, nën UNMIK-un dhe e njohur si Dogana e Kosovës në dhjetor 2008, është zhvilluar mbi bazën e standardeve të BE-së, ka filluar të konsolidojë punën e saj dhe ka arritur rezultate. Në vitin 2012, ajo bëri të mundur zbulimin e mallrave ilegale, si narkotikë, në 12 raste, ku konfiskoi 185 kg e 500 gr kryesisht, marihuanë (DK, 2012: 20). Po ashtu, gjatë vitit 2014 ka zbuluar gjithsej 18 raste me lëndë narkotike dhe ka konfiskuar rreth 45 kg marihuanë dhe rreth 2.5 kg kokainë (DK,2014:15). Kjo punë e suksesshme ka vijuar edhe gjatë vitit 2015, kur u zbuluan 18 raste të ndryshme dhe mbi 20 kg lëndë narkotike (DK,2015b:2).

Kohët e fundit ajo ka finalizuar pjesën e Planit Kombëtar për Adaptimin e Acquis, ku do të harmonizohet legjislacioni doganor me theks të veçantë nga kërkesat e dala për zbatim të MSA-së.

Këto, arritje të mira i kontribuojnë zbulimit dhe pengimit të trafikut të drogave dhe luftës kundër narkokriminalitetit. Por ato nuk janë gjithçka. Në funksionimin e doganave, në përgjithësi, por edhe lidhur me parandalimin e narkokriminalitetit ka akoma probleme në evidencimin dhe menaxhimin e tërë procesit të kundërvajtjeve doganore dhe të veprave penale me narkotikët, në ndalimin e veprimeve joformale, në rritjen e performancës së doganës dhe sidomos në parandalimin dhe evitimin e krimeve që bëhen me ndihmesën e zyrtarëve të saj. Forcimi i punës parandaluese të narkokriminalitetit, kërkon gjithashtu, përmirësimin e etikës doganore, të çdo lloj konflikti të interesit, si edhe përmirësimin e mekanizmave dhe të mjeteve për parandalimin, hetimin dhe zbulimin e rasteve të korrupsionit.

Shërbimet e inteligjencës dhe parandalimi i narkokriminalitetit

Institucionet e inteligjencës, me organizimin që kanë dhe me punën specifike që bëjnë, kanë mundësinë t'u qasen grupeve të krimit të organizuar dhe zbulimit me kohë të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit. Ato sigurojnë informacione të vlefshme edhe për agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, policisë, prokurorisë dhe gjykatave, për zbulimin, kapjen, hetimin dhe goditjen e autorëve të veprave penale të lidhura me drogat.

Në Shqipëri, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), dhe në Kosovë, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) kanë një rol të madh në mbledhjen, vlerësimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacioneve që kanë të bëjnë me narkokriminalitetin. Ata janë ballafaquar me shumë sfida në këtë fushë, që lidhet jo vetëm me mbrojtjen e shoqërisë, por edhe me sigurinë kombëtare. Detyra kryesore SHISH-it *“Mbledh informacion për terrorizmin, për prodhimin dhe trafikun e narkotikëve, për prodhimin e armëve të dëmtimit në masë, për krimet kundër mjedisit”*, mbetet gjithnjë prioritarë për të edhe sipas Strategjisë së Sigurisë Kombëtare në Republikën e Shqipërisë (SSK), për mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme dhe të brendshme.

Në Kosovë, pas shpalljes së Pavarësisë, në mesin e vitit 2008 u krijua Agjencia Kombëtare për Inteligjencë, si domosdoshmëri e nevojës për informacion me kohë dhe të saktë për inteligjencë, kundërinteligjencë, lidhur me kërcënimet nga brenda dhe nga jashtë, me terrorizmin ndërkombëtar apo vendor, me prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, krimin e organizuar, krimin ekonomik, sabotazhin dhe të gjitha çështjet e tjera të inteligjencës të lidhura me sigurinë e Kosovës (Kushtetuta e Kosovës, Neni 169).

Por duhet thënë se AKI ka hapësirë veprimi vetëm brenda territorit të Kosovës. Kjo paraqet një sfidë për të, sepse limitimi i veprimit të saj vetëm brenda Kosovës e kufizon edhe fushëveprimin e saj për të dërguar dhe infiltruar agjentët e vet në territorin e shteteve tjera. Kjo agjenci e ka shtuar aktivitetin dhe ka rritur bashkëpunimin me SHISH-in e Shqipërisë.

SHISH edhe AKI vlerësohen si kontribues në sigurinë për qytetarët, shoqërinë dhe shtetin, brenda vendit, si dhe në rajon e më gjerë. Të dyja këto shërbime të inteligjencës e kanë rritur performancën në kryerjen e rolit të tyre edhe në drejtim të parandalimit dhe luftimit të narkokriminalitetit. Për këtë, ato janë fokusuar në krijimin e një sistemi sa më efikas të grumbullimit, analizimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së informacioneve, si brenda institucioneve kombëtare edhe atyre ndërkombëtare.

Por tendenca e rritjes së narkokriminalitetit në Shqipëri dhe në Kosovë shtrën para tyre nevojën për krijimin e më shumë produkteve analitike për vëllimin, strukturën dhe tendencën e narkokriminalitetit, sidomos të grupeve kriminale të organizuara, në fushën e drogës. Ato duhet të rrisin dhe të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre me qytetarët dhe me institucione të vendit, me shërbimet inteligjente të vendeve të tjera si kusht i suksesit edhe në luftën për parandalimin dhe luftimin me efikasitet të narkokriminalitetit.

Roli i gjyqësorit në parandalimin e narkokriminalitetit

Roli dhe rëndësia e sistemit gjyqësor është jashtëzakonisht e madhe, për shkak se, nëpërmjet një sistemi gjyqësor të mirëfilltë dhe profesional, arrihet goditja e autorëve të veprave penale, duke krijuar premisa për shkatërrimin e grupeve të krimit të organizuar dhe

për shpërndarjen nga veprimtaria kriminale të mjaft individëve që dënohen. Për shkak të shqetësimit të vazhdueshëm të publikut lidhur me abuzimin e drogave dhe krimin e dhunshëm, hetimet për drogën janë bërë një shtyllë e fortë në shumë agjenci të zbatimit të ligjit (Lyman,2010:561-562).

Me qëllim rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe përmirësimin e cilësisë së gjyqimit të veprave penale të këtij lloji, në vitin 2004, në Shqipëri sistemi gjyqësor iu shtua edhe Gjykata për krime të rënda. Ndërsa në Kosovë, në vitin 2013 u reformua i tërë sistemi gjyqësor, ndryshoi organizimi i tij, u ngritën gjykatat themelore, që kanë edhe Departamentin për Krime të rënda. Ky departament merret edhe me gjykimin e veprave penale të krimit të organizuar, trafikimit të narkotikëve, terrorizimit etj.

Nga një pjesë e publikut, sistemi i drejtësisë penale shihet si një mekanizëm i rivendosjes së një të drejte të shkelur ose marrjes së “shpërblimit” ose kompensimit për atë që një person ka pësuar (Hysi,2010:147-413).

Prokuroria, me seksionet e veçanta kontribuon në luftimin e kriminalitetit, me hetimet dhe procedimet penale që ndërmerr. Nga statistikat e prezantuara në kreun VI të këtij disertacioni, numri i procedimeve të pranura nga prokuroria dhe i procedimeve të dërguara prej saj për gjykim ka një tendencë rritjeje nga viti në vit. Në Shqipëri, roli i Prokurorisë në parandalimin e narkokriminalitetit është i fokusuar në hetime proaktive, me qëllim reduktimin e kësaj dukurie, dhe në rritjen e efikasitetit të saj. Në vitin 2013, Prokuria e Përgjithshme, bashkë me institucionet e tjera ligjzbatuese, përfshirë edhe shërbimet e inteligjencës, hartuan një strategji të përbashkët për të faktuar, nëpërmjet hetimeve proaktive, përgjegjësinë penale të personave që drejtojnë dhe organizojnë këtë veprimtari të

paligjshme (PP,2013:12). Kjo strategji përfshin edhe evidencimin dhe bllokimin e kultivimit të lëndëve narkotike në disa zona në Shqipëri (PP,2013:12).

Sistemi i prokurorisë, në strukturën e vet organizative ka edhe Prokurorinë Speciale, të themeluar dhe të funksionalizuar me ligj të veçantë (Ligji nr.03/L-052), që si kompetencë ekskluzive ka edhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit etj. Por në praktikë është vënë re se themelimi i Prokurorisë Speciale nuk është shoqëruar me ndonjë rritje të numrit të procedimeve penale për rastet e krimit të organizuar në fushën e narkokriminalitetit.

Ndikim të madh në ecurinë dhe minimizimin e narkokriminalitetit kanë edhe sanksionet penale që pretendojnë organet e prokurorisë dhe sidomos ato që gjykatat vendosin ndaj autorëve të krimeve me narkotikë. Sanksionet e parashikuara në Kodet penale janë tregues i politikës penale që ndjek një shtet.

Por çështja qëndron se si lexohen, si interpretohen në praktikë dispozitat përkatëse lidhur me dënimet. Sanksionet e përcaktuara me të drejtë në ligj zhvlerësohen krejt dhe nuk ndikojnë pozitivisht, përkundrazi, shpeshherë, favorizojnë krimin dhe kriminelët, kur shohim që prokuroria mbyll një çështje për arsye korruptive ose të politikës. kur gjykata liron në sallën e gjyqit autorë të veprave penale deri edhe trafikantë narkotikësh, ose japin ndaj tyre dënime të buta. Integriteti profesional dhe moral i prokurorëve dhe gjyqtarëve, korrektësia dhe ndershmëria e tyre në zbatimin e normave juridike janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në vënien para drejtësisë të shkelësve të ligjit. Kur këta veprojnë me profesionalizëm të lartë, pa u korruptuar dhe të pandikuar nga politika, atëherë rezultojnë edhe ndjekje penale dhe procese gjyqësore korrekte dhe ndëshkime sipas ligjit.

Por shumë prej tyre kanë humbur besimin te publiku. Në Shqipëri, është pranuar, tashmë, si nga ekspertët, nga politika, nga publiku dhe nga ndërkombëtarët se sistemi i drejtësisë çalon shumë dhe, për këtë, gishti vihet më së shumti në korruptimin dhe politizimin e prokurorëve dhe të gjyqtarëve.

Figura nr.24, ku pasqyrohen sanksionet penale të dhëna ndaj autorëve të veprave penale në fushën e drogave për periudhën 2005-2014, tregon se gjykatat në Shqipëri kanë dënuar në këto vite 4.204 persona si autorë krimesh në fushën e narkokriminalitetit. Por vëmë re se më shumë se gjysmën e këtyre sanksioneve e zë *dënimi me burgim nga 2-5 vjet* (2.196 herë), i pasuar nga *dënimi me burgim nga 5 deri 10 vjet* (1.105 raste). Ndërsa *dënimi me burgim nga 10 deri në 25 vjet*, megjithëse në shifra të vogla, shihet se ka pasur rritje. Në vitin 2013 pati 41 dënime të tilla, kurse në vitin 2012 dënimi në këtë masë ishte dhënë vetëm në 3 raste.


Sanksionet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Me gjobë	1	4	3	3	0	0	8	3	8	3
Deri 2 vjet	39	65	52	21	59	51	143	42	115	110
2-5 vjet	99	217	127	157	223	215	279	144	344	391
5-10 vjet	50	80	93	119	122	91	91	169	155	135
10-25 vjet	20	15	21	20	16	14	3	3	41	20
Total	209	381	296	320	420	371	524	361	663	659

***Burimi: Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor për periudhën 2005-2014.**

Figura 24: Sanksionet e shqiptuara për veprat penale të narkokriminalitetit nga gjykatat në Shqipëri, për periudhën 2005-2014.

Nga të dhënat e figurës nr.25 kuptojmë se gjykatat në Kosovë, për periudhën 2005-2015, kanë shqiptuar ndaj autorëve të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit

sanksione penale të lehta, dënime të tjera plotësuese apo alternative dhe shumë pak dënim me burg. Për 1.794 personat e dënuar nga gjykatat në Kosovë, në këto vite për narkokriminalitetin janë dhënë 2.047 sanksione penale. Më shumë është dhënë *dënimi me gjobë* (530 herë), i pasuar nga *dënimi me kusht* (349 herë). Sanksioni penal më i rëndë i shqiptuar nga gjykatat e Kosovës është *dënimi me burgim nga 5 deri në 10 vjet* (61 herë) (ASK&KGJK,2005-2015).



***Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Agjencia e Statistikave e Kosovës.**

Figura 25: Sanksionet penale që u janë shqiptuar autorëve të veprave penale në fushën e narkokriminalitetit në Kosovë, në periudhën 2005-2015.

Nga të dhënat statistikore zyrtare, del se në Shqipëri, gjykatat kanë dhënë dënime disi më të rënda lidhur me veprat penale në fushën e drogave, në krahasim me ato që janë

dhënë në Kosovë. Por konkluzione të sakta lidhur me këtë problem mund të bëhen vetëm duke shqyrtuar rast pas rasti çështjet penale, rrezikshmërinë e tyre, rrethanat, si dhe vetë autorët.

Institucionet e vuajtjes së dënimit dhe narkokriminaliteti

Në Shqipëri, ligji nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, i ndryshuar së fundmi me ligjin nr.40/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në dispozitën e nenit 11”, ka parashikuar rëndësinë e veçantë të realizimit të programit të trajtimit të të dënuarve apo të të paraburgosurve, ndër ta edhe të personave që kanë varësi nga droga. Kurse në nenin 33/1, të ligjit në fjalë, parashikohet kujdesi shëndetësor për kategori të veçantë, ku hyjnë edhe të dënuarit apo të paraburgosurit të varur nga droga. Ndërsa në paragrafin 5, të nenit 33/1, parashikohet që të dënuarit dhe të paraburgosurit, që shfaqin shenja të përdorimit të drogës, të substancave psikotrope ose të alkoolit, apo shfaqin shenja të stresit, trajtohen sipas programeve shëndetësore dhe sociale që zbatohen në qendra jashtë institucionit.

Në Kosovë është dekretuar Ligji nr.04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, i shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr.31, datë 28 gusht 2013, që nuk parashikon ndonjë trajtim të veçantë për personat që kanë varësi nga drogat, përveç ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm.

Në paragrafin 1, të nenit 172 të ligjit, parashikohet që trajtimi i rehabilitimit të detyrueshëm për të dënuarit e varur nga droga apo alkooli ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor apo në një institucion tjetër përkatës dhe, nëse kjo masë shqiptohet së bashku me dënimin me burgim, kryhet në institucionin shëndetësor. Edhe pse në këtë ligj

nuk është specifikuar trajtimi i personave të dënuar apo të paraburgosur që kanë varësi nga droga, përkujdesja shëndetësore dhe mjekësore e tyre rregullohet në mënyrë të përgjithshme në dispozitat e neneve 43, 44, 46, 47, 48 dhe 49.

Përcaktimet e bëra në legjislacion për trajtimin dhe rehabilitimin e të dënuarve apo të paraburgosurve, ka shumë rëndësi të njihen dhe të zbatohen, sepse qëndrimi në institucionin e burgut lë gjurmë të caktuara në personalitetin e të dënuarit, të cilat mund të kenë ndikim të caktuar në jetën e mëtejshme të këtyre personave (Latifi,2008:209).

Ekzekutimi i dënimeve nga organet penitenciare aplikohet me qëllim parandalimin e kriminalitetit, dhe të kontribuojnë sa më shumë për rehabilitimin e tyre, me qëllim që ata pas kryerjes së dënimit integrohen sa më parë në shoqëri. Nga kjo kuptohet se krahas elementit normativ, një politikë e tillë përfshin edhe aplikimin e trajtimeve për risocializim. Rehabilitimi social i personit të paraburgosur ose të dënuar realizohet nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, ndër të cilat më shumë përdoren punësimi, arsimimi dhe formimet profesionale (Hysi,2012:265-267). Ajo që kërkohet nga institucionet penitenciare është që, pas shqiptimit të dënimeve, ato të ekzekutohen me efikasitet dhe të arrihet qëllimi i risocializimit të autorëve, në këtë rast, të narkokriminalitetit, sidomos tek të miturit me masa disiplinore, mbikëqyrje të shtuar dhe masa institucionale (Salihu,2005:40).

Institucionet e sistemit penitenciar, strukturat përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë duhet të rrisin nivelin e punës dhe të kujdesit për të dënuarit që ndodhen në këto institucione. Në to ka shumë probleme lidhur me mbipopullimin, me respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe sidomos të atyre personave që kanë nevojë për rehabilitim mjekësor apo psikologjik. Duhet njohur mirë nevojat e tyre që të krijohen kapacitetet dhe

kushtet sidomos për kujdesin ndaj personave të dënuar që kanë probleme të varësisë nga drogat. Dihet se këto nevoja nuk janë të njëjta për të gjithë, secili ka specifikat e tij.

Gjithashtu ka mangësi në zbatimin e rregullave të sigurisë, pasi ka raste kur në burg janë futur edhe celularë, edhe drogë për të dënuarit. Nuk mungojnë rastet kur kriminelët të dënuar rëndë vazhdojnë të drejtojnë veprime kriminale, edhe të drogës, nga brenda burgut. apo të tjerë që përdorin edhe drogë. Kjo flet për dobësi në cilësinë e shërbimit, madje, edhe të komprometimit të punonjësve të burgut, që shpeshherë lehtësojnë dhe favorizojnë futjen e sendeve të palejueshme. Ndjekja e këtyre problemeve është e domosdoshme, sepse nuk i shërbejnë luftës kundër krimit.

Roli i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në luftimin e narkokriminalitetit

Për shkak të karakterit global të narkokriminalitetit dhe me qëllim parandalimin dhe luftimin e suksesshëm të tij, janë shumë të domosdoshëm bashkëpunimi dhe koordinimi midis shteteve, si dhe vendosja e standardeve ndërkombëtare në mbrojtjen e të dhënave të shkëmbyera. Bashkëpunimi ndërkombëtar penal rregullohet nga konventa ndërkombëtare, nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe nga ligjet vendase. Ky bashkëpunim përfshin plotësimin e kërkesave për kërkimin, ndjekjen, mbikëqyrjen, identifikimin dhe demaskimin e kriminelëve në bazë të marrëveshjeve paraprahe për shkëmbimin e komunikimeve të sigurt, të fshehta, të shpejta dhe të manovrueshme mes sektorëve përkatës lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë. Përmes konventave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërmjet shteteve rregullohen një sërë veprimtarish penalo-juridike, siç janë: ekstradimi, ndihma e vogël juridiko-penale ndërkombëtare, kalimi i ndjekjes penale

një shteti të huaj, ekzekutimi i aktgjykimit penal të gjykatës së shtetit të huaj dhe ndihma jashtë procedurës penale (Salihu,2010:141).

Bashkëpunimi dhe kordinimi mes institucioneve të zbatimit të ligjit në fushën e drogës, ka si qëllim zvogëlimin e ofertës dhe të furnizimit me të, ndalimin e trafikimit të saj. Organet ligjzbatuese të Shqipërisë dhe të Kosovës, janë përfshirë në procesin e bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe janë prezantuar me sukses, duke kontribuar deri edhe në shkatërrimin e grupeve kriminale mjaft të rrezikshme të trafikimit të narkotikëve. Përparime të dukshme janë bërë në fushën e patrullimeve të përbashkëta dhe patrullimeve të sinkronizuara mes Policisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës.

Shqipëria dhe Kosova kanë nënshkruar marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me shumë shtete për luftimin e veprimeve të paligjshme, ndër to, edhe të narkokriminalitetit, si: Marrëveshja për bashkëpunim policor ndërkufitar,2009; Marrëveshja për bashkëpunim doganor,2009; Memorandumi për bashkëpunim në inteligjencën financiare,2009; Marrëveshja ndërmjet dy qeverive mbi bashkëpunimin policor ndërkufitar,2010; Marrëveshja mes dy qeverive për shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar,2012; Marrëveshja ndërmjet dy qeverive mbi transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave,2011; Marrëveshja ndërmjet dy qeverive për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve nëpërmjet pikave të kalimit kufitar Qafë Morinë (Gjakovë)–Qafë Morinë (Tropojë),2011; Marrëveshja ndërmjet dy qeverive për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve nëpërmjet pikave të kalimit kufitar Qafë Prush (Gjakovë)–Qafë Prush (Has),2011; Marrëveshja ndërmjet dy qeverive për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve nëpërmjet pikave të kalimit kufitar Vërmicë (Prizren)-Morinë (Kukës),2011; Marrëveshja për

Ekstradim, ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje penale dhe transferimin e personave të dënuar, ndërmjet dy qeverive,2012; Marrëveshja ndërmjet dy qeverive për bashkëpunim në fushën e Sigurisë,2015; Memorandum mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e Kontrollit të Brendshëm,2015; Protokoli mbi shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve për kontrollin e kufirit; Protokoll për ndjekjen e menjëhershme ndërkufitare etj.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar me efektivitet kanë qenë edhe grumbullimi, shpërndarjen dhe shkëmbimi i informacioneve për grupet kriminale dhe për trafikimin e drogës, si dhe kryerja e operacioneve të përbashkëta për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit.

Në këtë kapitull bëme një parashtrim të aspektit etiologjik të narkokriminalitetit, duke u fokusuar në dhënien e faktorëve kriminogjenë, që kanë ndikim në shfaqjen e tij, me qëllim njohjen e tyre, të rolit që luajnë ata kanë tek individët për të kryer krime në fushën e drogave. Duke i njohur këta faktorë strukturat përkatëse, ligjvënësit, juristët, studiuesit, institucionet e shtetit dhe shoqëria, do të dinë të anagazhohen edhe më mirë e në mënyrë efikase në luftën parandaluese dhe goditëse të krimeve me narkotikët. Kjo arrihet me sukses kur në terren luftohen jo vetëm pasojat, por, në radhë të parë, shkaqet e lindjes dhe të përhapjes së narkokriminalitetit.

KREU VI: REZULTATET E PËRFTUARA NË ANKETIMET E BËRA NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË

6.1. Vështrim hyrës

Gjatë parashtrimit të dukurisë së narkokriminalitetit në këtë punim kemi theksuar se ajo është mjaft komplekse për nga format e zhvillimit, nga pasojat dhe rreziku që paraqet për individët dhe shoqërinë në përgjithësi. Për studimin e saj, aplikuam edhe metodën e e anketimit dhe të analizës së të dhënave empirike të mbledhura në terren. Synimi primar ishte që, duke anketuar tri grupe personash, të siguronim të dhëna të rëndësishme lidhur me narkokriminalitetin dhe, duke ia nënshtruar analizës shkencore, të krijonim një tablo të qartë për trajtimin e problematikës së studimit tonë. Pasi përcaktuam mostrat, hartuam planin për kërkimin në terren, në Kosovë dhe në Shqipëri dhe instrumentet e anketimit, pyetësorët dhe intervistat gjysmë të strukturuar.

Bazuar në përvojën e praktikës studimore dhe botuese në këtë fushë, kisha krijuar idenë se të studiosh një dukuri kriminale, siç është narkokriminaliteti, fillimisht duhet t'i qasesh hulumtimit të faktorëve kriminogjenë, që ndikojnë te personat që janë potencialisht në rrezik për t'i hyrë rrugës së narkokriminalitetit. Si persona të tillë mund të përcaktohen, në shikim të parë, të rinjtë dhe adoleshentët e rrugës dhe të papunë. Por ne nuk mund të linim jashtë atë masë të rinjsh, që të mbledhur bashkë në shoqëri, në mjedise të caktuara, siç janë shkollat etj., mund të priren të imitojnë apo të nxiten, të joshen nga të tjerët të provojnë drogat, duke rrezikuar të kthehen në delinkuentë. Prandaj shënjestruam, së pari, shkollat e mesme.

Një grup tjetër me shumë interes për hulumtimin tonë menduam se do të ishin persona të dënuar ose që ishin në proces gjyqësor për vepra penale në fushën e narkokriminalitetit. Këta do të ishin një burim shumë i mirë informacioni konkret, pasi ata kanë ç'të tregojnë për veten dhe për veprat penale të kryera. Njëkohësisht, ata ishin përballur, tashmë, me strukturat e zbatimit të ligjit, me organet e drejtësisë, me ligjin dhe, kështu, do të merrnim mendimet e tyre lidhur me këto.

Grupin e tretë për anketim e zgjodhëm nga persona përdorues të substancave narkotike dhe psikotrope ose që kishin njëfarë eksperience në përdorimin e tyre. Nga këta do të përftonim të dhëna me interes për fenomenin e narkomanisë. Me këtë grup, zbatuam një metodë pak të njohur, intervistat gjysmë të strukturuar me individë, për të bërë vërtetim të drejtpërdrejtë të personave përdorues drogash, që vullnetarisht dhe me pëlqimin e tyre do t'u nënshtroheshin pyetjeve. Kjo praktikë vërtetimi na shërbeu mjaft për mbledhjen drejtpërdrejt, sy ndër sy, të të dhënave të sinqerta dhe interesante lidhur me faktorët kriminogjenë që kishin ndikuar tek ata t'i futeshin rrugës së narkokriminalitetit dhe narkomanisë.

Proces me rëndësi i punës sonë për këtë anketim ishte përgatitja e pyetësorëve dhe e pyetjeve për intervistat gjysmë të strukturuar. Për këtë, krahas shfrytëzimit të literaturës dhe burimeve të tjera dokumentare, ne patëm edhe këshillimin dhe mbikëqyrjen nga disa sociologë në Kosovë, që na ndihmuan jo vetëm në përcaktimin e çështjeve më problematike që do të përfshiheshin në pyetjet tona, por edhe për mënyrën e kontaktimit, të komunikimit dhe të vjeljes së mendimeve nga këto kategori të ndryshme personash që do të anketonim.

Zhvillimi konkret i anketimit me pyetësorë dhe me intervistat gjysmë të strukturuar ishte një përvojë mjaft interesante dhe e frytshme, pasi ndryshe nga studimi i literaturës apo i dokumenteve dhe i akteve ligjore, në këtë vërtetim, gjendesh përballë personash të inkrimnuar, aty, në vendin e vuajtjes së dënimit, gjendesh përballë me viktimë të narkomanisë, aty në institucionin e rehabilitimit, të cilëve guxon t'u bësh pyetje dhe ata pranojnë të përgjigjen. Prej tyre përftuam përgjigje konkrete, reale dhe me interes për narkokriminalitetin dhe për ata vetë. Mendimet e tyre, por edhe mbresat, emocionet dhe perceptimet që krijohen gjatë intervistimit për subjektet e intervistuar janë një pasuri më vete për studiuesin. Ato e ndihmojnë atë të prekë realitetin, ta njohë atë, por edhe të arrijë në disa përfundime, shkencore dhe psiko-sociologjike.

Në këtë kuptim, intervistat gjysmë të strukturuar qenë shumë të frytshme për hulumtimin tonë, por edhe për strukturat dhe punonjësit, që, për shkak të detyrës, përballen me këto kategori njerëzish.

Të dhënat empirike që siguroam nga ky anketim na shërbyen për vërtetimin e hipotezave të studimit tonë dhe për arritjen e disa përfundimeve. Por mendoj se edhe për strukturat e zbatimit të ligjit, për shoqërinë në tërësi e sidomos për institucionet arsimore, shkollat, mësuesit, komunitetin e prindërve mund të kenë interes për punën e tyre në mbrojtjen të të rinjve të shkollave të mesme, për t'i shmangur nga narkokriminaliteti.

6.2. Analizimi i të dhënave nga anketimi i nxënësve të shkollave të mesme, në Shqipëri dhe në Kosovë

Realizimi i anketimit me pyetësor të nxënësve të shkollave të mesme, kishte edhe vështirësitë e veta, lidhur me përzgjedhjen e kampionit që do t'i shërbente me efektivitet hulumtimit tonë. Kjo ishte sfida e parë. Për përballimin e saj, u pa, edhe ana sasiore e të anketuarve, por edhe mbulimi i një hapësire sa më të gjerë, për të krijuar një ide sa më të qartë edhe për shtrirjen e dukurisë që po studiojmë. Sipas planit të përgatitur, në anketim u përfshinë nga tri shkolla të mesme, në kryeqytetet Tiranë dhe Prishtinë dhe nga një shkollë e mesme në dy qytete më të vogla, si Shkodra dhe Malisheva. Hartuam listën me emrat e qyteteve të Kosovës dhe me shkollat përkatëse, të cilave u vendosëm nga një numër. Një listë të tillë hartuam edhe për qytetet dhe shkollat në Shqipëri, ku do të kryhej anketimi. Në këto lista përfshimë shkollat e vlerësuara si më të mira nga dy Ministrinë e Arsimit. Më pas bëmë ndarjen e pyetësorëve.

Përse u përzgjedhën shkollat e suksesshme dhe jo ato që njihen si “jo të suksesshme” dhe me probleme? Për këtë, u nisëm nga argumenti se të rinjtë e shkollave më të mira, në njëfarë mënyre, janë më të prirur të përqafojnë siç e quajnë ata “jetën *trendi*” apo “jetën *in*”. Në këto shkolla mund të gjenim “lëndën” e hulumtimit të narkokriminalitetit dhe të narkomanisë. Presupozohet se në shkollat që konsiderohen më të mira nga autoritetet, ndjekin mësimin fëmijë nga familje relativisht me gjendje të mirë ekonomike, prej nga edhe gjejnë mundësi financiare për t'iu qasur kësaj jete që përmendëm dhe sidomos marrjes së substancave narkotike, alkoolit, duhanit etj.

Meqenëse nga hulumtimet e kaluara, por edhe nga statistikat e institucioneve të zbatimit të ligjit, del që më së shumti në këtë dukuri përfshihet grup-mosha 13-18 vjeç, menduam që edhe në vrojtimin tonë të përqendroheshim tek kjo moshë. Kështu, përcaktuam që, si në Kosovë dhe në Shqipëri, të intervistonim nga 1100 nxënës të klasave XI. Në Prishtinë u ndalëm në shkollat: “Sami Frashëri”, “Xhevdet Doda”, “28 Nëntori”, me nga 300 të intervistuar secila. Ndërsa në shkollën e mesme “Hamdi Berisha” të Malishevës u intervistuan 200 nxënës. E njëjta paraktikë u ndoq edhe në Shqipëri. Në tri shkollat e mesme të Tiranës, “Qemal Stafa”, “Petro Nini Luarasi” dhe “Sami Frashëri”, do të intervistonim nga 300 nxënës; ndërsa në shkollën “28 Nëntori”, të Shkodrës, do të intervistonim 200 nxënës.

Për të realizuar anketimin u ndoqën tri faza: *faza e parë* ishte kryerja e intervistave në Shqipëri. Fillimisht, u përpiluan dhe u dërguan në Drejtoritë Arsimore Rajonale të Tiranës dhe të Shkodrës kërkesat për lejimin e realizimit të intervistave me pyetësorë. Me marrjen e miratimit, do të paraqiteshim në shkollat përkatëse t’u shpërndanim nxënësve pyetësorin; *faza e dytë* ishin të njëjtat hapa për realizimin e anketimit të nxënësve në Kosovë. *Faza e tretë* ishte mbledhja e pyetësorëve të plotësuar nga nxënësit dhe futja e të dhënave të përftuara në SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) Versioni 20.

Por që në fillim doli edhe problemi i parë. Drejtoria e shkollës “Sami Frashëri” në Tiranë nuk pranoi të bëhej anketimi. Na u desh të bënim një riplanifikim dhe ramë dakord me drejtoritë dy shkollave të tjera që në to të intervistonim, të paktën, nga 400 nxënës, që bashkë me Shkodrën, në Shqipëri të arrinim në total 1100 të anketuar që kishim parashikuar.

Të njëjtin pyetësor e shpërndamë edhe në 4 shkollat e mesme të Kosovës dhe, duke e ndjekur në vazhdimësi procesin e plotësimit të pyetësorëve, më në fund u arrit që anketimi të realizohej. Në fund grumbulluam pyetësorët e plotësuar.

Pyetësori për nxënësit përmbante 54 variabla, të varura dhe të pavarura, kryesisht, rreth raportit: drogë, nxënës dhe shkollë. Nga analizimi i të dhënave të futura në sistem, na rezultoi se në anketim morën pjesë 2.200 nxënës të shtatë shkollave të mesme në Shqipëri dhe në Kosovë, nga të cilët 1.330 femra (60.5%) dhe 870 meshkuj (39.5%). Moshë e të anketuarve: 67 nxënës të moshës 15 vjeç (3%); 859 nxënës të moshës 16 vjeç (39%); 1.197 nxënës të moshës 17 vjeç (54.4%) dhe 77 nxënës të moshës 18 vjeç (3.5%).

Nga analizimi i përgjigjeve për vendbanimin, rezultuan këta tregues: 1.983 (90.1%) banonin në qytet, ndërsa 217 (9.9%) jetonin në fshat.

Lidhur me gjendjen ekonomike të familjeve të të anketuarve, rezulton se 42 nxënës (1.9%) e vlerësojnë *e dobët*; 471 (21.4%) e vlerësojnë *mesatare*; 1.193 (54.2%) e vlerësojnë *e mirë* dhe 494 (22.5%) *shumë e mirë*.

Vetëm 36 të anketuar kanë deklaruar se nuk e vijnë rregullisht mësimin në shkollë.

Lidhur me pyetjen *A ka njohuri i anketuari për efektin e drogave?* 1.948 nxënës (88.5%) pohuan *kanë njohuri*; 221 (10%) *nuk kanë njohuri*; 31 nxënës (1.4%) nuk iu përgjigjën pyetjes.

Pyetjes *A keni parë ndonjëherë drogë?* i janë përgjigjur 2.176 nxënës, kurse 24 nuk iu përgjigjën. Nga 2.176 nxënësit që u përgjigjën, 1.565 pohuan se *kanë parë drogë*, 611 deklaruan se *nuk kanë parë drogë asnjëherë*.

Për llojin e drogave që kanë parë, 2.169 nxënës deklaruan se kanë parë *marihuanë*; 31 nxënës nuk iu përgjigjën pyetjes. Nga numri total prej 2.169 nxënësish, rezultoi se 1.304 (59.3%), kanë parë, së paku një herë, marihuanë; 865 deklaruan se nuk kanë parë asnjëherë marihuanë.

Lidhur me narkotikun *speed/crystal meth*, rezulton se vetëm 141 nxënës (6.3%) e kanë parë atë, kurse 1.960 nxënës deklaruan se nuk e kanë parë asnjëherë. Për *Ecstasy/MDMA*, 269 nxënës (12.2%) pohuan se e kanë parë; 1.833 (83.3%) deklaruan se nuk e kanë parë; ndërsa 98 nxënës nuk janë përgjigjur.

Për *kokainën*, 610 nxënës (27.7%) pohuan se e kanë parë atë; 1.526 (69.4%) deklaruan se nuk e kishin parë. Për *heroinën*, 339 (16%) nxënës pohuan se e kanë parë; 1.773 (83.6%) pohuan se nuk e kanë parë asnjëherë; kurse 88 nxënës (0.4%) nuk janë përgjigjur.

Me rëndësi të veçantë për anketimin ishte edhe variabli *A ka përdorur ndonjëherë drogë shoqëria juaj?* Nga analizimi i të dhënave të përpunuara rezulton se 1.336 (61.1%) nxënës deklaruan se shoqëria e tyre *përdor* drogë, ndërsa 688 (31.5%) thanë se shoqëria e tyre *nuk ka përdorur* ndonjëherë drogë dhe 161 (7.3%) deklaruan se nuk janë të sigurt. Kësaj pyetjeje nuk iu përgjigjën 15 të anketuar.

Nga përgjigjet e dhëna për këtë pyetje, kuptojmë që shumë nxënës kanë shoqëri me përdorues droge. Ata e dinë këtë fakt dhe prapë e ruajnë shoqërinë, pavarësisht se pajtohen ose jo me këtë fenomen. Problemi është a reagojnë ata ndaj këtyre dukurive, qoftë duke ua thënë shokëve të tyre, qoftë duke i denoncuar te prindërit apo në shkollë?

Pyetjes *Çfarë lloj narkotiku kanë përdorur shokët tuaj?* 1.015 (46.14%) nxënës, që deklaruan se shoqëria e tyre ka përdorur narkotikë, se ka përdorur *marihuanë*: kurse 655

(29.77%) pohuan se shoqëria e tyre *nuk ka përdorur* marihuanë; 506 (23. %) thanë nuk janë të sigurt, dhe 24 (1.09%) nuk janë përgjigjur.

Për narkotikun *speed/crystal meth*, vetëm 47 nxënës (2.2%) deklaruan se shoqëria e tyre e ka përdorur; për *ecstasy/MDMA*, vetëm 177 (8.4%) pohuan se shoqëria e tyre e ka përdorur. Sipas 298 (13.5%) nxënësve është përdorur nga shoqëria e tyre *kokainë*, ndërsa *heroina* del se është përdorur më pak, pasi vetëm 117 të anketuar (5.3%) deklaruan se shoqëria e tyre e ka përdorur atë.

Me shumë interes ishte pyetja e drejtpërdrejtë: *A keni përdorur ndonjëherë drogë?* Nga anketimi rezultoi se nga 2.200 nxënës të anketuar, 331 (15.05%) deklaruan se *kanë përdorur* drogë, ndërsa 1.869 (84.95%) deklaruan se *nuk kanë përdorur*. Prej 331 nxënësve që deklaruan se kanë përdorur drogë, 173 janë nxënës të shkollave të Kosovës. Në raport me numrin e të gjithë të anketuarve në Kosovë (1.100) ata përbëjnë 15.73%. Në Shqipëri, 154 nxënës të deklaruar se kanë përdorur narkotikë zënë 14% të numrit total 1100 të të anketuarve në Tiranë dhe në Shkodër.

Pyetjes lidhur me llojin e drogës, që nxënës të deklaruar se kanë përdorur drogë, del se *marihuana* zë vendin e parë, pastaj vijnë *heroina*, *kokaina* dhe shumë më pak *ecstasy* dhe *speed*.

Me interes për ta njohur dhe për ta parandaluar përdorimin e drogës ishin përgjigjet për pyetjen *Në ç'moshë e keni filluar përdorimin e drogës?* Nga analizimi i frekuencës së këtij treguesi rezultoi se mosha më e ulët kur e kanë filluar përdorimin e drogës është mosha 11-vjeç. Nga 331 të anketuar ose 15.05% a atyre që deklaruan se kanë përdorur drogë, 4 ishin të moshës 11 vjeç, 4 të moshës 12 vjeç, 18 të moshës 13 vjeç, 40 të moshës 14 vjeç, 90 të moshës 15 vjeç, 126 të moshës 16 vjeç dhe 49 të moshës 17 vjeç.

Këto të dhëna janë shumë shqetësuese. Kur e fillon drogën ende fëmijë, vetëm 11 vjeç apo 12-14 vjeç, do të thotë se këta të mitur janë jashtë çdo kontrolli, të familjes, të shkollës, të shoqërisë. Rreziku në këtë rast është shumë i madh, jo vetëm për këta fëmijë, si individë, por edhe për mbarë shoqërinë dhe vendin, sepse ata për moshën, fizikun, organizmin e dobët që kanë, janë të prirur të krijojnë varësi nga droga, të kërkojnë ta përdorin përsëri atë dhe, kështu, rrezikojnë të përfundojnë në shpërndarës dhe shitës narkotikësh dhe të kthehen në autorë veprash penale të narkokriminalitetit. Nga ana tjetër, kjo dukuri tregon për punën e pamjaftueshme parandaluese që bëjnë familja, shkolla, shoqëria për ruajtjen e këtyre të miturve nga droga dhe nga pasojat e saj.

Duke i parë të anektuarit sipas gjinisë, rezulton se djemtë, pra, gjinia mashkullore përbëjnë numrin më të madh të personave që kanë deklaruar se kanë përdorur drogë (202 djem dhe 108 vajza)

Lidhur me pyetjen *A është e lehtë të sigurohet droga (nëse keni pará) brenda 24 orëve?* 1.611 (80%) nxënës pohuan *po*, kurse pjesa tjetër, *jo*.

I nënvizuar përgjigjet e kësaj pyetjeje për të theksuar se si shoqëri kemi një problem të madh. Prej këtyre përgjigjeve dalin disa pyetje të tjera. Nga e dinë këta nxënës se qenka e lehtë të sigurosh drogën? Si e ditkan ata se në cilat pika dhe vende shitet ajo, që e sigurokan lehtë? I njihkan ata personat që posedojnë dhe shesin drogë? Kaq të mirinformuar qenkan për aktivitetin e blerjes dhe shitjes së drogës? Mund të vazhdonim edhe me të tjera shqetësime të kësaj natyre, por po mjaftohemi këtu për të thënë se ç'sfidë të madhe kanë familja, shoqëria dhe shkolla, por edhe strukturat e zbatimit të ligjit për ta kthyer vëmendjen e tyre tek këto mosha të vogla, që, siç duket, nënvlerësohen dhe neglizhohen, kur është fjala për planet e masave parandaluese të narkokriminalitetit.

Analizimi i frekuencës së variablës *A janë mbajtur në shkollën tuaj ligjërata lidhur me drogën?* tregon se 632 të anketuar deklaruan se nuk janë mbajtur ligjërata në shkollë për drogën, kurse 1.508 të anketuar pohuan se janë mbajtur ligjërata.

Pyetjes *A përdoret drogë në shkollën tuaj?* 1.443 e të anketuarve i janë përgjigjur po.

Siç shihet, këtë e pohojnë rreth 2/3 e nxënësve të intervistuar. E theksojmë fjalën ‘nxënës’ për të thënë se këtë “informacion e japin ata që janë përherë të pranishëm në mjediset e shkollave, ndaj edhe janë të besueshëm, pasi i kanë parë dhe dëgjuar rastet e përdorimit të drogës në klasë, në WC, në ndonjë cep të shkollës etj., ose edhe i kanë përdorur vetë. Problemet që dalin këtu janë, jo vetëm përmasat e përdorimit të drogës në mjediset e shkollave, dëmtimet që pësojnë të rinjtë prej saj etj., por, për më tepër, edhe çështja nëse këta 1443 nxënës, që e pohojnë një gjë të tillë, a kanë reaguar ndonjëherë ndaj këtij fenomeni, a janë shqetësuar ata për këtë dukuri që dëmton veten, shokun apo shoqen e tyre, a janë pyetur ndonjëherë ata nga ndokush për këtë problem dhe si janë sjellë, kanë treguar të vërtetën apo e kanë fshehur atë. Këto dhe të tjera pyetje të tilla duhet të na bëjnë të mendojmë se pak punohet në këtë drejtim nga drejtuesit dhe edukatorët e shkollave, por edhe nga të tjera struktura që lidhen me luftën kundër narkokriminalitetit.

Ndërsa në variablën *A vijnë në shkollën tuaj persona të cilët u ofrojnë nxënësve ndonjë lloj të drogave?* vetëm 592 të anketuar janë përgjigjur pozitivisht, kurse pjesa tjetër e kanë mohuar një gjë të tillë.

Lidhur me arsyet përse nxënësit përdorin drogë, 2.102 të anketuar u përgjigjën se faktorët që ndikojnë tek të rinjtë për përdorimin e drogës, janë kryesisht: depresioni, stresi, shoqëria e keqe, problemet në familje, vetmia, dashuria, ikja nga realiteti etj.

Siç shihet nga pohimet e të intervistuarve, nga statistikat që kemi nxjerrë dhe analizuar, dalin mjaft probleme që meritojnë të studiohen e të analizohen një nga një dhe në mënyrë më të hollësishme, jo vetëm nga sociologët, por edhe nga strukturat e zbatimit të ligjit.

6.3. Analizimi i të dhënave nga anketimi i personave të dënuar ose të paraburgosur për vepra penale në fushën e narkokriminalitetit në Shqipëri dhe në Kosovë

Grup i dytë i rëndësishëm që zgjodhëm për hulumtimin tonë shkencor në terren përbëhej nga persona të dënuar ose të paraburgosur për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit në Shqipëri dhe Kosovë. Duke vlerësuar dhe besuar se një kampion i tillë do të na siguronte të dhëna të vlefshme, vendosëm të intervistonim 100 persona të këtyre kategorive. Morëm kontakt me institucionet për zbatimin e vendimeve penale (IEVP) dhe me miratimin e Drejtorisë Qendrore të Shërbimit Korrektues (SHK), në Kosovë, e zhvilluam anketimin në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë, Vushtrri, me 35 të dënuar për vepra penale në fushën e narkokriminalitetit dhe me 5 të tjerë, që gjendeshin në qendrën korrektuese për femra dhe për të mitur në Lipjan. Prej këtyre, 4 ishin femra dhe 1 i mitur, mashkull.

Pjesën tjetër, 60 të anketuar, i zgjodhëm në Shqipëri, me miratimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPP), në IEVP në Fushë-Krujë, ku shpërndamë pyetësin për 50 të dënuar ose të paraburgosur për vepra penale në fushën e narkokriminalitetit, dhe në

IEVP “Ali Demi”, për 10 femra të dënuara ose që ishin në procedurë gjyqësore për vepra penale në fushën e narkokriminalitetit.

Pyetësi u hartua i ndarë në dy pjesë: Pjesa e përgjithshme përmbante 14 variabla, të varur dhe të pavarur, kryesisht rreth të kaluarës së të anketuarit, me qëllim që të studiohen faktorët socialë, ekonomikë, arsimorë, si dhe faktorë të tjerë që mund të kenë ndikuar në përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale me narkotikë. Pjesa e veçantë përbëhej nga 11 variabla, nga të cilat 9 të varur dhe 2 të pavarur e që lidhen kryesisht me faktorë krimogjenë që kanë ndikuar në personalitetin e të anketuarit për t’u përfshirë në narkokriminalitet.

Në qershor 2015, kur e ndërmorëm anketimin, në Kosovë kishte 188 të dënuar për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit (*Shërbimi Korrektues*, maj 2015). Pjesa më e madhe e tyre (35) ishin vendosur në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë, ndaj u adresuam këtu.

Ndërsa në Shqipëri, në muajin maj 2015, sipas statistikave zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rezultonin rreth 507 të dënuar dhe 577 të paraburgosur për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, maj 2015). Si kampion përzgjedhëm 60 persona.

Gjatë muajve maj-qershor 2015 u bë shpërndarja e pyetësorëve dhe më pas futja e të dhënave në sistemin SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) Versioni 20, duke krijuar gjithsej 36 variabla, të cilat janë testuar dhe kanë rezultuar të matshëm. Në vijim u bë analizimi i pyetësorëve, prej nga janë nxjerrë të dhëna shkencore.

Nga shikimi i këtyre të dhënave rezulton se pyetëtorët janë plotësuar nga 86 (86%) të anketuar meshkuj dhe 14 femra (14%). Moshë e tyre rezulton: nga 100 të anketuar, 11 (11%) ishin 28 vjeç, 10 (10%) 24 vjeç dhe më i ri, 17 vjeç, ndërsa më i moshuari 50 vjeç.

Sipas statusit të gjendjes civile, rezulton se 15 të intervistuar ishin të fejuar, 45 të martuar, 5 bashkëjetonin, 9 të divorcuar dhe 30 ishin beqarë/beqare.

Sipas shteteve, përkatësia e të anketuarve është: 39 shtetas të Kosovës; 59 shtetas të Shqipërisë dhe 2 shtetas të huaj.

Niveli arsimor i të anketuarve ishte në raporte interesante: 4 (4%) nuk kishin fare shkollim; 26 ishin me shkollim fillor, 50 me arsim të mesëm dhe 20 me arsim të lartë.

Nga analizimi i të dhënave me sistemin SPSS, rezulton se 57% e të anketuarve kishin qenë të punësuar para se të arrestoheshin, kurse 43% nuk kanë qenë të punësuar.

Nga analizimi i frekuencës së tri variablave të varura rezulton:

Lidhur me vendbanimin, 76% e të anketuarve gjatë fëmijërisë kanë jetuar në qytet, ndërsa 24%, në fshat.

Për variablin se në çfarë bashkësie familjare kanë jetuar të anketuarit gjatë fëmijërisë, rezulton se 84% e tyre kanë jetuar me të dy prindërit; 8% vetëm me njërin prind, me nënën; 5% vetëm me babanë dhe 3% pa prindër, por me të afërm.

Ndërsa për shkollimin i prindërve të tyre; 52% deklaruan se dy prindërit ishin me arsim të mesëm; 24% e kishin babain me shkollë të lartë; 21% pohuan se nëna ishte me shkollë të lartë. Lidhur me punësimin e prindërve, rezultoi se 60% e të anketuarve i kishin prindërit të punësuar, kurse 40% nuk i kishin të punësuar.

Gjatë analizimit të të dhënave empirike del një e dhënë e rëndësishme për gjendjen ekonomiko-financiare të të anketuarve. Frekuenca e këtij variabli të varur tregon se: 55%

deklaruan se gjendja e tyre financiare-ekonomike është *e dobët*, 23% pohuan se ajo është *mesatare*; 17% e vlerësuan si *të mirë* dhe vetëm 5% e vlerësuan *shumë të mirë*.

Nga pjesa e veçantë e pyetësorit, analizuam variablin *Sa herë keni qenë në burg, duke mos e llogaritur burgimin e tanishëm?* Nga kjo rezultoi se 65% e të anketuarve nuk kishin qenë asnjëherë në burg më parë; 19% kishin qenë një herë më parë në burg dhe 16% e tyre kishin qenë në burg nga dy deri në pesë herë para arrestimit të tanishëm.

Me interes për studimin tonë konsideruam edhe masën e dënimit me burgim për veprat penale të narkokriminalitetit. 25% deklaruan se ishin dënuar me më pak se një vit burgim; 25% me një vit ose më pak se dy vjet burgim, 15%, me dy vjet, ose më pak se katër vjet burgim, 11% katër vjet ose më pak se dhjetë vjet burgim; 9% me dhjetë vjet e më shumë burgim. 15% e të anketuarve nuk janë përgjigjur, pasi disa prej tyre ishin ende në procedurë gjyqësore.

Të dhëna të vlefshme morëm edhe për pyetjen: *Para burgimit të tanishëm, a keni përdorur drogë, qoftë edhe vetëm një herë?* Nga analizimi rezultoi: 79% e të anketuarve kanë përdorur drogë; 21% pohonin se nuk kanë përdorur drogë. Një pyetje tjetër kishte të bënte me *moshën kur kanë përdorur drogë për herë të parë*. Nga të dhënat rezultoi se 62% të anketuarve pohuan se kanë filluar të përdorin narkotikë në moshën 13-21 vjeç, kurse më kritike ishte mosha 16 vjeç (14 persona); 10 të anketuar e kishin filluar drogën 17 vjeç dhe 10 të tjerë në moshën 18 vjeç.

Një pyetje me rëndësi ishte edhe: *Cila ka qenë arsyeja që ju ka shtyrë të merreni me shitjen, posedimin, prodhimin apo blerjen e drogës?* Kësaj iu përgjigjën 99 të anketuar (99%), vetëm njëri nuk ka dhënë përgjigje. Analizimi i variablit tregon se 21 të anketuar kanë dhënë si arsye të marrjes me “biznesin” e drogave *gjendjen ekonomike* në

familje; 11 të tjerë japin si shkak *problemet* në familje; 25 të anketuar *fajësojnë shoqërinë e keqe*, që i futi në këtë rrugë; 34 të anketuar thonë se nevoja për më shumë pará (*aspekti financiar*) i shtyu në këtë veprimtari kriminale dhe 8 të anketuar kanë deklaruar se ishte *kureshtja* ajo që ndikoi që të merreshin me blerjen dhe shitjen e drogave.

Pyetjes *Me çfarë lloji të drogës jeni kapur nga policia në kohën kur ju kanë arrestuar?* rezulton se 30% e të pyeturve i janë përgjigjur: me marihuanë: 26% me heroinë; 8% me kokainë; 6% me hashash; 26% e pyeturve janë përgjigjur se në momentin e arrestimit nuk kishin drogë me vete; 1 është përgjigjur se ishte ekstraduar nga një shtet i huaj për të vuajtur këtu dënimin dhe 3 persona deklaruan se nuk janë arrestuar për drogë, por për vepra penale të tjera, vjedhje, grabitje dhe vrasje.

Pyetjes *Cilat janë rrethanat që e shtyjnë një person të kryejë veprat penale në fushën e narkotikëve?* iu përgjigjën 88 të anketuar; 12 nuk dhanë përgjigje. Prej 88 të anketuarve, 68 japin si rrethanë shtytëse faktorët *ekonomikë*; 10 e lidhin këtë me *shoqërinë e keqe*; 3 pohuan *kureshtjen*; 3 *mospunësimin* dhe 4 theksuan *problemet familjare*.

Pyetjes së parafundit: *A mendon se përdorimi i drogave sot paraqet problem të madh në Kosovë apo në Shqipëri?* 85% e të anketuarve janë përgjigjur ‘po’; 7 % kanë deklaruar ‘jo’; 8 % thonë se nuk janë të sigurt.

Mendojmë se këto të dhëna paraqesin interes sidomos për të kuptuar dhe për të provuar se cilët faktorë dominojnë në shtytjen e personave të ndryshëm të përfshihen në veprimtari penale të narkokriminalitetit. Në radhë të parë, ata nxjerrin gjendjen ekonomike dhe problemet në familje. Por edhe më shqetësues është fakti se shumica e autorëve të veprave penale të narkokriminalitetit, përdorin vetë drogë, madje e kanë

filluar ata që në moshë të vogël (edhe 13 vjeç) dhe pastaj kanë nisur veprimet e kundërligjshme të blejnë, të shesin a të trafikojnë narkotikë. Këto të dhëna u shërbejnë studiuesve të kësaj fushe, por edhe strukturave të shtetit dhe të shoqërisë për të parë se ku duhet ta përqendrojnë punën e tyre për parandalimin e fenomeneve të tilla, veçanërisht për të nxjerrë konkluzione lidhur me rrezikun që një përdorues droge mund të kalojë në kontingjentin e narkokriminalitetit dhe të përfshihet në kryerjen e veprave penale me narkotikë.

6.4. Analizimi i të dhënave nga anketimi i personave përdorues të drogave, në Shqipëri dhe në Kosovë

Intervistat gjysmë të strukturuar i konsideruam si instrumentin e përshtatshëm për grumbullimin e të dhënave empirike me personat që kishin përdorur ose ishin ende duke përdorur substanca narkotike dhe psikotrope. Këta persona janë përfaqësues të asaj pjese të popullatën në të dyja vendet, të përfshirë në dukurisë e narkomanisë. Përzgjedhja e kampionit, pati probleme, se jo kushdo pranonte të fliste për veten. Edhe pse numri i atyre që pranuan ftesën tonë ishte 24, menduam se prejtyre do të merrnim të dhëna të mjaftueshme për problemet që do të shtronim.

Edhe identifikimi dhe intervistimi i përdoruesve të drogave paraqitën probleme. Ndaj kërkuam ndihmë dhe bashkëpunim dhe gjetëm mirëkuptim te një OJF, “Aksion Plus”, që vepron në Tiranë, dhe tek OJQ “Labyrinth”, në Prishtinë. Pasi ramë dakord për të mos përdorur emrat e të intervistuarve, në këto qendra rehabilitimi na ofruan bashkëpunimin e tyre 14 persona në Shqipëri dhe 10 persona në Kosovë.

U paraqitëm kërkesën dy organizatave joqeveritare dhe planin për zhvillimin e intervistave. Plani përmbante tri pjesë:

1. Shpjegimi të intervistuarve i procedurës dhe i qëllimit të intervistimit; marrja e aprovimit verbal prej tyre për zhvillimin e intervistës dhe që intervista të regjistrohej; njohja e intervistuesit se pyetjet që lidhen me personin e tij kishin të bënin thjesht me moshën, profesionin, shkollimin, punësimin, statusin familjar dhe ekonomik.

2. Zhvillimi i intervistës, pyetje-përgjigje lidhur me përdorimin e drogave nga të intervistuarit.

3. Përmbyllja e bisedës së bashku me intervistuesin.

Anketimin e filluam në Shqipëri. Zhvillimi i intervistave shkoi normalisht dhe mendojmë se prej 14 të intervistuarve këtu, u siguruan të dhëna të rëndësishme që lidhen me historinë e tyre me drogat; me faktorëve që i kishin shtyrë të përdorin drogë; me mënyrën apo qasjen e tyre ndaj drogave, si dhe me problemet e rehabilitimit.

Ndër ata që pranuan, vetëm 2 ishin të gjinisë femërore, 22 janë të gjinisë mashkullore.

Meqenëse për intervistat gjysmë të strukturuar që zhvilluam është folur edhe në kreun II të këtij disertacioni, po kalojmë te gjetjet kryesore prej tyre.

Nga këto intervista gjysmë të strukturuar arritëm të krijojmë një pamje më të qartë rreth disa aspekteve konkrete të dukurisë së narkokriminalitetit. Ato na përforcuan bindjen se një pjesë e personave të përfshirë në narkokriminalitet janë edhe përdorues të substancave narkotike; së dyti veprimtarinë e tyre e kishin filluar më parë si përdorues. Vetëm 3 prej 14 të intervistuarve në Shqipëri pohuan se fillimisht ata janë marrë me trafikimin e narkotikëve dhe më pas kishin kaluar në përdorues droge. Ndërsa nga të 24

personat e intervistuar gjithsej, në Shqipëri dhe në Kosovë, 7 pohuan se, kishin filluar më parë të përdornin narkotikë dhe pastaj, me qëllim që të siguronin për vete dozën e nevojshme, kishin filluar të kryenin rolin e shpërndarësit të drogës.

Njëri nga 24 të intervistuarit deklaroi se shitblerjen e drogës e kishte vazhduar edhe në një nga burgjet në Greqi, pasi ishte arrestuar për trafikim narkotikësh.

Karakteristikë e veçantë ishte se përdoruesit e narkotikëve, ndryshe nga të dënuarit për narkokriminalitet, deklarorin si faktor shtytës për të marrë drogë *shoqërinë e keqe*. Këtë e dëgjuam prej 13 të anketuarve. Kurse 11 të tjerë thanë se e kanë filluar drogën nga *kureshtja*.

Lidhur me nivelin arsimor të të intervistuarve, rezultoi: vetëm 1 person, i gjinisë femërore, kishte përfunduar arsimin e lartë jashtë shtetit; 9 persona kishin arsimin e mesëm; 9 të tjerë kishin përfunduar filloren, kurse 6 persona shkollën fillore e kishin ndërprerë.

Nga intervistat mësuam se përdorimi i drogave për një kohë të gjatë i ka varfëruar ekonomikisht, fizikisht dhe psikikisht, i ka ndarë nga shoqëria dhe nga familja.

Një konkluzion tjetër që se, përgjithësisht, nuk ka qenë *varfëria* faktori që i ka shtyrë të përdorin drogë. Vetëm 4 nga 24 të intervistuarit thanë se e nisën drogën nga varfëria, por edhe këtë faktor e lidhnin me mungesën e arsimimit, të vendbanimit, të punës dhe të familjes. Ata ishin rritur rrugëve, në parqe dhe në objekte të braktisura, në vende që njihen si vendstrehime të narkomanëve.

I intervistuari me shifrën INSH0800 shpjegon: *“po ta them një si shembull kështu, kur ishim në Itali, ishin burrë e grua, nja pesëdhjetë e ca vjeç, i dërgojshim ne, ndonjë mostër me e provu, se ishin më mjeshtra ata, mostër nga droga që na u deshte ta shisnim. Ata ishin të dy përdorues nga njëzet e ca vjet, të kokainës dhe heroinës, ishin italianë.*

Shërbimet sociale ua kishin marrë fëmijët dhe ata e mbanin fëmijën fshehtas në shtëpi dhe kur i shifsha unë ata, pesëdhjetë e ca vjeç, burrë e grua, si u bon këta që njëzet vjet që përdorin drogë, shkatërruar nga të gjitha krahët dhe kur ishim në shtëpinë e tyre i binim njëri-tjetrit me krahë, si për shaka, dhe thoshim si ia bën njeriu këtë vetes së vet dhe kur unë bëj llogari vetes, se tani unë shkova tek dyzetat, dhe ky është përfundimi se nuk duhet me përdor drogë”.

19 prej të intervistuarve kishin shkelur ligjin, shumica për vepra të rënda kriminale, si vrasje, grabitje me armë, vjedhjet e rënda etj.

Me interes për studimin, por edhe për strukturat e shtetit dhe për shoqërinë është pohimi i të 24 të intervistuarve se ata kishin “marrë” sende nga shtëpia dhe familjarëve, për t’i shitur me qëllim për të blerë drogën.

Në Shqipëri 6 nga të intervistuarit deklaruan se largimi nga shtëpia, dërgimi në emigracion nga familja, për t’iu shmangur drogës, ishte tjetër shkak i fortë që i ka bërë ata të zhyteshin edhe më shumë në rrugën e përdorimit të drogës. Lidhur me këtë, personi i intervistuar me shifrën INSH0200 shprehet: *“Në vitin 1997 fillova ta përdorja heroinën me hundë dhe familja, duke parë që fytyra po më zvogëlohej, më dërgoi në Greqi, për të më larguar nga droga. Mirëpo harruan se në Greqi me drogën bëhej nami... dhe atje unë vazhdova me drogën”.*

Një tjetër bindje që na u përforcua nga ky intervistim gjysmë i strukturuar, ishte se të rinjtë e fillojnë përdorimin drogën në moshë shumë të re. Nga të 24 të intervistuarit, 4 prej tyre deklaruan se e kanë filluar drogën kur ishin 15 vjeç; 6 në moshën 16 vjeç; 8 në moshën 17 vjeç; 3 në moshën 18 vjeç dhe 3 mbi moshën 20 vjeç.

Vëmendje kërkon edhe një pohim tjetër, që doli në këtë intervistim, përdorimi nga shqiptarët i drogave të forta. Personat e pyetur pohuan se deri në vitet 1999-2000 ata kishin përdorur droga të forta, por vetëm, heroinë, kurse, më vonë, kishin vazhduar me marihuanën, hashashin dhe kokainën. Edhe më i rëndë ishte fakti të 24 personat kishin përdorur më shumë se dy droga njëkohësisht, heroinë dhe kokainë.

Të intervistuarit në Shqipëri deklaruan se nuk kanë përdorur substanca të tjera, përveç marihuanës, hashashit, heroinës dhe kokainës. Ndërsa në Kosovë, 2 nga 10 të intervistuarit, deklaruan se kanë përdorur edhe substanca sintetike, si LSD-25 etj.

Në këto intervista vumë re edhe një çështje tronditëse: këta persona ishin pjesë e margjinalizuar e shoqërisë. Askush nuk i merrte në punë. Edhe kur gjenin punë, sapo merrej vesh se kishin përdorur drogë, menjëherë i largonin. Kjo u kishte ndodhur 50% të të intervistuarve. Pra, në vend që ata të ndihmoheshin, braktiseshin dhe i ktheheshin përsëri drogës. I pyeturi me shifrën INTSH0300 deklaroi: *“Në momentin që punoj në sezon në bregdet, nuk përdor drogë dhe as që më shkon mendja për drogën, kurse në momentin që vij në Tiranë menjëherë filloj të përdor drogë, pasi këtu nuk kam ku të punoj”*.

Shqetësues ishte edhe raporti dhe sjellja e familjes ndaj këtyre personave. Të gjithë të intervistuarit na pohuan se, si pasojë e përdorimit të drogave, kanë pasur probleme të mëdha në familje. 6 prej tyre jetonin vetëm, ngaqë familjet i kanë dëbuar nga shtëpia.

Nga të intervistuarit që kishin jetuar jashtë Shqipërisë dhe Kosovës, theksuan se e filluan atje drogën, pasi në komunitetin e shqiptarëve atje ishte e përhapur dukuria e narkokriminalitetit. Njëri nga të anketuarit nga Kosova theksoi se shumica e shoqërisë së tij në emigracion merrej me shitblerjen e drogave.

Tre persona, 1 femër dhe 2 meshkuj, pohuan se kishte qenë partneri në çift që kishte ndikuar në fillimin e përdorimit të drogave.

Me interes ishte pohimi i 16 të intervistuarve se drogën e kanë përdorur edhe në periudhën e vuajtjes së dënimit me burg në Shqipëri, Kosovë, Itali, Gjermani, Angli dhe Zvicër. Ky problem doli edhe për periudhën e rehabilitimit. Të gjithë ata që rehabilitoheshin në qendrat përkatëse, kanë përdorur droga, në raste të caktuara.

Në anketim pamë edhe raportin qytet-fshat lidhur me fillimin e përdorimit të drogave. Nga 24 personat e intervistuar, 21 e kishin filluar drogën në qytet, në qendra urbane, dhe vetëm 3 persona, në fshat. Njëri, e kishte filluar në një shtet jashtë Kosovës. Kjo provon mendimin se urbanizimi ndikon shumë në përhapjen e narkokriminalitetit dhe të narkomanisë.

I paraqitëm këto deklarime të personave të pyetur në anketimin me nxënës të shkollave të mesme, me të dënuar apo të paraburgosur për vepra penale në fushën e drogave, dhe me personave që kishin krijuar varësi nga drogat, për të hedhur dritë rreth problemeve që na interesonin në këtë studim. Ato na ndihmuan të provojmë disa ide që kishim rreth aspekteve të veçanta të narkokriminalitetit dhe narkomanisë, rreth shkaqeve dhe faktorëve që shtojnë numrin e veprave penale dhe kontingjentin e kriminelëve në këtë fushë. Por ato evidencuan edhe disa situata dhe probleme shqetësuese që kërkojnë vëmendjen e organeve të zbatimit të ligjit dhe për shoqërinë.

Informacionet që morëm shfaqin interes sidomos kur është fjala për të hartuar dhe përsosur plan-veprimet parandaluese në mbrojtje të të miturve, të nxënësve të shkollave të mesme dhe të kategorive të marginalizuara të shoqërisë nga narkomania dhe nga pasojat e

saj. Bashkërendimi i punës në këtë drejtim i institucioneve të shtetit, të shkollave, institucioneve të ekzekutimit të dënimeve dhe qendrave të rehabilitimit të narkomanëve, por edhe shoqëria civile, OJQ, komuniteti i prindërve, familja etj. është një obligim i madh për suksesin e punës parandaluese dhe për luftimin e narkokriminalitetit.

KREU VII: VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT PENAL TË DISA VENDEVE NË FUSHËN E NARKOKRIMINALITETIT

Legjislacioni penal është i rëndësishëm jo vetëm si një tërësi rregullash, që përcaktojnë se kujt do t'i japim të drejtë dhe kë të dënojmë, por është i rëndësishëm për shumë arsye të tjera (Katz,1996:226). Çdo shtet u kushton vëmendje ligjeve, kodeve dhe akteve ligjore që rregullojnë çështjet e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe luftën kundër narkokriminalitetit dhe narkomanisë, që kanë marrë përmasa të mëdha dhe janë përhapur shumë në botën e sotme. Ato nuk mjaftohen vetëm me aderimin në Konventat dhe organizatat rajonale ose botërore, që merren me luftim e narkokriminalitetit, por punojnë edhe për përafrimin i legjislacionit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e drogave.

Në nivel ndërkombëtar dhe europian bëhen shumë përpjekje për të orientuar politikën penale të shteteve lidhur me drogat. Përafrimi i legjislacionit vendas me direktivat dhe me strategjinë e BE-së kundër narkotikëve është kërkesë e domosdoshme për secilin shtet, për rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit të agjencive kombëtare të zbatimit të ligjit me institucionet e dhe strukturat europiane dhe ndërkombëtare të angazhuara në parandalimin dhe luftimin e veprave penale të narkokriminalitetit.

Në legjislacionin penal të shteteve të veçanta ka mjaft dallime, ka mospërputhje me legjislacionin europian dhe ndërkombëtar, dallime që pengojnë bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimeve të përbashkëta. Kjo vihet re edhe në legjislacionin e dy vendeve tona, prandaj analiza krahasuese e ligjeve të vendeve të ndryshme, që kemi ndërmarrë në

këtë studim, mendojmë se shërben jo vetëm për të gjetur dhe për të marrë përvojat dhe modelet më të mira, por edhe për t'i përafruar me ato të vendeve të tjera.

Në këtë kapitull jemi fokusuar në analizën krahasuese të legjislacionit të fushës së narkokriminalitetit të disa shteteve të rajonit dhe të një shteti anëtar të BE-së. Përzgjedhja e tyre është bërë nisur nga dy kritere: *së pari*, fqinjësia dhe nevoja për forcimin e bashkëpunimit rajonal; *së dyti*, krijimi i një tabloje të qartë mbi legjislacionin e Gjermanisë, që është me traditë në shtetndërtim dhe me infrastrukturë ligjore mjaft të mirë, me legjislacion perfekt dhe me përvojë praktike efikase në kontrollin dhe në luftimin e narkokriminalitetit. Ky vështrim krahasues ndihmon të shohim mundësitë reale për përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe të legjislacionit tonë.

7.1. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Maqedonisë

Republika e Maqedonisë, sikurse vendet e tjera të Europës Juglindore, paraqet udhëkryqin e rrugës së tranzitimit dhe trafikimit të narkotikëve. Në këtë vend, megjithë përpjekjet e institucioneve, veprat penale me narkotikët janë në rritje. Maqedonia është pjesë e rrugës ballkanike. Ajo paraqet një vend tranzit të substancave narkotike nga vendi i origjinës për në vendin e destinacionit. Maqedonia mund të luajë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në trafikimin e kanabisit (UNDOC,2014:22-108).

Në Maqedoni, kanabisi dhe derivatet e tij vijnë nga Shqipëria, nëpërmjet Greqisë dhe Bullgarisë. Ndërsa në Shqipëri ose në Serbi vjen heroina, më shpesh nga Turqia, Bullgaria ose nga Greqia, kurse kokaina është trafikuar nga ajri nëpërmjet aeroportit të

Shkupit ose nga deti për në portet detare të Shqipërisë dhe të Bullgarisë. Ndërsa droga sintetike më shpesh vjen nga Bullgaria dhe Serbia.

Sipas Kodit penal të Maqedonisë, abuzimi me substanca narkotike dhe psikotrope ngre një seri pyetjesh mbi objektin e mbrojtjes, mbi personin juridik, subjektet, rastet, elementet themelore dhe veprimet e ekzekutimit të veprave penale.

Në të përcaktohen dy vepra penale të narkokriminalitetit, nenet 215 dhe 216 (Marjanoviç,1998:82-89). Por ato gjenden në kapitullin XXI të Kodit penal, në grupin e krimeve kundër shëndetit (Kambovski,2005:363). Neni 215 përcakton veprën penale të *“prodhimit të paautorizuar dhe lëshimit në treg të narkotikëve, të substancave psikotrope dhe të prekursorëve”*, ndërsa neni 216 parashikon *“mundësimin e përdorimit të narkotikëve dhe të prekursorëve”*. Të bie në sy, se sipas Kodit penal të Maqedonisë, nuk është i lejuar posedimi i lëndëve narkotike për përdorim personal.

Për veprën penale të nenit 215, përcaktohen disa forma të rënda, për të cilat parashikohen sanksione të rënda penale. Konkretisht, për prodhimin, përpunimin, posedimin, blerjen, shitjen, transportimin dhe tregtimin pa autorizim të substancave narkotike dhe psikotrope apo të prekursorëve, autori dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet (Kodi penal, neni 215, paragrafi 1). Kjo vepër penale konsiderohet e kryer, kur personi e bën vetëm me dashje.

Paragrafi 2 i nenit 215 parashikon: kur vepra penale e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, është kryer me substanca narkotike, substanca psikotrope apo prekursorë *në sasi të vogël* dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Në paragrafin 3 të nenit 215 përcaktohet: *kur veprën penale nga paragrafi 1 e kanë kryer disa persona, ose në qoftë se autori i kësaj vepre organizon një rrjet të rishitësve apo të ndërmjetësuesve, autori do të dënohet me burgim më së paku 5 vjet.*

Në paragrafin 4 inkriminohen veprimet e kundërligjshme që ndërlidhen me pajisje apo material ose substanca për të cilat ai e di se ato janë të destinuara për prodhimin e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve. Figurën e këtij krimi e përbëjnë prodhimi, prokurimi, ndërmjetësimi dhe dhënia në përdorim e sendeve të përmendura më lart.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë parashikon përjashtimin nga dënimi të autorëve të veprës penale në sasi të vogël të përcaktuar në paragrafin 2, të cilët zbulojnë krimin ose do të ndihmojnë në zbulimin e tij, por jo të organizatorit (neni 215, par.5).

Në paragrafin 6 të tij, ku përcaktohet: *“Nëse vepra penale e përcaktuar në këtë dispozitë, është kryer nga një person juridik, do të dënohet me gjobë”*.

Sikurse kodet penale të Shqipërisë dhe të Kosovës, edhe Kodi penal i Maqedonisë parashikon konfiskimin e substancave narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët, si dhe të pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme, që është përdorur për prodhimin, transferimin dhe shpërndarjen e tyre (neni 215, par.7).

Ndërsa në nenin 216, paragrafi 1, parashikohet: *Personi që nxit tjetrin të konsumojë narkotikë apo prekursorë, ose ofron narkotikë, substanca psikotrope dhe prekursorë t’i konsumojë ai vetë apo t’ia japë për konsum ndonjë personi tjetër, ose do të vërë në dispozicion hapësirën për konsumim të narkotikëve apo prekursorëve, ose në ndonjërin nga mënyrat e tjera ua bën të mundur të tjerëve të konsumojnë narkotikë a substanca psikotrope dhe prekursorë, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet*”. Në bazë të

kësaj dispozite, kjo vepër penale konsiderohet e kryer, kur bëhet vetëm me dashje. Mënyra e kryerjes përcaktohet me veprime alternative. Si formë më e rëndë e veprës penale konsiderohet kur kryhet ndaj një të mituri, ose ndaj disa personave, ose kur ka shkaktuar pasoja të rënda.

Në paragrafin 3 të nenit 216 parashikohet: *“Nëse krimi referuar në këtë nen është kryer nga personi juridik, personi juridik do t’i nënshtrohet një gjobe”*. Kurse në paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet: *“Droga narkotike, si dhe pasuritë e luajtshme ose pasuritë e paluajtshme të përdorura në prodhimin e tyre, transferimin dhe shpërndarjen, apo posaçërisht vënien në përdorim të tyre, duhet të konfiskohen”*.

Maqedonia ka aprovuar edhe disa ligje që lidhen me luftimin dhe parandalimin e narkokriminalitetit. Njëri ndër ta është ligji nr.07-3399/1, datë 1 gusht 2008, mbi kontrollin e narkotikëve dhe substancave psikotrope.

Nga praktika gjyqësore në bazë të këtij legjislacioni, në Maqedoni vihet re se në vitin 2013, Departamenti Kundër Krimit të Organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka referuar në Prokurorinë Speciale 85 kallëzime penale kundër 605 personave dhe numri më i madh i këtyre kallëzimeve ka të bëjë me veprën penale nga neni 215 i Kodit penal të Maqedonisë (EMCDDA,2014b:1-85).

7.2. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Malit të Zi

Kodin penal i Malit të Zi, në Kapitullin XXIV *“Aktet penale kundër shëndetit të njerëzve”* përcakton edhe veprat penale të narkokriminalitetit. Janë dy nene që lidhen

veprat penale me narkotikë: prodhimi i paautorizuar, mbajtja dhe trafikimi i narkotikëve (Neni 300) dhe lehtësimi i konsumimit të narkotikëve (Neni 301).

Vepra penale e përcaktuar në nenin 300, paragrafi 1, mund të kryhet me veprime alternative, si prodhimi i paautorizuar, procedimi, shitja, ofrimi për shitje, blerja me qëllim shitjeje; posedimi apo transportimi me qëllim shitjeje; ndërmjetësimi në shitje apo blerje dhe forma të tjera të paautorizuara të vënies së tyre në dispozicion. Për këto veprime, përcaktohet dënim me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Në paragrafin 2 përcaktohet forma më e rëndë e veprës penale: *“kushdo që pa autorizim, sjell (importon) në Mal të Zi substanca apo preparate të shpallura si narkotikë, duhet të dënohet me burgim nga dy deri në dymbëdhjetë vjet burg”*.

Paragrafi 3 i këtij neni përcakton: *“Nëse vepra penale e përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2, kryhen nga më tepër se një person, apo nëse autori ka organizuar rrjetin e rishitësve apo ndërmjetësuesve, atëherë autori duhet të dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet burg”*.

Paragrafi 4 përfshin dispozitat e uljes së dënimit apo lirimin nga dënimi në rastet *“kur kryerësi i veprës penale nga paragrafët 1 deri në 3 zbulon personin nga i cili është furnizuar me drogë, mund të lirohet nga dënimi”*.

Në paragrafin 5 përcaktohet: *“Kushdo që prodhon, siguron, posedon apo furnizon për përdorim të mëtutjeshëm mjetet, materialin apo substancat që njihen të jenë të destinuara për prodhim të drogave narkotike, do të dënohet me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet”*. Ky paragraf paraqet si vepra të veçanta veprat përgatitore, si dhënia e ndihmës.

Ndërsa paragrafi 6 përcakton që substancat narkotike dhe substancat që përdoren për prodhimin e tyre duhet të konfiskohen dhe të asgjësohen.

Në nenin 301, përcaktohen veprimet për lehtësimin e përdorimit të narkotikëve. Paragrafi 1 përcakton: *cilido që inkurajon personin tjetër të përdorë narkotikë apo bën furnizimin e personit me substanca narkotike për përdorim nga ai person apo ndonjë tjetër, a lejon hapësirën a objektin për marrje të narkotikëve apo në ndonjë tjetër mënyrë bën ofrimin e ndihmës personave për marrjen e substancave narkotike, duhet të dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet burgim*”.

Paragrafi 2 u referohet formave të caktuara të veprës penale, ku përfshihet rasti kur në veprimet e specifikuar në paragrafin 1 përfshihet ndonjë i mitur apo më shumë persona, ose kur veprimet kanë pasoja të rënda. Për këtë formë përcaktohet dënimi me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

Paragrafi 3 parasheh konfiskimin dhe asgjësimin e lëndëve narkotike.

Edhe në Malin e Zi përdorimi personal i drogës nuk sanksionohet penalisht. Brenda kornizave të përshkrimit të veprave penale të keqpërdorimit të drogave, Kodi Penal i Malit të Zi nuk i klasifikon drogat individualisht. Megjithatë, në praktikë, bëhet dallimi në kohëzgjatjen e dënimit, i cili varet nga lloji i drogave narkotike të përfshira në vepër. Kështu, për veprat penale që përfshijnë të njëjtën sasi marihuane, heroine apo kokaine kohëzgjatja e dënimit me burg është e ndryshme.

Sipas raportit vjetor të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi, institucionet e zbatimit të ligjit, gjatë vitit 2012 kanë konfiskuar 1.030.839,06 gramë substanca narkotike, prej tyre 1.022.347,60 gramë marihuanë, 8.045,63 gramë heroinë, 408.53 gramë kokainë etj. Kurse në vitin 2011 janë konfiskuar 809.114,07 gramë, prej tyre

804.260,26 gramë marihuanë, 3.768,34 gramë heroinë dhe 338,9 gramë kokainë (MUP,2013:49-51).

7.3. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Bosnjë dhe Hercegovinës

Sipas raporteve të ndryshme, "rruga e Ballkanit" për trafikimin e drogës me origjinë nga Azia kalon përmes territorit të Bosnjë dhe Hercegovinës për të përfunduar në Europën Perëndimore (CSS,2014:52-90). Kjo duhet parë edhe në kontekstin historik dhe gjeopolitik të këtij vendi, që ka kaluar nëpër një luftë të gjatë dhe shkatërruese, ka ekonomi të rrënuar dhe sistem jofunksional të sigurisë. Prandaj ndërhyrja ndërkombëtare për të vendosur paqe ishte shumë e nevojshme. Ajo rifitoi pavarësinë e saj në vitin 1992, pas shpërbërjes së ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Maljeviç,2005:277-290) dhe tani është një shtet i pavarur, sovran dhe demokratik, që shtrihet në Europën Juglindore, në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik (EMCDD,2014a,5-45). Në vitin 1995 palët në konflikt nënshkruan marrëveshjen e Dejtonit për paqe, e cila për pasojë kishte ndërtimin e strukturës shtetërore në dy etnitete, siç janë Federata e Bosnjës e Hercegovinës (FBeH) dhe Republika Serbe (RS), si dhe Qarkun e Bërçkos.

Në këto kushte, krime të tilla, si trafikimi i drogës, i armëve dhe trafikimi dhe kontrabanda e njerëzve duket se kanë qenë historikisht probeme kryesore për Bosnjë dhe Hercegovinën, por ende mbeten të pranishme sot, ndonëse llogaritë e hollësishme të natyrës së tyre të tanishme janë të kufizuara (Brady,2012:3-7). Prandaj, është i nevojshëm shqyrtimi i legjislacionit aktual dhe rregulloreve të tjera për parandalimin e abuzimit me

drogë narkotike në nivel shtetëror në Bosnjë e Hercegovinë, si dhe në entitetet e tjera dhe Qarkun e Bërçkos (EMCDDA,2014a:5-45).

Nisur nga fakti se trafikimi i substancave narkotike paraqet një sfidë të madhe sidomos për shtete me një ekonomi të dobët, siç është Bosnjë dhe Hercegovina, ky shtet, i vetëdijshëm për nevojën e një lufte gjithnjë e më komplekse kundër drogës, po zhvillon legjislacionin e saj dhe po rrit bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në këtë fushë.

Bazuar në organizimin shtetëror të Bosnjë dhe Hercegovinës, atje ka 4 Kode penale. Kodi penal i Bosnjë dhe Hercegovinës (*Službeni glasnik Bosne i Hercegovine, br.3/03*), në kreun XVII, ‘Krime kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare’, në nenin 195, përcakton veprën penale "*Trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike*" dhe bën kriminalizimin e disa formave të trafikimit që kanë karakter ndërkombëtar.

Paragrafi 1 i nenit 195 përcakton: "*Kushdo që, në mënyrë të paligjshme, bën shitjen dhe bartjen ndërkombëtare ose ofron në shitje, ose për shkak të shitjes, blen, posedon, mban, transporton ose kalon, ose ndërmjetëson në shitjen ose blerjen ndërkombëtare, dërgon porosi, importon, eksporton, ose në ndonjë mënyrë tjetër të palejuar vendos në tregun ndërkombëtar substancat ose preparatet që janë të deklaruar si droga narkotike, do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet*".

Ndërsa paragrafi 2 parashikon: "*Kush organizon një grup njerëzish me qëllim të kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni, ose kush bëhet anëtar i atij lloji grupi të organizuar, do të dënohet me burgim se paku tre vjet*".

Paragrafi 3 përcakton: "*kushdo që në transaksion ndërkombëtar, në mënyrë të paligjshme, bën, porosit, ndërmjetëson, ose jep për përdorim pajisjet, materialin ose*

substancën duke e ditur se do të përdoret për prodhimin e drogave narkotike, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet”.

Konfiskimi i drogave narkotike dhe i pajisjeve për prodhimin e tyre përcaktohet në paragrafin 4 të këtij neni.

Theksojmë se edhe kodet e tjera penale janë në veprim dhe përmbajnë dispozita lidhur me narkokriminalitetin. Kodi i Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës, në nenin 238 përcakton veprat penale *"Prodhimi dhe trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike"*, ndërsa neni 239 *"Posedimi dhe mundësimi i përdorimit të drogave"*.

Kodi Penal i Republikës Serbe (*Službeni glasnik RS, br.85/2005*), përcakton në nenin 224 veprën penale *"Prodhimi dhe trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike"* dhe në nenin 225 *"Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike"*.

Kurse Kodi penal i Qarkut të Bërçkos (*Službeni glasnik Brčko distrikta BiH, br.10/03*), përcakton në nenin 232, veprën penale *"Prodhimi dhe trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike"* dhe në nenin 233 *"Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike"*.

Sipas nenit 239 të Kodit penal të Federatës së Bosnjë e Hercegovinës (*Službenim novinama FBiH», br.36/03, 29. jula 2003*), posedimi i drogës është trajtuar si vepër penale në këtë entitet. Në RS dhe Qarkun e Bërçkos posedimi i drogës trajtohet si kundërvajtje (EMCDDA,2014a:5-45).

Një rol mjaft të rëndësishëm luan ligji ‘Mbi parandalimin dhe luftimin e abuzimit me narkotikë’ (*"Sg BiH", br.8, od 7. februaru 2006. godine*). Në nenin 1, të ligjit përcaktohet qëllimi i tij: luftimi dhe parandalimi i abuzimit me narkotikë në Bosnjë dhe Hercegovinë, në përputhje me konventat ndërkombëtare. Në nenin 3, paragrafin 1 të këtij ligji, përcaktohet drogë narkotike: çdo substancë me origjinë natyrore ose artificiale, që

është përfshirë në listën e drogave të aktit në bazë të konventave ndërkombëtare mbi kontrollin e drogës ose me vendim të autoriteteve kompetente në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ligji përmban një listë të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe bimëve, që mund të përdoren për të prodhuar drogë narkotike, dhe prekursorëve, të renditura në Tabelat I, II, III dhe IV:

- Tabela I "Substancat dhe bimët e ndaluara";
- Tabela II "Substancat dhe bimët nën kontroll të rreptë";
- Tabela III "Substancat dhe bimët nën kontroll"
- Tabela IV "Prekursorët, (EMCDDA,2014:5-45)

Gjatë vitit 2013, në Bosnjë e Hercegovinë, pati 1.343 vepra penale, që lidhen me trafikimin e drogës dhe përdorimin e paautorizuar të drogave narkotike, me 1.572 autorë... ndërsa në vitin 2012 ishin 1.452 raste, me 1.726 persona të përfshirë në to (EMCDDA,2014a:5-45).

7.4. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Serbisë

Serbia është një vend tranzit i trafikimit të narkotikëve, kryesisht, i heroinës me prejardhje nga Afganistani, si dhe i marihuanës, që përshkon rrugën në drejtim të Europës (US Dept of State,2015b:281). Serbia ka kornizat strategjike, legislative dhe institucionale në fushën e narkotikëve, Strategjinë kombëtare për luftimin e abuzimit me narkotikë për 2014–2021, bashkë me planin e veprimit. Këto pasohen nga strategji dhe veprime, që janë

duke u përgatitur. Politikat mbi narkotikët adresojnë kërkesat, furnizimin me narkotikë, si dhe zvogëlimin e dëmeve. Në kuadër të procesit të hyrjes në BE, korniza është rishikuar dhe ka filluar hartimi i akteve nënligjore mbi zvogëlimin e kërkesave për narkotikë (EMCDDA,2014c:9-21).

Kornizën ligjore në fushën e narkotikëve e përbëjnë: Kodi penal (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, nr.111/2009,121/2012,104/2013); Ligji mbi substancat e kontrolluara psikoaktive (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, nr.99/2010) dhe Ligji mbi substancat e përdorura për prodhimin ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, nr.107/05), (EMCDDA,2014c:9-21).

Kodi Penal parashikon tri vepra penale të lidhura me narkotikët: prodhimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve (Neni 246); posedimi i paautorizuar i narkotikëve (Neni 246a); dhe mundësimi i përdorimit të narkotikëve (Neni 247).

Paragrafi 1 i nenit 246, parashikon veprimet e kundërligjshme, që përbëjnë figurën e krimit të kësaj vepre penale dhe që janë: prodhimi, përpunimi shitja ose ofrimi për shitje, apo blerje, posedim (mbajtje) apo transportim për shitje, ose ndërmjetësim në shitjen apo blerje, ose në mënyrë të paligjshme vënien në qarkullim të substancave apo preparateve që janë të deklaruara si narkotikë.

Republika e Serbisë ka një diferencë në formulimin dhe hartimin e dispozitave ligjore që inkriminojnë veprat penale në fushën e narkotikëve. Personat që kryejnë veprën penale shitja e paautorizuar ose ofrimi i drogave narkotike për shitje, dënohen me tre deri në 12 vjet burgim. Sipas këtij ligji, kushdo që, në mënyrë të kundërligjshme, rrit fara lulëkuqe, kerp psikoaktiv ose bimë të tjera, që gjenerojnë ose përmbajnë droga narkotike, dënohet me burgim gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Meqë edhe Serbia është pjesë e “rrugës Ballkanike”, ligjvënësi inkriminon edhe veprimet e grupeve të krimit të organizuar dhe, për këtë, parashikohet që autori dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet (Kodi penal, neni 246, par.3).

Mundësia e faljes së dënimit parashikohet për personin që tregon nga kush i ka marrë narkotikët. Sipas të njëjtit ligj, një person që posedon një sasi të vogël droge për përdorim personal mund të lirohet ose të dënohet me burgim deri në tre vjet (EMCDA, 2014c:9-21).

Paragrafi i 5, i nenit 246, parashikon veprimet e kundërligjshme: prodhimin, marrjen, posedimin ose dhënien ose përdorimin e pajisjeve, materialeve dhe substancave që janë të njohura si të destinuara për prodhimin e narkotikëve. Parashikohet edhe konfiskimi i narkotikëve dhe mjeteve për prodhimin dhe përpunimin e tyre.

Vepra tjetër penale me narkotikë, parashikohet në nenin 246a. Në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet vetëm një veprim i kundërligjshëm, *posedimi* i një sasive më të vogël të substancës ose preparatit, që janë shpallur drogë narkotike, me qëllim përdorimin e saj. Përdorimi i paligjshëm i drogës nuk është i lejuar në asnjë vend. Ligjet mbulojnë të gjitha drogat ilegale dhe dënimet janë të njëjta për të gjitha substancat (EMCDDA, 2014c:9-21).

Si rrethanë lehtësuese parashikohen rastet kur subjekti bashkëpunon me autoritetet në zbulimin e personit apo të personave nga të cilët është furnizuar me narkotikë apo substanca psikotrope dhe kjo mund të sjellë faljen e dënimit të subjektit.

Paragrafi 1, i nenit 247, parashikon këto veprime të kundërligjshme: nxitja e personit tjetër për të marrë narkotikë, ose i jep atij narkotikë për përdorim, ose i vë në dispozicion vendin për marrje të lëndëve narkotike, ose i mundëson personit tjetër të marrë narkotikë. Forma më e rëndë e këtij krimi parashikohet në paragrafin 3, të këtij neni: nëse

kryerja e veprës penale referuar në paragrafin 1 ka rezultuar me vdekjen e një personi, autori do të dënohet me burgim.

Masa e sanksionit për këtë vepër është mjaft e lartë, deri në 15 vjet burg. Përveç kësaj, neni 83 (Trajtimi i detyrueshëm i varësisë nga droga) i Kodit penal, rregullon trajtimin e detyrueshëm për një shkelës, i cili ka kryer vepër penale për shkak të varësisë nga droga.

Pjesë e rëndësishme e infrastrukturës ligjore është edhe ligji ‘Për substancat e kontrolluara psikoaktive’, miratuar në vitin 2010. Ai rregullon kushtet për prodhimin dhe tregtimin e substancave të kontrolluara psikoaktive, kushtet dhe procedurat për dhënien e licencave për prodhim, eksport, import dhe tranzit të substancave të kontrolluara psikoaktive, kushtet për kultivimin, përpunimin dhe tregtimin e bimëve nga të cilat mund të merren substancat e kontrolluara psikoaktive etj. Ligj tjetër, që rregullon narkotikët është ligji ‘Mbi substancat e përdorura në prodhimin e paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope’, i cili është në përputhje me konventat përkatëse të OKB-së.

7.5. Veprat penale kundër narkokriminalitetit në Kodin penal të Gjermanisë

Që nga viti 1920, kur për herë të parë hyri në fuqi ‘Akti i narkotikëve’ në Gjermani, theksi kryesor i legjislacionit u vendos në zhvillimin e instrumenteve për kontrollimin e tregtisë me droga narkotike, sesa në masat për parandalimin, kujdesin, trajtimin dhe rehabilitimin (Michels, Stöver & Gerlach, 2007:2-30).

Akti i narkotikëve (*Betäubungsmittelgesetz, BtMG*) nuk është i vetmi burim që rregullon veprat penale kundër narkokriminalitetit në Gjermani.

Ky akt dhe rregulloret ligjore të miratuara në bazë të BtMG, siç është Rregullorja e rëndësishme për përshkrimin e narkotikëve (*Betäubungsmittelverschreibungs-Verordnung*), përmbajnë të gjitha rregullat e rëndësishme si të merren me këto substanca, duke marrë parasysh konventat e OKB-së për substancat që krijojnë varësi (EMCDDA, 2014d:5-65).

Substancat që konsiderohen si droga narkotike, sipas Aktit gjerman për narkotikë, janë të përfshira në tri listat, ku janë të gjitha substancat e përmendura në marrëveshjet ndërkombëtare mbi barnat narkotike:

- Lista I: narkotikët e palejueshëm për tregti dhe përdorim mjekësor (p.sh. MDMA, heroína, psilocybina).

- Lista II: narkotikët e lejueshëm për tregti dhe përdorim mjekësorë (p.sh. meprobamate, methamphetamine).

- Lista III: narkotikët e lejueshëm për tregti dhe përdorim mjekësorë (p.sh. amfetamine, codeine, dihydrocodeine, cocaine, metadone, morfinë dhe opium (EMCDDA, 2014d:5-65).

Akti i narkotikëve ka pësuar ndryshime. Karakteristikë e këtij akti, në krahasim me vendet e tjera, që kemi shtjelluar në parashtrimin e mësipërm, është se rregullon të gjitha procedurat e eksportit e të importit; licensimin e personave fizikë dhe juridikë për eksportim dhe importim të substancave narkotike, marrjen e licensës për eksportim, importim dhe kultivimin e substancave narkotike dhe të atyre psikotrope, monitorimin, si dhe sanksionet penale në lidhje me posedimin, kultivimin, importimin, eksportimin e substancave narkotike dhe psikotrope.

Në kapitullin VII të Aktit të narkotikëve përcaktohen shkeljet penale dhe administrative lidhur me substancat narkotike dhe psikotrope. Në paragrafin 1, të nenit 29,

ka 14 nënparagrafë, që inkriminojnë: kultivimin, furnizimin, shitjen, blerjen, tregtimin, importimin dhe eksportimin e narkotikëve, kryesisht, duke mos pasur licensë, ashtu siç e parasheh ky akt. Aty përcaktohet se për këto veprime: çdo person do të dënohet me burgim deri në 5 vjet apo me gjobë. Edhe për veprimet e përshkruara në nënparagrafët 1, 2, 5 dhe 6, siç janë tentimi për kryerjen e kësaj vepre penale, sanksionohet dënimi përkatës.

Nenin 29, paragrafi 1, përcakton veprimet e rënda dhe dënimin me burgim jo më pak se një vit. Rast serioz konsiderohet kur autori i veprës penale vepron për qëllime komerciale apo edhe në rastet kur rrezikohet shëndeti i njeriut.

Paragrafi 5 i nenit 29 të Aktit të narkotikëve përcakton: *“Gjykata mund të përmbahet në dënimin i autorit, nëse kultivon, prodhon, importon, eksporton, tranziton, merr apo posedon substanca narkotike në sasi të vogla për përdorim personal”*.

Kurse neni 29a, paragrafi 1, parashikon: *“çdokush do të dënohet me burgim jo më pak se një vit nëse: „Si person mbi moshën 21-vjeçare, në mënyrë të paautorizuar furnizon me substanca narkotike një person nën moshën 18-vjeçare, në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1, administron ato te një person apo i vendos në dispozicion për përdorim të menjëhershëm”*.

Paragrafi 2, i nenit 29a, parashikon që në raste më pak serioze, kohëzgjatja e dënimit me burgim duhet të jetë nga tre muaj deri në pesë vjet.

Neni 30 përcakton që: nëse vepra penale nga neni 29, paragrafi 1, nënparagrafi 1, kryhet nga një anëtar i bandës (grupit kriminal), grup i krijuar për të kryer vepra penale të tilla; nënparagrafi 2: vepron në baza komerciale; nënparagrafi 3: administron apo vë në dispozicion substanca narkotike për përdorim të menjëhershëm, duke shkaktuar vdekjen e

personit; dhe nënparagrafi 4: importon substanca narkotike në sasi jo të vogël, pa licensë, jepet dënim me burg jo më pak se 2 vjet.

Paragrafi 2, i nenit 30, përcakton që, në raste më pak serioze, dënimi me burgim duhet të jetë nga tre muaj deri në pesë vjet.

Në nenin 30a, të Aktit të narkotikëve, përcaktohen sanksione të rënda penale, për shkak të natyrës së rëndë të veprimeve që kryhen.

Paragrafin 1 i nenit 30a përcakton: *“kushdo që në mënyrë të paautorizuar kultivon, prodhon, tregton, importon, eksporton substanca narkotike në sasi që nuk janë të vogla, vepron si anëtar i një bande (grupi kriminal), grup i krijuar për të kryer vepra penale të tilla, duhet të dënohet jo më pak se pesë vjet burgim”*.

Rrethanat rënduese përfshijnë sasinë “e mëdha” të narkotikëve, nëse personi i rritur furnizon personin tjetër nën moshën 18-vjeçare me substanca narkotike; personi që ka “profesion” trafikimit të narkotikëve, apo është anëtar i një grupi, ose është kryer një vepër e rëndë në lidhje me narkotikët, siç janë edhe mbajtje e armës, me të cilën kanë mundur të shkaktohen lëndime të rënda trupore (German Narcotic Act, 1981, section 30a, paragraph 2).

Ligjvënësi ka përcaktuar disa mundësi në ligj për të shmangur ndjekjen penale, kur përfshihen sasi të vogla narkotikësh për përdorim personal. Me këtë rast, prokurori publik mund ta pushojë ndjekjen penale pa pëlqimin e gjykatës edhe në ato raste kur ai konsideron se fajësia e personit që kryen veprën penale është e shkallës së ulët apo nuk rrezikon interesin e përgjithshëm (German Narcotic Act, 1981, section 31a, paragraph 1).

Gjykata Federale e Drejtësisë në Gjermani ka marrë disa vendime lidhur me “sasinë e vogël”, varësisht llojit të substancave narkotike, duke përcaktuar sasinë maksimale që

mund të ketë një person në posedim për përdorim personal. Në prill të vitit 2007, Gjykata e Lartë Federale e Drejtësisë (BGH) ka dhënë një vendim për përcaktimin e "sasisë jo të vogël" të *buprenorfinës*. Me këtë, Gjykata e Lartë Federale e Drejtësisë shtoi edhe një vendim në serinë e vendimeve historike për "sasi jo të vogla", në të cilin trajtohet për herë të parë një substancë e përdorur si terapi e zëvendësimit, e cila, është paraqitur në tregun e paligjshëm, duke shkaktuar disa shqetësime (Winkler,2007:238-241).

Krahas veprave penale të përcaktuar në Aktin e narkotikëve, në nenin, 32 janë përcaktuar edhe kundërvajtjet administrative, që kanë të bëjnë kryesisht me mosrespektimin e pjesës për licensimin e personave, mbajtjen e shënimeve, zbatimin për licensim në blerjen, shitjen, eksportin dhe importin e narkotikëve, si dhe dërgimin e narkotikëve përmes postës. Për të gjitha këto kundërvajtje mund të jepet dënim me gjobë deri në 25.000 euro.

Ligje të tjera të rëndësishme, që përcaktojnë pasojat e mundshme ligjore të konsumit të substancave aktive psikologjike, janë edhe ato që lidhen me trafikun rrugor:

- Rregulloret mbi trafikun rrugor (*Straßenverkehrsordnung, StVO*), që specifikojnë sesi kryhen kontrollet e trafikut;

- Akti i trafikut rrugor (*Straßenverkehrsgesetz, StVG*), që përcakton kufijtë e alkoolit në gjak, si dhe konsideron ngarjen e automjeteve motorike nën ndikimin e substancave të tjera intoksikuese, si shkelje e lehtë;

- Kodi penal (*Strafgesetzbuch, StGB*), i cili cakton pasojat e konsumimit të alkoolit dhe substancave të tjera intoksikuese në trafikun rrugor dhe përfshirjen e kriminelëve të varur nga substancat në spitale psikiatrike të mjekësisë ligjore (*Maßregelvollzug*); dhe

- Rregullorja mbi patentën e shoferit (*Fahrerlaubnisverordnung, shk*), që merret me kushtet për drejtimin e automjetit, me dyshimet lidhur me kualifikimin për drejtimin e automjetit dhe me heqjen e patentave shoferëve, kur kanë varësi ndaj drogave narkotike (EMCDDA,2014d:5-65).

7.6. Aspekte krahasuese të legjislacionit penal të vendeve të përmendura më sipër

Bazuar në shtjellimin e legjislacionit penal që përcakton veprat penale në fushën e narkokriminalitetit në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Gjermani, në vijim bëjmë krahasimin e këtyre legjislacioneve, që të nxjerrim në pah pikat e përbashkëta dhe ato të veçanta, të normave penalo-juridike që ato kanë.

a) ***Klasifikimi i veprave penale në legjislacionin kombëtar:*** Shqipëria, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia, në legjislacionin e tyre kombëtar veprat penale në fushën e narkokriminalitetit i kanë të përcaktuara në kapitullin e veprave penale kundër shëndetit, përveç Gjermanisë, që ka akt të veçantë penal, ku përcaktohen veprat penale, si edhe Kosovës, ku veprat penale në fushën e narkotikëve përcaktohen në kapitull të veçantë.

b) ***Dallimi dhe ngjashmëritë në emërtimin e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit:*** Kosova dhe Shqipëria dallohen nga shtetet e tjera, pasi në legjislacionin e tyre kanë përcaktuar një numër të konsiderueshëm veprash penale në fushën e narkokriminalitetit (Kosova, 10 vepra penale, Shqipëria, 14 vepra penale dhe kundërvajtëse).

Mali i Zi dhe Maqedonia, në legjislacionin e tyre penal përcaktojnë nga dy vepra penale, ndërsa Serbia dhe Bosnjë dhe Hercegovina përcaktojnë nga 3 vepra penale në fushën e narkotikëve.

Gjermania, përveç veprave penale në Aktin për narkotikë, ka përcaktuar edhe procedurat administrative lidhur me importin, licensimin dhe eksportin e narkotikëve, si edhe veprat kundërvajtëse me narkotikë.

c) ***Dallimet dhe ngjashmëritë lidhur me veprimet e inkriminuara në veprat penale në fushën e narkokriminalitetit:*** Kosova dhe Shqipëria dallohen nga shtetet e tjera, pasi në legjislacionin penal kanë inkriminuar shumë veprime të kundërligjshme që lidhen me veprat penale në fushën e narkotikëve. Legjislacioni penal i Shqipërisë dhe i Kosovës kanë një ngjashmëri shumë të madhe me atë të Gjermanisë, në inkriminimin e veprimeve, por dallojnë në masën e sanksioneve penale. Ndërsa në Malin e Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Maqedoni figurat e veprave penale në fushën e narkotikëve janë po thuajse të ngjashme. Kjo lidhet me trashëgiminë nga legjislacioni penal të ish-Jugosllavisë ku kanë bërë pjesë. Ky legjislacion sot nuk përkon as me kohën, as me objektin mbrojtës.

Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia në figurat e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit inkriminojnë: “*prodhimin, përpunimin, posedimin, blerjen, shitjen, ofrimin për shitje, transportimin, tregtimin etj*”. Në legjislacionin penal të Malit të Zi, ndryshe nga shtetet e tjera, inkriminohet edhe veprimi i “*sjelljes (importimit) në Mal të Zi të substancave narkotike*”, që nuk përcaktohet në legjislacionet e disa vendeve të tjera.

Lidhur me parashikimin e veprimit pozitiv “*Ndihma në zbulimin e krimeve*”. konstatohet se Kosova dhe Shqipëria e kanë si dispozitë të veçantë, ndërsa në

legjislacionin penal të Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë, Bosnjë dhe Hercegovinës përcaktuar në një paragraf të veçantë.

Kosova ka përcaktuar edhe një dispozitë të re, *kompensimi ndaj zbatuesve të ligjit (neni 282)*, që legjislacionet penale të vendeve të tjera nuk e kanë si dispozitë të veçantë.

d) *Dallimet dhe ngjashmëritë lidhur me posedimin për përdorim personal:*

Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Bosnjë dhe Hercegovina, Serbia e inkriminojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimin e posedimit të drogave për përdorim personal. Në Kodin penal të Kosovës përcaktohet edhe një rrethanë lehtësuese të kryerja e kësaj veprë penale, kur ajo kryhet për herë të parë apo kur autori posedon më pak se tre (3) gramë substancë narkotike apo substancë psikotrope dënohet deri në një vit burg.

Një dallim tjetër lidhur me posedimin e drogave për përdorim personal paraqet legjislacioni penal i Gjermanisë. Në Aktin për narkotikë përcaktohet: *Gjykata mund të përmbahet nga dënimi apo prokurori mund ta pushojë ndjekjen ndaj i autorit*, nëse ai blen, posedon, kultivon etj., sasi të vogël droge për nevoja të përdorimit personal. Këtë mendim e ka përforcuar edhe një seri vendimesh të Gjykatave të larta të landeve të Gjermanisë, lidhur me përcaktimin e sasisë të vogël që lejohet për përdorim personal, varësisht prej llojit të narkotikëve. Edhe Shqipëria me dispozitë nuk inkriminon rastet kur kemi të bëjmë me përdorim vetjak dhe në doza të vogla të drogave.

e) *Dallimet dhe ngjashmëritë lidhur me përgjegjësinë penale për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit:* Përgjegjësia juridike e personave fizikë përcaktohet në Kodet penale të vendeve përkatëse, ndërsa në legjislacionin penal të Maqedonisë përcaktohet edhe përgjegjësia penale për personat juridikë që konsumojnë veprën penale nga neni 215,

paragrafi 6. Përgjegjësia e personave juridikë nuk është e përcaktuar në kuadër të dispozitave të Kodit penal të vendeve tjera.

f) Dallimet dhe ngjashmëritë në masën e sanksioneve penale: Lidhur me masën e sanksioneve penale, në përgjithësi, shtetet kanë ngjashmëri. Nëse merret për krahasim vepra penale e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bosnjë dhe Hercegovina përcaktojnë maksimumin e sanksionit penal në 10 vjet burgim, ndërsa te minimumi i dënimit këto shtete kanë dallime. Shqipëria si minimum të sanksionit ka përcaktuar 5 vjet burgim, Maqedonia 3 vjet, Mali i Zi 2 vjet dhe Bosnjë dhe Hercegovina 1 vit. Ndërsa Serbia, për këtë vepër penale ka përcaktuar minimumin e sanksionit penal, 3 vjet burg, ndërsa maksimumin 12 vjet. Kosova ka sanksionin penal më të ulët, 2 vjet burg, ndërsa maksimumin 8 vjet.

Gjermania bënë dallim te pesha e narkotikut me apo për të cilën autori apo autorët arrestohen për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve. Nëse sasia e narkotikëve është e madhe, autori mund të dënohet deri në 5 vjet burgim dhe me gjobë.

Nga sa u tha më lart, rezulton se Gjermania paraqet shembullin më të mirë të hartimit të infrastrukturës ligjore të një shteti, të krijimit dhe implementimit të procesit praktik të kontrollit dhe luftimit të narkokriminalitetit. Mendojmë se nga ky legjislacion mund të përfitohet shumë për përmirësimin e legjislacionit tonë dhe përafrimin e tij me atë të vendeve të BE-së.

KREU VIII: ASPEKTI LIGJOR NDËRKOMBËTAR I RREGULLIMIT TË NARKOKRIMINALITETIT

Ky kapitull paraqet një nga pjesët më të rëndësishme të punimit, pasi shërben për njohjen me kuadrin ligjor ndërkombëtar, në të cilin mbështeten bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimeve në planin ndërkombëtar të luftës për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit. Duke analizuar aktet dhe konventat ndërkombëtare që rregullojnë çështjen e parandalimit dhe luftimit të narkokriminalitetit, jo vetëm rrisim kulturën tonë juridike, por edhe aftësohemi për të qenë partner i barabartë dhe efikas me shtetet e tjera dhe njëkohësisht ndërgjegjësohemi për obligimin që kemi si shtet për implementimin e tyre përderisa i kemi nënshkruar dhe kemi aderuar në to. Në këtë kuptim e quajtmë t'i sjellim ato edhe në studimin tonë, për t'i pasur si pikë referimi.

8.1. Zanafilla e kontrollit ndërkombëtar të drogave dhe zhvillimi i konventave ndërkombëtare për kontrollimin e narkokriminalitetit

Nevoja për krijimin e mekanizmave ligjorë për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit është shfaqur qysh në shekullin XIX, ngaqë kjo dukuria po përhapej kudo në botë dhe po merrte përmasa të rrezikshme. Me lëvizjet e njerëzve nga një shtet në tjetrin dhe me migrimet nga vendet më pak të zhvilluara drejt atyre në zhvillim, në shekullin XIX nisi të përhapet opiumi, që krijoi probleme për mjaft shtete. Siç shkruan një historian: “Opiumi hyri në Kinë në kurrizin e një deveje dhe përfundoi duke thyer kurrizin e një kombi të tërë” (Hanes&Sanello,2013:2-3). Kështu lindi nevoja dhe ideja për

mekanizma të kontrollit dhe shekulli XIX njihet si shekulli kur filloi kontrolli ndërkombëtar i opiumit. Në fillim të këtij shekullit bota e civilizuar ndodhej në kaos total, për shkak të luftërave të ndryshme koloniale dhe shkeljes së të drejtave themelore të njeriut. Në ato rrethana abuzimi me substanca narkotike dhe psikotrope përfshiu gjithnjë e më shumë njerëz të moshave të ndryshme dhe pasojat ishin të rënda. Kjo kërkonte kundërpërgjigje dhe këtë hap e ndërmorën si fillim shtetet e fuqishme, sigurisht jo në këto forma dhe përmasa që kemi sot. Prandaj themi se, edhe pse drogat kanë një kohë të gjatë që janë në përdorim, kontrolli i tyre, si në nivel vendi, edhe në atë ndërkombëtar, është një fushë e re, që ka filluar në fazë më të vonshme. Siç shprehet Sinha, në kontrast me historinë e gjatë të përdorimit të drogave të ndryshme në mbarë botën, nga kultura të shumta, kontrolli ndërkombëtar i prodhimit, i shpërndarjes dhe i përdorimit të drogave është relativisht i ri, një fenomen i shekullit XX, nxitur dukshëm nga rritja shqetësuese e abuzimit me drogën dhe varësinë (Sinha,2001:1-37).

Ngaqë veprimtaria e përdorimit të narkotikëve dhe e trafikimit po merrte karakter ndërkombëtar, sepse nuk po haste pengesa në kufi, kontrolli i saj nuk mund të bëhej si duhej nga shtete të veçanta, por kërkonte bashkëpunim midis tyre. Për këtë duheshin mekanizma ligjorë që të rregullonin këtë bashkëpunim.

Kështu, në vitin 1907 kemi "marrëveshjen dhjetëvjeçare", që nga avokatët shihej në parim si "traktat" i suksesshëm i opiumit dhe u dha theks për 60 vitet e ardhshme negociatave të kontrollit ndërkombëtar të drogave (McAllister,2000:24-27).

Mirëpo, me përmasat në rritje të përdorimit dhe trafikimit të substancave narkotike, po veshin në pikëpyetje masat parandaluese, ndëshkuese dhe ligjore të vendeve të ndryshme për luftimin e kësaj dukurie. Ndaj në vitin 1909, u mbajt Konferenca e parë

ndërkombëtare për rregullimin e çështjeve me narkotikët. Në të nuk u arrit ndonjë marrëveshje, prandaj në vitin 1910, në Shanghai, u themelua Komisioni Ndërkombëtar për Opiumin. Ky është akti i parë normativ në nivel ndërkombëtar, që i dedikohet luftimit të narkokriminalitetit. Ky pasohet nga Konventa e Hagës, që u miratua më 1912, si konventa e parë, që parashikonte kontrollin ndaj opiumit dhe narkotikëve dhe mundësoi kufizimin e përdorimit të narkotikëve për nevoja mjekësore dhe shkencore. Më pas u miratuan edhe 11 konventa dhe akte ndërkombëtare të tjera, si:

a. Marrëveshja mbi fabrikimin e opiumit dhe tregtinë e brendshme, e nënshkruar në Gjenevë, më 11 shkurt 1925;

b. Konventa ndërkombëtare për opiumin, e nënshkruar në Gjenevë, më 19 shkurt 1925;

c. Konventa mbi kufizimin e prodhimit dhe rregullimin e klasifikimin e narkotikëve dehës, e nënshkruar më 13 korrik 1931;

d. Marrëveshja mbi kontrollin e konsumit të opiumit për pirje, në Lindjen e Largët, e nënshkruar në Bangkok, më 27 nëntor 1931;

e. Konventa për parandalimin e tregtisë së palejuar të drogave të rrezikshme, e nënshkruar, më 26 qershor 1936, në Gjenevë;

f. Procesverbalet protokollare, të nënshkruara në Lejk Saksesu, më 11 dhjetor 1946, ku kryhen ndërrime dhe plotësime të marrëveshjeve, konventave dhe procesverbaleve protokollare për drogat dehëse, të lidhura në Hagë, më 23 janar 1912; në Gjenevë më 11 dhe 19 shkurt 1925 dhe 13 korrik 1931; në Bangkok, më 27 nëntor 1931, si dhe në Gjenevë më 26 qershor 1936;

g. Procesverballi protokollar, i nënshkruar në Paris, më 4 nëntor 1948, me të cilin u lanë nën kontroll ndërkombëtar disa droga, të cilat nuk përmendeshin në Konventat për kufizimin, fabrikimin dhe rregullimin e ndarjes së drogave dehëse, të cilat më 13 qershor 1931 u ndryshuan dhe u plotësuan në procesverbalin protokollar, të nënshkruar në Lejk Saksesu, më 11 dhjetor 1946;

h. Procesverballi protokollar mbi kufizimin dhe rregullimin e rritjes së lulëkuqes, prodhimit, mbi tregtinë ndërkombëtare me shumicë dhe pakicë të opiumit, të nënshkruar në Nju-Jork, më 23 qershor 1953;

i. Konventa unike për drogat dehëse, e nënshkruar në Nju-Jork, më 30 mars 1961;

j. Konventa për substancat psikotrope, e nënshkruar në Vjenë, më 21 shkurt 1972 dhe

k. Procesverballi protokollar mbi ndryshimin e Konventës unike për drogat dehëse, e vitit 1961, e nënshkruar në Gjenevë, më 25 shkurt 1972 (Bicaj, 2010:18-155).

8.2. Përshkrim i shkurtër i Konventave dhe akteve të para ndërkombëtare

Konferenca e Shangait

Sikurse u theksua edhe më lart, në shkurt të vitit 1909, Komisioni Ndërkombëtar i Opiumit u takua në Shanghai, por për shkak se pjesëmarrësit nuk kishin kompetencat e nevojshme të përfundojnë traktatin, rezultati ishte thjesht gjetja e fakteve dhe e një grupi jodetyrues rekomandimesh (Sinha, 2001:1-37). Problemet kineze lidhur me opiumin ishin në fokusin kryesor të konferencës. Mendohej se kur çdo vend e rregullon mirë në shkallë

kombëtare problemit në fjalë, me rregullimin në nivel botërore ky problem do të reduktohej dhe kontrollimi i tij do të jetë më i lehtë.

Konventa ndërkombëtare e Hagës për opiumin

12 vende ranë dakord të takohen në Hagë më 1 dhjetor 1911 për të hartuar traktatin. (Sinha,2001:1-37). Ai pati si objektiv kontrollin e drogave, vënien e tyre nën kontrollin ndërkombëtar. Konventa e miratuar fokusohet në prodhimin dhe shpërndarjen e opiumit, edhe pse kishte insistime për ndryshimin e këtij qëllimi. Ajo trajton përpunimin, përgatitjen, kufizimin e përdorimit të opiumit për qëllime mjekësore dhe shkencore, importin dhe eksportin, licensimin, kontrollin e drogave sintetike dhe respektimin e këtyre çështjeve. Në të parashikoheshin edhe masa parandaluese.

Konventa hyri në fuqi më 1920, me vonesë, për shkak të Luftës së Parë Botërore.

Konventa e Gjenevës për opiumin

Konventa e parë e Gjenevës, e vitit 1925, u përqendrua në nocionin e prodhimit të opiumit. Nënshkruesve u lejohej shitja e opiumit vetëm nëpërmjet rrugëve qeveritare dhe për t'i dhënë fund tregtisë brenda 15 vjetësh (Sinha,2001:1-37).

Konferenca e dytë e Gjenevës u fokusua në kontrollin ndërkombëtar të drogës, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e kanabisit, heroinës, morfinës dhe kokainës në tregtinë ndërkombëtare, duke kufizuar sasinë që shtetet mund të importonin legalisht.

Procesverbali protokollar i Lejk Sakseasu

Procesverbalet protokollare të vitit 1946 kishin për qëllim realizimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të të gjitha traktateve ekzistuese ndërkombëtare të kontrollit të drogave, përfshirë ndryshimin dhe plotësimin e konventave dhe marrëveshje që kishin si objekt të tyre drogat dehëse.

Protokolli i Parisit

Sipas Protokollit të Parisit, Bankës Botërore të Shëndetësisë iu dha autoriteti të vendosë lidhur me seleksionimin se cilat substanca duhet lënë nën kontrollin ndërkombëtar. Po ashtu, përfshihen edhe drogat që nuk janë listuar në traktate të tjera.

Protokolli i Nju-Jorkut për opiumin

Sipas këtij Protokolli, të nënshkruar më 23 qershor 1953, palët detyrohen për përdorimin e opiumit vetëm për qëllime mjekësore dhe shkencore. Lulëkuqja është konsideruar si prodhim dhe distribuim i opiumit. Kufizimi i opiumit ishte bërë vetëm në shtatë shtete, duke përcaktuar se importimi dhe eksportimi mund të bëhej vetëm në vendet përkatëse të përcaktuara paraprakisht. Protokolli i viti 1953, për opiumin, përbën dispozitat më të rrepta ndërkombëtare të kontrollit të drogës, por kurrë nuk e fitoi përkrahjen për të cilën kishte shpresuar Anslinger (Sinha,2001:1-37).

Aktualisht, korniza ligjore dhe administrative për kontrollin ndërkombëtar të drogës paraqitet në tri konventa ndërkombëtare, të negociuara nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Ato janë:

- Konventa Unike mbi drogat narkotike, 1961 (UN, Convention on Narcotic Drugs, 1961), (Konventa Unike) dhe Protokollin i ndryshimit të Konventës unike mbi drogat narkotike, 1961 (Protokollin i Konventës Unike);
- Konventa mbi substancat psikotrope (UN, Convention on psychotropic substances), (Konventa psikotrope);
- Konventa kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope (UN, Convention against illicit traffic in narcotic drugs and psychotropic substances 1988), (Konventa e Trafikimit).

8.3. Konventa Unike mbi drogat narkotike

Nga 24 janari deri më 25 mars 1961 u mbledh në selinë e Kombeve të Bashkuara Konferenca e Kombeve të Bashkuara për miratimin e Konventës unike mbi drogat narkotike (UN, Single Convention on Narcotic Drugs, 1961, article 1).

Duke pasur parasysh rëndësinë e konventës dhe faktin se ajo ishte diçka e re, u ftuan në Konferencë edhe përfaqësues të agjencive të ndryshme, organizata joqeveritare, të interesuara për rregullimin e kontrollit të drogave narkotike.

Konventa unike parashikon disa zgjidhje, si asistencë teknike në fushën e kontrollit të narkotikëve, trajtimi i personave me varësi nga droga, trafikantët e paligjshëm, përbërja e

komisionit mbi drogat narkotike, mekanizmi i kontrollit ndërkombëtar. Sipas Konventës, këto janë disa nga zgjidhjet që ngërthejnë mënyra të arritjes së qëllimit, si përkujdesja spitalore, implementimi i projekteve dhe programeve të ndryshme referuar kësaj fushe etj.

Në Konventë theksohet se palët do të marrin masa legislative dhe administrative, që mund të jenë të nevojshme:

a) Për të dhënë efekt dhe për përkujdesjen ndaj dispozitave të kësaj Konvente brenda territoreve të tyre;

b) Të bashkëpunojnë me shtetet e tjera në zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente;

c) Për të kufizuar ekskluzivisht për qëllime mjekësore dhe shkencore prodhimin, eksportin, importin, shpërndarjen, tregtinë, përdorimin dhe zotërimin e drogave (UN, Single Convention on narcotic drugs, 1961, article 5).

Konventa ka dy qëllime: detyron palët për hartimin e legjislacionit kombëtar për respektimin e Konventës; respektimi i detyrimeve që ka çdo shtet në raport me shtetet e tjera.

Konventa unike parashikon Komisionin mbi Drogat Narkotike të Këshillit Ekonomik e Social dhe Bordin e Kontrollit Ndërkombëtar të Narkotikëve, të cilëve shtetet u besojnë punën lidhur me drogat narkotike. Detyrat e komisionit lidhen kryesisht me vetëdijesimin dhe respektimin e Konventës. Bordi përbëhet nga 13 anëtarë, që zgjidhen nga Këshilli. Anëtarët e Bordit duhet të jenë persona, që meritojnë besimin e përgjithshëm për kompetencat dhe paanshmërinë e tyre, si dhe që nuk kanë konflikt interesi.

Mbi 100 barna narkotike janë nën kontroll sipas Konventës. Këtu përfshihen, kryesisht, produkte me bazë bimore, si opiumi, derivatet e opiumit (morfina, heroina,

kodeina), kanabisi, coca apo kokaina, por edhe substanca sintetike, përfshirë metadon dhe petidinë (Sinha,2001:1-37).

Protokolli i Konventës unike forcon kontrollet në prodhimin, përdorimin dhe shpërndarjen e narkotikëve të paligjshme. Gjithashtu, ai përmban dispozita mbi trajtimin dhe rehabilitimin për abuzim të drogës dhe varësisë (Sinha,2001:1-37).

Vlen të theksohet se edhe Shqipëria është ndër vendet nënshkruese të saj.

8.4. Konventa mbi substancat psikotrope

Kjo Konventë u miratua në Konferencën e Kombeve të Bashkuara, që u mbajt në Vjenë nga 11 janari deri më 21 shkurt 1971 (UN, Convention on psychotropic substances, 1971:1). Ajo shtrin kontrollin ndërkombëtar mbi substancat sintetike psikotrope: stimulantët, si: amfetamina, depresantët, barbituratet dhe haluçinogjenët (mescaline dhe LSD) (*Diethylamide acid Lysergic*), (Sinha,2001:1-37).

Në bazë të kësaj Konvente, vendet përfaqësuese obligohen drejtpërdrejt në kontrollin dhe rregullimin e eksportit, importit, tregtisë dhe fabrikimit të substancave psikotrope. Konventa përcakton procedurën që ndiqet kur konstatohet se një substancë nuk është ende nën kontrollin ndërkombëtar. Nëse një palë ose OBSH-ja ka një informacion të tillë dhe mendohet të kërkohet shtimi i kësaj substance në ndonjërin nga listat e kësaj Konvente, atëherë njoftohet Sekretari i Përgjithshëm, që të sigurohet informacioni mbështetur me këtë njoftim (UN, Convention on psychotropic substances,1971,article 2, paragraph 1). Ai transmeton njoftimin dhe çdo informacion që e konsideron të rëndësishëm

për palët dhe komisionin, edhe kur njoftimi është bërë nga palët ose OBSH-ja (UN, Convention on psychotropic substances, 1971, article 2, paragraph 2).

Nga analiza e përmbajtjes së Konventës mbi substancat psikotrope del qartë qëllimi i saj për të rregulluar importin dhe eksportin e kontrolluar dhe kufizimin për përdorim personal dhe sipas nevojave personale, që të mos ketë abuzime me përdorimin këtyre substancave. Kjo Konventë bën limitimin e përdorimit të substancave psikotrope për qëllime mjekësore dhe shkencore dhe secila palë i nënshtrohet kufizimit në këtë aspekt.

Palët duhet t'i japin Sekretarit të Përgjithshëm informacion, kur Komisioni mund ta kërkojë të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij dhe, në veçanti, t'i dërgojnë atij raportin vjetor lidhur me funksionimin e Konventave në territoret e tyre, duke përfshirë informacion për: a) ndryshimet e rëndësishme në ligjet dhe rregullat e tyre lidhur me substancat psikotrope; dhe b) zhvillimet e rëndësishme në abuzimin dhe trafikimin e paligjshëm të substancave psikotrope brenda territoreve të tyre (UN, Convention on psychotropic substances, 1971, article 16, paragraph 1).

Kur u referohemi masave të ndërmarra dhe rrugëve ndërkombëtare, që përdor një vend për transport, duhet pasur parasysh gjithmonë lejimi i substancave psikotrope për nevoja personale, emergjente dhe ato të ndihmës së parë, që, sipas Konventës, janë të lejueshme në transportin ndërkombëtar, duke iu referuar mjeteve të transportit.

Secila palë, pjesë e Konventës, duhet t'u referohet hierarkisë legislative, referuar Konventës ndërkombëtare dhe respektimit të dispozitave të saj. Në të kundërtën, në rast të mosrespektimit të dispozitave të Konventës, secila palë përballlet me sanksione.

Organi ndërkombëtar, i përcaktuar nga Konventa për kryerjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të saj, është: Komisioni për substancat narkotike i Këshillit Ekonomiko-Social të

Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Komisioni i Këshillit për Narkotikë) (UN, Convention on psychotropic substances, 1971, article 1-b).

8.5. Konventa kundër trafikut të paligjshëm të drogave dhe substancave psikotrope

Kjo Konventë, e vitit 1988, plotëson dy konventat e tjera për goditjen e trafikut të paligjshëm të drogave nën kontrollin ndërkombëtar. Ajo synon përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatimin e ligjit dhe për forcimin e legjislacionit penal të secilit shtet. Konventa përmban dispozita mbi pastrimin e parave, ngrirjen financiare dhe të dhënave komerciale, ekstradimin e trafikantëve të drogës, transferimin e procedimit penal, ndihmën ligjore të ndërsjellë dhe monitorimin e rreptë të kimikateve të përdorura shpesh në prodhimin e paligjshëm të drogave (Sinha, 2001:1-37).

Ajo parashikon detyrimin për shtetet që e kanë ratifikuar atë, t'i japin rëndësi, së pari, legjislacionit të brendshëm, duke u bazuar në raportet që krijohen ndërmjet shteteve, në luftën kundër kriminalitetit të ndërlidhur me trafikimin e narkotikëve, i cili prek rrugë dhe vende të ndryshme. Edhe sipas kësaj Konvente, palët kanë detyrime ligjore për hartimin e legjislacionit përkatës për respektimin e Konventës dhe obligimeve të tjera, të cilave shtetet duhen t'u përmbahen. Konventa parashikon sanksione për shtetin që nuk i respekton ato.

Konventa përmban edhe rregulla, sipas të cilave shtetet palë duhet të marrin masa lidhur me juridiksionin e saj, me sistemin e ligjor, me ekstradimin, krijimin e komisioneve, me krijimin e mundësive të ndryshme për arritjen e qëllimit të Konventës, me konfiskimin,

adoptimin e masave rreth të ardhurave që krijohen nga konfiskimet e produkteve të paligjshme etj.

Sipas saj, ekstradimi duhet t'u nënshtrohet kushteve të parashikuara nga ligji i palës së kërkuar ose nga traktatet e zbatueshme të ekstradimit, përfshirë arsyet mbi të cilat pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin (UN,Convention against illicit traffic in narcotic drugs and psychotropic substances,1988,article 6,paragraph, 2).

Veprat penale të detyrueshme përcaktohen në nenin 3, paragrafi 1 dhe kanë këtë përmbajtje:

a) Prodhimin, shpërndarjen apo shitjen e çdo droge narkotike ose substance psikotrope në kundërshtim me dispozitat e Konventës unike apo të Konventës mbi substancat psikotrope;

b) Kultivimin e hashashit, të bimës së kokainës apo të bimës kanabis në kundërshtim me konventat e mëparshme;

c) Posedimin apo blerjen e ndonjë droge narkotike ose substance psikotrope për qëllim trafikimi të paligjshëm;

d) Prodhimin, transportin ose shpërndarjen e materialeve, pajisjeve dhe substancave me qëllim kultivimin, prodhimin ose fabrikimin e paligjshëm të drogave narkotike apo substancave psikotrope;

e) Organizimin, menaxhimin ose financimin e ndonjëres prej veprave të mësipërme (Stewart,1990:392 & Gilmore,1991:5).

Konventa kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope në thellësinë e saj buron nga të drejtat e njeriut, bazuar në faktin e përdorimit personal dhe

pasojat që shkakton, ndaj parashikohet edhe në tri Konventat që përmendin të drejtat e njeriut dhe obligojnë palët për respektimin e të drejtave të njeriut.

Konventa kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope i kushton rëndësi eksportit të ligjshëm të substancave narkotike, ku duhet rregulluar, së pari, dokumentacioni i nevojshëm i eksportit të këtyre substancave, përfshirë faturat, doganat, taksat, për të cilat secila palë ka të drejtë të kërkojë rregullsi dokumentacioni dhe procedure, kur dihet se një procedurë e tillë vlen edhe për eksporte të mallrave të ndryshme, jo vetëm përjashtimisht për substanca narkotike.

8.6. Aderimi i Republikës së Shqipërisë në konventat ndërkombëtare

Shumë instrumente të Kombeve të Bashkuara, të Këshillit të Europës dhe të Bashkimit Europian kanë rëndësi për legjislacionin penal (Hysi,2008:282). Duke iu referuar hierarkisë ligjore, të përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 116 dhe 122), konventat e ratifikuara janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik, që renditen menjëherë pas Kushtetutës dhe kanë epërsi mbi ligjin, vendin, që nuk pajtohet me të. Republika e Shqipërisë ka aderuar në konventa ndërkombëtare të substancave narkotike me ligjet:

Ligji nr.8722, datë 26.12.2000, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope", shpallur me dekretin nr.2857, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, faqe 2156.

Ligji nr.8723, datë 26.12.2000, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën unike mbi drogat narkotike, e ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 për ndryshimin e Konventës unike mbi drogat narkotike,1961", shpallur me dekretin nr.2858, datë 5.1.2001, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare,nr.50,faqe 2190.

Ligjin nr.8965, datë 7.11.2002, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për substancat psikotrope", shpallur me dekretin nr.3582, datë 4.12.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

Konventat dhe aktet e tjera ndërkombëtare, të përmendura më sipër, kanë pasur efektet e tyre dhe kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit të luftës kundër narkokriminalitetit në nivel ndërkombëtar dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë luftë. Ratifikimi dhe aderimi në to i Shqipërisë, ka bërë që ajo të paraqitet si partnere serioze në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bashkë me Kosovën, kanë dhënë kontributin e tyre në arritjen e rezultateve në luftën kundër narkokriminalitetit brenda vendit, por edhe në operacionet e përbashkëta me shtetet e tjera, në zbatim të Konventave dhe akteve të tjera ligjore ndërkombëtare.

KREU IX: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

9.1. Përfundime

Në bazë të këtij hulumtimi shkencor kemi arritur në këto përfundime, lidhur me narkokriminalitetin dhe luftën kundër tij në Kosovë dhe në Shqipëri.

- Gadishulli Ballkanik, ku bëjnë pjesë Shqipëria dhe Kosova, paraqet një portë hyrëse të krimit të organizuar veçanërisht në fushën e trafikimit të narkotikëve për në Europën Perëndimore. Krimi i organizuar në këtë rajon paraqet rrezik për individin dhe shoqërinë e shteteve të rajonit, por edhe problematikën politike në vende të caktuara.

- Pas vitit 1990 Shqipëria është kthyer jo vetëm në një vend tranziti për trafikimin e narkotikëve, por edhe në një vend origjine, konkretisht, të kanabisit bimor. Ajo është bërë një nga eksportuesit më të mëdhenj të kanabisit. Narkokriminaliteti dhe narkomania kanë ardhur në rritje. Ndërsa Kosova ka një histori më të hershme të narkokriminalitetit dhe narkomanisë, pasi edhe para viteve '90 ka pasur përdorues drogash. Por sidomos pas luftës narkokriminalitetit është rritur. Kosova konsiderohet vend tranzitimi të drogës.

- Shqipëria dhe Kosova kanë legjislacion bashkëkohor për luftimin e narkokriminalitetit, në përputhje me konventat ndërkombëtare lidhur me drogat dhe substancat psikotrope. Por në to ka edhe zbrazësi juridiko-penale, sidomos në inkriminimin e veprimeve që kryhen përmes internetit në fushën e narkokriminalitetit etj. Prandaj dhe kërkohen plotësime dhe ndryshime, sidomos në Kodet Penale dhe në ligjet e tjera që rregullojnë luftën kundër narkokriminalitetit. Ndryshimet dhe përmirësimet e legjislacionit

janë jo vetëm një proces normal në zhvillimin e përsosjen e tij, por edhe një domosdoshmëri e kohës, përderisa veprimtaria e grupeve të krimit të organizuar me narkotikë është në rritje.

- Ndryshimet e realizuara në legjislacion nxjerrin para juristëve, ekspertëve të fushës, pedagogëve dhe studiuesve domosdoshmërinë e analizimit dhe të shqyrtimit të detajuar, në rrafshin teorik, juridiko-penal, kriminologjik dhe praktik të veprave penale të narkokriminalitetit të parashikuara në Kodin penal. Analizat e anëve objektive dhe subjektive të secilës figurë krimi janë të nevojshme në funksion të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore lidhur me to.

- Në Shqipëri ka ligje të mira, por drejtësia vuan, ngaqë këto ligje nuk zbatohen si duhet, ose zbatohen të shtrembëruara, ose sipas interesave të politikës, duke cenuar, kështu, në mënyrë flagrante dhënien e drejtësisë. I tillë është perceptimi dominues i publikut të gjerë për organet shqiptare të drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit, por edhe i ndërkombëtarëve.

- Në kushtet, kur në Shqipëri dhe në Kosovë përballemi me përhapjen e kriminalitetit, zbulimi i shkaqeve të kësaj dukurie përbën problemin më të rëndësishëm dhe të mprehtë për shkencën e kriminologjisë. Kërkohet trajtim më cilësor dhe në vazhdimësi i aspektit kriminologjik, me qëllim përpilimin dhe zbatimin e masave dhe të planeve parandaluese apo represive.

- Narkokriminaliteti nuk mund të parandalohet e të luftohet si duhet pa njohur karakteristikat personale të autorëve të përfshirë në këtë lloj krimi. Aspektet ekonomike, etnike e familjare, ndikojnë në përfshirjen e personave në rrugën e narkokriminalitetit, por, ato ndërlidhen edhe me aspekte psiko-sociale të individit, që janë shtytës të fortë për të kryer vepra penale dhe që të bëhen pjesë të grupeve të krimit të organizuar në fushën e

drogave. Ndaj dhe duhen studiuar mirë nga sektorët studimorë e shkencorë të strukturave të zbatimit të ligjit.

- Mbetet detyrë e ditës shikimi i legjislacionit që lidhet me narkokriminalitetin në plan krahasues me legjislacionin e vendeve të rajonit e më gjerë, për të shtuar njohuritë juridiko-penale, për të përfituar nga përvojat e mira, si dhe për të mundësuar përafrimin e legjislacionit tonë me atë të vendeve të Europës Perëndimore.

- Ndër faktorët që kanë ndikuar shumë në rritjen e përhapjen e dukurisë së narkokriminalitetit janë varfëria ekonomike, papunësia, prirja për t'u pasuruar shpejt, por edhe fenomene të tilla, si lëvizja e lirë, mungesa e rendit dhe moskontrollimi i kufijve. Rol të madh ka luajtur edhe urbanizmi në Shqipëri dhe në Kosovë, me zhvillimin e trafikut, ndërtimet, rritjen dhe mbipopullimin e qyteteve, si edhe me urbanizmin social. Dukuria masive e zhvendosjes demografike kaotike të popullsisë nga fshati në qytet, nga veriu në jug e anasjelltas, bënë që shumë persona të merreshin me kultivimin dhe prodhimin e e kanabisit, me trafikimin e drogave, me shitjen dhe shpërndarjen e tyre.

- Numri më i madh i veprave penale të narkokriminalitetit dhe i përdoruesve të drogave gjenden në zonat urbane, në qytetet e mëdha si Prishtina, Tirana, Fieri, Durrësi, Vlora etj. Pjesa dërmuese e përdoruesve të drogës, janë adoleshentët dhe të rinjtë, që frekuentojnë masivisht lokale dhe klube nate, ku shërbehen hapur dhe në mënyrë të fshehtë, bashkë me pijet alkoolike, edhe substanca narkotike. Në qytete përdorimi i drogave ka gjetur terren edhe në institucionet e arsimit, si në shkolla, konvikte etj., ku sistemohen dhe mësojnë të mitur dhe adoleshentë, që bien pre e substancave narkotike e psikotrope.

- Nga hulumtimi shkencor përmes anketimit me pyetësor, del se nxënësit e shkollave të mesme në Shqipëri dhe Kosovë, përdorin drogë edhe në mjediset e shkollës; se

në shkolla vijnë persona që u ofrojnë dhe u shesin nxënësve droga; se nxënësit joshin njëritjetrin për ta provuar drogën; se shumë prej tyre marrin drogë në lokale dhe klube nate, që i frekuentojnë shpesh. Nxënësit i dinë këto gjëra, por nuk reagojnë kundër tyre, nuk i denoncojnë, pra, nuk veprojnë në parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit. Ata flasin për mangësitë e drejtuesve dhe të mësuesve në punën edukative me nxënësit, nuk mbahen ligjërata dhe nuk zhvillohen veprimtari të tjera për rreziqet e drogës, për të shmangur futjen e drogave në oborrin dhe në klasat e shkollës dhe përdorimin e tyre nga nxënësit. Këto konstatime, që u morën nga vetë nxënësit e intervistuar, provuan se jo vetëm shkolla, por edhe strukturat e policisë, shërbimi inteligjent, komuniteti nuk bëjnë sa duhet për të mos lejuar praninë e substancave narkotike në shkolla dhe rrotull tyre.

- Sipas të dhënave të Prokurorisë dhe të Gjykatave, por edhe nga anketimet e bëra në terren, kontingjenti i personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale të narkokriminalitetit, sidomos i atyre që marrin droga, ka një shtrirje të gjerë nga pikëpamja e moshës, duke filluar nga të miturit e adoleshentët deri tek të rriturit mbi 45 vjeç. Kjo situatë nxjerr mjaft probleme, pasi secila grup-moshë ka karakteristika të ndryshme nga njëra-tjetra, ndaj kërkohen metoda dhe praktika pune të përshtatshme për secilën kategori.

- Në Shqipëri mendohet se numri i përgjithshëm i personave (të moshës 15-64 vjeç), që kanë provuar ndonjëherë drogë të paligjshme luhatet midis 40.000-60.000 personave. Kurse në Kosovë supozohet se janë 10.000–15.000 përdorues, prej të cilëve 4.000–5.000 mendohet të jenë përdorues të heroinës.

- Sipas statistikave të Policisë, në Shqipëri dhe në Kosovë vërehet një tendencë rritjeje e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit dhe të numrit të personave të dyshuar për kryerjen e tyre. Në Shqipëri për vitet 2007-2011 janë regjistruar 100 krime për

100.000 banorë. Po ashtu në Kosovë për periudhën 2007-2011 janë regjistruar 26 krime për 100.000 banorë.

- Pas shifrave të rritjes së narkokriminalitetit qëndrojnë edhe mangësitë në punën e organeve të zbatimit të ligjit, si në aftësinë zbuluese, edhe goditëse të tyre ndaj krimit dhe kriminelëve, që merren me narkotikë; edhe dobësitë në kualifikimin profesional të efektivave, edhe mungesa në bashkëpunimin midis agjencive dhe institucioneve të ndryshme, si dhe me komunitetin. Por edhe institucionet shkencore, akademike dhe shoqëria civile nuk kontribuojnë sa duhet me ide dhe me veprimtari që u vijnë në ndihmë organeve ligjzbatuese për të evidencuar dhe analizuar shkaqet e kësaj rritjeje të veprave kriminale dhe për zbulimin e autorëve të tyre. Këto nuk bëhen me fushata apo në mënyrë sporadike, por duhen vënë në themel të punës së tyre dhe të kenë vazhdimësi.

- Konfiskimi i substancave narkotike, i cili ka rëndësi jetike në luftimin dhe parandalimin e narkokriminalitetit, ka zënë vend në legjislacionin në Shqipëri dhe në Kosovë dhe po zbatohet mirë kur është fjala për bimët e mbjella që asgjësohen. Por problem mbetet rënia e konfiskimeve të narkotikëve që trafikohen, si nga kufiri tokësor, ashtu edhe në rrugë detare, çka duket në kapjen nga strukturat përkatëse të vendeve fqinje të sasive të drogës që vijnë nga Shqipëria apo Kosova. Këto raste flasin, ose për paaftësinë në zbulimin e drogës, ose për raste korruptive.

- Vihet re tendenca e shtimit të procedimeve penale nga Prokuroria dhe e proceseve gjyqësore ndaj krimeve në fushën e narkokriminalitetit. Por nuk përjashtohen rastet kur vepra të ndryshme penale me narkotikë, nuk shkojnë në gjykatë, dënimet e dhëna nga gjykatat, në Shqipëri, por edhe në Kosovë, shpesh janë të ulëta. Shtojmë se në Kosovë,

Prokuroria e Shtetit nuk bën publikimin e të dhënave lidhur me tendencën dhe vëllimin e kriminalitetit, në përgjithësi, dhe të narkokriminalitetit, në veçanti.

- Shqipëria dhe Kosova kanë rritur bashkëpunimin e tyre policor dhe të prokurorisë në luftimin e narkokriminalitetit. Ky bashkëpunim bëhet mbi bazën e Konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare, marrëveshjeve dy dhe shumëpalëshe. Ratifikimi dhe aderimi në to i Shqipërisë, ka bërë që ajo të paraqitet si partnere serioze në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bashkë me Kosovën, kanë dhënë kontributin e tyre në arritjen e rezultateve në luftën kundër narkokriminalitetit brenda vendit, por edhe në operacionet e përbashkëta me shtetet e tjera, në zbatim të Konventave dhe akteve të tjera ligjore ndërkombëtare.

- Në luftën parandaluese dhe goditëse ndaj narkokriminalitetit rol të madh luan policia, si institucion me rëndësi specifike në strukturat e sigurisë dhe të rendit publik. Në kuadër të detyrimeve ligjore, ajo kryen veprimtari konkrete në luftën kundër kriminalitetit, duke zbatuar masa me karakter parandalues, por edhe masa represive, për zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprave penale me drogat. Por veprimtaria e policisë ka nevojë për rritjen e efikasitetit të saj në luftimin e kriminalitetit, jo me çfarë t'i dalë përpara, por të udhëhiqet nga inteligjenca, të rrisë bashkëpunimin me institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore, si dhe me doganat. Edhe doganat, nga ana e tyre, duhet të rrisin aftësinë dhe kapacitetet zbuluese të veprimeve të paligjshme me drogat, qoftë në hyrje, apo në dalje të kufirit dhe të luftojnë shfaqjet korruptive në personelin e tyre.

- Policia ka nevojë, gjithashtu, për më shumë bashkëpunim dhe informacion nga shërbimi i inteligjencës, por edhe nga faktorë të tjerë nga shoqëria civile dhe komuniteti.

Problem mbetet edhe mbështetja e Policisë me më shumë infrastrukturë e pajisje logjistike, por edhe me stimuj të tjerë, pasi ndodhet përherë përballë krimit dhe kriminelëve.

▪ Hulumtimi i këtij problemi shqetësues dhe kompleks siç është narkokriminaliteti dhe lufta kundër tij, ishte jo vetëm një përvojë e vyer për njohjen e tij në rrafshin historik, shkencor, juridiko-penal, çka ndihmon në kualifikim tim të mëtijshëm shkencor e profesional, por edhe se më dha mundësinë që, me objektiva të caktuar dhe me një synim të qartë, të depërtoj në shfaqjet, në detaje, në forma të veçanta, me të cilat ai zhvillohet në terren, në jetën e përditshme. Ky ishte një tjetër mësim që nxora nga kjo përpjekje ‘e rëndë’ doktriture, se njohja e fenomenit që studion, jo vetëm përmes letrave, raporteve, akteve të ndryshme, botimeve dhe mediave, por edhe përmes vrojtimeve empirike në realitetin tonë të mbushur me vepra të narkokriminalitetit, përmes ndjekjes në praktikën e përditshme të dinamikës së tij është jo thjesht një nevojë për studiuesin dhe për punonjësit e strukturave që merren me këtë dukuri, por një domosdoshmëri për parandalimin dhe reduktimin e saj.

Kryerja e këtij studimi nuk është fundi i punës hulumtuese e kërkimore mbi dukurinë e narkokriminalitetit, por vetëm një fillim i guximshëm, i vështirë, por i frytshëm, dhe një bazë e mirë për të thelluar më tej studimet, për të shtuar kontributet teorike dhe shkencore në këtë fushë.

9.2. Përfundimet lidhur me hipotezat e punimit doktrinal

Nxjerrja e këtyre përfundimeve ishte një obligim i madh për autorin e kësaj teme doktriture. Duke qenë i bindur nga tërë hulumtimi i kryer, u përpoqa që, në mënyrë të

koncentruar dhe koncize, të formuloj provat që më çuan në vërtetimin e hipotezave të shtruara në fillim të studimit.

Hipoteza 1- *Prania e substancave narkotike dhe substancave psikotrope në shkollat e mesme në Kosovë dhe në Shqipëri ndikon në qëndrimet e nxënësve, që mund të jenë faktorë kriminogjenë nxitës ose lehtësues për t'u futur në botën e krimit.*

- Kjo hipotezë është vërtetuar. Me anketimin e bërë kemi provuar nga vetë nxënësit se në shkollat e mesme ka prani narkotikësh; se të rinjtë përdorin substanca narkotike; se ka nxënës që e kanë filluar drogën ende fëmijë, në moshën 11 vjeç apo 12-14 vjeç; se shoqëria e tyre përdor drogë, por shokët nxisin nxënës të tjerë të provojnë drogën në shkollë dhe jashtë saj, në klube dhe lokale nate dhe që i sjellin me vete të nesërmen në klasën ku zhvillojnë mësim. Shumë nxënës pohuan se, po të kesh të holla, droga sigurohet lehtë. Kjo provon se nxënësit e shkollave i njohin ata që shesin drogë, dinë vendet ku ata veprojnë, pra, kanë njohje dhe lidhje me poseduesit dhe shitësit e drogës. Ata pohuan se përtej portës dhe mureve të shkollës enden shitësit e drogës, duke rrezikuar këta nxënës adoleshentë që jo vetëm të konsumojnë drogë, por edhe të përfundojnë në shpërndarës dhe shitës narkotikësh dhe të kthehen në delinkuentë.

Hipoteza 2 - *Politika e parandalimit dhe politika penale në Kosovë dhe Shqipëri nuk janë efektive dhe, për rrjedhojë, gjatë tranzicionit ato janë kthyer në vende dhe burim i rëndësishëm i tranzitimit të lëndëve narkotike në Europë.*

- Kjo hipotezë është vërtetuar. Bazuar në analizimin dhe trajtimin që i është bërë hipotezës në kreun III deri në kreun V, rezulton se politika penale dhe politika e

parandalimit nuk kanë mundur të pengojnë shtrirjen e madhe që mori fenomeni i tranzitimit të narkotikëve, të pengonin që sidomos Shqipëria të mos bëhej praktikisht dhe të mos konsiderohej nga institucionet ndërkombëtare si vend origjine i kanabisit dhe një eksportuese e madhe e drogës dhe e trafikimit të saj. Këto politika nuk kanë mundur të parandalojnë krijimin dhe shtimin e grupeve shqiptare kriminale që ushtrojnë veprimtarinë e tyre me narkotikët, madje, duke u lidhur edhe me organizata kriminale ndërkombëtare, si mafia italiane etj. Kjo duket edhe në kapjen nga strukturat përkatëse të vendeve fqinje të sasive të drogës që vijnë nga Shqipëria apo Kosova, por që nuk janë zbuluar nga strukturat përkatëse brenda vendit. Këto raste flasin, ose për paaftësinë në zbulimin e drogës, ose për raste korruptive.

Këto konsiderata dhe të tjera që gjenden nëpër faqet e studimit, flasin në të mirë të kësaj hipoteze.

Hipoteza 3 - *Sistemi aktual i trajtimit dhe i rehabilitimit të përdoruesve të drogave në Kosovë dhe Shqipëri nuk është efikas.*

- Edhe kjo hipotezë është vërtetuar. Nga raporte dhe analiza të ndryshme me të cilat jemi konsultuar, por edhe me hulumtimin shkencor që bëmë përmes anketimit që zhvilluam në terren, me instrumente shkencore, si pyetësorët dhe intervistat gjysmë të strukturuar, konstatuam drejtpërdrejt dhe morëm konsiderata nga vetë personat që ishin në procesin e trajtimit dhe të rehabilitimit se kushtet, hapësirat, mjetet financiare etj. të qendrave klinike shtetërore, por edhe të OJQ-ve, në Kosovë dhe në Shqipëri, që ofrojnë rehabilitim, kanë mangësi, kapacitete të pamjaftueshme, jo thjesht nga ana sasiore, por vuanin edhe nga cilësia e tyre. Edhe trajtimi dhe shërbimi që bëhej në to nuk ishin në cilësinë e duhur, nuk i

përbushnin si duhet nevojat dhe specifikat e personave të ndryshëm që ndosheshin aty për trajtim dhe rehabilitim. Në këto qendra, kishte persona që përsëri merrnin drogë gjatë periudhës së rehabilitimit.

9.3. Rekomandimet

Në përgjithësi, studimi ka identifikuar fushat ku nevojiten përmirësime dhe ka identifikuar sfidat e çështjet që kërkojnë vëmendje më të madhe, në mënyrë që të rriten rezultatet në parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit.

Për këtë kemi konceptuar disa rekomandime:

- Të hartohet një strategji rajonale për parandalimin dhe luftimin e narkotikëve me nismën e ministrave të Punëve të Brendshme, në kuadër të shteteve të Ballkanit Perëndimor, për koordinimin midis të gjitha agjencive të zbatimit të ligjit për shkëmbimin e informacionit dhe për operacione të përbashkëta kundër narkokriminalitetit.
- Në Shqipëri dhe Kosovë, në nivel kombëtar të krijohen bazat e të dhënave, ku të regjistrohen të gjithë përdoruesit e drogës. Këto baza të dhënash t'i administrojnë Ministrinë e Shëndetësisë në vendet respektive.
- Në Kodin penal të Shqipërisë të bëhet ndryshimi i nenit 283/a, duke shtuar një fjali për *inkriminimin e shitjes së narkotikëve apo substancave psikotrope përmes internetit*, e cila paraqet një risi në aspektin ndërkombëtar të kryerjes së veprave penale në fushën e narkokriminalitetit. Po kjo çështje të përfshihet edhe në Kodin Penal të Kosovës, duke ndryshuar nenin 273.

- Në Kodin Penal të Shqipërisë të bëhet shtesë në nenin 283, te përcaktimi i sasisë minimale dhe maksimale të përdorimi personal, pasi termi “në doza të vogla” shkakton paqartësi juridike.

- Në Kodin Penal të Kosovës të bëhet plotësim ndryshimi i nenit 273, ku të parashikohet lejimi i narkotikut për përdorim personal dhe të përcaktohet sasia e lejueshme. Edhe në nenin 87 të Kodit të Procedurës Penale të përcaktohet “*Shitja e simuluar e sendit*”. E njëjta masë e veçantë të përcaktohet në nenin 1, të Ligjit nr.8750, për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope.

- Në Kosovë dhe Shqipëri, të aplikohen iniciativat e reja të agjencive ligjzbatuese lidhur me masat për parandalimin dhe luftimin e narkokriminalitetit, kryesisht, me ndërmarrjen e veprimeve proaktive si përgjigje kundër veprave kriminale. Të fillojë aplikimi i praktikës “shkëmbimi i agjentëve nën mbulim” dhe “dërgesat e kontrolluara” mes shteteve.

- Prokuroria e Shtetit në Kosovë të krijojë një model të pasqyrimit të të dhënave statistikore lidhur me vëllimin, tendencën, procedimet, të dyshuarit, moshën, gjininë, përkatësinë etnike, llojin e kriminalitetit, sipas veprave penale të parapara në Kodin Penal dhe ta përditësojë atë në vazhdimësi.

- Meqenëse Kosova dhe Shqipëria janë vende tranzit të trafikimit të narkotikëve, por edhe të origjinës së narkotikëve, të bëhet profilizimi i Prokurorive dhe Gjykatave të specializuara, që do të merren posaçërisht me goditjen e veprave penale në fushën e narkokriminalitetit.

- Në Shqipëri dhe Kosovë, të zhvillohen projekte nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë), Ministria e

Drejtnsisë dhe Ministria e Shëndetësisë për avancimin e politikave, programeve të punësimi dhe aftësimi profesional për përdoruesit e drogave dhe për të dënuarit për veprat penale me drogat, si edhe për ngritjen e vetëdijes mbi rolin e institucioneve shoqërore, familjes, shkollave, komunitetit dhe mediave në këtë fushë.

- Strukturat e larta të sistemi të Drejtnsisë, në Kosovë dhe në Shqipëri, të ushtrojnë më shumë kompetencën e tyre për kontrollin mbi zbatimin e politikës penale nga gjykatat e rangjeve të ndryshme, kryesisht, në dhënien e sanksioneve penale për veprat penale në fushën e narkokriminalitetit, të cilat në shumë raste konsiderohen të buta.

- Të shtohet numri i punonjësve antidrogë dhe punonjësve civilë të këtij sektori në intervalet kohore kur mendohet piku i veprimtarisë kriminale me drogën, për shembull, mes orës 18:00-02:00 të ditës, me qëllim rritjen e forcës goditëse në identifikimin e shpërndarësve, shitësve dhe përdoruesve të drogave. Po ashtu të programohen kontrole të befasishme për identifikimin e hapësirave ku përdoren narkotikë dhe të merren masa praktike për ndriçimin e tyre, për vendosje të kamerave të sigursë në vendet e shënuara si vende ku bëhet shitja dhe blerja e narkotikëve.

- Të ndërtohen plane konkrete, me tema dhe me persona të ngarkuar, për mbajtjen e ligjëratave, e work-shopeve, seminareve etj. me nxënësit në shkolla, me institucionet e sigursë, me institucionet shëndetësore, me shoqërinë civile etj., për njohjen e drogave dhe të rreziqeve dhe pasojave që shkakton përdorimi i tyre. Të intensifikohen programet e ndërgjegjësimi të nxënësve, prindërve, por edhe qytetarëve në përgjithësi, për këto probleme.

- Drejtoritë Rajonale Arsimore, në bashkëpunim me Drejtoritë e Shkollave, në Shqipëri dhe Kosovë, të ndërmarrin hapa për sigurimin e mjediseve shkollore nga

shpërndarësit dhe shitësit e lëndëve narkotike, me vendosjen e kamerave të sigurisë, me angazhimin e kompanive private të sigurimit fizik, për mbrojtjen nga drogat.

- Ministritë e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtoritë e Përgjithshme të Burgjeve, në Kosovë dhe Shqipëri, të krijojnë programe të veçanta për identifikimin dhe rehabilitimin e të dënuarve apo të paraburgosurve që janë përdorues të narkotikëve të ndryshëm. Programet të fokusohen në aftësimin profesional, këshillim dhe përkrahje, shërbime të psikologëve dhe mjekëve specialistë të fushës, por edhe në krijimin e kushteve të përshtatshme për trajtimin dhe rehabilitimin e personave.

- Të krijohen ekipe të përbashkëta të hetimit, të intensifikohet shkëmbimi i informacioneve me shtetet e rajonit, për profilizimin e grupeve të krimit të organizuar në fushën e narkokriminalitetit, për të rritur efikasitetin e organeve të sigurisë në luftimin e tij.

- Financimi i qendrave për trajtimin dhe rehabilitimin e personave që konsumojnë drogë, që duhet të jenë në kuadër të Ministrive të Shëndetësisë, në Shqipëri dhe në Kosovë. Të jenë me plotësohen me kapacitete të nevojshme dhe me programe pune të mirëstudiuara për trajtimin e duhur të përdoruesve të narkotikëve.

LISTA E REFERENCAVE/BIBLOGRAFIA

LITERATURË

- Arifi,A. (2008). *Drogat*. Shkup.
- Baçiç,F.,&Pavloviç,S.(2006). *Komentar krivičnog zakona, drugo dio*. Zagreb: Organizator.
- Begaj,S.(1999). *Kriminalistika*. Ripunim.Tiranë:SHBLU.
- Bicaj,K.(2010). *Drogat narkomania dhe kriminaliteti*.Prishtinë:Universiteti “Iliria”.
- Boire,G., R. (1996). *Marijuana law*. California: Ronnin Publishing.
- Bouquet, R. (1950). ‘*Cannabis*’, *Bulletin on Narcotics, Issue 4*. available online at: (http://www.unodc.org/unodc/en/data-and-analysis/bulletin/bulletin_1950-01html), shikuar më 15 shtator 2014.
- Brady., Sh. (2012). *Organised Crime in Bosnia Herzegovina: A silent war fought by an ambush of toothless tigers or a war not yet fought?*. Sarajevo. Marrë nga: (https://www.occrp.org/documents/OC_in_BH_ENG.pdf). Shikuar më 6 shkurt 2015.
- Busse,G.(2006). *Morphine*, New York:Chelsea House.
- Bufi,Y. (2001, Dhjetor). *Anëtarësimi i Shqipërisë në FMN dhe fillimet e reformës ekonomike*. Konferenca II e Bankës së Shqipërisë "Shqipëria midis reformave të brendshme të integritimit European". Tiranë.
- Clarke,R.C.(1998). *Hashish!*. Los Angeles: Red Eye Press.
- Cole,M.D.(2006). *The analysis of drugs of Abuse:An instruction manual*.CRC Press.
- Demolli,H.(1996). *Problemet e alkoolizimit dhe të narkomanisë, nocioni dhe paraqitja e tyre*. Prishtinë: E drejta.
- Elezi,I.(1974). *E drejta penale (pjesa e posaçme) II*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakultetit i shkencave Politiko-Juridike, Revista, Dispenca.
- Elezi,I. (2002). *Vështrim mbi zhvillimet e legjislacionit penal shqiptar kundër krimit*

të organizuar në “Gjendja e krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si dhe problemet që lidhen me të”. Tiranë.

Elezi,I.(2009). *E drejta penale (pjesa e posaçme)*. Tiranë: Erik Botime.

Elezi,I.,&Kaçupi,S.,&Haxhia,R.M.(2006).*Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme*. Tiranë.

Elezi,I.&Elezi,E.(2010). *Historia e së drejtës penale*. Tiranë: Libri Universitar.

Elezi,A.(2012).Droga, një sfidë inteligjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj. Disertacion i Doktoraturës. Tiranë: Universitetit i Tiranës.

Escobedo,A.(2010). *The General History of Drugs Volume One*. Valparaiso, Chile: Grafitti Militante Press.

Gerald,H.,T.(2007). *New Reserch on Methamphetamine Abuse*. Nova Science Publishers,Inc: New York.

Gilmore,W.(1991). *Combating international drugs trafficking: The 1988 United Nations Convention against Illicit Traffic in Narcotic Drugs and Psychotropic Substances*. London: Commonwealth Secretariat.

Gosop,M.(2007) *Living with Drugs. Sixth Edition*. Hampshire: Ashgate Publishing Copmany.

Gjika,G.(1974). *Procedura penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e posaçme, Dispenca II*. Tiranë.

Gjonçaj,L.&Gjonçaj,G. (2013). *Kriminologjia*. Tiranë: Ade-Print.

Hasani,F.(2013). *Reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë, Fjalim i kryetarit Dr.sc.Fejzullah Hasani*. Konferenca ndërkombëtare e kryetarëve të Gjykatave Supreme të Europës Qendrore dhe Juglindore, Mal i Zi.

Hanes,T.W.,&Sanello,F.(2013). *Luftërat e opiumit: varësia e një perandorie nga droga dhe korruptimi i një tjetre: Britani-Kinë, 1840-1860*. Tiranë: Helga’s Secrets.

Hanson,R.G.,&Venturelli,J.P.,&Fleckenstein, E.A.(2011). *Drugs and society 11th Edition*. Burlington: Jones&Bartlet, 2011. 11th Edition.

Halili,R.(2005). *Krimonlogjia*. Prishtinë: Fakulteti Juridik-Universiteti i Prishtinës.

Halili,R.(2008). *Kriminologjia*. Prishtinë.

- Haley,J.(2009). *The truth about drugs*. New York: Facts on File (J); 2 edition.
- Hysi,V.(2005). *Kriminologjia*. Tiranë, ‘Kristalina-KH’.
- Hysi, V. (2008). *A është sistemi i drejtësisë penale shqiptare efektiv në parandalimin e veprave penale në fushën e diskriminimit?*. Tiranë: Revista Studime Jurudike 2/2008.
- Hysi,V.(2010). *Krimonologjia, Botimi i dytë i përmirësuar*. Tiranë: ‘Kristalina-KH’.
- Hysi,V.(2012). *Penologjia,botimi i tretë i përmirësuar*. Tiranë: ‘Kristalina-KH’.
- Judah,T.(2002). *Kosova: Lufta dhe hakmarrja. Botimi i 2-të*. New Heaven: Yale University Press.
- Katz,L.(1996). *Akte keqbërse dhe mendje fajtore. Çështje të së drejtës penale (version i shkurtuar)*. Tiranë: ‘Marin Barleti’.
- Kambovski,V.(2005). *Organized Crime*. Skopje: 2nd August.
- Keefer,Ph.,&Norman,L.(2010). *Innocent Bystanders: Developing Countries and the war on drugs*. A copublication of The World Bank and Palgrave Macmillan: Washington DC.
- Kostiç, S. (1987). *Osnovi kriminalističke operative*. Beograd.
- Korajliç,N.&Muharremi,D. (2009). *Kriminalistika*. Prishtinë: Riinvest.
- Klosterman,L.(2006). *The facts about depressants*.New York:Marshall Cavendish.
- Lyman,D.M.(2010). *Criminal investigation, The art and the science, 6th edition*. New Jersey: Prentice Hall.
- Latifi,V.(2000). *Kriminalistika*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës: Fakulteti Juridik.
- Latifi,V.(2001). *Taktika kriminalistike*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës: Fakulteti Juridik.
- Latifi,V.(2008). *Politika kriminale*. Prishtinë: Koha.
- Maljeviç,A.(2005). *Trafficking in women in Bosnia and Herzegovina. The organised crime economy, Managing crime markets in Europe*.
- Marjanoviç,G.(1998). *Macedonian general criminal law section*.Skopje:Prosvetno act.
- Malcolm,N. (1998). *Kosova: Histori e shkurtë*. Londër: Papermac.
- McAllister,B.,W. (2000). *Drug Diplomacy in the JudaTwentieth Century*. London

and New York: Routledge.

Michels,I.I.,Stöver,H.,&Gerlach,R. (2007). *Substitution treatment for opioid addicts in Germany*. Germany: Harm Reduction Journal, 4(5), b40. Marrë nga (<http://www.biomedcentral.com.pdf>), shikuar më 26 prill 2015.

Muharremi, R.(2008). *Kosova dhe integrimi i saj në Bashkimin European*. Prishtinë: AUK.

Muçi,B.(2002). *Veprat penale në fushën e narkotikëve*. Tiranë: Julvin.

Milutinoviç, M. (1981). *Kriminologjia. Botim i dytë i ndryshuar dhe plotësuar*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe mjeteve mësimore i KSAK:.

Nushi,P.(2002). *Psikologjia e përgjithshme I*. Prishtinë: Libri Shkollor.

Oakley,R.,Ksir,Ch.,&Hart,C.(2010). *Drugs, Society, and human Behavior*. McGraw Hill Education; 15 edition:New York.

Olive,M.,F.(2008). *Drug the straight fact:Crack*.Chelsea House Publishers: New York.

Trenova,G.(2009). *Interpretime të kodit penal*. Tiranë: Botimet “Dita 2000”.

Papandile,J.,& Papandile,E.(2010). *Kriminologji*. Tiranë: Print 2000.

Pellerin,Ch.(1998). *Trips: How hallucinogens work in your brain*. New York: A Seven Stories Press, First edition.

Peck,G.,R.(1997). *Crack*. New York: Rosen Publishing Group.

Pietro, L. (2007). “*Mafiet e reja*”, *Struktura dhe format e shfaqjes së krimit të organizuar transnacional: analizë e përvojës gjyqësore italiane*”. Torino-Italy: UNICRI.

Plačko,D.(1997). *Droge- Bič novog doba*. Zagreb: K-2, Samobor.

Petroviç.,B.(2004). *Narkokriminal*. Sarajevo: Pravni Fakultet.

Ramljak,A. (2007). *Kriminalistika Mjekësore*. Prishtinë: Universiteti AAB.

Rosenthal,E.,&Kubby,S.(2003). *Why Marijuana should be Legal*. New York: Runnig Press.

Roger.,D.W.,Steven M.M.,& Roxanne L.B.,(2005). *Cocaine*. Washington DC.

Sahiti,E.(1995). *Kriminaliteti si dukuri shoqërore negative dhe provimi (argumentimi) procedural i tij*. Prishtinë: Revista e Drejta.

- Salihu,I.(2005). *E drejta penale për të mitur (me ligj penal për të mitur)*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës: Fakulteti Juridik.
- Salihu,I.(2009). *E drejta penale, pjesa e posaçme*. Prishtinë: Fama.
- Salihu,I.(2010). *E drejta penale ndërkombëtare*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës: Fakulteti Juridik
- Salihu,I.,&Zhitija,H.,&Hasani,F.(2014). *Komentari i kodit penal të Kosovës, Botimi I*. Prishtinë: GIZ.
- Sinha,J.(2001).*The history and development of the leading international drug control conventions*. Canada: Library of Parliament.
- Siegel,J.,L. (2008). *Criminology: The core, Third Edition*. Belmont: Thomson Wadsworth.
- Stewart,P.D.(1990). *Internationalizing the war on drugs: "The UN Convention against Illicit Traffic in Narcotic Drugs and Psychotropic Substances"*. Denver Journal of International Law and Policy, Vol. 18, No. 3, p. 392.
- Sokoli,L.(1999). *Droga*. Onufri: Tiranë.
- Shishani,F.(2006).*Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit*.Prishtinë: Prograf.
- Vokshi,A.&Musliu,B.(2013). *Reforma e sistemit të drejtësisë në Kosovë*. Prishtinë: Friedrich Ebert Stiftung.
- Vula,V.(2010). *Kriminaliteti Kompjuterik*. Prishtinë.
- Vula,V.(2011). *Kontrabanda me narkotik në Botën Bashkëkohore*. Prishtinë.
- Winkler,K.,R.(2007). *Bundesgerichtshof legt Grenzwert für die "nicht geringe Menge" beiBuprenorphin fest*. Sucht 53 (4).
- Weishiet,R.,&White,M.,W.(2009). *Methamphetamine: Its History, Physiology, and Treatment*. Center City, Minesota: Hazelden.
- Wegner,W.,Petroviç,B.,Bojaniç,N.,&Korajliç, N.,(2004). *Ballkanski, Putevi droge i BH*. Sarajevo.
- Zhilla.F.,& Lamallari.B.(2015). *Krimi i organizuar, Vlerësim i riskut të krimit të organizuar në Shqipëri*. Tiranë: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Marrë nga: (http://www.osfa.al/sites/default/files/press_report),

shikuar me datë 11.06.2015.

BURIMET PARËSORE:

- The full legal texts of each of the Conventions are available from the website of the United Nations Office for Drug Control and Crime Prevention (UNODCCP) at the following address: http://undcp.or.at/un_treaties_and_resolutions.html
- League of Nations Treaty Series Publication of Treaties and international engagements registered with the Secretariat of the League of Nations. VOLUME VIII 1922 NUMBERS 1, 2, 3 and 4, “The International Opium Convention”, signed at-The Hague, January 23, 1912, and subsequent relative papers, p. 187. Marrë nga: <https://treaties.un.org/doc/Publication/UNTS/LON/Volume%208/v8.pdf>.
- United Nations, Treaties and international agreements registered or filed and recorded with the Secretariat of the United Nations VOLUME 520 1964 I. Nos. 7511-7515, New York, 1966, Single Convention on Narcotic Drugs, 1961, (with schedules). Both done at New York, on 30 March 1961, Registered ex officio on 13 December 1964. p. 151. Marrë nga: (<https://treaties.un.org/doc/Publication>).
- United Nations, League of Nations Treaty Series Publication of Treaties and International Engagements registered with the Secretariat of the League of Nations. Volume LXXXI, 1929 NUMBERS 1, 2, 3 and 4, International Convention, Adopted by the Second Opium Conference (League of Nations), and Protocol relating thereto. Signed at Geneva, February j 9, 1925, p. 317-354. Marrë nga: <https://treaties.un.org/doc/Publication/UNTS/LON/Volume%2081/v81.pdf>
- United Nations,Treaty Series Treaties and international agreements registered or filed and recorded with the Secretariat of the United Nations, reaties and international agreements registered or filed and recorded with the Secretariat of the United Nations VOLUME 1019 1976 I. Nos. 14949-14956 II. No. 749, United Nations - Nations Unies New York, 1984, No. 14956, Multilateral, Convention on

psychotropic substances (with lists of substances). Concluded at Vienna on 21 February 1971, p. 175. Marrë nga: (<https://treaties.un.org/doc/Publicati.pdf>).

- United Nations, Treaties and international agreements registered or filed and recorded with the Secretariat of the United Nations VOLUME 1582 1990 I. Nos. 27621-27627, United Nations Convention against illicit traffic in narcotic drugs and psychotropic substances, adopted by the Conference at its 6th plenary meeting, on 19 December 1988, p. 175-195.

KODE DHE LIGJE

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008,
- Kodit penal i shtetit Shqiptar i vitit 1928.
- Kodi penal i Shqipërisë, 1952, i dekretuar me dekret nr.615, datë 13.05.1948, u shpall Ligji nr.599, Gazeta Zyrtare nr.63, E Premte, 4 qershor 1948, f.1-15.
- Kodi penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1977, i miratuar me ligjin nr.5591, datë 15.6.1977, Fletore Zyrtare, Tetor, Tiranë.
- Kodi penal i Republikës së Shqipërisë i azhurnuar, 1995, i miratuar me Ligjin nr.7895, datë 27.1.1995.
- Kodi penal i përkohshëm i Kosovës, viti 2004, (UNMIK/RREG/2003/25, Gazeta zyrtare 6 korrik 2003).
- Kodi penal i Kosovës, viti 2013 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.19 / 13 korrik 2012, Prishtinë).
- Gemran Narcotic Act, 1981 (*The Act was adopted as Article 1 of the Law of 28th July 1981 I 681 by the Bundestag with the consent of the Bundesrat. It entered into force on 1st January 1982 according to Article 7 subsection 1 of the Act on the Reform of the Narcotic Drug Legislation of 28th July 1981 BGBl. (Bundesgesetzblatt - Federal Law Gazette) I p. 681, 1187*).
- Kodi penal i Bosnjë dhe Hercegovinës (*Službeni glasnik Bosne i Hercegovine, br. 3/03*);
- Kodi penal i Serbisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë,

Nr.111/2009,121/2012 104/2013).

- Kodi penal i Maqedonisë, Consolidated version with the amendments from March 2004, June 2006, January 2008 and September 2009), Came into effect: 1 November 1996.
- Kodi penal i Republikës Serbe të BeH, (*Službeni glasnik RS, br. 85/2005*).
- Kodi penal i Qarkut të Bërçkos, (*Službeni glasnik Brčko distrikta BiH, broj 10/03*).
- Kodit penal të Federatës së Bosnjë e Hercegovinës, (*Službenim novinama FBiH», broj 36/03 29. jula 2003*).
- Kodi Penal i Malit të Zi (*Zakonik je objavljen u "Službenom listu RCG", br. 70/2003, 13/2004, 47/2006 i "Službenom listu CG", br. 40/2008, 25/2010, 32/2011, 40/2013 i 56/2013. Dana 1.9.2012. godine, prestale da važe odredbe glave VI - vidi: čl. 189. Zakona - 64/2011-1*)

LIGJET:

- Ligj nr.8722, datë 26.12.2000. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope". Shpallur me dekretin nr.2857, datë 5.1.2001.
- Ligj nr.8723, datë 26.12.2000. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën unike mbi drogat narkotike, e ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 për ndryshimin e Konventës unike mbi drogat narkotike, 1961" Shpallur me dekretin nr.2858, datë 5.1.2001.
- Ligji nr.8965, datë 7.11.2002 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për substancat psikotrope”, shpallur me dekretin nr.3582, datë 4.12.2002
- Ligji nr.7895, datë 27 janar 1995, “Mbi Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë” (*Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr.2, 16 mars 1995, f.23*).

- Ligji nr.7975, i datës 21 korrik 1995, Mbi substancat narkotike dhe psikotrope, (*Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr.20, 25 gusht 1995, f. 853*).
- Ligji nr.8750, datë 26.3.2001 (*Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr.14, 13 prill 2001, f. 391*), për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të drogave dhe lëndëve për prodhimin e tyre, i shpallur me dekretin nr.2963, datë 9.4.2001.
- Ligji nr.8874, i datës 29 mars 2002, Për kontrollin e lëndëve të cilat mund të përdoren për prodhimin e paligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope (*Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr.12, 29 prill 2002, f.359*).
- Ligji nr.9108, datë 17.7.2003, Për substancat dhe preparatet kimike, i shpallur me dekret nr.3922, datë 30.7.2003.
- Ligji me nr.10192, datë 3.12.2009, për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, i shpallur me dekretin nr.6362, datë 22.12.2009.
- Ligj Nr.8328, datë 16.4.1998, për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.
- Ligji mbi parandalimin dhe luftimin e abuzimit me narkotikë, Bosnjë dhe Hercegovinë ("*Sg BiH*", broj 8, od 7. februara 2006. godine).
- Ligji mbi substancat e kontrolluara psikoaktive (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr.99/2010).
- Ligji mbi substancat e përdorura për prodhimin ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, nr.107/05),
- Ligji Nr.03/L-052, Për Prokurorin Speciale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë:Viti III, Nr.27, 3 qershor 2008.
- Ligji nr.04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, shpallur në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr.31, datë 28 gusht 2013.

VENDIME TË GJYKATAVE

- Vendimi nr.13, datë 29.5.1997, me të cilin ka shpallur të papajtueshëm me Kushtetutë ligjin nr.8175.
- Vendimi unifikues Nr.1, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, datë 27.03.2008.
- Vendimi unifikues Nr.3, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, datë 24.01.2011
- Vendimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë, nr.56250-01373-00-2013, i Regj. Themeltar nr.00-2014 - 1072 i Vendimit (109), datë 16.04.2014.
- Vendimi me nr. të regjistrimit themeltar 1593/397 dhe nr. të vendimit Nr.427, të Kolegjit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 25.04.2014.
- Vendimi me nr. të regjistrimit themeltar 56260-01084-00-2013 dhe nr. të vendimit 00-2015- 714 i Vendimit (50), i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Vendim me nr. të regjistrimit themeltar 56280-01190-00-2012 dhe nr. të vendimit 00-2014-1965 i Vendimit (231), datë 19.12.2014, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Vendim me nr. të regjistrimit themeltar 56280-00344-00-2008 dhe nr. të vendimit 00-2010-532 i Vendimit (94), datë 10.02.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Vendim me nr. të regjistrimit themeltar 56290-00124-00-2008 dhe nr. të vendimit 00-2010-617 i Vendimit (414), datë 05.05.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Vendimin nr.663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020, dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016". Vendim i KM, Nr.814, datë 26.11.2014, Dt.Miratimit: 26.11.2014, Flet.Zyrtare Nr.187, Faqe:187

BURIMET DYTËSORE, RAPORTE:

RAPORTE TË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE KOMBËTARE:

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2005). *Statistikat e jurisprudencës*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29.05.2015.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2006). *Statistikat e jurisprudencës*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29.05.2015.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2007). *Statistikat e jurisprudencës*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29.05.2015.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2008). *Statistikat e jurisprudencës madhor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29.05.2015.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2008). *Statistikat e jurisprudencës minor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29 maj 2015.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2009). *Statistikat e jurisprudencës madhor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29.05.2015.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2009). *Statistikat e jurisprudencës minor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29 maj 2015.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2010). *Statistikat e jurisprudencës madhor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29.05.2015.

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2010). *Statistikat e jurisprudencës minor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29 Maj 2015.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2011). *Statistikat e jurisprudencës madhor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar me datë 29.05.2015.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2011). *Statistikat e jurisprudencës minor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29 maj 2015.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2012). *Statistikat e jurisprudencës madhor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29.05.2015.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2012). *Statistikat e jurisprudencës minor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më datë 29 maj 2015.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2013). *Statistikat e jurisprudencës madhor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më 29.05.2015.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2013). *Statistikat e jurisprudencës minor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më 29 maj 2015.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2014). *Statistikat e jurisprudencës madhor*. Prishtinë. Marrë nga: (<https://ask.rks-gov.net/drejtesi/publikimet>), shikuar më 29.05.2015.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2015). *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës*. Prishtinë. ‘Aksion Plus’ (2014). *Raporti e punës së Organizatës Jo fitimprurëse*. Tiranë.
- Banka Botërore, (16 qershor 2005). *Vlerësimi i varfërisë në Kosovë, Promovim i*

Mundësisë, Sigurisë, dhe Pjesëmarrjes për të Gjithë (Raporti Nr.32378 – XK).

Njësia e Reduktimit të Varfërisë dhe Menaxhimit Ekonomik, Regjioni i Europës dhe Azisë Qendrore. Marrë nga: (<http://siteresources.worldbank.org>).

Centre for Security Studies (CSS) (2014). *Study of organised crime in Bosnia and Herzegovina*. Sarajevo.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) (2015). *Të dhëna statistikore të sistemit të burgjeve Janar-Maj*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq>), shikuar më 15.06.2015.

Drejtoria e Hetimit Antimafia (DIA). (2014). *Arrivita volta e sui risultati conseguiti dalla Direzione Investigativa Antimaffia*. Roma, 2 semestre 2014. Marrë nga: (<http://www.calabrianews.it/wp-content>), shikuar më 15 shtator 2015.

Departamenti i Drejtësisë (US Dept of Justice). (1992). *National Drug Control Strategy, a nation responds to drugs use* (134372). Washington DC: The White House.

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2009). *International Narcotics Control Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Albania. Report Volume I Drug and Chemical Control*.

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2010). *International Narcotics Control Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Albania. Report Volume I Drug and Chemical Control*.

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2011a). *International Narcotics Control Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Albania. Report Volume I Drug and Chemical Control*.

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2011b). *International Narcotics Control Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Kosova*.

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2012). *International Narcotics Control Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Albania. Report Volume I Drug and Chemical Control*.

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2013). *International Narcotics Control*

Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Albania. Report Volume I Drug and Chemical Control.

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2014). *International Narcotics Control Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Albania. Report Volume I Drug and Chemical Control.*

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2015). *International Narcotics Control Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Albania. Report Volume I Drug and Chemical Control.*

Departamenti i Shtetit (US Dept of State). (2015b). *International Narcotics Control Strategy Report. International Narcotics Control Strategy Serbia. Report Volume I Drug and Chemical Control.*

Dogana e Kosovës (DK) (2012). *Raporti vjetor 2012*. Prishtinë.

Dogana e Kosovës (DK) (2014). *Raporti vjetor 2014*. Prishtinë.

Dogana e Kosovës (DK) (2015a). *Plani strategjik 2016-2018*. Prishtinë.

Dogana e Kosovës (DK) (2015b). *Raporti vjetor 2015*. Prishtinë.

EUROPOL, SOCTA, (2013). *Eu serious and organised crime threat assessment*. Van Deventer- Netherlands. Marrë nga: (<https://www.europol.europa.eu/sit>), shikuar më 17.09.2015.

EUROPOL, SOCTA, (2015). *Interim SOCTA 2015: An update on Serious and Organised Crime in the EU*. Brussels. Marrë nga: (<http://www.statewatch.org/news>), shikuar më 15.09.2015.

European Sourcebook (ESB). (2014). *European sourcebook of crime and criminal justice statistics 2014, fifth edition*. Helsinki: Academic Bookstore. Marrë nga ([http://www.heuni.fi/material/attachments/heuni/reports/nEg1vtgIp/Final Source](http://www.heuni.fi/material/attachments/heuni/reports/nEg1vtgIp/Final_Source)).

Fjalori i shqipes së sotme (FSHS) (2002). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Toena.

Fakulteti Juridik, Instituti i Kërkimeve Juridike dhe Shoqërore. (1979). *Përmbledhje e ligjeve penale*. Prishtinë.

- Instituti i Statistikave (INSTAT) (2011). *Shqipëria censusi i popullatës dhe banesave, pjesa e parë*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.instat.gov.al/media/178070/>) shikuar më 19.06.2015.
- Instituti i Statistikave (INSTAT). (2015). *Shqipëria: Trendi i varfërisë 2002-2005-2008-2012, rishikuar 2015*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.instat.gov.al/media/28839>), shikuar më 20.05.2015.
- Instituti kosovar për kërkime dhe zhvillime të Politikave (KIPRED) (2009). *Drejtesia tranzicionale në Kosovë: Punim diskutues*. Seria e kërkimeve politike. Botim i veçantë. Prishtinë: KIPRED. Marrë nga: (<http://www.kipred.org/repositor>).
- KAHRC&KEC. (2012). *Kosova 1912-2000 në tekstet mësimore të historisë të Kosovës, Shqipërisë dhe Serbisë*. Prishtinë: KAHRC &KEC. Marrë nga: (http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/03/botime_035-shqip.pdf), shikuar më 15 gusht 2015.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). (2016). *Raportet statistikore lidhur me veprat penale në fushën e narkokriminalitetit 2005-2015*. Prishtinë.
- ‘Labyrinth’ (2014). *Raportet e punës të organizatës jo qeveritare ‘Labyrinth’*. Prishtinë. Ministria e Drejtësisë (MD). (2005). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.drejtesia.gov.al/al/doku>), shikuar më 12 qershor 2015.
- Ministria e Drejtësisë (MD). (2006). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.drejtesia.gov.al/al/doku>), shikuar më 12 qershor 2015.
- Ministria e Drejtësisë (MD). (2007). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.drejtesia.gov.al/al/doku>), shikuar më 12 qershor 2015.
- Ministria e Drejtësisë (MD). (2008). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.drejtesia.gov.al/al/doku>), shikuar më 12 qershor 2015.
- Ministria e Drejtësisë (MD). (2009). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.drejtesia.gov.al/al/doku>), shikuar më 12 qershor 2015.
- Ministria e Drejtësisë (MD). (2010). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.drejtesia.gov.al/al/doku>), shikuar më 12 qershor 2015.
- Ministria e Drejtësisë (MD). (2011). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë

nga:(<http://www.drejtësia.gov.al/al/doku>),shikuar më 12 qershor 2015.

Ministria e Drejtësisë (MD). (2012). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga:(<http://www.drejtësia.gov.al/al/doku>), shikuar më 12 qershor 2015.

Ministria e Drejtësisë (MD). (2013). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga:(<http://www.drejtësia.gov.al/al/doku>), shikuar me datë 12 qershor 2015.

Ministria e Drejtësisë (MD). (2014). *Vjetari Statistikor*. Tiranë. Marrë nga:(<http://www.drejtësia.gov.al/al/doku>),shikuar me datë 12 qershor 2015.

OBSH & SAIMS, (2011). *Raport i OBSH-SAIMS mbi sistemet e parandalimit dhe trajtimit për çrregullimet shëndetësore të lidhura me drogat në Shqipëri*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles3.pdf>), shikuar më: 20.04.2015.

Policia e Kosovës (PK) (2016). *Raporte dhe statistika prej vitit 2005 deri 2015*. Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me narkotikë. Prishtinë.

Policia e Shtetit (PSH) (2016). *Raporte dhe statistika prej vitit 2005 deri 2015*, Drejtoria për Hetimin e Trafikeve. Tiranë.

Prokuroria e Përgjithshme (PP) (2005-2013). *Raporti vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.pp.gov.al/web/>), shikuar më 10 korrik 2014.

Qendra Europiane për monitorimin e drogave dhe drogë-varësinë (EMCDDA). (2007). *Drugs in focus*. Lisbona: Office for Official Publications of the European Communitie. Marrë nga: (<http://www.emcdda.europa.eu/attachem>), shikuar më 15.05.2016.

Qendra Europiane për monitorimin e drogave dhe drogë-varësinë (EMCDDA). (2013). *National Report, Albania New Development, Trends and in-depth information on selected issues*. Lisbona: Office for Official Publications of the European Communitie. Marrë nga: (<http://www.emcdda.europa.eu>) shikuar më 10.03.2013.

Qendra Europiane për monitorimin e drogave dhe drogë-varësinë (EMCDDA). (2014 a). *National report (2013 data) to the emcdda: Bosnia and Herzegovina, New Development and Trends*. Lisbona: Office for Official

- Publications of the European Community. Marrë nga: (<http://www.emcdda.europa.eu/html.cfm/ind>) shikuar më 19.04.2015.
- Qendra Europiane për monitorimin e drogave dhe drogë-varësinë (EMCDDA). (2014b). *National Report, The Former Yugoslav Republic of Macedonia*. Lisbona: Office for Official Publications of the European Community. Marrë nga: (<http://www.emcdda.europa.eu/html.cf>) shikuar më 13 mars 2015.
- Qendra Europiane për monitorimin e drogave dhe drogë-varësinë (EMCDDA). (2014c). *National Report, of Serbia*. Lisbona: Office for Official Publications of the European Community. Marrë nga: (<http://www.emcdda.europa.eu/html.cf>) shikuar më 14 mars 2015.
- Qendra Europiane për monitorimin e drogave dhe drogë-varësinë (EMCDDA). (2014d). *National Report, of Germany*. Lisbona: Office for Official Publications of the European Community. Marrë nga: (<http://www.emcdda.europa.eu/html.cf>) shikuar më 09 Mars 2015.
- Qendra Europiane për monitorimin e drogave dhe drogë-varësinë (EMCDDA). (2014dh). *National report, of Kosovo*. Lisbona: Office for Official Publications of the European Community. Marrë nga: (<http://www.emcdda.europa.eu/html.cf>) shikuar më 15.03.2015.
- Qendra Europiane për monitorimin e drogave dhe drogë-varësinë (EMCDDA). (2015). *European Drug Report*. Lisbona: Office for Official Publications of the European Community. Marrë nga: (<http://www.emcdda.europa.eu/html.cf>) shikuar më 20.08.2015.
- Shërbimi Korrektues (SHK). (maj 2015). *Të dhëna statistikore të sistemit të burgjeve Maj*. Prishtinë. Marrë nga: (<http://shkk.rks-gov.net>), shikuar më 19.06.2015.
- Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNDOC). (2006). *World drug report, Volume 1, Analysis*. Vienna. Marrë nga: (https://www.unodc.org/pdf/WDR_2006/wdr200), shikuar më 5.03.2015.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNDOC). (2008). *Crime and its impact on the Balkans and affected countries*. Vienna. Marrë nga: (http://www.unodc.org/documents/Balkan_study.pdf), shikuar më 5.03.2015.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNDOC). (2014). *The illicit drug trade through South-Eastern Europe*. Vienna. Marrë nga: (https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/Illicit_DT), shikuar më 09.03.2015.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNDOC). (2015). *World drug report* (United Nations publication, Sales No. E.15.XI.6). Vienna. Marrë nga: (<https://www.unodc.org/doc>), shikuar më 15.09.2015.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNDOC). (2015b). *International Standarts in Drug Preventions*. Vienna. Marrë nga: (<https://www.unodc.org/unodc/en/prevention/preven>), shikuar më 20.09.2015.

Intervista me një përdorues të drogave të rënda, L.G., 24-vjeçar. Prishtinë.

Intervista me një përdorues të drogave të rënda, M.K., 32-vjeçar, Tiranë.

ARTIKUJ NGA MEDIA ELEKTRONIKE DHE TË SHKRUAR:

Blakaj,S.(2015). *Short Description on Situation of Problematic Drug Users in Kosovo and Launch of Methadone Maintenance Therapy (MMT), NGO Labyrinth*. Prishtinë. Sigurimi i materialit është bërë më 16 qershor 2015. Ky material mund të gjendet edhe në: (<http://idhdp.com/mediaimport/16996/>).

Erebara,Gj.(28 nëntor 2012). Historia e Shqipërisë 1912-2012, Marrë nga: (<http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2012/11/28>), shikuar më 15 mars 2015.

Tahiri,S.(16 shtator 2015). *Antidroga një histori suksesi*. Tiranë. Marrë nga: (<http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/fjalime/antidroga-nje-histori-suksesi-video>), shikuar më 20 shtator 2015.

Simoni,S.(30 qershor 2015,.). *Intervistë e dhënë për Top Channel nga kryetari i gjykatës së shkallës së Parë të krimeve të rënda*. Tiranë. Parë në: (<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id>).

Koha Ditore e mërkurë, 8 dhjetor 2010, Prishtinë, p. 20.

SHTOJCË

Pyetësi për nxënësit e shkollave të mesme

QËLLIMI I PYETËSORIT

Quhem Ridvan Kajtazi dhe jam kandidat për titullin doktor i shkencave juridike pranë Universitetit Europian të Tiranës. Si pjesë e studimeve të doktoratës është edhe ky pyetësor në mënyrë që hulumtimi ynë të jetë më i saktë, më domethënës dhe përmbajtësor. Në këtë kontekst kemi marrë për detyrë që të bëjë një hulumtim lidhur me tezën e doktoratës: “Narko-kriminaliteti në Kosovë dhe Shqipëri (Aspekte juridiko-penale dhe kriminologjike)”. Qëllim i këtij pyetësi është që të mbledhë informacione lidhur me përdorimin e substancave narkotike dhe substancave psikotrope (drogave) në Kosovë dhe Shqipëri. Pyetësi ju drejtohet juve si nxënës të shkollave të mesme duke u bazuar në të dhënat shkencore, se numri më i madh i përdoruesve të drogave i përket moshës ndërmjet 16-30 vjeç. Rezultatet e këtij pyetësi do të përdoren për qëllime akademike duke hulumtuar problematikën e përdorimit të drogave në shoqërinë tonë veçanërisht në Kosovë dhe Shqipëri.

UDHËZIME SE SI DUHET TË PLOTËSOHET PYETËSORI

Pyetësi përbëhet nga gjithsej 30 pyetje dhe plotësohet si në vijim:

-  Pyetësi plotësohet në mënyrë anonime dhe të dhënat tuaja do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.
-  Ju lutem që përgjigjet tuaja të jenë të sinqerta.
-  Ju do të keni kohë të mjaftueshme të plotësoni pyetësin.
-  Pyetjet të cilat kanë alternativa të përgjigjes, ju lutemi që të përcaktoheni vetëm për njërin.
-  Për pyetjet të cilat nuk kanë alternativë për përgjigje, jeni të lirë që me fjalë të përshkruani këndvështrimet tuaja.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe ju falënderojmë për përgjigje dhe bashkëpunim.

PYETËSORI

Data e Pyetësit: (___/___/2015), Numri i Pyetësit NX/ /2015/KS

A. PJESA E PËRGJITHSHME:

1. Gjinia: Mashkull: _____, Femër: _____.
2. Sa vjeç jeni sot kur ju po e plotësoni këtë pyetësor _____ vjeç.
3. Ku jetoni për momentin?
Qytet _____.
Fshat _____.
4. Cila është gjendja ekonomike apo financiare e familjes tuaj?
 - a) Dobët
 - b) Mesatare
 - c) E Mirë
 - d) Shumë e Mirë
5. Si jeni duke e vijuar shkollimin Tuaj?
 - a) Rregullisht
 - b) Jo rregullisht

B. PJESA E VEÇANTË:

6. A keni njohuri se çfarë efekte kanë drogat e shënuara më poshtë në trupin e njeriut?

DROGAT	PO	JO
Marihuana/ Bari		
Speed/Crystal Meth		
Ecstasy/MDMA		
Kokaina		
Heroina		

7. Në cilat burime besoni në lidhje me informacionet për efektet e drogave?

BURIMET	DROGAT
Shoqëria	
Shkolla	

Prindërit/të afërmit	
Artikuj/Libra	
Interneti	
Filma/TV	
Profesionistët/Këshilluesit	

8. Kur vije puna tek informacioni mbi drogat, sa ju besoni këtyre burimeve?

Burimet	1 (Nuk ju besoj shumë)	2	3	4	5 (Besueshmëri të lartë)
Shoqëria					
Shkolla					
Prindërit/të afërmit					
Artikuj/Libra					
Interneti					
Filma/TV					
Profesionistët/Këshilluesit					

9. A keni parë ndonjërin nga këto droga të listuara më poshtë?

DROGAT	PO	JO
Marihuana/ Bari		
Speed/Crystal Meth		
Ecstasy/MDMA		
Kokaina		
Heroina		
Të tjera		

10. Shoqëria e juaj e ngushtë a ka përdorur ndonjëherë ndonjërin nga drogat si më poshtë?

DROGAT	PO	JO	NUK JAM I SIGURT
Marihuana/ Bari			
Speed/Crystal Meth			
Ecstasy/MDMA			
Kokaina			
Heroina			
Të tjera			

11. A keni përdorur Ju ndonjëherë ndonjërin nga drogat e cekura më poshtë në?

	PO	JO
Marihuana/ Bari		
Speed/Crystal Meth		

Ecstasy/MDMA		
Kokaina		
Heroina		
Të tjera		

12. Nëse përgjigjja Juaj në pyetjen 11 është **“PO”**, atëherë, sa vjeç keni qenë kur ju keni përdorur ndonjërin nga drogat e shënuara më poshtë?

DROGAT	MOSHA	ASNJËHERË NUK KAM PËRDORUR
Marihuana/ Bari		
Speed/Crystal Meth		
Ecstasy/MDMA		
Kokaina		
Heroina		
Të tjera		

13. A është e lehtë të sigurohen drogat e shënuara më poshtë? (Nëse ju keni para, a mund ju, ti siguron brenda 24 orëve?)

DROGAT	PO	JO
Marihuana/ Bari		
Speed/Crystal Meth		
Ecstasy/MDMA		
Kokaina		
Heroina		
Të tjera		

14. A mendon se gjendja është “problematike” në lidhje me përdorimin e drogave nga të rinjtë në shoqërinë apo shkollën Tuaj?

DROGAT	PO	JO	NUK JAM I SIGURT
Marihuana/ Bari			
Speed/Crystal Meth			
Ecstasy/MDMA			
Kokaina			
Heroina			
Të tjera			

15. Nëse përgjigjja Juaj në pyetjen 14 është **“PO”**, çka ju shtyn të mendoni se gjendja është problematike?

16. A mendoni se shoqëria (shteti, shkolla, organizata jo qeveritare) duhet të bëjnë diçka në lidhje me uljen e përdorimit të drogave nga nxënësit e shkollave të mesme?

DROGAT	PO	JO	NUK JAM I SIGURT
Marihuana/ Bari			
Speed/Crystal Meth			
Ecstasy/MDMA			
Kokaina			
Heroina			
Të tjera			

17. Nëse përgjigjja Juaj në pyetjen 16 është **“PO”**, çka mendon se duhet të bëhet në lidhje me përdorimin e drogave?

18. Nëse ju mendoni se duhet të bëhet diçka në shoqërinë tonë, cila gjë do të jepte rezultate më të mira?

	Fuqishëm nuk pajtohet	Nuk pajtohem	I/E pasigurt	Pajtohem	Fuqishëm pajtohem
Më shumë arsimi dhe edukim	1	2	3	4	5
Më shumë këshillim dhe mbështetje	1	2	3	4	5
Legjislacion të ashpër	1	2	3	4	5
Prezenca më e madhe e Policisë	1	2	3	4	5
Të tjera	1	2	3	4	5

19. Nëse ju mendoni se diçka duhet bërë në komunitetin tonë për të pakësuar sasinë e përdorimit të drogave nga nxënësit, çfarë do të sugjeroni se mund të ketë rezultat?

20. Nëse shkolla dhe komuniteti, do të jenë të gatshëm për të krijuar një grup të veprimit në lidhje me çështjen e përdorimit të drogave nga nxënësit, a do të jeni të gatshëm, që të jeni pjesë e këtij grupi?

Po ☐

Jo ☐

21. A dini ndonjë lloj të drogës?

Po ☐

Jo ☐

22. Nëse përgjigja juaj në pyetjen 21 është **“PO”**, a mund të na tregoni se cilën drogë e njihni?

23. A u janë mbajtur ligjërata në shkollën tuaj ndonjëherë për droga dhe rrezikun nga drogat?

Po ☐

Jo ☐

24. Nëse përgjigja juaj në pyetjen 23 është **“PO”**, kush ua ka mbajt këto ligjërata?

25. A përdoren drogat ne shkollën tuaj nga nxënësit?

Po ☐

Jo ☐

26. A e vizitojnë shkollën tuaj ndonjëherë Policia?

Po ☐

Jo ☐

27. A vijnë ne shkollën tuaj persona të cilën ju ofrojnë nxënësve ndonjë lloj të drogave?

Po ☐

Jo ☐

28. Nëse përgjigja juaj në pyetjen 27 është **“PO”**, çfarë lloje të drogave u ofrojnë?

29. Çfarë mendoni ju, cilat janë rrethanat që e shpien një person të përdor narkotik?

30. A dëshironi të shtoni diçka në fund?

Dëshiroj të ju falënderojë për kohën Tuaj, në lidhje me plotësimin e këtij pyetësi. Ju bëjë me dije edhe një herë se përgjigjet e dhëna në këtë pyetësor do të mbesin konfidenciale dhe se këto përgjigje do të përdoren vetëm për qëllim të hulumtimit shkencor të temës “Narko-kriminaliteti në Kosovë dhe Shqipëri (Aspekte juridiko-penale dhe kriminologjike)”.

Pyetësi për të dënuarit dhe paraburgosurit

QËLLIMI I PYETËSORIT

Quhem Ridvan Kajtazi dhe jam kandidat për titullin doktor i shkencave juridike pranë Universitetit Europian të Tiranës. Si pjesë e studimeve të doktoratës është edhe ky pyetësor në mënyrë që hulumtimi ynë të jetë më i saktë, më domethënës dhe përmbajtësor. Në këtë kontekst kemi marrë për detyrë që të bëjë një hulumtim lidhur me tezën e doktoratës: “Narko-kriminaliteti në Kosovë dhe Shqipëri (Aspekte juridiko-penale dhe kriminologjike)”. Qëllim i këtij pyetësi është që të mbledhë informacione lidhur me faktorët që shtyjnë një person të kryejnë veprat penale nga fusha e narkotikëve, si në Kosovë dhe Shqipëri. Pyetësi ju drejtohet juve pasi që jeni personat që mund të jepni një kontribut mjaftë të madhe në parandalimin e kësaj dukurie devijante. Rezultatet e këtij pyetësi do të përdoren për qëllime akademike duke hulumtuar problematikën e përdorimit të drogave në shoqërinë tonë veçanërisht në Kosovë dhe Shqipëri.

UDHËZIME SE SI DUHET TË PLOTËSOHET PYETËSORI

Pyetësi përbëhet nga gjithsej 25 pyetje dhe plotësohet si në vijim:

-  Pyetësi plotësohet në mënyrë anonime dhe të dhënat tuaja do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.
-  Ju lutem që përgjigjet tuaja të jenë të sinqerta.
-  Ju do të keni kohë të mjaftueshme të plotësoni pyetësin.
-  Pyetjet të cilat kanë alternativa të përgjigjes, ju lutemi që të përcaktoheni vetëm për njërin.
-  Për pyetjet të cilat nuk kanë alternativë për përgjigje, jeni të lirë që me fjalë të përshkruani këndvështrimet tuaja.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe ju falënderojmë për përgjigje dhe bashkëpunim.

PYETËSORI

Data e Pyetësit: (___/___/2015): Numri i Pyetësit D/ /2015/KS/RSH

PJESA E PËRGJITHSHME

1. Gjinia: Mashkull ☐
Femër ☐

2. Sa vjeç jeni sot kur ju po e plotësoni këtë pyetësor? _____ vjeç.

3. Cili është statusi i juaj?

- a) I/E Fejuar
- b) I/E martuar;
- c) Bashkëjetojë
- d) I/E Divorcuar
- e) Tjetër: _____ (Specifiko)

4. Cila është shtetësia e juaj?

- a) Shtetas i Kosovës
- b) Shtetas i ndonjë shteti tjetër (specifiko) _____
- c) Nuk është deklaruar /refuzuar

5. Çfarë niveli të shkollimit keni?

- a) Nuk kam shkollim fare
- b) Shkollim Fillor
- c) Shkollim të Mesëm
- d) Shkollim të Lartë

6. A keni qenë i punësuar para se të arrestoheshit?

Po ☐

Jo ☐

7. Sa gjatë jeni në burg për periudhën e tanishme të burgimit?

- a) më pak se gjashtë muaj
- b) gjashtë muaj deri në më pak se një vit
- c) një deri në pesë vite
- d) më shumë se pesë vite
- e) nuk është deklaruar/refuzuar

8. Në çfarë vendi keni jetuar gjatë fëmijërisë suaj?

Fshat ☐

Qytet ☐

9. Me kënd keni jetuar gjatë fëmijërisë suaj?

- a) Dy prindërit
- b) Nënë
- c) Babain
- d) Pa asnjërin prind (me vëllezër apo motra)
- e) Te ndonjë i afërm kushëri

10. Çfarë niveli të shkollimit ka apo ka pasur e Ëma (Nëna) e juaj?

- a) Nuk ka pas shkollim fare
- b) Shkollimin fillor
- c) Shkollimin e mesëm
- d) Shkollimin e lartë (Shkollë e lartë/Fakultet/Master/Magjistraturë/Doktoraturë)

(rrumbullakosje apo nënvizoje cilën)

11. Çfarë shkollimi ka/ ka pasur i Ati (Babai) i juaj?

- a) Nuk ka pas shkollim fare
- b) Shkollimin fillor
- c) Shkollimin e mesëm
- d) Shkollimin e lartë (Shkollë e lartë/Fakultet/Master/Magjistraturë/Doktoraturë)

(rrumbullakosje apo nënvizoje cilën)

12. A kanë qenë apo a janë të punësuar prindit tuaj?

E ëma: Po ☐ Jo ☐

I ati: Po ☐ Jo ☐

13. Cila është gjendja ekonomike apo financiare e familjes tuaj?

e) Dobët	☐
f) Mesatare	☐
g) E Mirë	☐
h) Shumë e Mirë	☐

14. Në çfarë vendi keni jetuar para se të arrestoheshit?

Fshat ☐

Qytet ☐

B. PJESA E VEÇANTË

15. Sa herë keni qenë në burg, duke mos e llogaritur burgimin e tanishëm?

- a) kurrë
- b) një herë
- c) dy deri në pesë herë
- d) më shumë se pesë herë
- e) nuk është deklaruar/refuzuar.

16. Cili është statusi juaj ligjor në këtë Institucion?

- a) I/E paraburgosur
- b) I/E burgosur i dënuar i cili ka apeluar aktgjykimin
- c) I burgosur i dënuar
- d) Rast tjetër (specifikojë_____)
- e) nuk është deklaruar/refuzuar.

17. Sa është lartësia e dënimit tuaj me burg?

Ju lutem përgjigjuni kësaj pyetje nëse jeni i dënuar me burgim

- a) Më pak se një vit burgim
- b) 1 (një) vit, por më pak se 2 (dy) vite burgim
- c) 2 (dy) vite, por më pak se 4 (katër) vite burgim
- d) 4 (katër) vite, por më pak se 10 (dhjetë) vite burgim
- e) 10 (dhjetë) vite por më pak se 15 vite burgim
- f) 15 (pesëmbëdhjetë) vite e më shumë burgim
- g) nuk është deklaruar/refuzuar.

18. Para burgimit të tanishëm, a keni përdorë ndonjëherë nga drogat e shënuara në vijim, çoftë edhe vetëm një herë?

DROGAT	PO	JO	ASNJËHERË NUK KAM PËRDORUR
Marihuana/ Bari	☐	☐	☐
Speed/Crystal Meth	☐	☐	☐
Ecstasy/MDMA	☐	☐	☐
Kokaina	☐	☐	☐
Heroina	☐	☐	☐
Të tjera	☐	☐	☐

19. Nëse përgjigja juaj në pyetjen e 18, është “PO”, atëherë sa vjeçar keni qenë kur i keni përdorë këto droga për here të parë?

DROGAT	MOSHA	ASNJËHERË NUK KAM PËRDORUR
Marihuana/ Bari		☐
Speed/Crystal Meth		☐
Ecstasy/MDMA		☐
Kokaina		☐
Heroina		☐
Të tjera: _____		☐

20. Cili ka qene arsyeja që ju ka shtytë të merreni me shitjen, posedimin, prodhimin apo blerjen e drogës?

- a) Gjendja ekonomike ne familje;
- b) Problemet në familje;
- c) Shoqëria e keqe;

d) Nevoja për më shumë para (aspekti financiar);

e) Kureshtja;

f) Tjetër: _____

21. Me çfarë lloji të drogës jeni takuar nga Policia në kohën kur ju kanë arrestuar?

22. Sa është e lehtë të sigurohen drogat e shënuara më poshtë? (Nëse ju keni para, a mund ju ti siguron brenda 24 orëve?)

DROGAT

Marihuana/ Bari, Speed/Crystal Meth, Ecstasy/MDMA, Kokaina, Heroina

Të tjera: _____

a) Shumë e lehtë të sigurohen;

b) Aspak e lehtë;

23. Çfarë mendoni ju, cilat janë rrethanat që e shpien një person të kryej veprat penale në fushën e narkotikëve ?

24. A mendon se përdorimi i drogave sot paraqet problem të madh në Kosovë apo Shqipëri?

a) Po

b) Jo

c) Nuk jam i Sigurt

25. A dëshironi të shtoni diçka në fund ?

Dëshiroj të ju falënderojë për kohën Tuaj, në lidhje me plotësimin e këtij pyetësi. Ju bëj me dije edhe një herë se përgjigjet e dhëna në këtë pyetësor do të mbahen konfidenciale dhe se këto përgjigje do të përdoren vetëm për qëllim të hulumtimit shkencor të temës “Narkokriminaliteti në Kosovë dhe Shqipëri (aspekte juridiko-penale dhe kriminologjike”.

Qëllimi i Intervistës

Qudem Ridvan Kajtazi dhe jam kandidat për titullin doktor i shkencave juridike pranë Universitetit Europian të Tiranës. Si pjesë e studimeve të doktoratës është edhe kjo intervistë gjysmë e strukturuar, në mënyrë që hulumtimi ynë të jetë më i saktë, më domethënës dhe përmbajtjesor. Në këtë kontekst kemi marrë për detyrë që të bëjë një hulumtim lidhur me tezën e doktoratës: “Narko-kriminaliteti në Kosovë dhe Shqipëri (Aaspekte juridiko-penale dhe kriminologjike)”. Qëllim i kësaj interviste gjysmë të strukturuar është që të mbledhë informacione lidhur me faktorët që shtyjnë një person të përdor narkotikë, si në Kosovë po ashtu edhe në Shqipëri.

Intervista ju drejtohet juve pasi që jeni person që mund të jepni një kontribut mjaftë të madhe në parandalimin e kësaj dukurie devijante. Rezultatet e kësaj interviste do të përdoren për qëllime akademike duke hulumtuar problematikën e përdorimit të drogave në shoqërinë tonë veçanërisht në Kosovë dhe Shqipëri.

Udhëzuesi për intervistën gjysmë të strukturuar

Intervista do të përbehet nga disa pyetje andaj në vijim janë udhëzimet lidhur me këtë intervistë:

- ✚ Do të zhvillohet në ambiente apo objekt ku i intervistuari do të ndihet më mirë.
- ✚ Intervista zhvillohet plotësisht në mënyrë anonime dhe të dhënat tuaja do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.
- ✚ Intervista zgjatë jo më shumë se 60 minuta.
- ✚ Me pëlqimin e të intervistuarit, do të përdoren aparate regjistrimi audio gjatë procesit të intervistimit me qëllim që të sigurohej në mënyrë sa më të detajuar informacioni*.
- ✚ Gjatë zhvillimit të intervistave do të respektohen plotësisht të drejtat e Tuaja duke përfshirë edhe rastet për të mos u përgjigjur, kur hezitoni të flisni për gjëra që mund të jenë rënduese nga pikëpamja psikologjike për Ju.
- ✚ Në secilin rast, do të respektohet e drejta e pjesëmarrjes vullnetare në studim.

* Bashkangjitur gjeni formën e pëlqimit me shkrim të të intervistuarit për pjesëmarrje në intervistim gjysmë të strukturuar.

- ✚ Lidhur me këtë është marrë më parë miratimi me shkrim.
- ✚ Ju lutem që përgjigjet tuaja të jenë të sinqerta.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe ju falënderojmë për gatishmërinë për të kontribuar në këtë hulumtim shkencor.

PLANI I INTERVISTËS GJYSMË TË STRUKTURUAR:

- ❖ Fillimisht prezantimi i intervistuesit para të intervistuarit.
- ❖ Shpjegimi nga ana e intervistuesit për të intervistuarin në lidhje me qëllimet e intervistës gjysmë të strukturuar.
- ❖ Intervista gjysmë e strukturuar në tri faza.
- ❖ Pjesa e parë e parashtrimi të pyetjeve:
 1. Sa vjeç jeni?
 2. Cila është shtetësia e juaj?
 3. Cili është statusi i juaj?
 4. Çfarë niveli të shkollimit keni?
 5. A jeni i/e punësuar?
 6. Në çfarë vendi keni jetuar gjatë fëmijërisë suaj?
 7. Me kënd keni jetuar gjatë fëmijërisë suaj?
 8. A kanë qenë apo a janë të punësuar prindit tuaj?
 9. Cila është gjendja ekonomike apo financiare e familjes tuaj?
- ❖ Pjesa e dytë e parashtrimi të pyetjeve:
 10. Çfarë mendoni ju, cilat janë rrethanat që nxisin një person të përdorë drogë?
 11. Çfarë mendon se duhet të bëhet lidhur me parandalimin e kësaj dukurie?
 12. A mund të tregosh, sa vjeç keni qenë dhe si keni filluar të përdorni drogë për herë të parë?
 13. Çfarë ju ka shtyre juve të përdorni drogë?
 14. Çfarë lloj të drogave keni përdorur?
 15. A ka krijuar përdorimi i drogës probleme në mes jush dhe familjes tuaj?
 16. A jeni futur në përleshje apo probleme kur keni qenë në ndikim të drogës?
 17. A jeni marr me aktivitete të kundërligjshme në mënyrë që të siguronit drogë për vete?
 18. A keni qenë i arrestuar për shkak të posedimit të drogës?
- ❖ Faza e tretë, mbyllja e intervistës:
 19. A dëshironi të shtoni diçka në fund?

PËLQIMI ME SHKRIM I TË INTERVISTUARIT PËR PJESËMARRJE NË INTERVISTIM GJYSMË TË STRUKTURUAR.

I nderuar studiues,

Unë pranoj të marrë pjesë vullnetarisht në studimin tuaj mbi jetën time lidhur me përdorimin e drogave. Unë deklaroj se të gjitha përgjigjet duhet të jenë konfidenciale dhe se mund të tërhiqem nga studimi në çdo moment.

Firma e të Intervistuarit:

Data

Shënime

ⁱ Sativa prejardhjen e ka nga Kolumbia, Meksiko, Tajlanda dhe Azia Juglindore.

ⁱⁱ Indica është tradicionalisht burim i hashashit, kurse prejardhjen e ka nga Maroku dhe Afganistani.

ⁱⁱⁱ Ruderalis prejardhjen e ka nga Rusia, Polonia dhe shtete të Europës Juglindore.

^{iv} Në Konventën ndërkombëtare për substancat psikotrope e vitit 1971, janë të bashkangjitura 4 lista me substanca psikotrope që janë nën kontroll ndërkombëtar:

Lista numër I, përfshin disa nga këto substanca psikotrope me emër të pambrojtur ndërkombëtar: Psilocybine, Tenamfetamine, Tenocyclidine etj.

Lista numër II, përfshin disa nga këto substanca psikotrope me emër të pambrojtur ndërkombëtar: Amfetamine, Metamfetamine, Phencyclidine etj.

Lista numër III, përfshin disa nga këto substanca psikotrope me emër të pambrojtur ndërkombëtar: Amobarbital, Cathine, Flunitrazepam etj.

Lista numër IV, përfshin disa nga këto substanca psikotropike me emër të pambrojtur ndërkombëtar: Aminorex, Barbital, Bromzepam, Diazepam, Mazindol etj.

^v Më 8 gusht 2011, Prokurori Publik, Kristijan Hatlo, deklaroi për Radion norvegjeze se: “Analizat e gjakut të Anders Bering Breivikut, tregojnë se ai ka qenë nën ndikimin e narkotikëve, kur e ka kryer masakrën masive në ishullin norvegjez Utoja”. Mirëpo prokurorit të përmendur i mungoi dëshira të zbulonte se për cilin lloj droge bëhej fjalë në këtë rast.